

ARAN Cucine Store
Blv. Gjergj Fishta, Nr 146
TIRANE_ALBANIA
© +355 68 2067733
✉ cucinatua@gmail.com

**OUR WORLD
INTO YOUR KITCHEN**

 **ARAN**
CUCINE

S T O R E





The Plaza Tirana 5 Star Hotel, at the city center!

Rr. 28 Nentori, Tirane AL ♦ +355 (0) 422 112 21 ♦ info@plazatirana.com ♦ www.plazatirana.com



MEDIUS

Histori me mite apo mite historike?

Do të ishte krejtësisht e lehtë të binim të gjithë dakord se lufta për të njohur botën dhe vetveten kanë qenë betejat dhe aventurat më të mëdha shpirtërore të njeriut. Në këtë luftë njeriu shpesh ka anuar nga ajo që dëshiron të jetë dhe jo nga ajo që ai ka qenë apo që ka mundur të jetë. “Shpjegimi historik nuk është thjesht shpjegimi i ngjarjeve që pasojnë njëra-tjetrën, porse nxjerrja në pah e kuptimit të tyre... sa më mirë që ta demonstrojë karakterin e domodoshëm të një ngjarjeje, të një veprimi, të një personaliteti, aq më mirë e ka kuptuar studiuesi ngjarjen, aq më i thellë mendimi i tij dhe më pranë të së vërtetës përfundimtare gjithëpërfshirëse” shprehet filozofi Izajah Berlin në librin e tij “Idetë politike të shekullit XX dhe katër ese për lirinë”, duke treguar dy rrugët që ndajnë këndvështimet mes konceptit shpirtëror sipas Hegelit dhe konceptit tërësisht material sipas Marksit.

Në fakt, “Historia është e prirur të vetëfshihet”, shprehen historianët, duke iu referuar “mungesës së fjalëve” që shpesh shoqëron faktet. Ky duket se ka qenë shtrati më i sigurt ku janë ngjizur edhe interpretimet e ndryshme që herë kanë shtrirë dorën nga mitet, herë nga ideologjitë. Popuj të mëdhenj apo të vegjël kanë kthyer sytë te mitet për të ndërtuar të shkuarën e tyre, sidomos kur nuk kanë gjetur mjaftueshëm dokumente. Sociologu Emile Durkheim shprehej se “në qoftë se nuk ka njohuri objektive, shoqëria mundet ta njohë vetveten vetëm nga përbrenda. Ajo përpqet të shprehë këtë sens të vetvetes dhe ta përdorë atë si udhëzues. Me fjalë të tjera, ajo mund të sillet duke iu referuar një përfaqësimi të të njëjtit lloj me ato që përbëjnë të vërteta mitologjike”. Sipas Durkheim mitet nuk kalojnë nga verifikimi apo dyshimi, por nga koncepti i njëzëshëm që fitojnë, duke u kthyer më pas në autoritare dhe vetimponuese.

Iluminizmi, humanizmi, marksizmi, progresizmi, sekularizmi, pozitivizmi e shumë rryma të tjera të mendimit kanë lënë pasojat e veta në rishkrimin e historisë, padyshim edhe në gjykimin apo interpretimin e miteve, që shpesh mund të jenë shkak për pajtime apo për luftë. Shoqëria shqiptare nuk u ka shpëtuar këtyre këndvështrimeve mbi mitet dhe historisë, sidomos në kohën e komunizmit, ku gjithçka i përshtatej oreksit ideologjik të kohës, duke fshehur thellë e më thellë fakte apo interpretime krejt të ndryshme deri në atë kohë lidhur me mitologjinë apo faktet historike. Rishkrimi i të dhënave rreth figurave historike apo i disa miteve mbi të shkuarën, mbi origjinën, vijnë të jenë në Shqipëri burime të pashtershme debatesh. Shpesh, askush nuk pyet as për metodologjitë e as për të vërtetat faktike, duke i dhënë udhë edhe më shumë idesë se bindja e thellë mund të zhbëjë çdo fakt. “Medius” sjell në këtë numër një sërë vështrimesh mbi raportin e mitit me historinë, ndarjes së logosit nga mitin, debatin mbi heronjtë e dikushëm dhe të sotëm, duke u mbështetur në nevojën që kemi për të njohur jo vetëm veten, por edhe botën.



AGIM BAÇI
KRYEREDAKTOR

KUJTESA 'E RRËFYEME' E BARLETIT – NGA MITI NË HISTORI

Vehbi Miftari

98



MODELI MONOHEROIK SHQIPTAR PËRBALLË MODELIT POLIHEROIK EUROPIAN

Ardian Muhaj

130



88 MITET PËR TA ZBUKURUAR VETVTEN DHE ATO PËR TA SHËMTUAR TJETRIN!

Kim Mehmeti



106 PROBLEMI ËSHTË PROGRESI


Fitim Zekthi



Përgjatë historisë bota ka njohur mizorinë e Neronit, dhunën dhe masakrat e Alarikut apo të Atilës, djegien e qyteteve nga Xhengis Khani, plaçkitjet dhe plojën e kryqëzatave, krimet e Kortezit ndaj aztekëve dhe banorëve indigjenë etj., por bota nuk ka njohur asnjëherë krime më të patregueshme sesa ato të komunistëve dhe nazistëve, të Leninit, Stalinit, Pol Potit, të Maos, Hitlerit etj.

32 HAKMARRJA DHE IRONIA E HISTORISË

Ergys Mërtiri



80 MITET RRETH ADAMIT

Selami Xhepa

50 HISTORY IS A NIGHTMARE FROM WHICH I AM TRYING TO AWAKE

Armand Bora



138 ROLI I TEKNOKRATËVE NË TRANZICIONIN E SË DREJTËS

Fabian Zhilla

18

HISTORIA E GABUAR E "TË MIRIT" DHE "TË KEQIT"

Blendi Fvezui



8

NJERËZ DHE VEGLA

Doan Dani



44 HISTORIA ESENCIALE SI RRUGË E TRETË MIDIS MITIT DHE LOGOSIT

Klementin Mile



MEDIUS

BOTIM I INSTITUTIT MEDIUS

BOTIMIT NR.02
VITI I BOTIMIT 2018

KORRIK-SHTATOR 2018

KRYEREDAKTOR

Agim Baçi

BORDI EDITORIAL

Redi Shehu
Kim Mehmeti
Milazim Krasniqi
Armand Bora
Emine Sadiku
Fitim Zekthi
Ergys Mërtiri
Doan Dani
Fabian Zhilla

DESIGN

Rudin Janku

SHTYPSHKRONJA

Mediaprint

COPYRIGHT 2018

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Instituti i Komunikimit "Medius". Përmbajtja nuk mund të riprodhohet, shitet ose transmetohet pa lejen e "Medius".

PER KONTAKTE

Adresa: Rruga "3 Dëshmorët",
Pallati "Beta" 4/5
Tiranë/Albania
E-mail: info@mediusinstitute.com

INTERVISTA

24

Pse duhet ndarë Skënderbeu si mit/e nga historia e tij

Miti duhet, por ai edhe duhet kuptuar, edhe duhet ndarë nga historia. Skënderbeu i "kërkimit shkencor" duhet parë si histori, pasi çdo popull ka nevojë të rritet dhe të njohë historinë e vet si shkencë, me fakte dhe dokumente dhe jo si një të vërtetë të pandryshueshme.

Fatos Lubonja

64 MIDIS TRADITËS DHE MEDIAVE:
TRUALLI I MITEVE MODERNE
SHQIPTARE/ MITI I PUSHTETIT
Diana Kastrati

150 MITET DHE
REALITETI I
URRETJES
Agim Baçi

118 NJERIU DHE
" E VËRTETA
HISTORIKE"
Redi Shehu





NJERËZ
DHE
VEGLA



DOAN DANI

Rrungaja me ithtarë të verbër, të gjymtuar, me një këmbë në varr ose pa këmbë fare, pa shëndet, pa arsim, pa kallo në duar ose pa duar fare, me të cilën bymehet ushtria revolucionare e Njerëzve të Rinj apo të rinuar nga biopolitika e regjimit, të transporton sa në atmosferën e Kryqëzatës së V (1217) - kur legati Robert i Courçon ftonte «fëmijë, pleq, gra, gjytrymë, qorra, shurdhë e të gërbulur» për t'u shëruar e shëlbuar në Tokën e Shenjtë - sa në parodizimet e shumëfishta të Mario Monicelli-t.



TEMPULLI I RI

Në fundin e vitit 1963. «Me kenë se unë, siç e dini edhe ju, jam i verbët, pa asnji të ardhun e as ndihmë prej kuej, me rastin e pushimit nga puna mbetem shumë keq ekonomikisht, për arsye se nuk jam në gjendje me krye kurrfarë punet tjetër vetëm se shërbyes në xhami. I dëshpruem nga ky komunikim, prap se prap, mbetem me shpresë se lutja ime do të merret parasysh dhe do të keni mirësin që të mos më leni pa sigurue të pakten buken e gojës». Kështu i drejtohej KMSH-së, tashmë tërësisht në morsën e shtetit, «Hafiz Riza Myrto Mani, shërbyes si mezin në xhaminë e Rusit Maxharr», për të mos i ndërprerë «shpërblimin prej 1000 lek» (të vjetra) në muaj. Ai bashkë me Hafiz Qazim Rakiqin, gjithashtu i verbër, erdhën në vitet '90 si të vetmit hafizë, të paktën në zonën e Shkodrës, të mbijetuar nga deflagracioni totalitar, për të dëshmuar vazhdimësinë e traditës - pa akte heroizmi homerik - dhe aftësinë e njeriut për të konservuar dinjitet, një vete reale koherente e mbi të gjitha njerëzillëk edhe në kushte ekstreme.

Katër vjet më vonë. Një foto emblematike e nëntorit të 1967, e qarkulluar gjithandej në aparatin propagandistik të kohës, fikson të verbrin Fuat Çela teksa shkruan fjalën "Parti" nën shikimin taumaturgjik të Enver Hoxhës. Është apoteoza e spektaklit ngashënjes me personazhin Fuat Çela që në atë çast merr pjesë në përmbylljen e procesit të transformimit - të nisur, publikisht, disa muaj më parë, gjatë zellit aksionist në ndërtimin e hekurudhës Rrogzhinë-Fier - përmes shënimit të logosit Parti, hyjnesha imanente, e cila shpeshherë shoqëron nënën biologjike në tekstet për fëmijë (ku babai biologjik është në deflacion dhe rolin e tij e mbulon Udhëheqësi), ilustron me rreze diellore, me

dritën e pishtarit dhe, në raste endemike, përfytyrohet me trajta femërore, siç e përshkruan pensionisti lezhjan Mark Mula, i cili, ndonëse i dëshpëruar nga pamundësia për t'iu përgjigjur pozitivisht zërave (të zemrës) «çohu mos rri, marsho me punëtorët», ndjehet i lumtur që «nuk vdes me marak», sepse fëmijët e tij «ngelen me një babë akoma ma të mirë dhe me një nanë gji pashterrun për ta: me Partinë, me Enverin» (Mark Mula, Edhe zemrat e ne pleqve tingëllojnë me kohën, tingëllojnë si gjithnjë të reja, «Bashkimi», 24.11.1967). Dhe Demiurgu i Shqipërisë së Re, disa ditë para momentit solemn të dëshmisë publike që shndërron Fuatin në shokun Fuat, konkretisht përmes një letre të datuar më 15 nëntor, demonstroi tek i riu nga Vërzhezha gjithë fuqinë hyjnore të Partisë, pa aliazhin 'dhë e pështymë' (Gjoni 9:6-7): «Ti, shoku ynë i shtrenjtë Fuat pa sy, ndjen, mendon, lufton dhe shikon me ndjenjat, me mendjen, me stilin luftarak dhe me syrin shqiponjë të partisë sonë» (Përpara, me vullnetin e partisë, me mendjen e kthjelltë të partisë, me sytë e ndritshëm të partisë, «Bashkimi», 15.11.1967). Nga ana tjetër, në letrën e tij, datuar 10 nëntor - për t'u nënvizuar është ekspozimi i letrave në gazetë: letra e Hoxhës, megjithëse përgjigje e një letre pararendëse, është pozicionuar lart, gjë e cila transmeton parësinë e liderit dhe përparësinë e kumtit - Çela i premtori Udhëheqësit pikërisht mposhtjen e handikapit fizik, e jo më kot propaganda e ditëve në vijim e vendos atë brenda një narrative vepruese: merr pjesë në mbledhje, "shkruan" fletërrufe, diskuton, këndon «këngë lufte e pune» dhe sigurisht punon (Edhe pse pa sy, ti je ushtar i pararojës, je një flamur për të gjithë, «Bashkimi», 23.11.1967).

ARMATA BRANCALEONE

Euforia kolektive vërshon nga të gjitha skajet dhe shtresat e humusit shqiptar. «Invalidët e portit detar të Durrësit shkruajnë: “[...] kemi shumë për të mësue nga shebulli heroik i shokut tonë Fuat, të cilin dielli i shkëlqyeshëm i partisë sonë dhe mësimet Tueja e bënë ushtar heroik e të papërkulur për çështjen e socializmit [...]. Trembëdhjetë nga ne filluan menjëherë punën në ngarkim-shkarkim [...], të tjerët nga ne do të punojnë vinxhiera në vapore, në punë bujqësore dhe në punë të tjera konkrete” (Akti i Shkurte Pal Vatës dhe vullneti i të riut Fuat Çela po shtojnë vrullin dhe entuziazmin e punonjësve, «Bashkimi», 28.11.1967). «E si të mos kërkojmë ne të shkojmë në frontet më të vështira, i shtrenjti shoku Enver», shkruan një grup të rinjsh nga Gjirokastra, «kur shikojmë punën dhe luftën që bën Fuat Çela, që është trim mbi trimat, se është pa sy, në një kohë kur ne jemi të fortë e të shëndetshëm» (Shembulli i të rinjve revolucionarë Shkurte Pal Vata dhe Fuat Çela, burim frymëzimi për të gjitha masat dhe rininë e vendit, «Zëri i Popullit», 24.11.1967). Në Kukës, një pensionist 68-vjeçar premtan se «do ta mposht pleqërinë»; në Mjedë (afër Shkodrës), kryetarja e kooperativës Prenusha Lleshi krenohet me 300 ditët e punës të regjistruara nga një bashkëfshatar i saj «invalid me një këmbë»; një traktorist nga Librazhdi deklaron se do të punojë «edhe natën, po të jetë nevoja», dhe krahas punës (ditën e natën) zotohet se «do të mbarojë edhe shkollën 8-vjeçare» (në një dimension kohor përtej natës e ditës), ashtu si blegtori nga kooperativa e Spathares, i cili, përveç përfundimit të shkollës, «me vullnetin për t’i dashur dhentë», i mbrujtur nga shembulli i shokut Fuat, zotohet «të rrisë përqindjen e lindjeve nga 85 në 97» (ATSH, Mësimet jetëdhënëse të partisë po rritin e shtojnë çdo ditë heroizmin e masave, «Bashkimi», 22.11.1967). Megjithëse i është propozuar të punojë «me ditë



pune fikse, si roje fushe apo roje magazine», ngaqë ka humbur dorën e majtë në fëmijëri, Shaban Taragjini nga Shinapremjta e Gramshit refuzon dhe kërkon të aktivizohet «në prashitje, në mbjelljen e patateve, në vaditje, në plehërimin e tokës», e me këtë vrull, vetëm brenda 8 muajve të 1968, regjistron «240 ditë pune» (Shembulli i lartë i një të riu revolucionar, «Zëri i Popullit», 23.01.1969).


Runqaja me ithtarë të verbër, të gjymtuar, me një këmbë në varr ose pa këmbë fare, pa shëndet, pa arsim, pa kallo në duar ose pa duar fare, me të cilën bimehet ushtria revolucionare e Njerëzve të Rinj apo të rinuar nga biopolitika e regjimit, të transporton sa në atmosferën e Kryqëzatës së V (1217) - kur legati Robert i Courçon ftonte «fëmijë, pleq, gra, gjytyrymë, qorra, shurdhë e të gërbulur» për t’u shëruar e shëlbuar në Tokën e Shenjtë - sa në parodizimet e shumëfishta të Mario Monicelli-t. Është përgjigja reale e pyetjes që, nga letra dërguar Çelës, Hoxha injekton në vetëdijen e çdo «të madhi e të vogli»: «Kur i verbri Fuat Çela, me vullnetin e tij të çeliktë, zbaton në mënyrë të mrekullueshme vijën e partisë dhe korr rezultate të mahnitshme, atëherë

“ **Mes errësirave të vrara ishte domosdo edhe feja, bashkë me klerin dhe vendet e praktikës publike të saj, deri në ndalimin përfundimtar (de facto në 1967, de juro në 1976).** ”

ç’duhet të bëj unë që i kam sytë në vend?». Unit nuk i mbetet tjetër veçse të konformohet, sipas devotshmërisë së ideal-tipit Fuat, dhe të verbohët, sigurisht nga ekstaza për dritën, siç ndodhi me Nikollë Çekajn, i cili, «kur u bë elektrifikimi i plotë i vendit më të skajshëm të Atdheut tonë të dashur, Kelmendit malor, mori pushkën e kandilin dhe doli në qendër të fshatit ku ishin grumbulluar i madh e i vogël për të festuar së bashku festën e dritës [...], vendosi kandilin afro 100 metra larg dhe», pasi e mori në shenjë, «e qëlloi tri herë radhazi», ndërsa «gojë të këqija e përqeshën duke i thënë se tash po të duhet kur të prishen dritat», por «Nikolla ua sqaroi të gjithëve se kur e thonë fjalën Partia dhe shoku Enver nuk e luan as topi», dhe për më tepër «Partia ka thënë ta vrasim errësirën, siç e vrava» (Sokol Pepushaj, Dritë është jeta jonë, «Jeta e Re», 13.10.1984).

Mënyra e parë, më e natyrshme për fitimtarët në pushtetet e dala nga gryka e pushkës, është elimini-mi, si në rastin -real, demagogjik a simbolik - i kandilit. Mënyra e dytë është asgjësimi: «fesë i kemi thyer këmbë e duar, por duhet t’i thyejmë edhe kokën», titullohet kapitulli i një artikulli (1970) të Hulusi Hakos. Si në sferën e objekteve, ashtu edhe

në atë të subjekteve shprehet me zhdukje të pranisë dhe dëshmisë fizike (rrafshim, varrim i zëvendësuar nga groposja). Zhvarrosja dhe hedhja e eshtrave të Atë Gjergj Fishtës në lumë është ndër ilustrimet më të skajshme, sepse kemi të bëjmë me dhunim të varrit, të cilin eksperiencia e njerëzimit e ka brendësuar e trashëguar në formë arketipale si tabu. Në narrativën e pas 1990-tës për të sajuar sinonimi, mes heronjsh të lavdishëm apo mes fazash historike të demonizuara - rasti i Fishtës është krahasuar me rastin e Skënderbeut, por ajo çka mëton të përçojë Marin Barleti me zhvarrosjen e heroit - duke e marrë për të vërtetë këtë pjesë të apologjisë së tij - është tërësisht e kundërta: tjetërsimi në një masë reliktesh adhurimi, siç ndodh(te) në traditën kishtarë që Barleti përfaqëson. Më afër rastit të Fishtës, edhe pse shumë herë më i sofistikuar, është Sinodi i kufomës, organizuar në 897 nga papa Stefano VI për të ndëshkuar paraardhësin e tij, i cili kish vdekur prej disa muajsh. Formoso u zhvarros, u vesh dhe u stolis me të gjitha salltanetet, u pajis me një avokat diakon dhe, mes një auditori me kardinalë e ipeshkëv në Bazilikën e Shën Gjorit në Lateran, u akuzua për ambicie e uzurpim të fronit papnor. Pasi e shpalli kufomën fajtorë, gjyqi e dënoi me heqje të rrobave zyrtare, me prerje të tre gishtërinjve të dorës së djathtë dhe me flakje në lumin Tevere. Elementi që i shtohet këtu degradimit në asgjë është poshtërimi i të mundurit nga fitimtari, megjithëse, zakonisht, historia dëshmon për shembuj antagontësh akoma në



jetë (Çezari ndaj Verçinxhetoriksit, Timuri ndaj Bajazitit I).

Të njëjtin rezultat, natyrisht pa spektaklin e këtij gjyqi, synon rrafshimi i varrezës myslimane të lagjes Zdrale (Shkodër), me qëllim ngritjen e stadiumit (një pjesë u shtri mbi prona private) dhe tjetërsimin e gurëve të varreve në shkallë-ndenjës: ekzistenca në këtë rast, e materializuar te memoria që përçojnë varret, tolerohet vetëm sepse u nevojitet mekanizmave të poshtërimin. Dhe esenca e lënies së Hafiz Rizait në vegjetimin «për bukën e gojës» është tjetërsimi i tij në vegël (siç është Çela në kahun tjetër), me të cilën synohet poshtërimi i trashëndencës, fillimisht në ambientin publik (feja) dhe pastaj në atë individual (besimi). Kështu ngadhënjyesi mund ta shpalosë triumfin me pyetjen cinike: ku është Zoti yt? «Po si shpjegohet që tamam “vendet e tija të shenjta” dhe njerëzit e tij “të besuar” kërcënohen nga

perëndia, dhe për t’u ruajtur nga ajo kanë kërkuar ndihmën e njeriut dhe shkencës duke vënë rrufepritëse?», pyet gazeta Zëri i Rinisë në komentin - botuar më 1961 me titullin - «e shenjtë» kërkojnë mbrojtjen e njeriut kundër “zotit” - e fotove të xhamisë së Et’hem Beut dhe të kishës ortodokse në Tiranë. Përgjigjet e këtij cinizmi fillojnë me ndajfoljen pra. Ilariteti në sallë është i garantuar: «Ti u matufepse fare Zeus / Ti me rrufe akoma gjuan qytetet / Megjithëse rrufetë e tua



Shpersonalizimi - një nga tiparet më karakteristike të historisë dhe historiografisë shqiptare - ia ka reduktuar individualitetin tek emri dhe **e ka shndërruar në koordinatë, specifike në pozicion por e njëjtë në përmbajtje.**

/ Me anë të rrufepritësave / Njerëzit i kapin / [...] Dhe Vullkani / Përgjegjësi “NISH prodhimit rrufeve” / Vështron si mundohet zoti i tij / [...] Dhe prapë gjuan Zeusi / Me rrufetë, armë të demoduara / Por ti, o gjen-erata ime, qesh dhe qesh / Grindet Zeusi / Por shumë plak është Zeusi / Ndaj s’ia vëmë vesh» (Ismail Kadare, Shënime për brezin tim, «Zëri i Rinisë», 4.02.1961). Në fakt kulmimi i komikes është vetë simulakri njerëzor ‘shoku Fuat’, kallëpi i çdo-gjékafshe tjetër të fabrikuar nga biopolitika taumaturgjike e regjimit, ndërsa Fuati mbetet personazhi mbase më tragjik.

SHIJA E METAFORËS

Dy personazhet qendrore te “Bij të tokës”, punim i Dhimitraq Trebickës në 1976 (në një pullë poste prej 25 qindarkash tabloja emërtohet “Zotër të tokës”), pozojnë, natyrisht të gëzuar, mbi dheun e përmbysur nga traktorët në sfond, përpara një sofrabezi të begatë - plot fruta, pije, gjellë e duhan. «Vrull i ri në punë për të plotësuar para afatit detyrat dhe zotimet» është titulli slogan i gazetës më propagandistike të regjimit, të cilën ekspozon mesoburri në të majtë, nga pozita simbolike e atit, e ruajtësit dhe e përçuesit të ligjit, të fjalës, të drejtimit, të rendit, teksa i riu përbri, në momentin e prerjes së bukës industriale të shtrënguar fort në gjë, shoqëron me po aq patos kënaqësinë - e dhuruar nga plastika e fytyrës - për planet që janë duke u realizuar, prej ku lexohet garancia e prosperitetit të Tokës socialiste, çka përbën edhe qëllimin kryesor të piktorit. Gjithçka paraqitet në përcjellore: dy personazhet duke veguar, traktorët duke lëruar, fëmijët duke luajtur, ca njerëz thellë në sfond duke punuar, shtylla e tensionit të lartë duke ndriçuar (!), ashtu si vetë atdheu. Pothuajse gjithçka, sepse akti i të ushqyerit, më i pritshmi në këtë ikonografi, refuzohet nga një ngrirje në çastin që sapo duhej të fillonte: megjithëse përballë një sofrabezi të

begatë dhe pas një pune të lodhshme, askush nuk është duke ngrënë.

Funksioni metonimik i ushqimit karakterizon imazhin dhe narrativën e propagandës dhe historisë sakrale (lufta çlirimtare, nga lashtësia deri në 1939-44, dhe lufta për ndërtimin e socializmit). Në këto kontekste të sakralizuara nga politika, e vjetra, e ndryshmeja, e huaja, armiku apo Tjetri, në përgjithësi, e komunikojnë të keqen edhe përmes ushqimit. Jemi mësuar me imazhin ose përshkrimin e ballistit, beut, pashait, pushtuesit, tradhtarit, feudalit, kapitalistit e jo pak herë të klerikut të dhjamosur, që jepet pas kënaqësive trupore. «Tradhtarët e vatanit [ballistët] / Vijnë rreth hotel Ballkanit [Vlorë] / Shuan verën e dyqanit / Vozat e Pavlo Bezhanit», thoshte një rimë, me gjasë e viteve të Luftës së Dytë Botërore (Jorgo Panajoti, Humori dhe satira popullore gjatë luftës nacional-çlirimtare, «Pionieri», n. 6, 1972, f. 11). Sali Protopapa, me të cilin Dritëro Agolli rrënjosi ballistin ideal në memorien kolektive shqiptare, ka të paktën meritën e standardizimit të fjalës kukurrec. Nga episodet e shfaqjes së ushqimit në filmin “Skënderbeu” vetëm njëri i përket kategorisë ‘Ne’, dhe aty është i pashmangshëm sepse, përveç simbolit të mikpritjes, plotëson atmosferën e dasmës së vetme të filmit. Në shumicën e vjershave satirike të Bik Pepës në librin “Feja lakuriq”, botuar në 1967, antiheronjtë (gjithmonë klerikë) parodizohen duke flirtuar me ushqimin (e jo vetëm). Edhe te “Kështjella” e Ismail Kadaresë vetëm armiku përshkruhet në aktin e të ushqyerit, megjithëse në këtë rast, përveç barbarizimit të Armikut, synohet tëhuajsimi i çdo reminiscence të tij. Piro Misha është dhe më i qartë. «Më thoshte mua im atë, ndjesë pastë, kur turqit pushtuan qytetin tonë, e di ti se ç’ishte gjëja e parë që bënë? [...] Morën tërë vëren që gjetën, nga ishte nga s’ishte, e derdhen dhe vaditen me të udhët e dheun, aq sa s’të zinte syri gjë tjetër veçse pellgje vere, që dukej si gjak [...]. E po atë mbrëmje, që thua ti, turqit kishin nxjer-

rë në shesh të qytetit ca kazanë të mëdhenj të mbushur me pilaf e i kishin detyruar të gjithë ç'ishin, me të mëdhenj e me të vegjël, të kalonin vargan para tyre e të hanin pilaf» (Piro Misha, Për mallin e tokës, 1981, f. 63-64).

«Njeriu i parë u dëbua nga Parajsa [...] për shkak se iu nënshtrua barkut e jo Zotit», mendonte Shën Jeronimi (Massimo Montanari, Alimentazione e cultura nel medioevo, 2012, f. 4). E megjithëse e konsideronte të ushqyerit si portë vesesh për shpirtin, ai nuk ia mohonte domosdoshmërinë, por këshillonte agjërimin, si rrugë afrimi me Zotin. Modeli heroik i Njeriut të Ri shqiptar e shpie në ekstrem këtë praktikë: ai është përherë agjërueshëm. Është imunizuar nga dëshira dhe nevoja. Njeh vetëm detyra e zotime. Shpersonalizimi - një nga tiparet më karakteristike të historisë dhe historiografisë shqiptare - ia ka reduktuar individualitetin tek emri dhe e ka shndërruar në koordinatë, specifike në pozicion por e njëjtë në përmbajtje: të gjithë riprodhojnë shokun Fuat të radhës dhe anasjelltas; të gjithë jetojnë për të punuar dhe përmes punës shprehin devotshmërinë, ndryshe nga njeriu i anatemuar si i vjetër i cili njeh dhe pranon limitet, punon për të jetuar dhe jeton duke adhuruar. Imuniteti ndaj nevojave, i shprehur nga indiferenca ndaj të ushqyerit dhe ndaj limiteve fiziologjike (mosha, funksionet trupore), e ka tjetërsuar edhe në trajtat njerëzore. Dilema e Primo Levit nëse kish mbetur ose jo (moralisht) njeri në eksperiencën e kampit të përqendrimit këtu thjeshtohet te bios-i. A është biologjikisht njeri i verbër që nga 30 ditët e një muaji punon 47, që këtë angazhim e quan lumturi, që sapo kthehet në shtëpi në darkë, pasi ka kaluar më parë nga vatra e kulturës, i gëzuar i kërkon së motrës t'i lexojë «ca pjesë nga fjalimi i shokut Enver në Kongres» (Edhe pse pa sy, cit.)? A është njeri bariu që zotohet se «nga çdo dele do të sigurojë një



Një foto emblematiske e nëntorit të 1967, e qarkulluar gjithandej në aparatin propagandistik të kohës, fikson të verbrin Fuat Çela teksa shkruan fjalën “Parti” nën shikimin taumaturgjik të Enver Hoxhës. Është apoteoza e spektaklit ngashënjes me personazhin Fuat Çela që në atë çast merr pjesë në përmbylljen e procesit të transformimit - të nisur, publikisht, disa muaj më parë, gjatë zellit aksionist në ndërtimin e hekurudhës Rrogozhinë-Fier - përmes shënimit të logosit Parti, hyjnesha imanente, e cila shpeshherë shoqëron nënën biologjike në tekstet për fëmijë (ku babai biologjik është në deflacion dhe rolin e tij e mbulon Udhëheqësi), ilustruohet me rreze diellore, me dritën e pishtarit dhe, në raste endemike, përfytyrohet me trajta femërore, siç e përshkruan pensionisti lezhjan Mark Mula, i cili, ndonëse i dëshpëruar nga pamundësia për t’iu përgjigjur pozitivisht zërave (të zemrës) «çohu mos rri, marsho me punëtorët», ndjehet i lumtur që «nuk vdes me marak», sepse fëmijët e tij «ngelen me një babë akoma ma të mirë dhe me një nanë gji pashterrun për ta: me Partinë, me Enverin»

qengj»? Patjetër që ky bios merr kuptim në një regjim me obsesionin e nënshtrimit të Natyrës.

SHPATAT DHE GARUZHDA

«Unë i peshoj mirë forcat e mia dhe kam parasysht madhësinë e punës dhe lëndën e gjerë për t'u shkruar, e cila do të duhej të trajtohej nga një penë më me fat dhe do të kërkonte, siç u dëgjua të ankohej dikur për veten e tij Aleksandri, një lavdëtar më bilbil se unë», shprehet disi me dëshpërim Marin Barleti në hyrjen e epopesë së Skënderbeut. Këtë mangësi e përmbush, paradoksalisht, historiografia zyrtare, e cila tejkalon edhe imagjinatën mitologjike të rilindësve, duke prodhuar një simulakër të njerëzores, që lidhjen me mitin e ruan vetëm te funksioni (themelues, kundërperfaqësues, modelues). Me fjalë të tjera, Skënderbeu - gjithmonë duke qëndruar në pedestalin e Heroit - sa më shumë që i largohet punishtes së Barletit aq më pak ngjan njerëzor. Edhe kur përshkruan gjeste heroike, në limitet e të besueshmes, Barleti e ruan, me ose pa vetëdije, dimensionin njerëzor.

Një pasazh polisemik i narrativës barletiane mund të shkëputet nga ngjarjet e 1443, aty ku nis epopeja, kur Skënderbeu rilind. «Fuqitë e krishtera ishin gjithashtu të rëndësishme si nga numri, si nga trimëria e ushtarëve dhe e komandantëve; ata kishin 35 mijë luftëtarë. Veç këtyre, me ta ishte edhe Huniadi [...]. Por trimërisë së tyre ia preu hovin puna që pjesa më e madhe u shtri nga një sëmundje e papandehur, për shkak se ushtarët, ngaqë u mungonte buka, ushqeheshin me grurë të zier e ky farë ushqimi u shkaktoi një të hequr çurkë të barkut». Si rrallëherë Barleti i jep hapësirë (edhe) ushqimit, madje në një dualizëm: nga njëra anë lufta si mjet i ekspozimit të vendosmërisë, trimërisë, virtytit, vlerave, e nga ana tjetër ushqimi si mjet i mbijetesës;

lavdia dhe banalja, shpirti dhe trupi, ideali dhe nevoja, sakralja dhe profania. E nëse filtri kërkon një dualizëm qytetërimesh, me barbarinë përherë nga Orienti, ç'gjurmë qytetërimi mund të rrezatojë kampi i këtejme? Jo vetëm që funksionet organike janë pranishme, por kanë forcë që t'i kushtëzojë vlerat, ngjarjet dhe historinë. A nuk ndodhi që njeriu i parë, në traditën e Barletit, prej mollës zbuloi seksualitetin dhe njëherësh u flakërua nga Edeni? Episodi është fshikullues për një historiografi të qepur pas gjeesteve në limitet e njerëzores: për pak sa Huniadi i lavdishëm nuk dështon, dhe bëhet fjalë për një pëgërje të «papandehur», që do të përmbyste të dy Atletët, edhe të saporilindurin Skënderbeu. Është gjithashtu një leksion epistemologjik për historianin shqiptar të mësuar me armatosjen e llogoreve me sisteme vlerash, virtytesh e idealesh, me reduktimin e burimeve të shpatat, me zhdoganime shifrash absurde (sa tenxhere e ustallarë lipsen për 400 mijë ushtarë?). Ja që nevojitet edhe ushqimi, që mjafton edhe pak grurë e ujë për ta ndryshuar historinë, e jo më kot politika e jashtme e Skënderbeut dhe shtrirja e autoritetit të tij në Arbëri u kushtëzuan nga burimet materiale.

Parë nga një këndvështrim psikoanalitik, Skënderbeu i historiografisë shqiptare, praktikisht imazhi (i tij) dominues në imagjinatën tonë kolektive, del nga procesi i fabrikimit me një handicap, pasi i mungon Idi (Esi), shprehja psikike e nevojave pulsionale. Për mënyrën sesi prezantohet sot ky produkt, pamundësohet kategorikisht formimi i fjalive pyetëse me përemrat çfarë apo cili/cila dhe imponohet pjesorja 'a': A hante bukë Heroi? A kishte marrëdhënie seksuale? A kishte ndjesi ndaj dhimbjes/kënaqësisë? A kishte emocione? A kishte dëshira? A kishte nevoja? Përkundrazi dhe ironikisht, kjo formë pyetëse është e pakuptimtë për mitet, pikërisht sepse ata i

KËNDVËSHTRIMI PSIKOANALITIK

Parë nga një këndvështrim psikoanalitik, Skënderbeu i historiografisë shqiptare, praktikisht imazhi (i tij) dominues në imagjinatën tonë kolektive, del nga procesi i fabrikimit me një handicap, pasi i mungon Idi (Esi), shprehja psikike e nevojave pulsionale. Për mënyrën sesi prezantohet sot ky produkt, pamundësohet kategorikisht formimi i fjalive pyetëse me përemrat çfarë apo cili/cila dhe imponohet pjesorja 'a': A hante bukë Heroi? A kishte marrëdhënie seksuale? A kishte ndjesi ndaj dhimbjes/kënaqësisë? A kishte emocione? A kishte dëshira? A kishte nevoja? Përkundrazi dhe ironikisht, kjo formë pyetëse është e pakuptimtë për mitet, pikërisht sepse ata i jetojnë pulsionet, dëshirat, emocionet.

jetojnë pulsionet, dëshirat, emocionet.

Në mungesë të Idit, ose tërësisë së pavetëdijes, impersonales, alogjikes, amoralit, mungesës së kategorive e mira/e keqja, Uni, i cili në shpjegimin frojdian duhej të kishte pozita ndërmjetësuese, ekspozohet vetëm ndaj presionit të Mbiunit, ose sistemit të vlerave, që njeriu formon me brendësimin gradual të imponimeve (rregulla, limite, shtrëngime, ndalime) prej autoriteteve të jashtme (familja, shkolla, shoqëria, shteti etj.). Historiografisë i është dhënë ky pushtet nga një regjim që kërkon te modelin atavik të përsosur për Njeriun e Ri, dhe ajo ka përbushur zotimin duke i imponuar personalitetit të Skënderbeut sistemin e saj të vlerave e nevojave, e për rrjedhojë ai figuron i imunizuar nga kënaqësia, dëshira, frika, zemërimi, egoizmi, gabimi e deri nga domosdoshmëritë trupore (nevojat). Edhe kur, para ca kohësh, qarkulloi një "lajm" rreth pranisë së muzikës në "oborrin" e Skënderbeut, menjëherë pasioni i tij i pretenduar u përdor si lluburdinë e dëshirave të subjekteve që zelli për të dëshmuar Europë (në vend të Parti) i ka verbuar logjikën, çka në fakt evidenton leximin dhe selektimin funksional të historisë, apo, më tej akoma, parimin e 'vetëflijimit për

ideale', me të cilin çdo altoparlant i regjimit mëtonte paralizimin e egos së Njeriut të Ri.

Vërtet u dogj e u rrënu Arbëria, por rezultati nuk identifikohet si dështim - a mund të infektohet i pagabueshmi? - përkundrazi është akt sublim sepse shpëtuam qytetërimin. «Shiko», i thotë Xhani, «të janë djegur vetullat», dhe Lej Feni vetëmohues ia kthen me krenari se «nuk ka gjë më të mirë se sa kur shuhet zjarri dhe nuk dëmtohet pasuria e shtetit» (Niko Mitrusi [përkth.], Lej Feni. Biri i mirë i popullit punonjës, 1965, f. 93). Edhe ideal-tipi i Njeriut të Ri kinez sfidon ligjet e Natyrës: kur Je-i pyet Lej Fenin «e veshur hollë» nëse kishte «të ftohtë», ai i përgjigjet se «unë e kam provuar që kur bëj një të mirë për të tjerët, edhe sikur të bëjë pak ftohtë, më duket se nuk është ftohtë» (f. 55). Cili lexues, qoftë sadopak, i Skënderbeiadës zyrtare mund ta imagjinojë Heroin kombëtar në spazmat nga acari apo uria? Duke iu përshtatur çarjes permanente të historisë - përherë dhe të gjithë - me shpatë në dorë, individualiteti dhe personaliteti i Skënderbeut kanë përfunduar në një frakturë pikërisht me historinë dhe njerëzoren, për t'u shndërruar sipas maketit dhe njëkohësisht në maketin karikatatural të projektit 'Njeriu i Ri'. ■

Historia e gabuar

E “TË MIRIT”
DHE “TË KEQIT”





BLENDI FEVZIU

Zhvillimet politike të një vendi, ndryshimi i sistemeve dhe regjimeve, por edhe roli që individët luajnë në histori ndryshon shpesh, por për historiografinë komuniste, që ende vijon të dominojë mendësinë e shoqërisë, kjo ishte e papranueshme dhe e pamundur.



NË NJË PRITJE TË AMBASADËS FRANCEZE më 14 korrik të vitit 2002 isha duke biseduar më këmbë, në mes të një grumbulli të madh e heterogjen të ftuarish me liderin e fundit komunist të Shqipërisë, Ramiz Alinë. Nuk e kujtoj nëse biseda ishte fokusuar në çështje të ditës apo të së shkuarës, por një moment dallova pretendentin e fronit mbretëror, Lekën e I-rë, ose Leka Zogun siç njihet në Shqipëri, që po afrohej duke përshëndetur të ftuarit në dy anët e tij. Leka kishte mbërritur në Shqipëri ca javë më parë, për t'u vendosur përfundimisht në atdhe, prej nga ishte larguar thuajse 48 orë pasi kishte ardhur në këtë jetë dhe qe kthyer tashmë 63-vjeçar. Me të isha njohur 3 vjet më parë në Johannesburg të Afrikës së Jugut, kur i kisha bërë, së bashku me të ëmën, Mbretëreshën Geraldinë, një intervistë shumë interesante. Leka u afrua të më jepte dorën dhe vetëm momentin e fundit dalloj përballë meje Ramiz Alinë. Lideri i fundit komunist dhe pretendenti për fron u gjendën përballë, të dy të ngrirë, pa i dhënë dorën njëri-tjetrit, por edhe pa mundur të thonë asnjë fjalë.

Rastësia i vendos njerëzit në situata të çuditshme e, shpesh, shumë problematike. Ajo ngrirje prej statujash e të dyve, vetëm një hap larg, ishte më shumë se një ngërç personash, ishte një ngërç i historisë. Leka Zogu ishte larguar nga Shqipëria 2 ditë pasi kishte lindur. Babai i tij u largua si pasojë e pushtimit italian dhe jo e ndonjë zhvillimi të brendshëm politik. Logjikisht një fëmijë nuk mund të mbajë kurrë përgjegjësi për bëmat e babait të tij dhe as të jetë përgjegjës për një kohë kur ai nuk kishte lindur ende. Por komunistët nuk e ndoqën këtë parim universal. Ramiz Alia doli në atë kohë partizan dhe u bë një nga liderët e rëndësishëm komunistë në vite. Pas ardhjes së tyre në pushtet, Mbretit iu ndalua kthimi në Shqipëri. Kur Mbreti Zog i I - rë iku nga kjo botë, Leka u konsiderua kërcënimi kryesor i regjimit. Ai u vendos në krye të listës së kriminelëve të luftës edhe pse gjatë saj kishte qenë 4 - 5 vjeç dhe kishte jetuar në Angli! Komunistët vendosën ta luftojnë Lekën me çdo mënyrë dhe kudo që të ishte. Por edhe Leka nuk u pajtua me fatin e tij. Ndërmori jo pak nisma për ta rrëzuar regjimin komunist, edhe pse pa sukses. Nëse Alia dhe regjimi i tij do ta kishte kapur Leka Zogun, ai patjetër do të kishte përfunduar në togën e pushkatimit. Por edhe Leka nuk do të kishte pasur ndonjë sjellje më bujare nëse Alia një ditë do të ishte në dorën e tij. Ata kishin luftuar fort si dy kundërshtarë politikë, produkte të ideologjive të ndryshme dhe tani gjendeshin përballë. Të pafuqishëm për ta luftuar njëri-tjetrin; të pabindur plotësisht për ta falur njëri-tjetrin dhe, pa dyshim, të çuditur me mënyrën se si zhvillimet politike i kishin sjellë tani përballë, në të njëjtin ambient dhe të dy të ftuar të një vendi demokratik.

Zhvillimet politike të një vendi, ndryshimi i sistemeve dhe regjimeve, por edhe roli që individët luajnë në histori ndryshon shpesh, por për historiografinë komuniste, që ende vijon të dominojë mendësinë e shoqërisë, kjo ishte e papranueshme dhe e pamundur.

Në fakt, kjo përballje e Alisë me Zogun niste pikërisht këtu. Te bindja jonë e rrënjësor që një gjë e tillë nuk mund të ndodhte. Te keqkuptimi që historia e shkruar kishte krijuar në Shqipëri dhe te paaftësia jonë për ta rishkruar atë

mbi një bazë dhe stil krejt tjetër nga ai që kishte imponuar sistemi totalitar.

Si gjithçka e shkruar në mungesë lirie dhe me një ndikim të fortë ideologjik, historiografia komuniste kishte vetëm një mënyrë të shpjegimit të fenomeneve, ngjarjeve dhe personazheve. Atë të ndarjes së tyre në të mirë dhe të këqij. Në pozitivë dhe negativë. Në patriotë dhe tradhtarë. Asgjë e ndërmjetme nuk ekzistonte. Nuk po zgjatëm me shpjegimin më të detajuar të kësaj metodologjie të sakatuar, sepse do të kërkonte një analizë më të thelluar dhe më të gjatë, por po mundohem ta ilustroj që të jetë më lehtësisht e kuptueshme. Sipas kësaj metode, në varësi të qëndrimit ndaj komunistëve apo filozofisë së tyre, personazhet kalonin në njërin sirtar apo tjetrin pa ekuivoqe.

Historiografia komuniste përpunoi edhe një format të "të mirit" dhe të "të keqit", të patriotit dhe të tradhtarit. Më shumë se me historiografinë, ky trajtim na ngjan me letërsinë e realizmit socialist dhe me modelin e njeriut të ri. Patrioti ishte gjithnjë trim, nuk gabonte kurrë, ndodhej gjithnjë nga ana e drejtë e historisë, madje ai nuk kishte as vese dhe as probleme në jetën e tij personale. Tradhtari ishte gjithnjë në anën tjetër. Gjithnjë gabim, gjithnjë me armikun dhe plot me vese. Kjo mënyrë absurde e shikimit të historisë jo vetëm i ndau më dysh personazhet e ngjarjeve të rëndësishme, por zhvlerësoi debatin mbi ngjarjet dhe qëndrimin që personazhet e historisë mbajnë ndaj tyre. Nga shikimi i mëpasshëm, roli i shumë personazheve ka qenë dhe mbetet kompleks. Në bazë të bindjeve, të rreshtimeve, apo qëndrimeve politike, shumë prej tyre patën aksione politike që historia sot i vlerëson si të kota e të dështuara, apo të suksesshme. Por shumë prej tyre që në një moment kanë zgjedhur ose janë orientuar gabim, një moment tjetër kanë qenë nga ana tjetër e peshores së historisë. Si të gjithë, me uljet dhe ngritjet, në fitoret apo humbjet e tyre, ata krijuan një tablo komplekse, e cila jo vetëm që nuk mund të shpjegohet, por përkundrazi, masakrohet duke u shpjeguar vetëm bardhë e zi, vetëm me të mirë e të këqij.

P.sh., Mit'hat Frashëri, që ishte gjatë luftës një kundërshtar ideologjik i komunistëve, u klasifikua automatikisht negativ, duke mos i konsideruar as faktin që ishte firmëtar i aktit të Pavarësisë së Shqipërisë, as që ishte anëtar i Qeverisë së parë të Ismail Qemalit, as ambasador shumë i rëndësishëm i Shqipërisë në Athinë dhe as kontributin e tij fantastik si albanolog dhe njeri i letrave. Madje ky aktivitet nuk i vihej në pah kurrë. Me parimin që personazhi negativ i historisë duhet të jetë gjithnjë i tillë, historiografia komuniste i fshiu atij gjithë aktivitetin e mëparshëm 40-vjeçar, edhe atë të zhvilluar kur komunizmi nuk ekzistonte as is term në Shqipëri. Absurdi shkonte deri aty sa nuk përmendej as fakti që ishte djali i Abdyl Frashërit, madje kjo ishte herezi. Sepse Abdyl Frashëri ishte klasifikuar te personazhet pozitivë dhe kjo e prishte skemën. Me këtë metodologji personazhe tejet të rëndësishëm e me kontribut të historisë së Shqipërisë u fshinë prej saj ose u vendosën në kolonat e tradhtarëve, me 1001 etiketime negative, ndërsa personazhe episodike, shpesh banditë apo keqbërës lokalë, që u përfshinë në luftë dhe u renditën në anën e komunistëve u shpallën heronj ose modele të historisë.



Historia nuk trajtonte fenomene të dyzuara. P.sh., Mehdi Frashëri, që kishte qenë një nga personazhet e rëndësishëm të rezistencës së 7 Prillit 1939, u klasifikua automatikisht tradhtar, sepse në vitin 1944 ishte për disa kohë anëtar i regjencës. Por historia nuk lodhej të shpjegonte argumentin e tij për të qenë aty dhe as lëvizjet politike që ai bëri duke pasur si synim kryesor marrëdhëniet me britanikët.

Ahmet Zogu që u konsiderua armik, u zhduk nga historia e Kongresit të Lushnjës edhe pse ai kishte luajtur aty një rol kryesor. Ndërsa Kongresi në vetvete mbeti një moment tejet i rëndësishëm i shtetit shqiptar.

Mbi 30 firmëtarë të aktit të pavarësisë, që patën përplasje me regjimin komunist, u fshinë automatikisht nga historia, madje firmat e tyre, në faksimilet e botuara u fshinë ose u transformuan.

Shikimi i personazheve si robotë të programuar që mund të ishin vetëm të mirë ose të këqij; nxjerrja nga çdo lloj konteksti historik, zhveshja nga debati normal dhe, mbi të gjitha, moskuptimi që të gjithë me qëndrimet e tyre mundoheshin për Shqipërinë, pavarësisht se kush ishte më largpamës, krijoi një tablo historike të gjymtuar dhe me ndikim tejet negativ.

Ky keqkuptim historik, që u bë në fakt histori zyrtare, nuk qe korrigjuar as atë moment, kur Ramiz Alia, “heroi” dhe “i miri”, deri më 1990, qëndronte përballë armikut dhe të keqit, po deri më 1990, Leka Zogu. Për fat të keq, pas vitit 1990, ose në ato 12 vite që qëndronin midis, historia nuk kishte dituar as të korrigjonte veten, as personazhet e saj.

“Ngritja e shoqërive të reja demokratike postkomuniste nisi në Europën Lindore nga rishkrimi i historisë”, thotë Urs Altermat, një filozof dhe historian zviceran që studioi me themel këtë fenomen. Për të ndihmuar këtë simbolikë godinat më të rëndësishme të këtyre kryeqyteteve, iu dhanë instituteve dhe akademive të historianëve. Shqipëria, për fat të keq, e anashkaloi krejtësisht

këtë fenomen. Jo vetëm që nuk pati përgjegjësi penale për dramën dhe katastrofën gjysmëshekullore që regjimi totalitar komunist solli në Shqipëri, por as një lloj rehabilitimi moral. Për arsye se historia, sidomos ajo e Luftës së Dytë Botërore, shërbeu edhe si ndarje ideologjike për partitë moderne shqiptare, rishikimi i së shkuarës nuk u vu në shërbim të së vërtetës, por të politikës së momentit. Ajo varioi sipas forcave politike që vinin në pushtet, duke krijuar një kaos të plotë dhe duke e bërë sot Shqipërinë të vetmin vend të Ballkanit ku historia nuk është debat akademik, por politik. E bëri dhe e bën ende të vetmin vend ku monumentet e personazheve historikë dhe emrat e rrugëve vendosen mbi bazën e preferencave politike, dhe jo mbi bazën e kontributit real që personazhet kanë dhënë ndaj vendit.

Për këtë arsye, edhe Ramiz Alia e Leka Zogu qëndronin përballë njëri - tjetrit, midis disa qindra të tjerëve, elita e Shqipërisë, të ftuar në atë pritje, e cila ishte po aq e paaftë sa ata vetë për të bërë një definicion të aksonit të të dyve!

Ndarja e historisë në patriotë dhe tradhtarë, pra versioni të mirit dhe të keqit, është padyshim defekti më i madh që historiografia komuniste ka lënë pas në shoqërinë e sotme. Ky stereotip vijon ende, madje shërben jo rrallë edhe si element i luftës verbale politike. Zhbërja e tij duket e vështirë sa për arsye të rrënjës së thellë të ardhur nga tekstet apo propaganda e viteve të komunizmit, aq edhe nga paaftësia e historianëve postkomunistë për të ndërtuar tekste të besueshme dhe të mbështetura mbi dokumente. Më shumë se sa për të treguar të vërtetën, dokumentet zgjidhen dhe jo nuk shërbejnë për të ilustruar idenë e parafiksuar. Kjo është arsyeja, që edhe përzgjedhja dhe publikimi i tyre është selektiv. Por ky shikim bardhë e zi i ngjarjeve, fenomeneve dhe personazheve nuk është gjymtimi i vetëm që historiografia komuniste dhe vi-

jimi i saj i ka bërë formimit të shqiptarëve.

Dy fenomene të tjera po kaq negative janë ai i kërcënimit të përjetshëm dhe i armikut të përhershëm, që ka ndikuar fort në sindromën e izolimit të shqiptarëve. Dhe i dyti, trajtimi i historisë sonë, thjesht, si një histori qëndrese, duke lënë jashtë vëmendjes dhe duke mos trajtuar periudha të tëra historike të jetesës së shqiptarëve në formacione shumëmetrike. Nëse u referohesh teksteve të historiografisë komuniste, filozofia e tyre ka qenë ajo e një populli të rrethuar dhe të izoluar, në luftë të përjetshme me të gjithë. Identifikimi i regjimeve totalitare me kombin ishte thujse normë dhe kjo sillte një sindromë të armikut të përhershëm. P.sh., Perandoria Osmane njësohej me turqit dhe detyrimisht Turqia shihej si një armik. Ndërkohë Turqia moderne kishte të bënte pak ose aspak me Perandorinë Osmane, sidomos me ekspansionin e saj 500 vjet më parë; Gjermania naziste identifikohesh me gjermanët, duke i konsideruar ata apriori armiq, edhe 50 vjet pas luftës. Kjo metodologji ndikonte tej mase në idenë e vetizolimit, duke e kthyer atë të shqiptarët në një sindromë me peshë. Një sindromë nga e cila nuk jemi shëruar ende. Pra, vendet nuk janë parë si regjime që në kohë të ndryshme kanë dhënë e kanë marrë, apo edhe kanë luftuar, por si kombe të cilat si pasojë e një momenti historik, konsiderohen kërcënim permanent për ne. Për këtë arsye, sindroma e Luftës së Dytë Botërore, nuk kishte ikur ende nga Shqipëria deri në vitin 1990, edhe 45 vjet pas mbarimit të saj.

Fiksimi i shikimit të historisë sonë si një histori qëndrese ka sjellë, më pas, një deformim jo të vogël të periudhave të tëra. Periudha 5-shekullore e shqiptarëve në perandorinë osmane thujse nuk ekziston. Ajo është reduktuar në një seri kryengritjesh, një pjesë e të cilave ishin lëvizje proteste për autonomi fetare apo favore fiskale. Kjo e ka lënë thujse bosh rolin që shqiptarët kanë luajtur në Ballkanin Osman dhe mënyrën e stilit e jetës së shqiptarëve në këtë perandori. Disa përpjekje

të zbehta janë bërë kohët e fundit, por ende pa kontributin e duhur për të sqaruar se si ka qenë jeta, rregullat dhe kontributi që shqiptarët kanë pasur në Perandorinë Osmane bashkë me shumë popuj të tjerë. Të jetuarit në një perandori ka qenë në mesjetë formë e organizimit politik. Në perandori kanë jetuar edhe popuj më të mëdhenj dhe të më të zhvilluar sesa ne. Kjo nuk na bën as më inferiorë, as më të dobët. Ideja që bashkëjetesa në perandori ka qenë moment dobësie, është thjesht derivat i tezave të komunizmit për një popull të izoluar që kërkonte dhe donte të jetonte thjesht i vetëm.

Një popull që nuk di të vlerësojë të shkuarën e tij e ka gjithnjë të vështirë ndërtimin e së ardhmes. Kjo frazë që shpeshherë duket si shabllon, i shkon më shumë se kushdo tjetër momentit që përmenda në fillim të shkrimit. Ngrirjes përballë të Ramiz Alisë dhe Leka Zogut, pa guxuar të përhëndeten, por edhe pa asnjë dëshirë për të vijuar më pas grindjet e tyre. Secili i bindur se kishte pasur një rrugë të drejtë dhe historia që ende nuk ka mundur t'i vendosë të dy në vendin që meritojnë... ■

“ Si gjithçka e shkruar në mungesë lirie dhe me një ndikim të fortë ideologjik, **historiografia komuniste kishte vetëm një mënyrë të shpjegimit të fenomeneve, ngjarjeve dhe personazheve. Atë të ndarjes së tyre në të mirë dhe të këqij.** Në pozitivë dhe negativë. Në patriotë dhe tradhtarë. Asgjë e ndërmjetme nuk ekzistonte.



PËRSE DUHET NDARË

SKËNDERBEU SI MIT/E

NGA HISTORIA E TIJ?

Miti duhet, por ai edhe duhet kuptuar, edhe duhet ndarë nga historia.

Skënderbeu i “kërkimit shkencor” duhet parë si histori, pasi çdo popull ka nevojë të rritet dhe të njohë historinë e vet si shkencë, me fakte dhe dokumente dhe jo si një të vërtetë të pandryshueshme.



FATOS LUBONJA

Z. Lubonja, ju shfaqni një tjetër qasje mbi figurën e Skënderbeut, përse kjo qasje?

Unë jam botues i një reviste kulturore me titullin “Përpykja”, që është një përpykje për të futur frymën kritike në kulturën shqiptare. Logoja e saj është: “Bëhu i ditur që të jesh i lirë”. Në tematikat e kësaj reviste, në funksion të asaj që të bëhemi të ditur për të qenë të lirë, bën pjesë edhe çlirimi i mendjes së shqiptarëve nga ideologjia nacional-komuniste, që ka farkuar mënyrën e tyre të menduarit. Edhe rishkrimi i historisë së Skënderbeut bën pjesë në këtë përpykje për ta parë historiografinë me frymë kritike, për të shpjeguar, për të dekonstruktuar mitet e nacional-komunizmit. D.m.th. për të kuptuar se: si janë krijuar mitet, cilët kanë qenë faktorët historikë, të mirat dhe të këqijat e këtyre miteve, që, në njëfarë mënyre, vazhdojnë t’i mbajnë shqiptarët, ashtu siç e thotë në këtë numër historiani gjerman Michael Schmidt Neke, “robër të Skënderbeut”. Pra, ideja është të çlirohemi nga një lloj “robërie”, që nuk na e shkakton Skënderbeu si figurë historike, por hartuesit e miteve nacional-komuniste

që e kanë manipuluar këtë figurë historike për të pushtuar e “robëruar” mendjet e shqiptarëve.

Ka pasur një moment kthese tek ju, apo kështu e kenë parë gjithnjë këtë figurë?

Padyshim që njeriu ndryshon, ndryshe nuk bëhet i ditur. Sepse të bëhesh i ditur do të thotë të shtosh dije; në të kundërt, mbetesh me njohuritë që ke marrë në fillore, atëherë kur na mësohej se që një kohë - ajo e Skënderbeut - kur “Shqipëria pillte vetëm trima dhe luanë”. Problemi është të dimë: pse nuk po ndodh kjo sot? Apo, mos vallë, historia ka qenë ndryshe?

Si mund ta ndajmë mitin nga historia?

Skënderbeu është personazh historik i mitizuar disa herë në forma të ndryshme, sipas projeksioneve në kohën e tij të problemeve të kohëve kur ai është mitizuar. Skënderbeu është mitizuar herën e parë nga Marin Barleti dhe Kisha Katolike në përgjithësi, si “Kalorës i krishterimit”, pasi ka qenë një figurë që për 24 vjet luftoi me Perandorinë Osmane, perandori në ekspansion edhe të fesë islame. Momenti i dytë lidhet me kohën kur kjo figurë, që tashmë ishte bërë e famshme në Perëndim jo si shqiptar, por si “Kalorës i krishterimit”, rimerret në shekullin e XIX, në periudhën e lindjes së nacionalizmave. Është koha kur të gjithë popujt kërkojnë në historitë e tyre

QASJA NDAJ HEROIT

Qasja ndaj heroit, me të cilin edukohemi në fëmijëri, në moshën e pjekurisë duhet parë nga pikëpamja psikoanalitike. Frojdi ka më shumë se një shekull që ka hapur një dritare të jashtëzakonshme në këtë aspekt për njohjen e njeriut, por drita e psikanalizës te ne ka hyrë shumë pak. Qasja ndaj heroit, sipas meje, duhet të jetë kjo: Ne kemi në inkoshiencën tonë arketipin e heroit - thotë Jungu - dhe atë duhet ta integrojmë në koshiencën tonë. Pra (në fëmijëri) ne e projektojmë arketikipin e heroit që është në inkoshiencën tonë te një Skënderbe apo ndonjë udhëheqës tjetër. Jungu thotë se ne arrijmë të piqemi kur ia dalim që këtë arketip ta fusim në koshiencën tonë, kështu ne çlirohemi dhe bëhemi heronj të vetes, bëhemi si kolibri që bën pjesën e vet. Kjo qasje ndaj heroit kërkon, veç të tjerash, dituri. P.sh. duhet ditur se Skënderbeu ka qenë njeri, ka pasur dobësitë e tij, nuk ka qenë një qenie e jashtëzakonshme, por një njeri me gjithë problematikat e veta.

heronj për t'u identifikuar. Edhe shqiptarët gjetën Skënderbeun, ashtu siç grekët gjetën Sokratin, Platonin e në përgjithësi qytetërimin antik grek. Në këtë periudhë, nga rilindësit shqiptarë shkruhet një histori tjetër e tij. P.sh. në poemën "Historia e Skënderbeut" të Naim Frashërit hiqet elementi i krishterë, pasi ishte periudha kur predikohej që "feja e shqiptarit është shqiptaria". Ai paraqitet kësaj here si çlirimtar i kombit shqiptar. Dhe përsëri kemi një mit, që do të thotë një projektim të problemeve të shqiptarëve të shekullit të XIX në kohën e Skënderbeut.

Po a na duhet ne miti?

Miti duhet, por ai edhe duhet kuptuar, edhe duhet ndarë nga historia. Skënderbeu i "kërkimit shkencor" duhet parë si histori, pasi çdo popull ka nevojë të rritet dhe të njohë historinë e vet si shkencë, me fakte dhe dokumente dhe jo si një të vërtetë të pandryshueshme. Dija shkencore ndryshon vazhdimisht në varësi të dokumenteve. Dhe kjo duhet bërë edhe në emër të një kulture tjetër: kulturës së të vërtetës, njohjes dhe pranimit të saj përtej dëshirave dhe pasioneve tona, përndryshe mbetemi infantilë, siç kemi mbetur ne, që besojmë më shumë gënjeshtërën, manipulimin sesa të vërtetën.

Diktatura na ka lënë këtë kulturë, që vazhdon të na bëjë të manipulojmë dhe të simulojmë heroin, duke gënjyer për veten dhe historinë tonë. Prandaj gënjeshtria mbretëron në këtë vend. Shihni politikanët që gënjejnë vazhdimisht, aq sa na shkon ajo thënia e Gianni Rodarit, se "në një vend ku sundon gënjeshtria, e vërteta është një sëmundje".

A po e bëjmë ne ndarjen e mitit nga historia dhe nëse jo, si mund ta bëjmë këtë?

Njëra nga rrugët është të njohim edhe historinë e vetë mitit. Sepse edhe miti ka historinë e tij. Si është formuar miti i Skënderbeut që nga Barleti te nacionalizmi, Naim Frashëri, Konica, për të ardhur në kohën e Enver Hoxhës? Si e përdori diktatori Skënderbeun për të na izoluar? Si është pasqyruar kjo në artet figurative, letërsi etj.? Të gjitha këto janë pjesë e historisë së mitit, që duhet studiuar.

Pra, nëse arrijmë të studiojmë si historinë, ashtu edhe historinë e mitit, jo vetëm bëhemi më të vetëdijshëm për këtë figurë, por ngrihemi edhe si formë mendimi, bëhemi shumë më të aftë për të kuptuar edhe shumë gënjeshtria të tjera, për të kuptuar më mirë veten.

P.sh. miti "Skënderbeu mbrojtës i Ev-



ropës” nuk i qëndron historisë. Nëse do të pyesim shumë shqiptarë se cila ka qenë gjendja e trevave ku banojmë ne sot në kohën e Skënderbeut, do të shohim se, pikërisht, për shkak të këtij miti, ata nuk e dinë. P.sh. nuk dihet se Berati ishte osman, Vlora ishte osmane, ndërkohë që Durrësi ishte venedikas. Sulltan Mehmeti II në 1466, dy vjet para se të vdiste Skënderbeu, i ka bërë një rrethim Durrësit dhe nuk e ka marrë dot jo nga Skënderbeu, por nga venedikasit. Ndërkohë që Kruja kishte qenë osmane pastaj e mori Skënderbeu në 1443 dhe e mbajti deri në 1451 kur u bë vasal i Napolit. Pastaj, ishte Napoli që zotëronte Krujën. Ne nuk i dimë këto, por themi që shpëtuam Evropën. Por kush e shpëtoi, sepse në atë kohë Shkodra, Lezha dhe Drishti ishte veneciane, Kruja ishte e Napolit. Ndërkaq, Ballaban Pasha, kundërshtari i famshëm i Skënderbeut, ishte një shqiptar i konvertuar, i cili, kur ka vdekur, është varrosur në Petrelë, sepse edhe Petrela ishte osmane. Pra, ku paska qenë ky shteti që krijoi Skënderbeu për të cilin flasim ne?!

Pak kohë më parë Aurel Plasari ka

deklaruar se Skënderbeu nuk është marrë kurrë peng, por është rritur dhe është stërvitur në Krujë, madje ka qenë i punësuar i Sulltanit në Krujë...

Mesa di unë, i punësuar ka qenë i ati. Në këtë historinë (e rrëmbimit) ka shumë të thëna e të pathëna. Ne duhet të themi që ai ka qenë jeniçer dhe të dimë se çfarë ishin jeniçerët, se si merreshin ata në botën e krishterë, se si edukoheshin dhe si përdoreshin nga Perandoria Osmane. Sepse kur u bë gjeneral, ai u bë atje. Në këtë thënie të Plasarit shoh sërish një nevojë për vetëmburrje kombëtare. Nëse do të shikojmë realitetin, do të shohim se të gjitha figurat e mëdha të kohës kanë dalë nga metropole të mëdha.

Në intervistën e tij Plasari, p.sh., përdori termin “Albania venedikese” duke e vënë Matin si vijën ndarëse midis pjesës osmane lindore dhe pjesës perëndimore. Albania Venedikase ka qenë, siç e thashë, deri në Durrës në kohën e Skënderbeut, por kjo s’do të thotë se ka qenë Shqipëria siç e kemi ne sot. Emri “Arbëri” tregon një vend gjeografik, mbiemri “venedikase” tregon

se ka qenë zotërim venedikas që ka qenë deri lart në Dalmaci. Pastaj kanë ardhur osmanët dhe e kanë pushtuar duke e zvogëluar. Pra gjërat kanë lëvizur në histori në kohë, ndërsa ne duam të flasim për një shtet shqiptar që e ka ndërtuar Skënderbeu që në atë kohë me këta kufijtë e sotëm. Kjo nuk qëndron historikisht.

Pra nëse flasim për të si themeluesin e shtetit shqiptar, ky është një mit?


Sigurisht që është një mit, i cili rrjedh nga nevoja e shqiptarëve (të shek. XIX-XX) për shtetformim. Ndaj them se duhet të dimë historinë e mitit. Sepse edhe miti i tij nuk është farkuar e përdorur gjithnjë njësoj. Siç thashë, Skënderbeu në shekujt e mëparshëm ka frymëzuar të krishterët, shkrimtarë kanë shkruar, Vivaldi ka bërë muzikë.

Pra miti ka vlerën dhe kohën e vet, siç ka edhe problemet e veta. P.sh., në kohën e Enver Hoxhës, Skënderbeu i Enver Hoxhës u përdor shumë edhe për t'i izoluar shqiptarët. Shqipëria rezistonte si një kështjellë ndaj imperializmit dhe soc-imperializmit nën shembullin Skënderbeut. Pra,

një Skënderbeu që, historikisht, në kohën e tij ishte i hapur, qe diplomat, kishte lidhje me Vatikanin, Napolin, me papatin, u paraqit sikur mbronte Shqipërinë nga të gjithë, duke u bërë kështu simbol i izolimit të Shqipërisë. Pra mitet edhe keqpërdoren, sidomos mitet nacionaliste. Dhe nacionalizmi është një ideologji që ka çuar në urrejtje, në ndarje nga të tjerët. Ja pse sot s'guxohet të thuhet se nëna e tij ishte sllave. Për shkak të nacionalizmit, ndërkohë që koha kur ka lindur Skënderbeu ishte një kohë tjetër dhe marrëdhëniet me serbët kanë qenë të tjera. P.sh. të gjithë i kanë harruar emrat e vëllezërve të Skënderbeut, që ishin Stanisha, Reposhi..., të cilët janë emra sllavë. Njëri prej tyre është varrosur në malin Athos, sepse ishte prift ortodoks. Tani një pjesë e bëjnë Skënderbeun edhe katolik; sepse tani na duhet katolik. Ky është instrumentalizimi i figurës mitike.

Sa na vlen tani ai si një mit?

Problemi që ka mënyra se si e trajtojmë ne Skënderbeun si mit,



MARIN BARLETI

Skënderbeu është personazh historik i mitizuar disa herë në forma të ndryshme, sipas projeksioneve në kohën e tij të problemeve të kohëve kur ai është mitizuar. Skënderbeu është mitizuar herën e parë nga Marin Barleti dhe Kisha Katolike në përgjithësi, si "Kalorës i krishterimit", pasi ka qenë një figurë që për 24 vjet luftoi me Perandorinë Osmane, perandori në ekspansion edhe të fesë islame. Momenti i dytë lidhet me kohën kur kjo figurë, që tashmë ishte bërë e famshme në Perëndim jo si shqiptar, por si "Kalorës i krishterimit", rimerret në shekullin e XIX, në

është se i bën shqiptarët të presin akoma Skënderbeun që të vijë t'u sjellë lirinë. Unë kam shkruar një shkrim të titulluar "Skënderbeu dhe kolibri", ku rrëfej një përrallë indiano-amerikane. "Në një pyll bie një zjarr i madh dhe të gjitha kafshët u shqetësuan. Ndërsa ato debatonin me njëra-tjetrën se si do ta zgjidhnin këtë situatë, kolibri, zogu më i vogël i pyllit, shkon në një përrua, merr me sqepin e tij të vogël një pikë ujë dhe e hedh te zjarri. Disa kafshë e qesëndisën duke i thënë: "Po ti, me këtë sqep do ta shuash zjarrin? - Po, e di, - u tha ai, - por unë bëj pjesën time."

Pra, sot ne jemi përballë nevojës për të bërë shtet, por këtë nuk mund të na e bëjë "Skënderbeu" i Spiropalit, Edi Rama, sipas modelit kulturor që na ka lënë Enver Hoxha. Këtë shtet duhet ta bëjmë të gjithë ne, si kolibri, duke bërë secili pjesën e vet. Ky do të ishte një shtet demokratik. Përndryshe ai që na bëhet "Skënderbeu" i radhës, shndërrohet në dhunuesin e lirive tona, siç ka ndodhur edhe më herët.

Pra na lipset një qasje tjetër ndaj heroit?

Qasja ndaj heroit, me të cilin edukohemi në fëmijëri, në moshën e pjekurisë duhet parë nga pikëpamja psikoanalitike. Frojdi ka më shumë se një shekull që ka hapur një dritare të jashtëzakonshme në këtë aspekt për njohjen e njeriut, por drita e psikanalizës te ne ka hyrë shumë pak. Qasja ndaj heroit, sipas meje, duhet të jetë kjo: Ne kemi në inkoshiencën tonë arketipin e heroit - thotë Jungu - dhe atë duhet ta integrojmë në koshiencën tonë. Pra (në fëmijëri) ne e projektojmë arketipin e heroit që është në inkoshiencën tonë te një Skënderbe apo ndonjë udhëheqës tjetër. Jungu thotë se ne arrijmë të piqemi kur ia dalim që këtë arketip ta fusim në koshiencën tonë, kështu ne çlirohemi dhe bëhemi heronj të vetes, bëhemi si kolibri që bën pjesën e vet. Kjo qasje ndaj heroit kërkon, veç të tjerash, dituri. P.sh. duhet ditur se Skënderbeu ka qenë njeri, ka pasur dobësitë e tij, nuk ka qenë një qenie e jashtëzakonshme, por një njeri me gjithë problematikat e veta.

periudhën e lindjes së nacionalizmave. Është koha kur të gjithë popujt kërkojnë në historitë e tyre heronj për t'u identifikuar. Edhe shqiptarët gjejnë Skënderbeun, ashtu siç grekët gjetën Sokratin, Platonin e në përgjithësi qytetërimin antik grek. Në këtë periudhë, nga rilindësit shqiptarë shkruhet një histori tjetër e tij. P.sh. në poemën "Historia e Skënderbeut" të Naim Frashërit hiqet elementi i krishterë, pasi ishte periudha kur predikohej që "feja e shqiptarit është shqiptaria". Ai paraqitet kësaj here si çlirimtar i kombit shqiptar.



SKENDERBEU





Ndërkohë që jemi në këtë mjerim të madh dhe na duhet të ndërtojmë vërtet shtetin, si kolibri, popullit i jepet kjo festa e madhe, vetëmburrja se qenkemi shpëtimtarët e qytetërimit european etj.

Kur doli libri i Oliver J. Schmidt, i cili e sjell Skënderbeun në një këndvështrim më njerëzor, nuk e pranuan ata që mbajnë mitin, monopolin e heroit. Po të kërkosh të fusësh këtë dije, ata ngrihen dhe të thonë: “ky është agjent i serbit, këtë e ka blerë greku, atë e ka blerë turku.” Ky banalitet nuk lejon të zhvillohet mendimi i lirë. Në fakt këtë monopol gjoja dijeje ata nuk e lëshojnë se, përndryshe, po iu ra kjo dije, që e kanë fabrikuar me librat e tyre në kohën e komunizmit, ata s’vlejnë asgjë.

Nuk e di nëse i keni ndjekur deklaratat e prof. Pëllumb Xhufit mbi ju, në një tjetër televizion, i cili thotë: “Lubonja është krejtësisht i palexuar për këtë çështje (Skënderbeun), do t’i lutesha shumë t’i rrijë larg Skënderbeut, nuk ka asnjë punë ai me këtë figurë. Le të merret me punëra të tjera, por me Skënderbeun, jo! E kam thënë edhe herë të tjera, Fatosi është i palexuar”. Do të doja një koment tuajin...

Unë nuk jam historian, por nuk mund të thuash se jam i palexuar. Këtu (në revistën “Përpjekja”) kam 350 faqe ku kam botuar autorët më të njohur. Kam botuar Oliver Schmidtin, figurë e ndritur që mund të na shërbente për t’u dhënë leksione në shkolla studentëve. Por njerëz si Xhufi kanë bërë që

Schmidt të largohet dhe të thotë që atje është ende një vend stalinist. Madje, kur ka bërë promovimin në Vjenë të librit të tij mbi Skënderbeun, shqiptarët janë kontrolluar për armë, se mos e vrisnin. Kjo për shkak të këtyre njerëzve që instrumentalizojnë nacionalizmin për qëllime pushteti. Ja, shikoni si thotë: “të qëndrojnë larg!...” d.m.th. sikur e ka ky dhe njerëzit si ai monopolin e Skënderbeut. Kjo është, përveç të tjerave, edhe injorancë. Më fal që detyrohem t’ia them. Sepse sot, në demokraci, kur flitet për histori, nuk flitet për një të vërtetë që e ka Schmidt apo Xhufi, por që e kanë shumë të tjerë. Ndaj duhet të ketë shumë tekste. Mirëpo ja, këtë revistë (Përpjekja), që fatkeqësisht ka pasur një nga bashkëthemeluesit atë që është sot kryeministër, Edi Ramën, nuk e merr kush sot për studentët. Sepse duhet të vazhdojnë përralla e madhe. Ky është qëndrim enverist ndaj dijës. Ndaj edhe thënia: “bëhu i ditur të jesh i lirë”, u vlen shumë shqiptarëve.

A ka një artificë në gjithë festimet e këtij viti për Skënderbeun?

Sigurisht që ka, sepse ndërkohë që jemi në këtë mjerim të madh dhe na duhet të ndërtojmë vërtet shtetin, si kolibri, popullit i jepet kjo festa e madhe, vetëmburrja se qenkemi shpëtimtarët e qytetërimit european



etj. Dhe kjo na bën qesharakë, kur shkojmë e ua themi këtë botës, siç pashë se po bënte një shoqatë shqiptarësh disa ditë më parë në Itali. Por ky është rezultat i delirit të izolimit që ka lënë pas Enver Hoxha. Na ka lënë në një shqiptarocentrizëm, sikur të jemi qendra e botës, që nuk na le të kuptojmë dimensionin tonë. Prandaj ngulmoj se edhe Skënderbeun duhet ta vendosim në dimensionin historik, edhe Shqipërinë, jo sikur të paskëshim qenë përherë një kështjellë e rrethuar nga armiqtë. Identitetet janë të lëvizshme, jo ashtu siç duam t'i trajtojmë ne.

Besoju ju jeni njohur me kalendarin e aktiviteteve të cilit duket se u është bashkuar edhe opozita, pasi edhe Lulzim Basha në protestë kishte në sfond muzikën e filmit “Skënderbeu”...

Po një kulturë kanë edhe këta. Edhe Basha imiton Ramën, pasi thotë: “Kështu ky ka suk-

ses”. Nuk mendon të sjellë diçka të re. Jo vetëm për Skënderbeun, por në të gjitha. E keqja është se këta nuk lejojnë as edhe një minorancë që të zhvillojë një kulturë tjetër. Sepse tek ne mbisundon konformizmi. Dhe ja ku po ju them se sikur të ndodhte që të bëhej Erdogani, Turqia, “babai” i shqiptarëve, siç është Amerika sot, të gjithë këta konformistë do të ktheheshin tek Hamza Kastrioti. Sepse kemi mbetur tek kultura e sipërfaqësisë dhe manipulimit që ushqen atë që besohet më lehtë nga “këta budallenjtë” - siç i konsiderojnë njerëzit - e që, në rreth vicioz, ripërsëritet duke na lënë në injorancë.

Intervistë e dhënë fillimisht në News 24, dhe e përgatitur nga autori për Medius. ■

“ Kemi mbetur tek kultura e sipërfaqësisë dhe manipulimit që ushqen atë që besohet më lehtë nga “këta budallenjtë” - siç i konsiderojnë njerëzit - e që, në rreth vicioz, ripërsëritet duke na lënë në injorancë.



Hakmarrja dhe ironia e

HISTORISË

Prej kohësh historia është bërë jo vetëm një armë lufte, por edhe një burim konflikti. Ajo ndoshta zë hapësirën më të madhe të debatit pas politikës dhe shpesh diskutohet me të njëjtin zjarr sesa ajo. **Në fakt debati historik është në thelb politik. Në më të shumtën e rasteve ajo është vetëm instrument për legjitimimin e pozicioneve politike.**



ERGYS MËRTIRI

PËR ÇFARË NA DUHET HISTORIA?”, - është pyetja me të cilën historiani i madh Marc Bloch nis apologjinë e tij për zanatin e vet, i vënë në dyshim nga një adoleshent në zjarrin e Luftës së Dytë Botërore. Është një pyetje fare naive, por e vlefshme të shtrohet kur debati harliset nëpër shtigje pa krye dhe historia përdoret për të plehëruar pikëpamje që e dëmtojnë apo edhe e kërcënojnë shoqërinë. Duke rimenduar arsyet përse bëjmë histori, mund të ripeshojmë herë pas here edhe vlerën e pikëpamjeve dhe të bindjeve tona.

Prej kohësh historia është bërë jo vetëm një armë lufte, por edhe një burim konflikti. Ajo ndoshta zë hapësirën më të madhe të debatit pas politikës dhe shpesh diskutohet me të njëjtin zjarr sesa ajo. Në fakt debati historik është në thelb politik. Në më të shumtën e rasteve ajo është vetëm instrument për legjitimimin e pozicioneve politike.

Atëherë për çfarë na duhet historia kur, për më tepër, nuk kemi as vullnetin ta shohim të kaluarën me objektivitet e paanësi? Na duhet pikërisht për të mposhtur kundërshtarët, për të fortifikuar llogoret duke injektuar te publiku helmin e qasjeve ideologjike me të cilat mbajmë gjallë konfliktin shoqëror. Historia bëhet kështu e pashmangshme, për aq sa njeriu është një “zoon politicon”, ndërsa e kaluara mbetet një instrument i domosdoshëm për krijimin e përfytyrimeve të së tashmes.

Natyrisht, historia si dije, jo si strategji betejash politike, ofron vlera të rëndësishme. Ajo është një basen ku grumbullohet përvoja e kohërave dhe e popujve, e cila

na shërben për të njohur më mirë veten dhe botën. Ajo na ofron ndoshta materialin më të rëndësishëm mbi të cilin ndërtohen të gjitha shkencat humane. Ajo është burimi i vetëdijes sonë për veten dhe shoqërinë ku jetojmë duke plotësuar nevojën tonë për identitet dhe kulturë. Ajo bëhet një farkëtuese e solidaritetit dhe e kohezionit shoqëror. Por për sa kohë elitat i vendosin vlerat në plan të dytë, përballë nevojave imediate të interesave të vogla personale, klanore, politike e ideologjike, ajo do t'i shërbejë konfliktit në vend të solidaritetit.

A NA MASHTRON HISTORIA?

Njohja e së shkuarës na ndihmon pa dyshim të përmirësojmë njohuritë që ndikojnë mbi vendimet e së tashmes e prej këndeje, realiteti shqiptar na thotë se përvoja e së shkuarës nuk na ka vlejtur edhe aq. “Sa herë që shoqëritë tona të trishtuara, në krizë të përhershme rritjeje, zënë e dyshojnë ndaj vetvetes, ato kërkojnë nëse kanë patur të drejtë të pyesin të kaluarën e tyre ose në e kanë pyetur mirë atë”, thotë Marc Bloch. Në një situatë krize, të traumatizuar nga ethet e luftës, ai shpjegon skepticizmin e përhapur në rrethet e studiuesve në Gjermaninë e Hitlerit. Të zhgënjyer dhe të tradhtuar nga iluzionet e fillimshkullit ata shtronin pyetjen: “Mos duhet të besojmë se historia na ka mashtruar”? E njëjta pyetje vlen të shtrohet edhe sot kur flasim mbi realitetin shqiptar.

Historia bëhet mashtruese, mbi të gjitha, kur studimi historik ka për busull ideologjitë, sidomos ato totalitare. E shtrënguar nëpër skemat e tyre interpretative, ajo shndërrohet nga një dije mbi të kaluarën, në një projekt politik të veshur me kohë, ku ngjarjet e rrëfyera tërhiqen prej së tashmes në mënyrë prapavepruese. Ideologjia e shndërron historinë nga një burim i rëndësishëm njohjeje në një mjet spekulativ

në shërbim të një veprimtarie të tashme. Ideologjia e orienton keq interpretimin historik. Kuptimi i ngjarjeve është caktuar para se ato të merren në analizë dhe detyra e historianit mbetet vetëm t'i rrëfejë ato në atë mënyrë që të përforcojë atë çfarë është paracaktuar. Historiani në këtë rast nuk i vëzhgon dhe i rrëfen ngjarjet, por i monton në atë mënyrë që të nxjerrë përfundimin e kërkuar. Ai e sajton të shkuarën për t'i dhënë kuptim së ardhmes që parashtron ideologjia. E gjithë kjo bëhet një gënjeshtër e rrezikshme.

Ideologjitë përpiqen ta thjeshtojnë botën në vetëm disa aspekte të saj. Kështu, fjala vjen, marksizmi e redukton gjithçka te klasa, nazizmi te raca, nacionalizmi radikal te kombi, etj. Të shikuarit e historisë vetëm në një prej aspekteve të marrëdhënieve njerëzore përbën një prej formave më të mëdha të të mashtrimit prej saj. Mohimi i rëndësisë së faktorëve të tjerë në zhvillimin e historisë dhe shpërfillja e kompleksitetit të raporteve njerëzore bën që kuptimi i saj të jetë i gjymtuar, i tjetër-

suar, i manipuluar.

Rajmond Aron shpjegon se si marksizmi krijon rrugë të tilla të shkurtra për të ofruar shpjegime të thjeshtëzuara të botës. Sipas tij, ai e sheh historinë si një të tërësi unike dhe homogjene, e cila bart në të gjitha etapat e saj të njëjtin kuptim. Pikërisht ky kuptim është çelësi për shpjegimin e gjithçkaje në botë, si dhe, rrjedhimisht, çelësi për realizimin e premtimeve të së ardhmes. Kjo e bën ideologjinë të pakorrigjueshme e sidomos të papajftueshme me mendimin shkencor. Nëse komunistit do t'i duhet të pranojë, për shembull, se Partia nuk mund t'i përmbushë medoemos të gjitha detyrat e proletariatit, atëherë Revolucioni i Tetorit në Rusi e humb vendin që i ka caktuar historia e shenjtë, duke bërë që ai të kthehet thjesht në një "grusht shteti fatlum". "Rreziku më i madh i këtyre dogmave, - thotë Bloch, - është se ato përkufizojnë me aq kujdes vetëm e vetëm që të vënë kufij. Kufijtë japin verdiktin përfundimtar mbi faktet dhe njerëzve u mbetet vetëm ta pranojnë dhe ta vënë në zbatim."

Vetë shkenca e historisë ka historinë e saj të përdorimit politik në funksion të ideologjive që i kanë sjellë jo pak kosto botës moderne. Medievalisti Patrick Geray gjykon se historia moderne është krijuar si shkencë për të qenë në shërbim të ideologjive politike, që në gjenezën e saj në shek. XIX. Sipas tij ajo u konceptua dhe u zhvillua si një instrument i ideologjisë nacionaliste europiane dhe ajo ia ka dalë ta shndërrojë të kuptuarit

“ Historia si dije ka për mision të zbardhë të kaluarën, duke na i rrëfyer ngjarjet sipas një metode të besueshme njohjeje. Ajo e bën të mundur këtë nëpërmjet dëshmive dhe dokumenteve të trashëguara, të cilat përbëjnë materialin faktik mbi të cilin ndërtohet rrëfimi dhe interpretimi i së shkuarës.

tonë mbi të kaluarën në “një kosh plehrash toksik”, i cili e ka depërtuar helmin e tij thellë në vetëdijen popullore.

Po kështu, marksizmi dhe një sërë pikëpamjesh, si iluminizmi, pozitivizmi, progresizmi, kanë lënë ndikimet e veta në mendimin historik duke krijuar qasje dhe instrumente shpjegimesh që dëmtojnë përfytyrimin mbi të shkuarën. Njësoj siç historianët kanë shpikur kombet në mesjetë, ata kanë shpikur gjithashtu edhe mite të tilla si lufta e klasave, errësira mesjetare apo despotizmi oriental. Prirjet historiciste kanë qenë bashkëshoqëruese të mendimit historik dhe ende vazhdojnë të jenë objekt kritikash nga teoricienë të shumtë, qofshin këta historianë, filozofë apo studiues të shkencave shoqërore.


HISTORIANI SI KRIJUES I FAKTEVE

Historia si dije ka për mision të zbardhë të kaluarën, duke na i rrëfyer ngjarjet sipas një metode të besueshme njohjeje. Ajo e bën të mundur këtë nëpërmjet dëshmimeve dhe dokumenteve të trashëguara, të cilat përbëjnë materialin faktik mbi të cilin ndërtohet rrëfimi dhe interpretimi i së shkuarës. Duke hetuar faktet, historianët përpiqen të ndërtojnë një të vërtetë bindëse. Mirëpo faktet janë shumë, sidomos kur flitet për periudha të vona dhe asnjë historian apo projekt studimor nuk mund t'i shterojë ato deri në fund. Atij i duhet gjithsesi t'u përzgjedhë ato, t'i rendisë, t'iu japë

vlerë e në fund t'i interpretojë për t'i bërë të vlefshme nga pikëpamja studimore.

Pra historiani është i detyruar të jetë selektiv. Në morinë e fakteve ai merr në konsideratë disa prej tyre dhe le në planë të dytë, ose edhe jashtë vëmendjes, disa të tjera. Natyrisht që selektiviteti bëhet mbi bazë të një paragjykimi,

IDEOLOGJITË



Vetë ideologjitë e ngurta dhe totalitare i paaftësojnë individët të korrigjojnë pikëpamjet e tyre në raport me realitetin apo përballjen me pikëpamje të tjera alternative. Ata fortifikojnë strukturën konceptuale dhe koherencën logjike të vetë ideologjisë, duke vendosur barriera ndaj çdo ideje të huaj që vjen nga jashtë, qoftë nëpërmjet fakteve, qoftë nëpërmjet debatit. Kjo i bën ata të hyjnë në një rrugë pa kthim. Ata nuk mund të hapen dot ndaj të vërtetave të tjera, përtëj intransegjencës së tyre teorike.

prej të cilit zë fill rrjeta e interpretimeve të së shkuarës. Më pas ai i rendit ato sipas një skeme interpretimi dhe u jep atyre peshë, në bazë të sistemit të tij të vlerësimit. Kjo e bën historinë një shkencë tepër subjektive, duke i lënë hapur derën abuzimit.

Epistemologët, tanimë edhe shumë historianë, na kanë treguar se faktet në vetvete janë mece. Ato nuk na thonë asgjë jashtë një skeme interpretimi, gjë që do të thotë se jemi ne që u japim atyre zë: faktet mund të thonë atë çfarë ne duam. Ne mund t'u vëmë atyre në gojë fjalët tona, t'i bëjmë ato të pohojnë të vërtetat tona, bindjet tona, qëndrimet tona. Në njëfarë mënyre faktet janë krijime të interpretimit, që do të thotë se ato i krijojnë historianët, më shumë sesa na i ofron objektivisht e kaluara. Ajo çfarë na ofrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga e kaluara janë vetëm burimet. Ato kthehen në fakt në momentin kur ne i vendosim në skemën tonë të interpretimit. Ato marrin kuptim vetëm kur përdoren dhe, natyrisht, vetë përdorimi u përcakton atyre, në një masë të madhe, edhe kuptimin që marrin.

Francis Bradley është nga të parët që themeloi shkollën kritike të historisë duke vënë në plan të parë vetë historianin. Sipas tij, historiani gjykon duke u mbështetur mbi një eksperiencë të tijën. Ai nuk i qaset dot objektit jashtë kësaj eksperiencë dhe ai nuk mund të jetë një qenie e zhveshur totalisht nga çdo subjektivitet kur trajton të kaluarën. Ai nuk është thjesht një pasqyrë e fakteve, por ai ndërhyr mbi to, duke i interpretuar ato mbi bazë të eksperiencës së tij. Vetë dëshmitë kanë nevojë për interpretim, që të mund të marrin vlerë historike dhe është puna e historianit që ua jep këtë vlerë. Kjo do të thotë se ka një marrëdhënie midis subjektit dhe objektit në studimin historik dhe kjo e bën atë të mos jetë një shkencë objektive, siç janë p.sh. shkencat e natyrës.

Dekada më vonë Michael Oakeshott e rimerr këtë tezë duke zhvilluar idenë se në

thelb të eksperiencës së historianit qëndron mendimi. Ai ka aftësinë t'i japë formë eksperiencës së tij, e madje edhe ta ndryshojë atë. Për këtë arsye Oakeshott mendon se eksperiencia historike duhet ringjallur nëpërmjet mendimit. Historia nuk është, sipas tij, një botë ngjarjesh objektive të së kaluarës, historia është bota e ideve të historianit, i cili organizon ndërgjegjen e tij në raport me ngjarjet. Në këtë mënyrë, kritikizmi i njohjes historike nuk qëndron te zbulimi i fakteve të reja, por te rishikimi i postulateve nëpërmjet të cilave i kemi interpretuar këto fakte. Për rrjedhojë, zgjerimi i dijes sonë mbi të kaluarën buron nga transformimi i ideve tona për shkak të zhvillimit të mendimit. Janë idetë e reja që na sugjerojnë lexime të reja mbi të shkuarën dhe natyrisht metoda të reja njohjeje dhe skema të reja interpretimi.

Një prej elementeve themelore që ndan një historian profesionist nga një i tillë ideolog është pikërisht vetëdija mbi subjektivitetin e kësaj shkence. Objektiv është ai që është i vetëdijshëm mbi kushtëzimet metodologjike të historisë si shkencë, ndaj dhe përgjithësisht kjo kategori historianësh nuk i ofron leximet e veta të fakteve si të vërteta shteruese të pakontestueshme. Përkundrazi, historianët dogmatikë, siç janë përgjithësisht edhe historianët shqiptarë, të paçliruar ende prej mendësive totalitare ku janë formuar, i paraqesin rrëfimet e tyre si të vërteta faktike, objektive e përfundimtare. Ata nuk arrijnë të ndajnë pikëpamjet e tyre nga faktet në vetvete dhe vështrimin e tyre mbi të kaluarën e paraqesin si të jetë vetë e kaluara.

Vetë ideologjitë e ngurta dhe totalitare i paaftësojnë individët të korrigjojnë pikëpamjet e tyre në raport me realitetin apo përbaljen me pikëpamje të tjera alternative. Ata fortifikojnë strukturën konceptuale dhe koherencën logjike të vetë ideologjisë, duke vendosur barriera ndaj

FAKTET DHE BURIMET

Epistemologët, e tanimë edhe shumë historianë, na kanë treguar se faktet në vetvete janë memece. Ato nuk na thonë asgjë jashtë një skeme interpretimi, gjë që do të thotë se jemi ne që u japim atyre zë: faktet mund të thonë atë çfarë ne duam. Ne mund t'u vëmë atyre në gojë fjalët tona, t'i bëjmë ato të pohojnë të vërtetat tona, bindjet tona, qëndrimet tona. Në njëfarë mënyre faktet janë krijime të interpretimit, që do të thotë se ato i krijojnë historianët, më shumë sesa na i ofron objektivisht e kaluara. Ajo çfarë na ofrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga e kaluara janë vetëm burimet. Ato kthehen në fakt në momentin kur ne i vendosim në skemën tonë të interpretimit. Ato marrin kuptim vetëm kur përdoren dhe, natyrisht, vetë përdorimi u përcakton atyre, në një masë të madhe, edhe kuptimin që marrin.

çdo ideje të huaj që vjen nga jashtë, qoftë nëpërmjet fakteve, qoftë nëpërmjet debatit. Kjo i bën ata të hyjnë në një rrugë pa kthim. Ata nuk mund të hapen dot ndaj të vërtetave të tjera, përtej intransegjencës së tyre teorike.

Për këtë arsye, shohim që historianët shqiptarë janë të ngurtë dhe aspak tolerantë. Ata janë të prirur të mos pranojnë diversitetin dhe të vënë gardhe për të mos lejuar të renë të depërtojë në debatin publik. Ata sulmojnë në terma luftarakë këdo që nuk bindet mbi të vërtetat e tyre, duke shantazhuar me një gjuhë linçimi cilindo që guxon të dalë nga vatha e tyre e interpretimeve. Kjo është arsyeja përse ata janë konfliktuar në mënyrën më absurde dhe qesharake, me shumë historianë të huaj që e lexojnë dhe shkruajnë ndryshe historinë e Shqipërisë. Kjo vjen pikërisht për shkak të paaftësisë së tyre për të operuar në një terren pluraliteti, si dhe për

shkak të paaftësisë së tyre për t'u vetëdijesuar mbi kufizimet teorike e metodologjike të fushës që ata studiojnë. Duke mbetur në kategoritë e tyre teorike ata nuk lejojnë asnjë hapësirë për ide të reja që i hapin udhë zhvillimit të mendimit historik.

HISTORIA, PAVDEKËSIA DHE KUPTIMËSIA

Hannah Arendt ofron një tablo interesante të mënyrës sesi e konceptojmë sot historinë, në dallim nga ajo çfarë konceptohej në antikitet dhe shoqëritë tradicionale. Ajo ekspozon një tablo interesante të faktit që mënyra sesi e përfytyrojmë historinë lidhet fort me mënyrën sesi konceptojmë natyrën. Duke iu referuar Herodotit ajo nxjerr në pah se rrëfimi historik në antikitet kishte për qëllim përjetësimin e bëmave të heronjve në një botë ku njeriu është i vdekshëm dhe heronjtë nuk i kemi

më pranë. Nëpërmjet kujtesës historia iu jep pavdekësi bëmave të heronjve, duke bërë që lavdia e tyre të mbesë në shekuj. Sipas konceptit grek natyra është e pavdekshme përkundër njeriut që është i vdekshëm si individ. Gjithçka në natyrë, me përjashtim të njeriut, është e përjetshme dhe vetëm kujtesa arrin t'u japë pavdekësi bëmave të vdekatarëve.

Ardhja e Krishterimit sjell një koncept të ri për natyrën, e për rrjedhojë edhe një konceptim tjetër mbi historinë. Situata përmbysset. Tashmë nuk është më bota e pavdekshme. I pavdekshëm është vetëm njeriu. Jeta e tij konsiderohet tashmë e shenjtë, ndërsa bota, si çdo gjë tjetër, është e fundme. Rrjedhimisht nevoja për madhështi dhe përjetësimin e saj si në antikitet humbet. Arendt thotë se epoka e krishterë ndryshoi konceptimin ciklik të rrjedhës së historisë, duke futur konceptimin drejtvizor të saj, siç e gjejmë tek Agustini. Historia tashmë ka një mision: shpëtimin e njeriut dhe kjo bëhet e mundur falë ndërhyrjes së Zotit në të. Përtej historisë së mëkatit, apo edhe thjesht historisë profane të pavlerë, ka edhe një histori si gjurmë e Zotit në funksion të shpëtimit të njeriut.

Epoka moderne përmbys gjithçka duke sjellë një konceptim krejt tjetër. Ajo ruajtja kahjen e zhvillimit drejtvizor dhe mesianizmin e konceptit të krishterë, por riktheu konceptimin e njeriut si vdekatar,

ndërkohë që riktheu laicizimin e historisë duke përjashtuar ndërhyrjen e Zotit në të. Ajo solli një pikëpamje të re, ku historia filloi të konceptohet si një proces dhe kjo, sipas Arendt, është dika krejt ndryshe që gjendet vetëm në epokën moderne e që sjell transformime të mëdha.

Në një proces asgjë nuk ka kuptim të pavarur, si dhe asgjë nuk mbetet të jetë e pakuptimtë. Veprimet individuale njerëzore, të konsideruara vanitoze në vetvete prej Kantit dhe të tjerëve, fillojnë e marrin kuptim pasi ato perceptohen se janë pjesë e një tërësie zhvillimesh që përfshin gjithçka. Pra qeniet njerëzore, në mënyrë të pavullnetshme, janë në shërbim të një plani natyror drejt të cilit shkon pa e kuptuar i gjithë njerëzimi. Historia nuk është më ajo e bëmave të njeriut, por një proces i krijuar prej tij në bazë të disa ligjësisë që gjenden thellë në natyrën njerëzore. Historia bëhet kështu mesianike, ndonëse laike. Ajo shpëton jo vetëm prej pakuptimësisë dhe kotësisë së jetës individuale njerëzore, por edhe prej problemit të vdekjes.

Arendt vëren se ky ndryshim erdhi si pasojë e një konceptimi të ri mbi natyrën. Në rast se në antikitet natyra ishte e pavdekshme ndërsa njeriu i vdekshëm dhe në krishterim njeriu ishte i pavdekshëm, ndërsa natyra e vdekshme, në modernitet kemi një konceptim tjetër: natyra dhe njeriu janë të dy të vdekshëm. Ndryshe nga epoka e krishterë, gjatë rilindjes pati një ndarje ku natyra shihej si vepër e Zotit, ndërsa historia si vepër e njeriut. Ideja e panjohshmërisë dhe paprekshmërisë së natyrës filloi të bjerë gradualisht derisa filloi të ngulitej bindja se njeriu mund ta vërë atë nën kontroll.

E njëjta gjë mund të ndodhte edhe me historinë. Njeriu mund të vërë në kontroll historinë duke iniciuar tashmë procese të vullnetshme. Kjo i hap udhë inxhi-

“ Njeriu mund të vërë në kontroll historinë duke iniciuar tashmë procese të vullnetshme. Kjo i hap udhë inxhinierisë njerëzore dhe projekteve ideologjike totalitare në përpjekje për krijimin e një bote të re.

nierisë njerëzore dhe projekteve ideologjike totalitare në përpjekje për krijimin e një bote të re. Fundi i historisë është rrjedhojë logjike e kësaj mënyre të menduari. Historia e ka një cak. Ai është momenti i pashmangshëm i një rrjedhe ku njeriu arrin të përmbushë misionin e tij, gjë që bën që procesi të ndalet dhe bashkë me të edhe qëllimësia, e cila tashmë është arritur.

HISTORIOGRAFIA SHQIPTARE SI MISION

Një konceptim i tillë i historisë bëhet truall i mirë për çdo lloj ideologjie duke qenë i adaptueshëm lehtësisht me skemat e tyre të interpretimit. Ideja e një historie që zhvillohet si proces, e cila ka një mision e madje edhe një fund, mund të gjejë ilustrim në shpëtimin iluminist nëpërmjet arsyes, idenë e marshimit të progresit njerëzor, triumfin e proletariatit në luftën midis klasave, triumfin e racës superiore në përmirësimin gjenetik të botës, apo edheshpëtimin e njerëzimit nëpërmjet zhvillimit të teknologjisë, inteligjencës artificiale e riprodhimit të jetës në laborator. Tundimi mbetet ndonëse përvojat e gjysmës së parë të shek. XX na ofrojnë fakte tronditëse, si pasojë e këtyre ideve.

Një konceptim i tillë i historisë si proces konstatohet edhe në mendimin historik shqiptar. Historiografia shqiptare gjatë periudhës së Enver Hoxhës ishte plotësisht ideologjike e totalitare, ku në themel të misionit historik ishte lufta e klasave dhe fitorja



përfundimtare e proletariatit që shpie historinë drejt fundit të saj me vendosjen e rendit komunist. Por përtej kësaj kemi paralelisht edhe zhvillimin e një mesianizmi lokal në perceptimin e historisë shqiptare në vetvete.

Sipas ideologjisë zyrtare, natyrisht edhe historiografisë, historia e popullit shqiptar ishte një proces që merr hovin e vet kryesor në periudhën e Skënderbeut dhe zhvillohet përgjakshëm deri me lindjen e Partisë Komuniste, ku tashmë, me ardhjen e saj në pushtet, luhet finalja e madhe drejt instalimit të rendit komunist dhe industrializimit të plotë të vendit. Shqipëria po bëhej një “fanar ndriçues”, e vetmja që ndiqte me përpikëri mësimet e marksizëm-leninizmit e që

MASHTRIMI

Historia bëhet mashtruese, mbi të gjitha, kur studimi historik ka për bu-sull ideologjitë, sidomos ato totalitare. E shtrënguar nëpër skemat e tyre interpretative, ajo shndërrohet nga një dije mbi të kaluarën, në një projekt politik të veshur me kohë, ku ngjarjet e rrëfyera tërhiqen prej së tashmes në mënyrë prapavepruese. Ideologjia e shndërron historinë nga një burim i rëndësishëm njohjeje në një mjet spekulativ në shërbim të një veprimtarie të tashme. Ideologjia e orienton keq interpretimin historik. Kuptimi i ngjarjeve është caktuar përpara se ato të merren në analizë dhe detyra e historianit mbetet vetëm t'i rrëfejë ato në atë mënyrë që të përforcojë atë çfarë është paracaktuar. Historiani në këtë rast nuk i vëzhgon dhe i rrëfen ngjarjet, por i monton në atë mënyrë që të nxjerrë përfundimin e kërkuar. Ai e sajton të shkuarën për t'i dhënë kuptim së ardhmes që parashtron ideologjia. E gjithë kjo bëhet një gënjeshtëri e rrezikshme.

shumë shpejt do të konsiderohej si një model për të gjitha vendet në botë. Shqipëria po i printe kështu të gjithë botës në rrugën drejt zhvillimit dhe rendit komunist të përkryer.

Procesi historik perceptohet i ndarë në dy periudha: atë para erës sonë dhe në atë të erës sonë që nis me Skënderbeun dhe përfundon me Enver Hoxhën. Ky i fundit është shpëtimtari që bën të mundur realizimin e misionit, duke i dhënë fund një seriali të gjatë të epopesë së një populli që “e ka çarë udhën e historisë me shpatë në dorë”.

Ky konceptim i historisë si proces me një mision të madh final ka mbetur ende në perceptimin e shumë historianëve dhe intelektualëve shqiptarë edhe pas viteve '90, ndonëse disi më me këmbë në tokë krahasuar me delirin komunist. Shqiptarët shihen prej tyre si një popull i lashtë (më i lashti në Europë) i cili i ka mbi-jetuar furtunave të kohës, deri në mbërritjen e një ere të re që nis me

Skënderbeun dhe, pas një epepe të gjatë e të përgjakshme 6-sheku-llore, pritet të përmbillet me fi-nalën e madhe, momentin kur Shqipëria do të hyjë në Bashkimin Europian. Natyrisht na mungon një hero mitologjik i ditëve tona, por, në mungesë të dikujt me për-masat e duhura për të zëvendë-suar Enver Hoxhën, heroi mbetet vetë populli mitologjik shqiptar, i cili prej 600 vjetësh mban gjallë istikamin në një luftë titanike për të mbetur në përendim!

Edhe këtu ne kemi gjithashtu një mision me rëndësi në Europë. Zëra të shumtë intelektualësh dhe politikanësh pretendojnë se ne mund t'u mësojmë europianëve tolerancën fetare, si një vlerë që, mesa duket, e kanë shpikur dhe e ruajnë vetëm shqiptarët. Nga ana tjetër shqiptarët konsiderohen si shpëtimtarët e Europës, duke e mbrojtur atë në momentin më të vështirë, gjatë ekspansion-it osman, në luftën e lavdishme të Skënderbeut. Pa shqiptarët ndoshta sot nuk do kishte Europë

dhe kjo është arsyeja përse ata e meritojnë më shumë se kushdo për të qenë pjesë e familjes së madhe europiane.

KËRCËNIMET E HISTORISË

Narrativi historik i paraqitur nëpërmjet ideologjive mesianike mund të bëhet i rrezikshëm. Ai kërcënon të ardhmen duke ndërhyrë në rrjedhën e historisë, për t'i dhënë kahjen që dëshiron. Ai ndërhyrë në gjakun tonë duke ndezur tërbimin e ndjeshmërive identitare, kulturore e politike. Ai na josh me ideale të rreme që thithin energjinë dhe pasionin tonë. Historia mbahet fort midis premtimit dhe kërcënimit. Ajo premtton një parajsë imagjinare që i shkund njerëzit drejt revolucioneve të përgjakshme, por ajo edhe kërcënon me ferrin e luftës dhe despotizmit, duke trazuar qetësinë e turmave. Frika dhe joshja janë burimet kryesore të krimeve, individuale apo kolektive dhe një motivacion i fortë për gjithçka të paimagjinueshme në kushte normale.

Në sytë e Edgar Morin-it qytetërimi evropian ra në këtë krizë në kulmin e fuqisë së vet. Sipas tij, shenjat ishin dhënë që në fund të shekullin e XIX me përhapjen e skepticizmit dhe relativizmit. Brenda gjirit të kulturës evropiane, humanizmi, arsyeja, shkenca ishin bërë objekt shqyrtimeve kritike duke lëvruar pikëpamje që sillnin kriza. Schopenhauer-i, me thirrjet për dorëzim, e më pas Nietzsche, dhanë alarmet e para mbi mbër-

ritjen e papërballueshme të nihilizmit. “Shembja vetëvrasëse e Evropës, - thotë Morin, - përkon me krizën e humanizmit, arsyes dhe progresit. Në fillim filozofia, mandej edhe vetë shkenca, pikërisht në momentin e triumfit të vet më të shkëlqyeshëm, zbulojnë brishtësinë e parakuptimeve të veta”.

Nihilizmi ushqehet, ndër të tjera, edhe nga vetë konceptimi i historisë si një proces. Një kategori mendimtarësh, si Hegel apo Marks, ofrojnë një panoramë ironike mbi realitetin njerëzor, të cilin e shohin si të paaftë për të njohur forcat impersonale të historisë, që arrijnë një moment kur, në pavarësi nga vetëdija e njerëzve për to, iniciojnë përmbyesje kataklizmike të pashmangshme për të dalë në një etapë tjetër më të zhvilluar. Isaiah Berlin pikas në shkrimet e tyre një ndjenjë kënaqësie të hidhur teksa përfytyron rënien dhe shkatërrimin e plotë të njerëzve, burra e gra, të përfshirë nga vobullat e historisë. Ata përshkruajnë, jo pa përbuzje, përpjekjet e njerëzve të rëndomtë për të ndërtuar jetën e tyre të thjeshtë, shtëpitë e tyre, vlerat, kulturën, duke besuar se këto vlera, rendi i tyre social, ekonomik e shoqëror, janë të përhershëm. Por ata nuk e kuptojnë se një vullkan po bëhet gati të shpërthejë mbi ta për të zhbërë gjithçka që ata kanë, shtëpitë, institucionet, idealët, zakonet, vlerat, duke e çuar njerëzimin drejt një etape të re. Të dy profetët e historisë mbeten duke soditur katastrofën plot ironi



Narrativi historik i paraqitur nëpërmjet ideologjive mesianike mund të bëhet i rrezikshëm. Ai kërcënon të ardhmen duke ndërhyrë në rrjedhën e historisë, për t'i dhënë kahjen që ai dëshiron.

e një përcëim sfidues.

Ky koncept i një historie që ecën sipas një plani kozmik bart jo vetëm urrejtje, por edhe themelet e një qëndrimi përjashtues. Berlin thekson se, sipas filozofisë hegeliane e marksiste, të jesh i mençur do të thotë të kuptosh se ku po shkon bota, për t'u rreshtuar në anën e fuqive që çajnë rrugën drejt botës së re. Marksi, madje, përcakton se hakmarrja e historisë e cila bën pluhur e hi të gjitha folletë mjerane të thenglave njerëzore, është plotësisht e drejtë, sepse e drejta dhe e padrejta, e mira dhe e keqja përcaktohen nga qëllimi drejt të cilit shkon gjithçka që është krijuar. Gjithçka që ndodhet në anën e arsyes ngadhënjimtare, sipas tij, është e drejtë, ndërsa gjithçka në anën e kundërt është e marrë, e paditur, subjektive, arbitrare dhe e verbër. Madje, në qoftë se këta dritëshkurtër e batakinj guxojnë t'u kundërvihen këtyre forcave të paracaktuara, ata mund të quhen me të drejtë, "reaksonarë, të poshtër, obskurantistë, armiq të ndyrë të interesave themelore dhe të vërtetave të njerëzimit".

Kemi këtu tharmin e një filozofie të dhunës, e cila - sidomos duke shtuar edhe rolin e veprimit njerëzor në histori dhe të revolucionit si instrument determinues drejt hopit vendimtar, siç e gjejmë tek Marksi - i hap derën kriminalitetit e madje edhe terrorit. Kjo lloj idhujtarie ndaj historisë, e shprehur në termat e Aronit, është dera prej nga revolucionarët shkojnë drejt legjitimitimit të dhunës. Sipas tij, qëllimi i amshuar përlligj mjetet e tmerrshme. Duke luftuar në emër të një ideali, ata janë gati të bëjnë gjithfarë kompromisi e të shkelin parimet e tyre. Miti i revolucionit ndërton një urë ndërmjet papajtueshmërisë morale dhe terrorizmit. Aron thotë se ndërgjegjja historike na mëson të respektojmë tjetrin edhe kur e luftojmë, ndërsa adhuruesi i historisë as e sheh dhe as që kërkon të shohë të tjetri tjetër gjë veç një armiku, i


cili duhet zhdukur e përbuzur, sepse nuk është i aftë të dojë e të njohë të mirën. Kjo vjen sepse, për të nuk ka të mirë tjetër përveç asaj të ideologjisë së tij.

* * *

Historiografia shqiptare, ashtu si mendimi historicist shqiptar, është i ngjizur në një truall të tillë ideologjik. Ajo është krijuar si një instrument për legjitimimin e një regjimi dhune me pretendime mesianike, ndaj dhe raporti i saj me pluralitetin është problematik. Edhe sot, pas gati 3 dekadash nga rënia e regjimit, historianët shqiptarë vazhdojnë ta rrëfejnë të kaluarën mbi kategoritë mik/armik, e jo vetëm kaq, por në të njëjtën mënyrë ata gjykojnë edhe kolegët e tyre, të huaj e shqiptarë, që e lexojnë ndryshe historinë e Shqipërisë. Sidomos për tema të nxehura, me ndikim të ndjeshëm mbi realitetin e sotëm shoqëror e politik, si p.sh. Lufta Nacional-Çlirimtare, standardet e vlerësimit të tyre ndërkëmbehen duke ruajtur atë konfigurim që pengon një qëndrim të drejtë ndaj të shkuarës së regjimit të kaluar.

Bie fjala, forcat nacionaliste të Ballit Kombëtar apo ato të Legalitetit gjykoohen me kategori prapavepruese, mbi bazë të faktit se ato na rreshtuan me kampin humbës të Luftës së Dytë Botërore, përkundër forcave partizane që na rreshtuan me kampin fitues, ndonëse kur u bë ky rreshtim (nëse ekziston një i tillë, pasi në realitet ky është një mit i historiografisë komuniste) askush nuk mund ta dinte se kush do ta fitonte luftën. Ndërkaq, forcat partizane nuk gjykoohen me të njëjtin standard për faktin se na rreshtuan me bllokun lindor dhe jo atë perëndimor, duke e mbyllur me turp atë histori rivaliteti e tensionesh që merr fund me rënien e murit të Berlinit dhe rrëzimin domino të të gjitha sistemeve komuniste në Europë.

GJYKIMI



Fakti që një kategori e madhe historianësh shqiptarë gjykojnë në të njëjtën mënyrë, si personazhet historike që studiojnë ashtu edhe kolegët e tyre që nuk pajtohen me ta, tregon se ata vetë janë të ngërthyer brenda objektit të tyre të studimit. Pra historia për ta nuk është thjesht një objekt studimor për t'u zbardhur me objektivitet, por një fushëbetejë për t'u fituar, në funksion të interesave të grupit shoqëror e politik ku vetë ata bëjnë pjesë.

Vetë vlerësimi sipas standardit fitues/humbës është tregues i një mendësie që nuk operon mbi terma të një gjykimi kontekstual, mbi parimet e neutralitetit moral apo të një morali universal mbi të drejtën. Përkundrazi, ata gjykojnë sipas një morali instrumental, sipas të cilit e pafalshme nuk është dhuna, krimi, padrejtësia, por humbja dhe dështimi. E drejta, sipas tyre, njësor si në etikën marksiste në raport me forcat impersonale të historisë, është ajo çfarë përcakton fituesi. Ai është gjykatësi suprem i historisë.

Fakti që një kategori e madhe historianësh shqiptarë gjykojnë në të njëjtën mënyrë si personazhet historike që studiojnë, ashtu edhe kolegët e tyre që nuk pajtohen me ta, tregon se ata vetë janë të ngërthyer brenda objektit të tyre të studimit. Pra historia për ta nuk është thjesht një objekt

studimor për t'u zbardhur me objektivitet, por një fushëbetejë për t'u fituar, në funksion të interesave të grupit shoqëror e politik ku vetë ata bëjnë pjesë. Për këtë arsye, jo vetëm ballistët, por edhe historianët që nuk i mbajnë iso linjës zyrtare të sanksionuar prej tyre, janë armiq. Mitet, klishetë, skemat konceptuale mbeten më tej mjetet e shantazhit, nëpërmjet të cilave kjo kategori historianësh e intelektualësh i përdor për të ndërsyer publikun ndaj kujtdo që del kundër.

Në kushte të tjera e në një tjetër situatë politike nga kjo që kemi, kjo lloj gjuhe dhe kjo lloj logjike në mos do të çonte në luftë do të shërbente për mrekulli si instrument legjitimimi për projekte politike kriminale, siç zaten i ka shpërblyer për dekada një projekti të tillë terrorist si ai i Enver Hoxhës.

HISTORIA ESENCIALE

SI RRUGË E TRETË MIDIS MITIT DHE LOGOSIT



KLEMENTIN MILE

EKZISTENCA E HISTORISË ËSHTË DIÇKA FAKTIKE, e cila nuk vihet ndo- njëherë në dyshim. Por si ekziston historia? Cilat janë kushtet e mundësisë së saj? Këto pyetje, në dukje të tepërta dhe të kota, kanë për qëllim ta problematizojnë fakticitetin e fenomenit të historisë dhe, duke e problematizuar, të hedhin dritë mbi të.

Martin Heidegger, në shumë prej veprave të tij, bën dallimin ndërmjet mitit dhe logosit, duke treguar se ky dallim qe vendimtar për itinerarin kulturor të Perëndimit. Kjo tezë konfirmohet edhe nga filozofi bashkëkohor gjerman Peter Sloterdijk, kur shkruan se në Perëndim gjen mendim pa zgjim, ndërsa në Lindje zgjim pa mendim. Po të përdorim shprehjen e Kantit për të karakterizuar problemin e Perëndimit, mund të thonim se ai është bosh, na ofron vetëm koncepte (konceptet pa intuita janë bosh). Nga ana tjetër, edhe ata që na shtynë drejt Lindjes duhet të mbajnë parasysh që Lindja është e verbër (intuitat pa koncepte janë të verbra). Sigurisht, boshësia dhe verbëria, ashtu siç i ka përdorur Kanti, janë metafora. Por, edhe si të tilla, ato arrijnë të shprehin problemet e thella që ekzistojnë



në Perëndim dhe në Lindje.

Këto probleme manifestohen edhe te çështja e historisë. A duhet të jetë historia një narrativë e ngjarjeve të ndodhura në të shkuarën, apo të shpaloset si manifestimi i jashtëm dhe i dukshëm i një logjike funksionale të brendshme dhe të padukshme? Cila është pra lënda e duhur e historisë, miti apo logosi?

Dallimi i mitit nga logosi shprehet në disa kuptime. Kështu, ndërsa miti është narrativë, logosi është logjikë; ndërsa miti është fjalë e autonomizuar (Roland Barthes),

Por a ka një alternativë të tretë për historinë, e cila të mund ta kapërcejë dallimin e mirëvendosur ndërmjet mitit dhe logosit, paramodernes dhe modernes? **Rruga e tretë është një histori esenciale, ose ngjizëse. Ajo nuk synon vetëm të përshkruajë ngjarjet, por edhe të tregojë referencat e këtij përshkrimi.** Në këtë kuptim, historia esenciale nuk është thjesht deskriptive, por edhe normative.



logosi është fjalë e prodhuar nga procesi i arsytimit; dhe ndërsa miti është natyrë, logosi është kulturë. Ky aspekt i fundit është me rëndësi vendimtare për çështjen e historisë. Kjo pasi është korrekt pohimi se në natyrë nuk ka histori. Nga ana tjetër logosi, duke qenë kulturë, mbetet të jetë njëkohësisht histori. Prandaj dallimi ndërmjet mitit dhe logosit arrin në konkluzionin se historia mund të jetë vetë logos (logjike), por kurrë mitike.

Ky argument është rimarrë edhe në projektin e modernitetit, i cili, po t'i besojmë Bru-

no Latourit në librin e famshëm të tij “Ne nuk kemi qenë kurrë modernë”, ka në thelbin e vet pastrimin e natyrës nga elementet kulturore (dhe historike) dhe pastrimin e kulturës (dhe historisë) nga elementet natyrore. Me fjalë të tjera, moderniteti nuk është gjë tjetër veçse divorci i plotë i mitit nga logosi. Në modernitet historia shihet e mundshme vetëm si logos. Latour na thotë, megjithatë, se ky ideal divorci nuk është arritur kurrë plotësisht dhe hedh dyshime në mund të arrihet ndonjëherë.

Nga ana tjetër, fakti që vetë moderniteti është thjesht dhe vetëm një fazë e historisë së



njerëzimit duhet të na bëjë ta shohim projektin modern jo si fjalën e fundit në këtë çështje. Kjo do të thotë që ka edhe mënyra të tjera për ta shkruar historinë, të cilat e kapërcejnë kuadrin modern. Nuk është ideja t'i kthehemi mitit, pasi edhe ky buron nga një epokë historike e caktuar (para-moderniteti), pa ndonjë pretendim për të qenë më pranë së vërtetës historike. Historia, si kur mbështetet te logosi, ashtu dhe kur mbështetet te miti, është njësoj partikulare, lokale dhe reflektuese e paragjytimeve tipike të epokës. Ajo nuk mund të pretendojë vlefshmëri universale dhe gjithmonë do të bëhet objekt i akuzave për përdorim ideolojik ose pragmatik.

Por a ka një alternativë të tretë për historinë, e cila të mund ta kapërcejë dallimin e mirëvendosur ndërmjet mitit dhe logosit, paramodernes dhe modernes? Rruga e tretë është një histori esenciale, ose ngjizëse. Ajo nuk synon vetëm të përshkruajë ngjarjet, por edhe të tregojë referencat e këtij përshkrimi. Në këtë kuptim,

historia esenciale nuk është thjesht deskriptive, por edhe normative. Aspekti normativ nevojitet për t'i mundësuar kuptimin atij deskriptiv, ashtu sikundër nevojitet esenca e diçkaje për të patur ekzistencë të saj.

Shembullin më të mirë të kësaj historie esenciale, por në nivelin ontologjik të qenies, e ka dhënë Heideggeri. Ai flet për epokat e qenies ose, me fjalë të tjera, për mënyrat se si qenia na është dhënë përmes tërheqjes dhe largimit nga ne. Në secilën epokë të përshkruar nga metafizika qenia na ka braktisur duke na lënë në vend të saj qenësorët. Gabimi madhor i metafizikës është pikërisht ngatërrimi i qenies me qenësorët, çka shpreh paaftësinë e saj për ta bërë këtë dallim. “Ky dallim, - thotë Heidegger, - bëhet vetëm në ontologji. Në metafizikë qenia është ngatërruar me qenësorë, të tillë si realiteti, ekzistenca, ideja, substanca, subjekti, energjia, aktualitas, vullneti etj. Rrjedhimisht metafizika si histori e qenies, duke qenë një histori e asgjësimit të qenies, është nihiliste. Vetë historia perëndimore,

DALLIMI MES MITIT DHE LOGOSIT

Martin Heidegger, në shumë prej veprave të tij, bën dallimin ndërmjet mitit dhe logosit, duke treguar se ky dallim që vendimtar për itinerarin kulturor të Perëndimit. Kjo tezë konfirmohet edhe nga filozofi bashkëkohor gjerman Peter Sloterdijk, kur shkruan se në Perëndim gjen mendim pa zgjim, ndërsa në Lindje zgjim pa mendim. Po të përdorim shprehjen e Kantit për të karakterizuar problemin e Perëndimit, mund të thonim se ai është bosh, na ofron vetëm koncepte (konceptet pa intuita janë bosh). Nga ana tjetër, edhe ata që na shtyjnë drejt Lindjes duhet të mbajnë parasysh që Lindja është e verbër (intuitat pa koncepte janë të verbra). Sigurisht, boshësia dhe verbëria, ashtu siç i ka përdorur Kanti, janë metafora. Por, edhe si të tilla, ato arrijnë të shprehin problemet e thella që ekzistojnë në Perëndim dhe në Lindje.

duke patur në bazë të saj metafizikën, është nihilizëm.”

Me fjalë të tjera, edhe logosi ku mbështetet shkrimi modern i historisë ka si destinacion final nihilizmin. Por ne vijojmë përpara pa e kuptuar fare këtë gjë. Një mënyrë për ta shpëtuar historinë nga generatori i saj i asgjësimit është ta konceptosh atë si histori ngjizëse, ose esenciale. Pra ta shohësh si një tërësi kushtesh që janë dhe prandaj diktojnë fatet dhe itineraret e popujve. Me fjalë të tjera, përshkrimi historik i realitetit ka nevojë për normativitetin që dikton esenca e një populli - aktualja ka nevojë për të mundshmen (“E mundshmjë qëndron më lart se aktualja”, shkruan Heidegger), realja ka nevojë për idealen. Idealet do të ishin konteksti që do të shërbente për t’i dhënë kuptim tekstit të ngjarjeve, idealet do të ishin rruga që duhet ndjekur dhe kuti matës i veprimeve tona.

Por si mund të shkruhet konkretisht një histori e tillë? A mund t’i japim dot përgjigje kësaj duke iu referuar rastit të popullit shqiptar? Po

të pyesësh sot një shqiptar se cilat janë idealet e kombit të vet, vështirë të marrësh përgjigje. Po të vësh re mënyrën se si sillet dhe vepron sot shqiptari, vështirë ta lidhësh dot atë me idealet kombëtare. Nuk ndodh e njëjta gjë në vende të tjera. Le të marrim për krahasim Francën. Francezët i njohin mjaft mirë idealet e kombit dhe sjellja e tyre, që nga qytetari i thjeshtë e deri te presidenti francez, duket se orientohet mjaftueshëm nga ato ideale.

Vështirësia për të thënë se cilat janë idealet kombëtare shqiptare prek edhe autorin e këtij shkrimi, për arsye që do të trajtohen më poshtë. Në këto kushte pasigurie për idealet, është e udhës të orientohemi nga elementet bazë të një kombi: flamuri dhe himni. Është e lehtë për francezët: ata kanë tri ngjyra në flamurin e tyre - blu, e bardhë, e kuqe - të cilat simbolizojnë idealet e revolucionit borgjez francez dhe njëkohësisht të republikës franceze - përkatësisht liri, barazi, vëllazëri. Ndërsa në flamurin shqiptar gjen dy ngjyra dhe një formë

ORIENTIMI

Në këto kushte pasigurie për idealet, është e udhës të orientohemi nga elementet bazë të një kombi: flamuri dhe himni. Është e lehtë për francezët: ata kanë tri ngjyra në flamurin e tyre - blu, e bardhë, e kuqe - të cilat simbolizojnë idealet e revolucionit borgjez francez dhe njëkohësisht të republikës franceze - përkatësisht liri, barazi, vëllazëri. Ndërsa në flamurin shqiptar gjen dy ngjyra dhe një formë që kanë nevojë për interpretim. Na është thënë që e kuqja simbolizon gjakun, sakrificën, ndërsa e zeza e shqiptonës nuk duket të ketë domethënie: shqiptonja mund të kishte edhe ngjyrë tjetër, por e zeza mbase i përshtatet më shumë vetë shqiptonës empirike - pra e zeza e flamurit është ikonë, jo simbol. Por vetë shqiptonja, si formë, është simbolike. Fakti që shqiptonja është dykrenare na është thënë se simbolizon gegët dhe toskët të bashkuar në një. Pra kuptimi i flamurit shqiptar duket të jetë 'bashkimi dhe sakrifica'; ideali që përcjell ky flamur është ai i 'sakrificës për bashkim' ose i 'bashkimit përmes sakrificës'.

që kanë nevojë për interpretim. Na është thënë që e kuqja simbolizon gjakun, sakrificën, ndërsa e zeza e shqiptonës nuk duket të ketë domethënie: shqiptonja mund të kishte edhe ngjyrë tjetër, por e zeza mbase i përshtatet më shumë vetë shqiptonës empirike - pra e zeza e flamurit është ikonë, jo simbol. Por vetë shqiptonja, si formë, është simbolike. Fakti që shqiptonja është dykrenare na është thënë se simbolizon gegët dhe toskët të bashkuar në një. Pra kuptimi i flamurit shqiptar duket të jetë 'bashkimi dhe sakrifica'; ideali që përcjell ky flamur është ai i 'sakrificës për bashkim' ose i 'bashkimit përmes sakrificës'.

Këtë ideal e konfirmon edhe himni shqiptar, ku gjen fraza, si: 'të përbashkuar', 'vdes si një dëshmor' etj. Përveç këtyre frazave që shprehin idealin, i pranishëm është edhe termi 'besë', që mbahet si njëra nga vlerat themelore shqiptare, së

bashku me bujarinë dhe mikpritjen (mbase prandaj thuhet 'bukë e kripë e zemër'). E megjithatë, autorit të këtij shkrimi iu desh t'u futej interpretimeve për të kuptuar idealet e kombit të vet. Kjo pasi në Shqipërinë e sotme dhe, ndoshta, edhe në trojet e tjera ku jetojnë shqiptarë, nuk është evidente dhe e vetvetishme se cilat ideale kombëtare duhet t'i orientojnë sjelljet dhe veprimet tona.

Në gjykimin tim kjo gjendje është prodhuar kryesisht nga dy faktorë. Së pari, idealet kombëtare shqiptare - sakrifica për bashkim - nuk udhëzojnë në terma parimorë ndonjë gjë tjetër veç mbrojtjes së kombit me çdo kusht dhe kosto dhe, si të tilla, në kuptimin e filozofisë politike i japin jetë vetëm nacionalizmit. Por nacionalizmi nuk mjafton për të organizuar jetën brenda kombit, ai është indiferent ndaj saj, duke lënë hapësirë për thuajse të gjitha doktrinat politike: fashizmin,

komunizmin, socializmin, libera lizmin e kështu me radhë. Si të thash, ideali i 'sakrificës për bashkim' është apolitik, ai informon vetëm politikën e jashtme, vetëm marrëdhëniet me kombet e tjera. Për informimin e politikës së brendshme nuk ndihmojnë as ato që i quajmë vlera themelore të shqiptarëve: besa, bujaria dhe mikpritja. Këto vlera janë mirëfilli apolitike dhe nuk është bërë ndonjëherë përpjekje serioze për t'i interpretuar politikisht. Përkundër këtyre, ideat franceze të lirisë, barazisë dhe vëllazërisë janë vërtet nocione politike, të tilla që mund të shërbejnë për të gjykuar performancën e qeverive, parlamenteve dhe vetë qytetarëve francezë në raport me to.

Së dyti, këtë gjendje e ka prodhuar muzealizimi i idealeve dhe i vlerave kombëtare. Ndërsa francezët i diskutojnë dhe i riinterpretojnë ideat e tyre, duke nxjerrë kuptime dhe aplikime të reja për praktikën, shqiptarët i vendosin ideat në muze për t'ua treguar të huajve dhe, në këtë mënyrë, i shpëpusin nga sfera praktike, ku këto ideale nuk kanë më fare efekt. Me këtë rast kujtoj një film francez, "Tri ngjyrat", ku riinterpretohen liria, barazia dhe vëllazëria në kontekstin e shoqërisë franceze bashkëkohore. Por, po kështu, kujtoj disa filma shqiptarë që flasin për besën dhe trajtojnë veçanërisht atë pjesë të Kanunit që u duket interesante të huajve, gjakmarrjen. Asnjë riinterpretim të besës nuk gjen në ato filma, por vetëm imazhe ekzotike që 'shesin' në Perëndim.

Përveç kësaj, nuk duhet harruar se gjithçka i nënshtrohet efekteve të kohës, e cila, duke na përballur me sfida të reja, ushtron presion

për t'i ndryshuar mënyrat e vjetra. Kështu, francezët, duke ndryshuar, kanë mbetur të njëjtët; ndërkohë që shqiptarët, duke mbetur të njëjtët, kanë ndryshuar. Është e vështirë të gesh lidhje ndërmjet sjelljes së Isa Boletinit dhe një shtetari shqiptar të sotëm, por ama është shumë e lehtë ta bësh këtë lidhje ndërmjet Napolon Bonarpartit dhe një presidenti francez sot.

Ky shkrim për historinë ngremë shumë pyetje sesa jep përgjigje. Por konkluzioni është i qartë: paaftësia jonë për ta marrë seriozisht idealen, paaftësia për ta lejuar të udhëzojë praktikatat tona sociale dhe politike, na ka lënë pa udhë. Ne, shqiptarët, nuk po arrijmë të bëhemi ata që jemi. Kjo gjendje na ka shpënë drejt besimit se vlen vetëm materialja. Si ta shpjegojmë ndryshe faktin që për të festuar 100-vjetorin e pavarësisë në 2012, nuk u gjet tjetër gjë për t'i bashkuar shqiptarët përveçse një torte gjigande? Gjithçka tjetër që mendohej të kishte vlerë simbolike (bashkuese) - emra, data, ngjarje - prodhoi vetëm konflikt në opinionin publik, ndasi të thella dhe efekte diabolike. Dhe kur materialja propozohet si simbolike, në vend të idealeve, ajo përfundon gjithmonë e abuzuar, e shfityruar dhe e nëpërkëmbur - tamam si ajo torta e pavarësisë. ■

“ Kur materialja propozohet si simbolike, në vend të idealeve, ajo përfundon gjithmonë e abuzuar, e shfityruar dhe e nëpërkëmbur - tamam si ajo torta e pavarësisë.



ARMAND BORA

“Historia është një makth nga i cili po përpiqem të zgjohem”, thotë Stiven, njëri nga personazhet e James Joyce në romanin “Uliksi”. **Gjithë historia e artit botëror është një galeri e pasur me të tilla personazhe: personazhe me marrëdhënie të makthta dhe aspak të paqta me të shkuarën e tyre.** Jo vetëm në letërsi, por edhe në gjini të tjera të artit, kryesisht skenike dhe kinematografike, personazhet e tyre qendrore janë pikërisht kjo kategori individësh.



**DRY IS A
NIGHTMARE
FROM WHICH I AM
TRYING TO AWAKE"**

**HISTORY IS A NIGHTMARE
FROM WHICH I AM
TRYING TO AWAKE¹**

“**H**ISTORIA ËSHTË NJË MAKTH NGA I CILI PO PËRPIQEM TË ZGJOHEM”, thotë Stiven, njëri nga personazhet e James Joyce në romanin “Uliksi”. Gjithë historia e artit botëror është një galeri e pasur me të tilla personazhe: personazhe me marrëdhënie të makthta dhe aspak të paqta me të shkuarën e tyre. Jo vetëm në letërsi, por edhe në gjini të tjera të artit, kryesisht skenike dhe kinematografike, personazhet e tyre qendrore janë pikërisht kjo kategori individësh. Interesi që ka treguar arti, por edhe fusha e shkencës ndaj këtyre individëve, është i kuptueshëm; sa më e trazuar dhe tronditëse të ketë qenë e shkuara e një individi, aq më

interesant bëhet ky personazh për t’i studiuar sjelljen dhe veprimet. Ndikimi dhe roli që luan e shkuara në përcaktimin e sjelljes dhe veprimeve të individit është tashmë një fakt i njohur dhe i pranuar prej të gjitha shkencave që merren me studimin e qenies njerëzore. E shkuara shtrihet si një zgjatim brenda enës të së tashmes duke përgatitur aty brumin e së ardhmes jo vetëm të individit, por edhe të vetë shoqërisë.

Disiplina të ndryshme shkencore japin këndvështrime të ndryshme mbi rolin dhe ndikimin që ka e shkuara. Psikologjia është e interesuar për eksperiencat individuale, për rolin që luan e shkuara tek individi si përcaktuese për sjelljen e tij në shoqëri, duke shpjeguar edhe shkaqet e konflikteve të individit me grupin, komunitetin apo shoqërinë ku jeton. Ndërsa përmes sociologjisë, e fokusuar kjo te marrëdhëniet midis grupimeve të ndryshme brenda strukturës sociale, shpjegohet se si interpretimet e ndryshme të historisë kanë prodhuar deri edhe konflikte midis grupimeve apo etnive të ndryshme.

Shpjegimi sociologjik bëhet edhe më i rëndësishëm kur bëhet fjalë për shoqëri që kanë probleme me njohjen e së shkuarës historike të tyre. Kur një kombi i deformohet historia, i ndryshohet, i shtrembërohet, kur i fshihen dhe i zhduken faktet, kur dëshmitarët nuk kanë guxim të tregojnë të vërtetën historike, kur ata janë

“ Sa më e ulët të jetë njohja që një shoqëri ka për historinë e saj, aq më lehtë arrihet manipulimi i historisë. Nga ana tjetër, **sa më i thellë të jetë manipulimi dha sa më të egra dhe të dhunshme të jenë mjetet dhe format e përdorura për të realizuar këtë manipulim, aq më shumë rritet niveli i mosnjohjes dhe i mosdijes së shoqërisë për të shkuarën e vet** dhe aq më shumë dobësohet kujtesa historike e kombit.



zhdukur dhe persekutuar, kur sajohen ngjarje dhe heronj jo të vërtetë, kur në shkolla dhe librat e historisë propagandohet një histori e gënjeshtërt dhe, për më tepër, kur arti dhe kultura bëhen pjesë aktive në prodhimin dhe shpërndarjen e këtij mashtrimi, atëherë kjo histori e gënjeshtërt qëndron mbi kryet e kombit si një ëndërr e makthtë, prej së cilës shoqërisë i duhet të zgjohet.

Nevoja për të kontrolluar dhe ndryshuar historinë, të shkuarën, të tashmen, madje edhe synimet delirante për të kontrolluar dhe përcaktuar të ardhmen e kombit (karakteristikë e sistemeve me kontroll të lartë mbi shoqërinë), të gjitha këtë janë shpjeguar qartësisht nga shkrimtari i njohur çek, Milan Kundera. Në njërin nga intervistat e tij ai shprehet se: “Njerëzit gjithnjë bërtasin kur

bëhet fjalë për të krijuar një të ardhme më të mirë, por kjo nuk është e vërtetë. E ardhmja është një zbrazëtirë e painteres për askënd. E kaluara është e mbushur me jetë, e gatshme për të na ngacmuar, për të na provokuar dhe për të na fyer; ajo na provokon me dilemën për ta shkatërruar apo për ta rindërtuar. E vetmja arsye se pse njerëzit duan të kenë kontrollin e së ardhmes është për ruajtje të shkuarën.”

Kontrolli mbi të ardhmen dhe të shkuarën bëhen rëndom në emër të një interesi i cili nuk ka asnjë lidhje me shkencën e historiografisë. Përkundrazi, nevoja për të fituar dhe mbajtur me forcë pushtetin politik dhe pushtetin ekonomik janë motivet e vërteta që shpjegojnë arsyen e ndryshimeve dhe shtrembërimeve në historinë e një kombi. Historia


KORRIGJIMI PËRMES ARTIT

Korrigjimi përmes artit i tjetërsimit që vetë arti i ka bërë historisë është një proces i cili kërkon njohjen e duhur mbi raportet e ndërtruara në kohë midis artit dhe historisë. Përdorimi i artit dhe kulturës në funksion të tjetërsimit të historisë nuk është një rast tipik shqiptar, dhe jo vetëm i vendeve që provuan sistemin komunist; për më tepër, nuk është një fenomen i shfaqur kohëve moderne. Shumë kohë përpara se të hidheshin themelet e shkencës së historiografisë, ngjarje dhe jeta e personazheve të rëndësishëm historikë i gjejmë të pasqyruara përmes artit dhe letërsisë. Prej antikitetit na vjen informacion edhe mbi mënyrën se si konceptohej në atë kohë pasqyrimi i ngjarjeve dhe personazheve historike në veprat e artit.

e Shqipërisë, por jo vetëm e Shqipërisë, është një shembull i qartë i nxitjes dhe shtysës që japin motive të tilla për të modifikuar historinë e kombit.

Gjithsesi, për të ndryshuar dhe tjetërsuar historinë e një kombi nuk mjafton vetëm dëshira, vullneti apo nevojat për pushtet. Historia e shoqërisë njerëzore ofron edhe shembuj të tjerë që tregojnë se sado të forta të jenë motivet që nxitin një individ apo një grup për të ndryshuar dhe zhdukur faktet e vërteta historike dhe sado të sofistikuar të jenë mjetet, realizimi i qëllimit për të tjetërsuar historinë varet shumë edhe nga faktorë të tjerë. Dy nga këta faktorë të rëndësishëm janë: shkalla e njohjes që shoqëria ka për historinë e saj deri në momentin kur nis manipulimi, si dhe niveli i kujtesës së shoqërisë. Sa më e ulët të jetë njohja që një shoqëri ka për historinë e saj, aq më lehtë arrihet manipulimi i historisë. Nga ana tjetër, sa më i thellë të jetë manipulimi dha sa më të

egra dhe të dhunshme të jenë mjetet dhe format e përdorura për të realizuar këtë manipulim, aq më shumë rritet niveli i mosnjohjes dhe i mosdijes së shoqërisë për të shkuarën e vet dhe aq më shumë dobësohet kujtesa historike e kombit. Analiza e këtyre dy faktorëve në Shqipëri tregon se studimet historiografike apo në lëmi të tjera të përafërta me historinë kanë qenë të pakta dhe kryesisht të kryera nga të huajt; njohja dhe dija mbi historinë e re dhe të vjetër të Shqipërisë nuk ka qenë e shtrirë thellë në shoqërinë shqiptare dhe, si rezultat, edhe rezistenca e shoqërisë ndaj ndryshimeve të historisë ka qenë fare e papërfillshme, për të mos thënë që edhe vetë shoqëria ka marrë pjesë vullnetarisht në të gjitha këto ndryshime. I gjithë procesi ka qenë politik, ku shkenca e historiografisë dhe disiplinat e tjera vetëm sa kanë certifikuar vullnetin politik, ndërsa arti dhe letërsia kanë promovuar dhe imponuar te masat, me mjetet



dhe format e tij, këtë histori të re.

Përdorimi i artit dhe i letërsisë për të tilla qëllime ka ndodhur edhe në vende të tjera të kampit ish-socialist, madje jo vetëm në këto vende. Në dallim nga vendet e tjera, rasti i Shqipërisë është i veçantë, për faktin se në Shqipëri arti ka qenë tërësisht i kontrolluar, pa asnjë hapësirë për mendimin ndryshe. Mobilizimit, në realizimin e detyrave partiake, iu përgjigjën jo vetëm artistët mediokër, ushtarë të armatës së përdorur vullnetarisht, por pati edhe nga ajo pjesë me vlera e artit shqiptar që e vuri talentin dhe mjeshtërinë e saj në shërbim të mashtimit historik.

Debatet e herëpashershme mbi të shkuarën dhe rolin që kanë luajtur individë të ndryshëm në historinë e Shqipërisë nuk kanë mundur të jenë shte-

ruese dhe me përfundime të pranuarra gjerësisht e nga të gjithë. Vazhdimi i mosdakordësisë, fillimisht prej politikës dhe më tej prej qarqeve akademike dhe opinionit publik, prodhon natyrshëm mosdakordësi edhe mbi idenë se si dhe sa janë përdorur arti dhe artistët për manipulimin dhe tjetërsimin e historisë. Fatkeqësisht, debati i zhvilluar mbi prodhimin artistik të realizuar përpara ndryshimit të sistemit u nxit prej kërkesës së një pjese të shoqërisë për ndalimin e veprave me ngarkesa të forta politike dhe ideologjike, dhe jo si një diskutim fillimisht mbi idenë se si dhe sa ka ndikuar arti dhe letërsia në formimin e stereotipave dhe anësimin në gjykimin mbi historinë e Shqipërisë. Gjithësesi, nga debatet dhe konfliktet mediatike përftohën dy përfundime të rëndësishme. E para,



Liria për të shprehur dhe për të prezantuar të vërtetën e ashtu si ajo duhet të jetë, pavarësisht të vërtetës historike, është shfrytëzuar nga pushtetet në kohë dhe vende të ndryshme për qëllime të mbrapshta në funksion të pushtetit politik dhe ekonomik.

vazhdimi i transmetimit, shpërndarjes dhe promovimit të asaj krijimtarie letrare, kinematografike, teatrore apo arteve të tjera nuk e ndihmon përmbylljen e diskutimit publik. Përkundrazi, ajo krijimtari, e cila vazhdon të shpërndajë të njëjtat mesazhe ideologjike për të cilat edhe u krijua, bëhet shtysë për debate dhe konflikte. E dyta, për korrigjimin e së shkuarës së deformuar nuk mjaftojnë vetëm konferencat dhe studimet shkencore. Përveç vullnetit politik, i cili bëhet i rëndësishëm edhe në këtë rast, nëse arti dhe letërsia, si mjet në dorën e pushtetit, janë përdorur në mënyrë efikase për manipulimin e historisë, atëherë lipset që po përmes artit dhe letërsisë të nisë edhe korrigjimi i këtij deformimi. Një shteti i cili e ka këtë shqetësim dhe kërkon rrugë për të korrigjuar historinë, nuk duhet t'i mungojnë politika të tilla kulturore.

Korrigjimi përmes artit i tjetërsimit që vetë arti i ka bërë historisë është një proces i cili kërkon njohjen e duhur mbi raportet e ndërtuara në kohë midis artit dhe historisë. Përdorimi i artit dhe kulturës në funksion të tjetërsimit të historisë nuk është një rast tipik shqiptar, dhe jo vetëm i vendeve që provuan sistemin komunist; për më tepër, nuk është një fenomen i shfaqur kohëve moderne.

Shumë kohë përpara se të hidheshin themelet e shkencës së historiografisë, ngjarje dhe jeta e personazheve të rëndësishëm historikë i gjejmë të pasqyruara përmes artit dhe letërsisë. Prej antikitetit na vjen informacion edhe mbi mënyrën se si konceptohej në atë kohë pasqyrimi i ngjarjeve dhe personazheve historike në veprat e artit.

Në veprën e tij “Poetika”, Aristoteli, filozof i Greqisë antike, nxjerr në dukje përparësinë që ka poezia ndaj historisë; sipas tij, poezia flet për atë që duhet apo do të duhet të jetë e vërteta, më shumë sesa për atë çka është e vërteta. Duket që Aristoteli jo vetëm që i jep liri artit për pasqyrim të ndryshuar dhe të modifikuar të ngjarjeve historike, por e kthen atë edhe si detyrim të funksioneve të artit. Liria për të shprehur dhe për të prezantuar të vërtetën e ashtu si ajo duhet të jetë, pavarësisht të vërtetës historike, është shfrytëzuar nga pushtetet në kohë dhe vende të ndryshme për qëllime të mbrapshta në funksion të pushtetit politik dhe ekonomik.

Një tjetër filozof dhe moralist i shquar i antikitetit grek, Plutarku, në veprën e të cilit gjenden me shumicë fakte historike mbi ngjarje dhe personazhe të botës së antikitetit greko-romak, i ka dhënë një tjetër detyrim veprës letrare në raport me faktin historik. Plutarku e ka parë artin dhe letërsinë më shumë në funksion të zhvillimit moral të lexuesit sesa si një detyrim për të pasqyruar me vërtetësi faktet historike. Sipas tij, vepra duhet të ketë si qëllim të tregojë shembullin e mirë i cili duhet edhe të ndiqet nga të tjerët. Edhe pse qëllimi mund të jetë pozitiv dhe i vlerësueshëm, anashkalimi i së vërtetës dhe i faktit historik ka ndikuar në mënyrën se si është abuzuar me to duke shtruar rrugën për krijimin e miteve, personazheve të idealizuar dhe atyre heroikë.

KRIJIMI I MITEVE

Periudha me më shumë ndërhyrje e ndryshime mbi historinë e vërtetë dhe me një rol të rëndësishëm në këtë proces të artit dhe të letërsisë është ajo e pas Luftës së Dytë Botërore. Pushteti i vendosur në Shqipëri tregoi, që në vitet e tij të para, një vëmendje të veçantë ndaj artit dhe letërsisë. Krijimi dhe vendosja e të gjitha institucioneve të artit dhe kulturës në shërbim të mbajtjes dhe forcimit të pushtetit, krijimit të miteve të reja dhe kthimit të shoqërisë në turmë pa identitet ishin eksperiencia të cilat pushteti i ri në Shqipëri i gjeti të gatshme dhe të provuara me sukses në vende dhe kohë të ndryshme.

Në kuptimin e saj të vërtetë dhe shkencor, historiografia i njeh fillimet e saj me historianin arab Ibn Khaldun. Vepra e tij “Muqaddimah” (Prezantimi), e njohur edhe me titullin “Prolegomena”, konsiderohet si libri themeltar dhe pararendësi i shkencës moderne të historiografisë.

Një tjetër teori e shkencës së historisë e konsideron historinë e botës jo më shumë sesa biografia e njerëzve të mëdhenj, e heronjve dhe e udhëheqësve që kanë drejtuar popuj dhe kombe. Duket se pikërisht kjo teori, e njohur si teoria e “njerëzve të mëdhenj”, e zhvilluar dhe e përpunuar nga filozofë, të tillë si Hegel, Kierkegaard, Nitçe dhe Max Veber, ka shërbyer për krijimin e miteve heroike në art dhe letërsi.

Në historinë e Shqipërisë dallohen qartë dy periudha ku arti dhe letërsia, duke anashkaluar faktet historike apo edhe duke i ndryshuar ato, ka prodhuar dhe promovuar ngjarje dhe histori larg dhe në ndryshim me të vërtetat historike. Ndonëse motivet, arsyet dhe qëllimet kanë qenë të ndryshme, në shumë raste forma dhe mjetet e përdorura kanë qenë të njëjta. Periudha e parë lidhet me përshkrimin në letërsi dhe arte të tjera të figurës dhe të rolit të Skënderbeut në historinë e Shqipërisë. Periudha e dytë nis me vendosjen e sistemit komunist në Shqipëri dhe për aq kohë sa nuk do të ketë

një gjykim dhe vlerësim shkencor dhe të vërtetë për të gjithë periudhën para dhe pas Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri, do të vazhdojë të shfaqet në forma dhe mënyra të ndryshme.

Në vlerësimin e drejtë të raportit midis artit dhe historisë një rol të rëndësishëm luan të kuptuarit e motivit dhe qëllimeve që kanë nxitur krijuesit për të trajtuar tema dhe personazhe nga historia. Trajtimi i figurës së Skënderbeut nga poetët në periudhën e Rilindjes Kombëtare ka qenë i shtyrë nga nevoja për të krijuar një personazh frymëzues në përpjekje për të krijuar një ndjenje kombëtare. Krijimi i mitit të Skënderbeut si luftëtar i pamposhtur, liridashës dhe atdhetar i shërbeu më shumë nevojës për të nxitur ndjenja dhe karakteristika të tilla mes shqiptarëve sesa qëllimit të pasqyrimin me vërtetësi të personazhit përmes një veprë mirëfilli biografike. Nuk ka pse të mos besojmë se në poemën epike “Histori e Skënderbeut”, autori i saj, poeti i rilindjes, Naim Frashëri të jetë ndikuar nga filozofi dhe shkrimtari skocez Thomas Carlyle. Në frymën e këtij filozofi, i cili njihet për zhvillimin e mendimit se “Historia e botës nuk është gjë tjetër veçse biografia e njerëzve të mëdhenj”, poeti është përpjekur të shkrijë në një historinë e Shqipërisë me atë të Skënderbeut duke e

DISKRETITIMI PËRMES ARTIT

“Mënyra më efektive për të shkatërruar njerëzit është t’u mohosh dhe t’u zhdukësh atyre kuptimin për historinë”, shkruan eseisti dhe shkrimtari anglez George Orwell, pikërisht ajo që ndodhi në Shqipëri pas vendosjes së regjimit komunist. Për regjimin e sapovendosur në Shqipëri shtysa për të shkatërruar kuptimin dhe të vërtetat për historinë ka lidhje vetëm me interesin e tyre për ta forcuar dhe mbajtur gjatë pushtetin.

idealizuar, madhëruar, romantizuar personazhin dhe duke mbledhur te figura e Skënderbeut të gjitha ato karakteristika dhe ideale të cilat autori do të donte t’i kishin shqiptarët; trimërinë, urtësinë, zgjuarsinë, besnikërinë, bukurinë e pamjes, forcën fizike dhe atë morale. Epietet, krahasimet dhe figura të tjera që madhërojnë figurën dhe rolin e Skënderbeut janë lehtësisht të kuptuara në këtë poemë epike:

“Ishte mbret i bukurisë,
si diell epte dritë.....,
... kish të gjitha mirësitë
dhe të tërë urtësinë,
njerëzinë e dituritë
dhe fuqinë e trimërinë.”²

Nga ana tjetër, për të rritur efektin frymëzues ndër shqiptarë, autori nuk ka hezituuar ta vizatojë Perandorinë Osmane si një faktor pengues dhe vështirësues të proceseve zhvilluese për kombin shqiptar. Portretizimi i drejtuesve të perandorisë dhe ushtrive otomane përmes etiketit dhe stigmatizuar si armiq të më të rrezikshëm që ka njohur kombi shqiptar është një imazh që çuditërisht vazhdon të mbizotërojë edhe sot opinionin e

shoqërisë shqiptare mbi atë periudhë. “Dualizimi midis shqiptarëve europianë dhe turqve aziatikë nuk ishte një krijim krejtësisht origjinal i rilindësve shqiptarë. Ai ushqej prej përfytyrimeve orientaliste të kohës, në të cilat bota paraqitej e ndarë midis Perëndimit të përparuar e të qytetëruar dhe Lindjes së prapambetur e barbare. Sikurse vepronin edhe nacionalistët e tjerë ballkanas, rilindësit shqiptarë i shtynin kufijtë e qytetërimit perëndimor më në lindje dhe pretendonin se turqit ishin orientalët, aziatikët, barbarët dhe përgjegjës të kryesorë për gjendjen e mjerueshme të atëhershme të shqiptarëve”, shkruan Enis Sulstarova në librin e tij “Arratisja nga lindja”³. E nisur me poetët dhe artistët e rilindjes kombëtare, trajtimi i periudhës së bashkëjetesës brenda hapësirave të një perandorie të madhe siç ishte Perandoria Osmane si një fatkeqësi kombëtare dhe si burimin e gjithë të këqijave ka vazhduar edhe pas më shumë se një shekulli shkëputje nga ajo perandori, me shkrimtarët dhe artistët e para dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Adresimi tek


ajo periudhë i të gjitha problemeve që gëlojnë sot në shoqërinë shqiptare, futja në debatin publik dhe diskursin politik të figurave dhe krahasimeve që burojnë prej asaj perandorie, fatkeqësisht, e ka bërë të pamundur bërjen e një analize shkencore e cila do të ndihmonte realisht identifikimin e burimit të problemeve dhe rreziqeve të vërteta që e kanë kërcënuar dhe vazhdojnë ta kërcënojnë kombin shqiptar.

Periudha me më shumë ndërhyrje e ndryshime mbi historinë e vërtetë dhe me një rol të rëndësishëm në këtë proces të artit dhe të letërsisë është ajo e pas Luftës së Dytë Botërore. Pushteti i vendosur në Shqipëri tregoi, që në vitet e tij të para, një vëmendje të veçantë ndaj artit dhe letërsisë. Krijimi dhe vendosja e të gjitha institucioneve të artit dhe kulturës në shërbim të mbajtjes dhe forcimit të pushtetit, krijimit të miteve të reja dhe kthimit të shoqërisë në turmë pa identitetet ishin eksperiencat të cilat pushteti i ri në Shqipëri i gjeti të gatshme dhe të provuara me sukses në vende dhe kohë të ndryshme. Në sfidën për të kontrolluar shoqërinë, pushtetet nuk e kanë anashkaluar asnjëherë vlerën që luan në këtë proces kontrolli mbi kuptimin që ka shoqëria mbi historinë.

“Mënyra më efektive për të shkatërruar njerëzit është t’u mohosh dhe t’u zhdokësh atyre kuptimin për historinë”, shkruan eseisti dhe shkrimtari anglez George Orwell, pikërisht ajo që

ndodhi në Shqipëri pas vendosjes së regjimit komunist. Për regjimin e sapovendosur në Shqipëri shtysa për të shkatërruar kuptimin dhe të vërtetat për historinë ka lidhje vetëm me interesin e tyre për ta forcuar dhe mbajtur gjatë pushtetin.

“Historia nuk përsëritet e njëjta, ajo risillet si një rimë”, ka thënë shkrimtari Mark Twain. E tillë nisi ajo edhe në Shqipëri, si eho përsëritëse e asaj që kishte kohë që zhvillohej në BRSS prej Revolucionit të Tetorit. Historinë jo vetëm që e shkruajnë fitimtarët, por ata kërkojnë që ajo të fillojë me ta. Rrëzimi dhe shkatërrimi i miteve të vjetra



“ Jo vetëm personazhi i Prefektit të Tiranës, i interpretuar nga aktori Mihal Popi, por edhe personazhet e tjera të familjes së tij nuk kanë asgjë të përbashkët me personazhet e vërteta historike, sepse **qëllimi nuk ka qenë prezantimi me vërtetësi i Prefektit të Tiranës dhe familjes së tij. Përkundrazi, qëllimi ishte krijimi i prototipit të një figure të urryer.**

dhe krijimi i miteve të reja, nga të cilat më i rëndësishmi ishte miti i udhëheqësit të Revolucionit të Tetorit, V. I Lenin, nisi të ndodhë si proces edhe në Shqipëri. Pjesë të shumta nga dramaturgjia ruse ishin ato që e shoqëruan në vitet e para të ekzistencës Teatrit e Shtetit (sot Teatri Kombëtar). Jo vetëm dramaturgjia e re ruse, por edhe artistë dhe regjisorë të ardhur nga Bashkimi Sovjetik kanë shoqëruar hapat e parë të ndërtimit të institucionit teatror. Që prej vitit 1947 filluan të vijnë regjisorë, si Vladimir Fjodoroviç Dudin në 1948, Andrej Ivanoviç Kriçko, Zina Andri, Bortko etj. Ajo që do të ndodhte më pas me rolin që arti do të luante në shtrembërimin e historisë dhe të personazheve të njohura publike shihet qartë që prej vitit 1947 me vënien në skenë të komedisë “Prefekti”, shkruar nga Besim Levonja. Jo vetëm

personazhi i Prefektit të Tiranës, i interpretuar nga aktori Mihal Popi, por edhe personazhet e tjera të familjes së tij nuk kanë asgjë të përbashkët me personazhet e vërteta historike, sepse qëllimi nuk ka qenë prezantimi me vërtetësi i Prefektit të Tiranës dhe familjes së tij. Përkundrazi, qëllimi ishte krijimi i prototipit të një figure të urryer. “E dashurova Qazimin për ta demaskuar më mirë”⁴, është shprehur aktori Popi që realizoi në skenë atë personazh. Në planin artistik kjo tingëllon interesante si metodë për aktorët e rinj. Ta dashurosh shumë personazhin për ta bërë atë sa më të urryer për spektatorin! Kjo metodologji mundet të jetë e vlefshme dhe e suksesshme për realizimin e figurës së Jagos, Rikardit të Tretë apo të gjithë kriminelëve të tjerë në dramaturgjinë botërore, por jo të një individi i cili jo vetëm që nuk ka asgjë të përbashkët me personazhin në skenë, por pagan edhe kosto të larta njerëzore bashkë me familjen e tij. Regjisor i shfaqjes, Andon Pano, duke argumentuar konceptin regjisorial të komedisë, shënonte: “Ne synuam që Qazim Mulleti të mos ishte një tip i lezetshëm që të shkrin së qeshuri, por të tregonte egërsinë e tij, njeriun shtypës dhe vegël të okupatorëve. Donim që ky njeri të rrëzohej gradualisht”⁵ Duket se kjo komedi ka qenë edhe një lloj testi për të matur reagimin ndaj asaj që do të vazhdonte më tej me pjesën satirike “Epopeja e Ballit Kombëtar”, shkruar nga Shefqet Musaraj dhe vënë në skenë prej regjisorit Pandi Stillo. Direkti-

vat politikë duket se kanë qenë të qarta: luftë, duke i etiketuar si tradhtarë të kombit dhe diskreditim për të gjitha shtresat dhe individët që nuk iu bashkuan lëvizjes komuniste. Dramaturgjia e ardhur nga Bashkimi Sovjetik me pjesë, të tilla si: “Invadimi” i L. Leonov, “Çështja ruse” e K. Simonov, “Karakterit moskovit” e V. Sofronov, “Përmbyjsja” e A. Llavrenjev, “Njeriu me pushkë” e N. Pogodin, “Armiqtë” e M. Gorkit etj. e konsoliduan karakterin propagandues të teatrit dhe promovues të historisë së re. Vëmendja dhe interesi i pushtetit të ri ndaj artit në përgjithësi dhe teatrit në veçanti, i cili po bëhej dita-ditës një art popullor dhe i ndjekur masivisht nga të gjitha shtresat, e tregon edhe motivacioni me të cilin Kuvendi Popullor dekoron Teatrin Popullor që në vitet e para të krijimit të tij: “... ka marrë pjesë aktive në kryerjen e detyrave që i ngarkoi Partia dhe pushteti për edukimin e masave të popullit ... duke ndihmuar kështu për ndërtimin e socializmit në vendin tone”⁶. Koha e të pavërtetave historike nisi të përmbytë skenën e artit shqiptar.

Përbaltja e historisë kaploi të gjitha shtresat, në qytet dhe në fshat. “Toka jonë”, drama kryesore e Kolë Jakovës, e cila trajton ngjarjet e reformës agrare në Shqipëri, përveç se legjitimon një akt barbar, si ai i rrëmbimit të pronës prej pronarit legjitim dhe shpërndarjen e saj midis fshatarëve të varfër, është e mbushur me stigmatizime, paragjykime, etiketime dhe urrejtje klasore.

Personazhi i Tuç Makut është përshkruar si një amalgamë e cilësive dhe karakteristikave më negative të qenies njerëzore: ai është dinak, i egër, dredharak, kriminel, imoral, ndryshe nga personazhi tjetër, Murashi, i cili është idealizuar duke i veshur cilësitë më të mira njerëzore dhe duke e bërë nga ana dramaturgjike një personazh skematik dhe jo të vërtetë. Shtrembërimin e të vërtetave historike në këtë veper e thekson edhe kritiku Josif Papagjoni, i cili në analizën që i bën kësaj drame në librin e tij “Teatri Kombëtar”, ndër të tjera shkruan: “Drama e këqyru nga sot paraqet problem me shtrembërime të së vërtetës historike, zotërohet nga një trajtim ideologjik... Për rrjedhojë, klasa e fshatarëve të kamur duhej likuiduar edhe fizikisht, duke i quajtur ata kriminelë, shtypës, shfrytëzues etj.”

Të tjera vepra skenike, si “Karnavalet e Korçës”, “Hijet e natës” sjellin portrete personazhesh që përfaqësojnë shtresën e borgjezisë së vogël në Shqipëri, tregtarët dhe pronarët. Në frymën e përg-

“Direktivat politikë duket se kanë qenë të qarta: luftë, duke i etiketuar si tradhtarë të kombit dhe diskreditim për të gjitha shtresat dhe individët që nuk iu bashkuan lëvizjes komuniste.”

jithshme për t'i tallur dhe satirizuar këto shtresa autorët nuk kanë nguruar të deformatojnë dhe shtrembërojnë të vërteta duke forcuar në publik ndjenjën e antipatisë dhe të urrejtjes për to.

Përveç stigmatizimit të shtresave të rrëzuara, ndaj të cilave qëllimi ishte të mbeteshin të diskredituara dhe të urrejta era për të gjithë masën popullore, skena teatrore i është kthyer here pas here temave historike. Edhe pse qëllimi dhe përdorimi këtyre temave nuk ishte i njëjti me atë që kishin poetët dhe shkrimtarët e periudhës së Rilindjes Kombëtare apo shkrimtarët e viteve '30, mënyra e trajtimit të historisë që shikojmë në pjesën më të madhe dhe të teksteve të shkruara dhe të vëna në skenat e teatrit shqiptar në vitet '60-'70 është gati i njëjtë. Heronj skematikë, të pabesueshëm dhe të pamotivuar në veprimet e tyre dhe një armik mizor, fodull dhe herë-herë edhe qesharak dhe i leshtë. Të tillë personazhe gjejmë në dramën "Halili dhe Hajria" e Kolë Jakovës, "Shtatë shaljanët" e Ndrek Lucës, "Dragoi i Dragobisë" etj.

Ajo që ndodhi më pas dhe që u përforcua me prodhimet kinematografike të Kinostudios "Shqipëria e Re" ishte krijimi i stereotipave në pasqyrimin e disa karakter-

eve, përfaqësues të shtresave të ndryshme sociale. Me krijimin e stereotipave në art dhe letërsi, sipas shpjegimit që fjalori i Kembrixhit i jep këtij termi, pushteti i ri synonte që përmes artit të ndërtonte dhe promovonte disa përfytyrime fikse mbi individë dhe shtresa të caktuara sociale. Sipas dy psikologëve të shquar, Daniel Katz dhe Kenneth Braly, stereotipizimi çon në paragjykime, ku njerëzit, emocionalisht, reagojnë ndaj emrit të një grupi, përshkruajnë karakteristikat për anëtarët e atij grupi dhe pastaj i vlerësojnë këto karakteristika. Krijimi i stereotipave në artin shqiptar nuk ka qenë vetëm në kahun negativ, si në rastin e stereotipave në pasqyrimin dhe gjykimin e ballistëve, nacionalistëve, tregtarëve, klerit etj., por estetika e realizmit socialist lehtësoi edhe stereotipin e partizanit fitimtar, komunistit të sakrificës dhe të dashur me masat, heroit të punës, gruas si forcë e rëndësishme në ndërtimin e socializmit, fshatarit që dorëzon pronën dhe hyn në kooperativë, e të tjera si këto. Përdorimi i artit në përgjithësi dhe atij kinematografik në veçanti në krijimin e stereotipave nuk është një fenomen shqiptar, as edhe vetëm i vendeve me eksperiencë ideologjike të majta. Në një numër jo të vogël të prodhimeve të Hollivudit dallohet me lehtësi përdorimi i stereotipave.

Studiuesi dhe kritik i rus Aleksandër Fedorov propozon në njërin nga leksionet e tij një koncept të ri të analizës së stereotipave në media, ku analizohet si e tillë edhe krijimtaria kinematografike.

Ky koncept lidhet me identifikimin dhe analizën e imazheve stereotipike të njerëzve, ideve, ngjarjeve etj. Ai shkruan se: "Në kontekstin e medias, personazhet që shfaqen në filma, ndikojnë shumë në mënyrën se si njerëzit në mbarë botën perceptojnë grupimin, racën apo komunitetin kulturor që ata përfaqësojnë". Kjo ka çuar në përhapjen përmes industrisë së kine-

“Një shoqëri me histori të tjetërsuar dhe deformuar është një shoqëri që bën një gjumë të makthshëm; të makthshëm si gjumi i personazheve në vizatimet e piktorit Francesco Goja në ciklin “Los caprichos”. Gjumë nga i cili i duhet të zgjohet sa më parë.

masë të stereotipave gjinore, racore, etnike dhe kulturore. Për shembull, portretizimet e Amerikës Latine në filma janë të kufizuara në një grup të ngushtë karakteresh. Ata përshkruhen kryesisht si macho, anëtarë bandash, emigrantë të paligjshëm ose artistë. Për krahasim, ato rishfaqen rrallë si njerëz të punës, drejtues biznesesh apo politikanë. Në të gjithë historinë e kinemasë shqiptare është e vështirë të gjenden filma që t'i kenë shpëtuar këtij fenomeni. Dallim bëjnë vetëm disa filma të cilët falë interpretimit të mirë aktoresk, paragjykimi apo etiketimi i individëve, skematizmi i personazheve, gjuha dramaturgjike e mbushur me slogane dhe ngarkesa politike shfaqen më të buta dhe bëhen më të padukshme se në pjesën dërmuese të filmave skematikë të realizuara ndër vite. Disa nga këta filma të realizuara ndër vite janë: “Përballimi”, “Dueli i heshtur”, “Përrallë nga e kaluara”, “I teti në bronz”, “Lulëkuqe mbi mure”, “Liri a Vdekje”, “Radiostacioni”, “Pylli i lirisë”, “Ballë për ballë”, “Gjeneral Gramafoni” etj. Një figurë tjetër e deformuar në disa nga filmat shqiptarë është ajo e klerikut. Pas ndalimit të praktikimit të fesë dhe shpalljes së Shqipërisë si një vend ateist, figura e klerikut filloi të shfaqej në filmat shqiptarë ose si bashkëpunëtor me pushtuesin, ose si personazh që përfaqësonte një botë të vjetër e të prapambetur. E vërteta historike mbi rolin e klerit në formimin dhe zhvillimin e shtetit shqiptar u fshi dhe u anashkalua edhe nga tekstet e historisë. Ishin filmat e prodhuar nga Kinostudio “Shqipëria e Re” ata që krijuan prototipin e agentit, spiunit, diversantit, sabotatorit dhe bashkëpunëtorëve të tyre nga jashtë Shqipërisë. Vëmendjes së artit shqiptar nuk i shpëtoi as periudha e monarkisë në Shqipëri. Filmat “Koncert në vitin 1936”, “Gjeneral Gramafoni”, “Historiani dhe kameleonët” e të tjerë filma që i zhvillojnë ngjarjet e tyre pikërisht në



periudhën e monarkisë nuk kanë guxuar të dalin jashtë formatit të qëndrimit politik ndaj asaj periudhe.

Duke iu rikthyer edhe një herë ndikimit dhe rolit që luajnë faktorët socialë, ekonomikë, politikë dhe kulturorë në formimin dhe përcaktimin e asaj që jemi dhe bëjmë, mund të kuptohet dhe imagjinohet se në çfarë ambienti është rritur dhe formuar shoqëria shqiptare. Një shoqëri me histori të tjetërsuar dhe deformuar është një shoqëri që bën një gjumë të makthshëm; të makthshëm si gjumi i personazheve në vizatimet e piktorit Francesco Goja në ciklin “Los caprichos”. Gjumë nga i cili i duhet të zgjohet sa më parë. ■

-
- 1 Tituli është huazuar nga libri “Uliksi” i shkrimtarit Xhejms Xhojsi
 - 2 Frashëri, N. Histori e Skënderbeut, Tiranë, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1967, kënga XXII
 - 3 Sulstarova, E. Arratisja nga Lindja. Tiranë, Botimet Dudaj, 2006, f. 43-44.
 - 4 Papagjoni, J. Teatri Kombëtar. Tiranë, Qendra e Studimeve të Artit, 2005, f. 44.
 - 5 po aty, f. 44.
 - 6 po aty, f. 39.
 - 7 Fedorov A. European Journal of Contemporary Education, 2015, vol.(12), ls. 2, pp. 116-128.


Midis traditës

dhe mediave:

TRUALLI I MITEVE MODERNE SHQIPTARE

Leximi i miteve të një shoqërie është një ndër çelësat më potencialë për të furnizuar elemente që lejojnë e thjeshtësojnë të kuptuarin e aspekteve të tjera të kulturës së një shoqërie.





DIANA KASTRATI

MITI I PUSHTETIT

PËR TË ARRITUR NË QËMTIMIN E “ESPRIT HUMAN” TË NJË KOMUNITETI NJERËZOR, lipset të kalohet edhe përmes studimit të miteve moderne, i cili ka të bëjë mbi të gjitha me strukturën e ideve. Shoqëria shqiptare, për vetë karakteristikat që paraqet, na vjen si një produkt social, i cili, si pasojë natyrisht e një rrugëtimi të gjatë historik, rezulton aktualisht mjaft kaotik apo amorf. Për këtë arsye, thelbi i kulturës tonë të të jetuarit, i konstitucionit mendor e shpirtëror është në fakt vetë struktura jonë.

Mitet, në fakt, janë të përbëra nga elemente të njohura me emrin “mitema” (në analogji me fonemat), që krijuesit e miteve i kombinojnë e i rikombinojnë për të krijuar kuptime, shpesh me pavetëdije. Mitet nuk tregojnë thjesht histori, ato janë bartëse të të shprehurit të të vërtetave simbolike, ngandonjëherë të disa kulturave specifike apo të zonave kulturore,

herë të tjera të kulturave universale. Vetë mitemat mund të gjenden në mite të ndryshme, të cilët nga ana e tyre transportohen në kultura të tjera, të ndryshme nga ajo e origjinës. Në çdo lloj këndvështrimi e konteksti, në atë historik, letrar, sociologjik etj., mënyra me të cilën ato mund të lexohen e kuptohen është si nëpërmjet asaj diakronike, ashtu edhe sinkronike. Leximi i miteve të një shoqërie është një ndër çelësat më potencialë për të furnizuar elemente që lejojnë e thjeshtësojnë të kuptuarin e aspekteve të tjera të kulturës së një shoqërie. Sa për ta ilustruar këtë që sapo thamë më lart, po sjellim në vëmendje faktin që gjatë dekadës së fundit, nevoja e shqiptarëve për të kuptuar veten pas hapjes me botën, solli në vëmendje shqyrtimin e fenomeneve të reja sociale e kulturore që rridhnin nga qëndrime të caktuara psikologjike e ngjarjeve historike. Kësisoj, pas viteve '90 të shekullit të kaluar te shqiptarët e paskomunizmit u vërejt (do të guxonim ta quanim “modë”), një braktisje kolektive e identitetit. Ndonëse tingëllon e fortë dhe e papranueshme, kjo ishte një pasojë deri diku e logjikshme e abuzimit me këtë term gjatë periudhës së regjimit diktatorial. Ngjallja e ndjenjës së identitetit kombëtar, e përkatësisë së një ko-

muniteti që mbante këtë emër, nuk u bë natyrshëm, por përkundrazi u imponua me dhunë për hir të një ideologjie që shkonte në fitim të forcimit të pushtetit të atij regjimi. Meqenëse këtë problem do ta trajtojmë edhe më poshtë, për momentin po ndalemi vetëm tek evidentimi dhe shkaku i kësaj kapjeje kaq të fortë pas mitit të origjinave tona: nevoja për t'u njohur si pjesë e një familjeje më të madhe që të përmbush ëndrrën e të jetuarit me dinjitet, pas ëndrrës kolektive të vvarë nga diktatura, i bëri shqiptarët të kërkonin me forcë e me pahir rrënjët e diçkaje që nuk njihnin. Kështu, pas valës së parë të “injorimit” të origjinave, të “braktisjes” ndoshta edhe të pavullnetshme të identiteteve, u evidentua “moda” e dytë: filluan të viheshin pikëpyetjet e forta mbi origjinat e mbi identitetin tonë dhe përgjigjet nuk vonuan të jepeshin nga diletantë e amatorë të kësaj fushe. Kjo për arsyen e thjeshtë se çështja tashmë kishte marrë përmasat e një fenomeni të legjitimitit të një dinjiteti të nëpërkëmbur. Boshllëku në të cilën u gjenden shqiptarët brenda kufijve, sidomos ata që emigruan jashtë Shqipërisë, i bëri që ta merrnin fort për zemër diskutimin e identitetit me çdo kusht. Ky diskutim me përmasa nacional-popullore, është treguesi më i qartë i një nevojë ulëritëse për t'u plotësuar në mangësitë e boshllëqet e krijuara nga politikat e shekullit të kaluar e të këtij fillim shekulli. Tryezat e sotme e tregojnë “zëllin amatoresk” me të cilin trajtohet çështja, për shembull, e origjinës dhe lashtësisë së gjuhës shqipe. Kur amatorizmi mbyl zërin e profesionalizmit dhe të shkencës, rezultati do të jetë sa mjeran, aq edhe qesharak. Miti i “gjuhës shqipe si gjuha më e vjetër në botë” ka filluar të zërë vend me një shpejtësi marrramendëse. Studiuesi Ardian Vehbiu

“**Pas viteve '90 të shekullit të kaluar te shqiptarët e paskomunizmit u vërejt (do të guxonim ta quanim “modë”), një braktisje kolektive e identitetit. Ndonëse tingëllon e fortë dhe e papranueshme, kjo ishte një pasojë deri diku e logjikshme e abuzimit me këtë term gjatë periudhës së regjimit diktatorial.**

shprehet se “nëse shqipja apo protoshqipja, për shembull, ka pasur apo jo marrëdhënie me një gjuhë hipotetike të folur nga popullsitë paragreke në Ballkanin e Jugut (e ashtuquajtura pellazgjishte), kjo nuk ngre kurrfarë peshe në funksionimin, riprodhimin dhe evolucionin aktual të kulturës shqiptare si tërësi komunikimesh midis miseve të kombit; edhe pse na paraqitet ndo-njëherë si një nga çështjet kyçe, thuajse atribuimi i një lavdie epërore iluzore të stërblashtë do të kompensonte sadopak mjerimin e sotëm.”¹

Në Shqipërinë e fillimshekullit të ri gjejmë të ngërthyerat e dyja shpërfaqjet e pastra të mitit: shpërfaqja e parë, ajo e mitit tradicional, e pacentuar akoma në zona të caktuara, por edhe me shtrirje deri në zonat urbane; ndërsa shpërfaqja e dytë, ajo e ngritjes së kulteve të reja me frymë perëndimore, mbartje “besnike” të modeleve të importuara, por edhe të lindjeve të natyrshme të produkteve të një kapitalizmi fillestar.

MITI “TRADICIONAL” DHE MODERNIZIMI

Faktorët që çuan në shqyrtimin e këtij fenomeni janë të shumtë, por do të parapëlqenim të veçonim dy prej tyre që, sipas mendimit tonë, kanë qenë dhe konsiderohen si më vendimtarët:

1) Lindja dhe zhvillimi i mjeteve të komunikimit të masës, apo siç njihen ndryshe masmedia dhe;

2) Epoka e re modernizmit, me pasojë në shekullin e kaluar globalizimin.

Para se të shqyrtojmë këto dy aspekte-faktorë të sipërpërmendur, do të përpiqemi të analizojmë traditën, apo natyrën e saj. Përseja është e thjeshtë:

MITI

Në Shqipërinë e fillimshekullit të ri gjejmë të ngërthyerat e dyja shpërfaqjet e pastra të mitit: shpërfaqja e parë, ajo e mitit tradicional, e pacentuar akoma në zona të caktuara, por edhe me shtrirje deri në zonat urbane; ndërsa shpërfaqja e dytë, ajo e ngritjes së kulteve të reja me frymë perëndimore, mbartje “besnike” të modeleve të importuara, por edhe të lindjeve të natyrshme të produkteve të një kapitalizmi fillestar.

vetëm duke kuptuar çfarë është dhe çfarë përmban tradita, karakteristikat dhe vendin e saj në shoqëritë moderne, mund të arrijmë të flasim për vendin që zë ajo realisht, apo atë që duhet të zinte në shkencat humanistike së pari e pastaj në mendësitë kolektive të të gjitha shoqërive të sotme, përfshirë edhe atë shqiptare. Çfarë është tradita? Cilat janë karakteristikat e saj kryesore?

Në kuptimin më të gjerë të këtij nocioni, “tradita” ose çdo gjë që transmetohet apo përçohet nga e kaluarja. Një nga trashëgimitë më këmbëngulëse të mendimit shoqëror klasik është ideja se, me zhvillimin e shoqërive moderne, traditat e humbin pak nga pak rëndësinë e tyre, në mënyrë graduale, gati-gati deri në shuarjen e rolit të tyre në jetën e përditshme e në masën më të madhe të individëve. Formimi i shoqërive moderne duket sikur e ka vënë traditën në një biçim kontradikte apo konflikti me ta. Shumë mendimtarë kanë rënë dakord mbi faktin se zhvillimi i shoqërive moderne do të ishte shoqëruar në mënyrë të pashmangshme me perëndimin e pakthyeshmë të rolit të traditës. Ky komponent interpretativ është njëkohësisht

“ÇLIRIMI” NGA TRADITAT

Një nga trashëgimitë më këmbëngulëse të mendimit shoqëror klasik është ideja se, me zhvillimin e shoqërive moderne, traditat e humbin pak nga pak rëndësinë e tyre, në mënyrë graduale, gati-gati deri në shuarjen e rolit të tyre në jetën e përditshme e në masën më të madhe të individëve. Formimi i shoqërive moderne duket sikur e ka vënë traditën në një biçim kontradikte apo konflikti me ta. Shumë mendimtarë kanë rënë dakord mbi faktin se zhvillimi i shoqërive moderne do të ishte shoqëruar në mënyrë të pashmangshme me perëndimin e pakthyeshem të rolit të traditës. Ky komponent interpretativ është njëkohësisht edhe një element përbërës themelor i shumë teorive të përpunuara gjatë viteve '50-'60 të shekullit të kaluar. E çuditshme është se kjo ide është rimarrë me forcë edhe në kohët e sotme nga studiuesit që mbështesin tezën se zhvillimi i modernizmit social sjell si pasojë edhe një proces të “çlirimit nga traditat”.

edhe një element përbërës themelor i shumë teorive të përpunuara gjatë viteve '50-'60 të shekullit të kaluar. E çuditshme është se kjo ide është rimarrë me forcë edhe në kohët e sotme nga studiuesit që mbështesin tezën se zhvillimi i modernizmit social sjell si pasojë edhe një proces të “çlirimit nga traditat”.

Nëse i referohemi kuadrin të sotëm të mitologjisë moderne me markë shqiptare, do të vërejmë se qëndrimi ndaj fondit të miteve të ashtuquajtura tradicionale ka ndryshuar shumë si në formë, ashtu edhe në përmbajtje. Miti tradicional vihet në “djepin e artë” të një pasurie të palëvizshme, si një lloj relikeje apo trashëgimie të bukur mbarëpopullore që ndihmon paksa në të ushqyerit e intrigimit ndaj të tjerëve të aspektit ekzotik të vendit tonë. Ndërrimet e forta historike e politike në terrenin tonë, kanë sjellë gjithmonë tronditje e kapërthime, ngandonjëherë të ngërçshme, të cilat janë reflektuar fuqishëm edhe në kornizën kulturore e shpirtërore të popullit shqiptar. Nga ana tjetër, jemi të bindur se një fenomen i tillë i shndërrimeve, gati radikale në të gjitha nivelet e ekzistencës njerëzore shqiptare, është karakteristikë e vendeve të cilat nuk kanë arritur akoma një stabilitet dhe ekuilibër socio-politik, e si pasojë presin me

krahë hapur çdo prurje të re pa e filtruar edhe aq shumë. Shumë mite kanë qëndruar, por po aq janë krijuar të reja. Sa do të jetë jetëgjatësia e tyre? Sa do t'u rezistojnë kohëve që do të vijnë? Duke përjashtuar mundësitë e profetizimit, do të shohim realisht mundësitë që ka sot pëlhura kulturore e shpirtërore shqiptare për të mbajtur në këmbë çfarë ka më të mirë nga tradita e çfarë i ofron modernizmi.

NATYRA E TRADITËS DHE VENDI I SAJ NËN DRITËN E TEORIVE SOCIALE TË KOMUNIKIMIT

Do të përpiqemi ta shohim problemin më me kujdes, duke e vënë në diskutim një tezë të tillë. Nëse ne i kushtojmë vëmendjen e duhur impaktit me mediat, arrijmë në një përfundim mjaft të kundërt në lidhje me ndryshimin e traditës e të rolit të saj në jetën shoqërore. Para zhvillimit të mjeteve të komunikimit të masës, ajo që e modelonte kuptimin e së kaluarës e të botës përtej mjedisit në të cilin jetohej, ishte pikërisht përmbajtja simbolike e shkëmbyer në ndërveprimet ballë për ballë. Pjesa më e madhe e individëve e formonte idenë mbi të kaluarën, mbi botën e largët etj. nëpërmjet traditave gojore të prodhuara e të riprodhuara në kontekstet sociale të jetës së



përditshme.

Megjithatë, duhet theksuar se zhvillimi i masmediave solli edhe eksperimentimin e ngjarjeve, të mësuarit e mënyrave e formave të reja të jetesës, por jo vetëm kaq: duke u vënë në kontakt të drejtpërdrejtë me mediat, individët arritën të marrin edhe distancat e duhura, jo vetëm nga përmbajtjet simbolike të ndërveprimit të drejtpërdrejtë, por edhe nga format e autoritetit që qeverisnin jetën e tyre të përbashkët.

Por, këto zhvillime a e kanë çrrënjësuar traditën? Nuk është e thënë. Jo vetëm traditat e transmetuara gojarisht kanë vazhduar të luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e shumë individëve, por me procesin e kalimit të përmbajtjeve të tyre simbolike, mjeteve të reja të komunikimit, kanë pësuar ndryshime edhe ata vetë, kanë fituar një forcë të re. Mediatizimi i ka dhënë traditës një jetë të re duke përfutur karakteristika të paparashikueshme. Mund të thuhet se është deritualizuar. Ka humbur gjurmët e saj në kontekstet e jetës së përditshme, por një çrrënjësje e tillë nuk e ka boshatisur. E vërteta është e kundërta: mediatizimi i traditave u ka lejuar atyre të shumëfishohen e të rinovohen duke u vendosur në kontekste të reja.

Katër karakteristikat e përgjithshme të

traditës, të paktën sipas studuesve të teorisë sociologjike të mendimit, janë: 1. ermeneutik; 2. normativ; 3. legjitimimi; 4. aspekti i identitetit.

Për të ilustruar mitin e pushtetit për të cilin do të flitet më poshtë, do të marrim në analizë vetëm aspektin e tretë e të katërt të traditës, atë të legjitimitetit dhe të identitetit.

Aspekti i tretë i traditës është ai që mund ta quajmë i legjitimitetit. Me këtë term kuptojmë faktin që ndonjëherë tradita, në disa rrethana të caktuara mund ta mbështesë pushtetin dhe autoritetin. Sipas Weberit, legjitimiteti i një sistemi pushteti mund të vendoset në tri mënyra kryesore. Mund të bazohet mbi racionalitetin, ose mbi besimin në ligjshmërinë e rrethave të formëzuara (ato që Weber i quan “pushtet ligjor”); mënyra e dytë, mbështetet mbi forcën karizmatike duke sjellë si pasojë respektimin ndaj shenjtëritimit apo tipareve të jashtëzakonshme të një individi (“pushteti karizmatik”); së fundmi, mbi traditën vetë ose mbi shenjtërinë e traditave shumë të vjetra (“pushteti tradicional”). Nëse pushteti është ligjor, individët i binden një sistemi rregullash pavetore. Anasjelltas, në rastin e pushtetit tradicional, bindja i detyrohet personit, pushteti dhe au-

toriteti i lirisë së veprimit të të cilit, janë të sanksionuara nga tradita.²

Është e pamundur ta nënvleftësojmë dobishmërinë e analizës së pushtetit tradicional të propozuara nga Weber. Kjo tezë ndihmon mjaft edhe në të kuptuarit e disa konteksteve shumë të hapura politike. Përveç se udhëzues normativ i veprimit, mund të shërbejë edhe si bazë për ushtrimin e pushtetit mbi të tjerët e si garanci bindjeje ndaj urdhërave. Për këtë arsye, shpeshherë, traditat mund të shndërrohen në “ideologji”: ato mund të shfrytëzohen për të stabilizuar ose për të përforcuar lidhjet e pushtetit, lidhje të strukturuar në mënyrë sistematikisht të çekuilibruara.

Së fundmi, tradita lidhet edhe me formimin e vetvetes, pra me aspektin e identitetit. Në këtë proces përfshihet edhe identiteti personal, edhe ai kolektiv. I pari, ai personal, tregon kuptimin e vetes, të një individi

të pajisur me disa veçanti e potencialitete që karakterizojnë rrugëtimin e tij ekzistencial. Identiteti kolektiv nga ana tjetër, i referohet kuptimit të vetes, por në këtë rast si anëtar i nje grupi apo kolektivi social. Është ndjesia e përkatësisë, ndjesia e të bërit pjesë të një grupi social që ka një histori të vetën e një fat kolektiv. Cila e sa është rëndësia e traditave në lidhje me këto dy momente të formimit të identitetit? Duke qenë traditat një bashkësi modelesh e sjelljesh të trashëguara nga e kaluara, ato furnizojnë një pjesë të materialit simbolik të nevojshëm për formimin e të dy identiteteve. Pavarësisht niveleve të ndryshme sipas konteksteve sociale, kuptimi i vetes dhe përkatësia janë që të dyja të modeluara mbi këto vlera, besime e forma sjelljesh. Procesi i formimit të një identiteti nuk mund të fillojë nga zeroja. Ai ndërtohet mbi bazën e një materiali simbolik paraekzistues që shërben më pas si themel

i identiteve.

Megjithatë, ka shumë mundësi që, falë lindjes së mjeteve të komunikimit të masës, natyra e këtij materiali simbolik paraekzistues të ketë ndryshuar, madje edhe në disa aspekte shumë të rëndësishme, të cilat kanë sjellë edhe implikime aspak të vogla.

Nëse flasim për një rezistencë të traditës në botën moderne, a është e mundur pra të flasim për zhdukjen e shoqërive tradicionale? Kundërshtia midis këtyre dy shoqërive, e parë nën këtë dritë, a ngjan si e gënjeshtërt? Në fakt është e tillë. Lidhja midis këtyre dy realiteteve është shumë më paradoksale se sa mund të hamendësohet duke u nisur nga një pohim i tillë. Rënia e autoritetit tradicional, si dhe e të vepruarit në një mënyrë të tillë, nuk sjell vdekjen e traditës, por shenjon një transformim të natyrës e të rolit të saj, një transformim i prodhuar nga fakti se, për ta interpretuar botën e për t'u ndjerë pjesë e saj, individët arrijnë t'i besohen gjithnjë e më shumë traditave të ndërmjetësuar nga mjetet e komunikimit, por tashmë të delokalizuar. Lidhja e traditave me këto të fundit është e dyfishtë: nga njëra anë zhvillimi i mediave e lehtëson rënien e autoritetit tradicional si dhe të rolit vendimtar të saj në veprimin e shoqërisë; nga ana tjetër, mjetet e reja të komunikimit dhurojnë njëkohësisht edhe instrumentet

“ Tradita lidhet edhe me formimin e vetvetes, pra me aspektin e identitetit. Në këtë proces përfshihet edhe identiteti personal, edhe ai kolektiv. I pari, ai personal, tregon kuptimin e vetes, të një individi të pajisur me disa veçanti e potencialitete që karakterizojnë rrugëtimin e tij ekzistencial. Identiteti kolektiv nga ana tjetër, i referohet kuptimit të vetes, por në këtë rast si anëtar i nje grupi apo kolektivi social.

për ta ndarë transmetimin e traditës nga aprovimi i përbashkët i një mjedisi shoqëror, duke krijuar kështu kushtet për rinovimin e traditës në një tjetër nivel. Të këtij mendimi janë një seri sociologësh të cilët kanë argumentuar përsenë e një transformimi shoqëror nga ndikimi i fuqishëm i mediave, por duke ruajtur gjithsesi traditën e cila mbetet në bërthamën e një komuniteti, por vetëm me një mvëshje të re.

TRADITA DHE MEDIAT, A ÇRRËNJOSEN TRADITAT NGA KËTO TË FUNDIT?

Daniel Lerner, para disa dekadave, arriti të ngjallte shumë diskutime e debate, po aq edhe kundërshti me anë të botimit të veprës “The Passing of Traditional Society: Modernizing the Middle East”. Pavarësisht kritikave të kohës, por edhe të mëvonshme, si një teori etnocentrike e bazuar mbi modelet perëndimore, edhe pse mund ta quajmë veprën “bijë të kohës së vet”, fakti që kjo vepër trajtoi ndoshta për herë të parë një problem të tillë kaq të madh e me interes të shumëfishtë, siç ishte kalimi në modernitetin e shoqërive tradicionale, është e vetmja që e analizon çështjen në mënyrë të detajuar dhe empirike.

Sipas tij, ka një dallim të qartë midis shoqërive tradicionale dhe atyre moderne.

Ai kërkon të individualizojë kushtet që të çojnë nga e para tek e dyta. Çfarë i karakterizon shoqëritë tradicionale? Sipas Lerner, ato janë të fragmentuara në komunitete të izoluar e të bazuara në masën më të madhe në lidhjet farefisnore. Horizontet e individëve kufizohen e kushtëzohen nga vendi, ndërsa ndërveprimet e tyre me të tjerët kufizohen me individët e njohur e që ndahen nga i gjithë mjedisi i përbashkët social. Jeta e përditshme drejtohet nga modelet tradicionale. Nuk ndjehet e nevojshme të mbrohen apo të përligjen modelet të tilla, është shumë e thjeshtë: për shumicën e individëve nuk ekzistojnë modelet të tjera. Individu i shoqërive tradicionale nuk interesohet për çështje të cilat janë jashtë kontekstit të tij. Nuk ka kureshtje për ngjarjet që ndodhin në vendet e largëta nga ai ku jeton. Si pasojë, meqenëse jeton një jetë të bazuar mbi shprehje, as nuk vë në diskutim, as nuk eksperimenton risi. Në shoqëritë tradicionale, vetja, është “vetvete e detyruar”: rrënjët e saj janë te mjedisi familjar e i zakonshëm, ndërsa zhvillimi i tij është i organizuar pa asnjë lloj ndërgjegjësimi për alternative të tjera të mundshme nga praktikatat ekzistuese.

Cili është kuadri i individit të shoqërisë moderne? Gjithnjë sipas gjykimit të tij, kemi të bëjmë me një gradë

IDENTITETI

Pavarësisht niveleve të ndryshme sipas konteksteve sociale, kuptimi i vetes dhe përkatësia janë që të dyja të modeluara mbi këto vlera, besime e forma sjelljesh. Procesi i formimit të një identiteti nuk mund të fillojë nga zeroja. Ai ndërtohet mbi bazën e një materiali simbolik paraekzistues që shërben më pas si themel i identiteve.

elasticiteti e lëvizshmërie që është krejt e kundërta e “vetvetes së detyruar” të shoqërive tradicionale. Gjejmë një hapje të vetvetes të çdo individit dhe aftësi të reja për t’u imagjinuar secili prej tyre në situata, vende e mundësi të paparashikuara, shtime udhëtimesh e spostimesh fizike përfshi edhe emigracionin brenda. Një hapje e tillë, pa pikë dyshimi, e këtu shprehim edhe bindjen tonë, është stimuluar edhe falë përhapjes së përvojave të lehtësuara nga ndërmjetësimi i mjeteve të komunikimit të masës. Parë nga ky këndvështrim, këto mjete mund të quhen një “shumëfishues i lëvizshmërisë”. Këto

mjete-instrumente vënë në dispozicion të individit një gamë të gjerë përvojash që, në kushte të tjera, do të ishin të pamundura të jetoheshin dhe e kryejnë këtë rol pa kërkuar spostime fizike. Përveç kësaj, pikërisht sepse bëhet fjalë për një përvojë fantazie, përvoja e ndërmjetësuar nga mjetet e komunikimit shërben edhe si edukatore e imagjinatës. Individu përfiton përvojën e të vendosurit në vend të tjetrit, në situata edhe shumë të largëta nga e vetja. Si rrjedhojë, ngurtësia e mënyrave tradicionale kriset nëse personat përballen me situata që më parë ishin të paimagjinueshme. Jeta shoqërore ngjan më e pasigurt nëse individët fillojnë të pyesin veten se çfarë do të ndodhë, në vend që të rehatoheshin se e ardhshmeja do t'i ngjante, siç kishte ndodhur deri më atëherë, të kaluarës së sigurt. Lerner përdor termin “empati” për të treguar aftësinë e stimuluar nga ekspozimi ndaj mediave, për ta imagjinuar veten në vend të tjerëve, një aftësi që ai e konsideron një karakteristikë kyçe për jetën shoqërore moderne. Falë zhvillimit të empatisë, individët arrijnë ta ngrenë shkallën e vetvetes në një nivel më të lartë, hapet

rrezja e shikimit duke u shndërruar në qenie të afta për të provuar dëshira edhe më të guximshme. Në vend që ta imagjinojnë veten të ngjuar përjetësisht në një vend fik, brenda një rendi gjërash të paracaktuara prej shekujsh e, për rrjedhojë, të pandryshueshme, vetvetja imagjinohet si një pikë që lëviz e shëtit përgjatë një rrugëtimi ngjarjesh të imagjinuara.

EKSPOZIMI NDAJ MEDIAVE NDIKON EDHE NË MËNYRAT SE SI RAPORTOHET INDIVIDU NDAJ PUSHTETIT DHE AUTORITETIT.

Pavarësisht ekzistencës së shumë shkollave të mendimit në lidhje me vendin që zë tradita në shoqëritë moderne, gjithsesi duhet thënë se krijimi i këtyre të fundit nuk është se e fshiu nevojën për të formuluar sisteme të reja besimi, konceptesh e vlerash për t'i dhënë një kuptim botëve të reja që po lindnin. Në ditët e sotme, ndoshta, shumë shoqëri që janë në embrionin e zhvillimit të tyre modern, në kuptimin e vërtetë të fjalës, siç është rasti i Shqipërisë, po hiqet keq të kuptohet ekuilibri që duhet vendosur midis

TRADITA NË SHOQËRITË MODERNE

Pavarësisht ekzistencës së shumë shkollave të mendimit në lidhje me vendin që zë tradita në shoqëritë moderne, gjithsesi duhet thënë se krijimi i këtyre të fundit nuk është se e fshiu nevojën për të formuluar sisteme të reja besimi, konceptesh e vlerash për t'i dhënë një kuptim botëve të reja që po lindnin. Në ditët e sotme, ndoshta, shumë shoqëri që janë në embrionin e zhvillimit të tyre modern, në kuptimin e vërtetë të fjalës, siç është rasti i Shqipërisë, po hiqet keq të kuptohet ekuilibri që duhet vendosur midis këtyre dy elementeve bazë për një shoqëri: tradita apo modernizmi me sistemet e tij të besimeve. Por, ajo që për ndokënd ishte marrë si e mirëqenë, për të tjerë përfaqësonte vetëm një zgjedhje, zgjedhjen për të privilegjuar disa koncepte të caktuara, disa vlera e besime në vend të disa tjerave. Natyrisht që të privilegjosh do të thotë që automatikisht të kryesh përjashtime apo humbje, siç interpretohet prej disa studiuesve.



këtyre dy elementeve bazë për një shoqëri: tradita apo modernizmi me sistemet e tij të besimeve. Por, ajo që për ndokënd ishte marrë si e mirëqenë, për të tjerë përfaqëson-te vetëm një zgjedhje, zgjedhjen për të privilegjuar disa koncepte të caktuara, disa vlera e besime në vend të disa tjerave. Natyrisht që të privilegjosh do të thotë që automatikisht të kryesh përjashtime apo humbje, siç interpretohet prej disa studiuesve. Ndër këto të fundit mund të fusim edhe atë që e kemi quajtur “deficit moral” ose, e thënë ndryshe, paaftësia për të përballur disa çështje themelore që lidhen me jetën, me vdekjen, me të drejtën e me të padrejtën. Në këtë kuadër mund ta konsiderojmë si deficit moral edhe të mbajturit gjallë të bindjes së rëndësishme të përjetshme të traditës fetare te disa persona. Të ruajturit e besimit ne fe të ndryshme është pjesë integrale e shoqërive si tradicionale, ashtu edhe atyre moderne, meqenëse praktikat fetare ndërthuren

me aktivitetin e përditshëm të individëve. Për këtë arsye, sociologu britanik John Thompson e sheh rolin e këtyre besimeve si një ushtrues të fortë të një autoriteti tradicional që në periudhën e lindjeve të shoqërive moderne, thjesht është rimodeluar. Nga ana tjetër, ai thekson se ky rimodelim edhe është relativizuar nën dritën e autonomisë në rritje të individit si një faktor i aftë për të reflektuar e për të plazmuar identitetin e vet.³

Gjithsesi, vlen për t’u nënvizuar se zhvillimi i mjeteve të komunikimit nuk ka çuar në vdekjen e traditës, por e ka transformuar atë në aspektet më kryesore të saj. Në vijim të këtij zhvillimi, proceset e formimit e të transmetimit të traditës janë varur në masën më të madhe nga mediat. Meqenëse shumë forma të komunikimit mediatik kërkojnë një lloj grade fiksimit të përmbajtjes simbolike mbi një substrakt material, këto mjete i pajisin këto përmbajtje me një rezistencë ndaj faktorit kohë. Pa

këtë proces të fiksimit, ruajtja e traditës në kohë kërkon përsëritjen e vazhdueshme simbolike në aktivitetet e jetës së përditshme. Përsëritja praktike është e vetnija mënyrë për të siguruar vazhdimësinë në kohë. Përfshirja e mjeteve mediatike në kultivimin e vlerave e besimeve të reja e siguron këtë formë të përsëritjes në kohë, por redukton nevojën e përsëritjes. Për këtë arsye, rënia e disa aspekteve të ritualizuara të traditës (frekuentimi i vendeve të kultit, për shembull) nuk duhet të interpretohet domosdoshmërisht si një perëndim i traditës. Në fakt, tradita deritualizohet në njëfarë mënyre.

Gjithmonë në kuadrin e transmetimit të traditave nga mjetet e komunikimit mediatik, ndodh që ky proces të depersonalizohet. E thënë ndryshe, ajo merr një formë që nuk është më thjesht personale për secilin pjesëtar të komunitetit, por fiton (tradita) një autonomi e autoritet të vetin, si një sistem vlerash, besimesh e konceptesh që ekzistojnë e mbijetojnë pavarësisht individëve të përfshirë në transmetimin e tyre nga njëri brez te tjetri.

Depersonalizimi i traditës nuk është gjithësi një proces uniform e i njëtrajtshëm. Natyra e kësaj lidhjeje mjaft interesante me zhvillimin e mjeteve mediatike, kryesisht elektronike, të televizionit në veçanti, midis autoritetit të traditës dhe individëve që e transmetojnë, ka filluar të rikrijohet. Në një masë të madhe, kjo lidhje vendoset e mbahet në brendësi të kornizës së ndërveprimit gati mediatik. Të gjithë ne jemi “njohës”, apo “të njohur”, të personazheve me influencë në televizion, i dëgjojmë ato, u besojmë apo jo, por ne kemi një kontakt të fortë e të dendur. Sidomos në Shqipëri, kontakti me figurat politike, është i përminutshëm. Në kushtet normale të një shoqërie të ngritur e të konsoliduar nga çdo pikëpamje, një kontakt i tillë nuk do të ekzistonte, por problemet e forta ekonomike e politike kanë sjellë në qendër të vëmendjes një grup të caktuar “predikuesish” që luajnë rolin edhe të predikatorëve “fetarë” që ndriçojnë mendjet e njerëzve. Ripersonalizimi që i bëjnë

traditave nëpërmjet autoritetit të pushtetit të traditës (në rastin tonë krejt unikal shqiptar), bën të mundur që individët të vihen në kontakt aty ku mungon ndërveprimi apo ndërsjellësia. Thompson e quan një proces të tillë “intimitet jo i ndërsjellë në distancë”. Ne, masa, turma, dëgjojmë ata, politikanët, të cilët predikojnë e ndriçojnë mendjet, por pa hyrë në kontakt të drejtpërdrejtë me palën tjetër. Tradita u vihet në shërbim të plotë, për fat të keq, nga ana e padrejtë për masën e dëgjuesve. Mediat ua lehtësojnë detyrën atyre, duke na e vështirësuar neve. Tradita ripersonalizohet falë mediave.

Si duhet ta kuptojmë procesin e rifutjes së traditave të mediatizuara në jetën e përditshme? Eric Hobsbawm, por edhe të tjerë pas tij, ka hedhur në “treg” një term që quhet “shpikje e traditës”⁴. Ajo që na intereson realisht ka të bëjë me faktin se një pjesë e literaturës mbi shpikjen e traditave është shqetësuar veçanërisht për të nënvizuar gradën e falsifikimit të tanishëm në kultivimin restrospektiv të disa praktikave e besimeve tradicionale.

Por, thelbi i problemit tonë përmblihet në këto rreshta: kur përmbajtjet simbolike të traditave gjejnë shprehjen e tyre në produktet e mediave, është e pashmangshme që të ndahen të paktën pjesërisht nga kontekstet praktike të jetës së përditshme. Por, për këtë arsye, nuk mund të konsiderohen më pak autentike sesa ato tradita që transmetoheshin dikur ballë për ballë, apo nga brezi në brez gojarisht. Ndoshta, mund të themi se kemi të bëjmë me të njëjtën histori, por “të kënduar” nga “këngëtarë” të ndryshëm. Mediat natyrisht që kanë ndryshuar kornizën e traditave në mënyrë gati radikale, por nuk është se i kanë çrrënjësuar apo kanë shkaktuar vdekjen e tyre. Gjithsesi, edhe në këtë rast roli i mediave mund të kontribuojë në mbijetesën e traditave. Ato, në fakt, ndërta çrrënjësuan traditat nga vende të caktuara të origjinës, i pajisin përmbajtjet e tyre simbolike me një gradë rezistence ndaj faktorit kohë e lëvizshmëri në hapësirë. Nga ky këndvështrim, mjetet e komunikimit përfaqësojnë një

instrument për të mbështetur vazhdimësinë kulturore pavarësisht spostimeve në hapësirë.

BOTA SHQIPTARE MIDIS TRADITËS DHE MODERNES

Për të kuptuar situatën shqiptare në lidhje me fenomenin e globalizimit të komunikimit, ndoshta do të mjaftonin pak elemente që do t'i sjellim në kujtesë. Gjithçka zë fill pas 1990. Për fat të keq, e gjithë periudha e pas Luftës së Dytë Botërore nuk mund të merret në konsideratë për vetë izolimin hermetik e total që e karakterizoi. Siç e kemi theksuar edhe në momente të tjera të këtij punimi, Shqipëria është vendi par excellence për karakteristikat e saj ekstremiste, sa lindore, po aq edhe perëndimore. E gjendur historikisht para kësaj dileme, apo udhëkryqi, që ngjarjet, apo edhe fataliteti do të thoshte dikush, i diktuan, ajo arriti të marrë drejtimin e aspiruar, atë perëndimor, vetëm pas rrëzimit të regjimit totalitar. Pavarësisht aspiratës dhe vendosjes gjeografike që natyrshëm duhet të çonin drejt “velit perëndimor” të të jetuarit, sipas mendimit tonë, ky aspekt u shpreh më shumë në formë sesa në përmbajtje. Për të mos rënë edhe ne në klishe të “oksidantizimit” me çdo kusht të çdo aspekti jetësor, si një detyrim sine qua non për t’u identifikuar me atë që konsiderohet në imagjinatën kolektive si forma më e zhvilluar e ekzistencës, pohimi që bëme pak më lart lidhet më shumë me një konstatim sesa me një gjykim. Në këtë proces përplasjeje të pashmangshme midis traditës dhe formave të reja, me-

diat ishin përçuesi dhe “zëdhënësi” më i fuqishëm i një sistemi vlerash të reja që po dilte në pah. Në konfliktin e përjetshëm midis së resë dhe së vjetrës në nivelin social, që nuk përbën asnjë lloj risie për vendin tonë, por integrohet si një natyrshmëri midis transformimeve radikale që po ndodhnin, evidentoi një problem me shumë rëndësi. Ky problem kishte të bënte me lidhjen, nga njëra anë, të modeleve të strukturuar të komunikimit global që nëpërmjet mediave “shtegtonte” në Shqipëri dhe, nga ana tjetër, kushteve lokale në të cilat individët përpiqeshin të përvetësonin këto produkte mediatike. Përvetësimi i produkteve të mediave është gjithmonë një fenomen i lokalizuar: përshin individë që jetojnë në kontekste historiko-sociale të veçanta dhe që interpretojnë mesazhet e mediave duke i bërë të vetat në jetën e tyre të përditshme, falë burimeve që kanë në dispozicion. Pikërisht për këtë arsye, pse individët i përshtatin mesazhet mediatike në kontekstet praktike të ekzistencës së tyre, këto mesazhe gjatë këtij procesi mjaft të komplikuar

“ Ndërsa çrrënjosin traditat nga vende të caktuara të origjinës, i pajisin përmbajtjet e tyre simbolike me një gradë rezistence ndaj faktorit kohë e lëvizshmëri në hapësirë. Nga ky këndvështrim, **mjetet e komunikimit përfaqësojnë një instrument për të mbështetur vazhdimësinë kulturore pavarësisht spostimeve në hapësirë.**

“**Sa më shumë intensifikohet dhe shtrihet procesi i globalizimit të komunikimit, aq më shumë rritet rëndësia e këtij aksi.** Ky proces rritjeje dëshmon që, ndërsa qarkullimi i informacionit dhe i komunikimit është bërë global, procesi i përvetësimit të këtyre mesazheve mediatike, mbetet i lidhur ngushtësisht e më një milion fije të pazgjidhshme me kontekstin dhe hermeneutikën.

pësojnë transformime. Globalizimi i komunikimit, natyrisht, ka shkaktuar transformime, por nuk mund të pranojmë se ka fshirë plotësisht karakterin lokal të përvetësimit të tyre. Ndoshta, ka krijuar një aks të ri simbolikash që i përkasin botës moderne. Një aks të tillë do ta quajmë aksi i përhapjes globale dhe i përvetësimit lokal. Sa më shumë intensifikohet dhe shtrihet procesi i globalizimit të komunikimit, aq më shumë rritet rëndësia e këtij aksi. Ky proces rritjeje dëshmon që, ndërsa qarkullimi i informacionit dhe i komunikimit është bërë global, procesi i përvetësimit të këtyre mesazheve mediatike, mbetet i lidhur ngushtësisht e më një milion fije të pazgjidhshme me kontekstin dhe hermeneutikën.

Një nga shembujt që dëshmon këtë proces të vështirë të përvetësimit të mesazheve mediatike nga ana e individëve sa kontekstual, aq edhe hermeneutik, është kujtimi që të gjithë ne kemi nga ikjet e para të shqiptarëve jashtë kufijve në fillim të viteve '90. Imazhet e transmetuara nga televizionet e vendeve fqinjë përktheheshin dhe interpretoheshin në forma nga më të papriturat nga destinatarët shqiptarë. Mosnjohja me asnjë nga format reale të kapitalizmit të vërtetë, të

funksionimit të mediave e të mekanizmave që përdoren në këtë fushë për të kapur vëmendjen e teleshikuesve, si dhe kontekstualizimi lokal që u bëhej atyre i hapën rrugën një përvetësimi masiv, krejtësisht joreal. Natyrisht, ky proces përvetësimi pati të njëjtat karakteristika pothuajse për të gjithë shqiptarët. Kushtet politike që sapo kishin filluar të ndryshonin dhe e ashtuquajtura liri që po miklonte ndjesitë e individëve të një komuniteti socio-politik si ai shqiptar i para viteve '90 ku, për gati 50 vjet kishte mbretëruar vetëm një formë të jetuari mendor, fizik, shpirtëror e kulturor, i çuan ata të ndërmarrin një hap të jashtëzakonshëm guximi: ikjen drejt një të panjohure të madhe. E vetmja “siguri” ishte garancia mediatike e imazheve të përfutuara të një parajse tokësore që të shfaqet sapo kalon kufirin, së cilës nuk i njihen mekanizmat se si mund të fitohet, por që ngjante se ishte aty e gatshme për të gjithë ata që e preknin. Mosnjohja absolute e logjikës së komunikimit mediatik, i përktheu pritshmëritë e shqiptarëve të parë në tokë të huaj, në një zhgënjim të jashtëzakonshëm.

Kjo është njëra mënyrë e të parit të kontekstualizimit të imazheve të reja e të modeleve të strukturuar të komunikimit global. Ekziston edhe një anë tjetër: të ndjekurit e imazheve që përçonin realitete të reja, njerëz të ndryshëm në mentalitet dhe sidomos, mundësi konsumi shumë të mëdha, shërbyen si shtysa më e fortë për emigrimin në masë të shqiptarëve. Ky emigracion, ashtu si çdo tjetër në historinë e njerëzimit, prodhoi transformime të jashtëzakonshme në të gjitha nivelet. Është banale të thuhet aspekti ekonomik, sepse falë remitancave të emigrantëve, Shqipëria filloi të ushqehet, të mbahej e të zhvillohej në nisma individuale, por një nga pasojat më të drejtpërdrejta në nivel social (aspekti që na intereson më shumë) ishte ai i ndryshimit të mendësisë

në lidhje me familjen, formën dhe funksionimin e saj. Përzjerja e opinionëve, e të menduarit, përballja jo vetëm me realitete të reja sociale, por edhe me ligjësi që mbrojnë pozitën e gruas në çdo rast, theu skemën e ngurtësuar që pengonte që në ide divorcin. Edhe pse ishte dhe vazhdon akoma të jetë një fenomen negativ për shumë aspekte për familjet që e pësojnë një fat të tillë, gruaja, e mbështetur ndoshta si asnjëherë tjetër nga komuniteti që e rrethonte, por edhe nga aspekti ligjor, arriti të bënte një hap që vite më parë do t'i kishte kushtuar gjithë ekzistencën. Në këtë rast, ndoshta, mund të themi se tradita nuk pati rezistencën që parashikohej. Kontekstualizimi i një modeli të ri të menduarit, u bë në përqindje të vogla. Imazhet e një bote tjetër, janë gjithmonë një burim: u lejojnë individëve të reflektojnë në mënyrë kritike mbi vetë ekzistencën dhe kushtet e tyre.

Ndërveprimi i produkteve mediatike me praktikën lokale ndodh në një mënyrë shumë komplekse. Ngandonjëherë mund të shërbejë, për disa aspekte, që të konsolidojë lidhjet e pushteteve ekzistuese, ose të krijojë forma të reja varësie. Vetëformimi i individëve ka një dozë të madhe injektimi mediatik. Ata bëjnë përpjekje të mëdha për të siguruar kontrollin e pajtimit apo të mbajtjes së një ekuilibri aspak të thjeshtë midis mesazheve të panumërta e impulseve që marrin nga mediat dhe vlerave e besimeve të trupëzuara në praktikën e zakonshme të jetës së tyre të përditshme. Mbivlerësimi i ndikimit të mesazheve mediatike do të ishte, mendojmë, i gabuar, por edhe nënvlerësimi, si faqja tjetër e medaljes, do të çonte në dëmtimin e gjykimit. Ndeshja e kulturave lokale, tradicionale me ato të huaja nga sistemi i tyre, ka një aspekt të jashtëzakonshëm pozitiv: atë të pasurimit të pamatë të brendësive të individëve. Është një minierë kulturore që ofron perspektiva alternative, duke i nxitur njerëzit të vënë në

diskutim vlerat tradicionale, si dhe interpretimet zyrtare të deriatëhershme, duke vënë në dispozicion mënyra jetese jo konformiste. Ndoshta mund ta konsiderojmë pak të guximshëm hamendësimin, por falë edhe imazheve televizive të Rumanisë së vitit 1990 që po dënonte më së fundi kolektivisht diktatorin e vet, të rinjtë tanë gjetën atë guxim aq të pritur për të zhdukur gjurmët e fundit të një sistemi diktatorial. Natyrisht, ishin këto ngjarje, por edhe shumë të tjera që i paraprinë, ishte vetë klima gjeopolitike që paralajmëronte se diçka radikale do të ndodhte, por ajo që duhet nënvizuar është se Shqipëria pa me sytë e saj se çfarë prodhon forca e tyre, pasi perceptuan e përvetësuan mesazhet e forta të mediave në të tërë botën. Nuk është se këto imazhe përcaktuan rrjedhurinë e ngjarjeve politike në Shqipëri, sepse e thamë që ishin një mori faktorësh të tjerë, por mund të themi me gojën plot se pa televizionin, ngjarjet e lëvizjes studentore në Qytetin e Studentit në 1990, me shumë mundësi nuk do të ishin zhvilluar në atë mënyrë, por as nuk do t'i kishin ndjekur me mijëra e miliona vetë të tjerë në të gjithë botën.

MITI I PUSHTETT

Duke iu referuar shqyrtimit të bërë mbi

MITI

Mbivlerësimi i ndikimit të mesazheve mediatike do të ishte, mendojmë, i gabuar, por edhe nënvlerësimi, si faqja tjetër e medaljes, do të çonte në dëmtimin e gjykimit. Ndeshja e kulturave lokale, tradicionale me ato të huaja nga sistemi i tyre, ka një aspekt të jashtëzakonshëm pozitiv: atë të pasurimit të pamatë të brendësive të individëve.

natyrën e traditës, do të ndalemi paksa të shohim si qëndron ajo në raport me pushtetin dhe me mitin e tij që, në mjaft raste, ndihmohet nga vetë tradita. Nëse traditën e konsiderojmë si një nocion statik të një strukture të caktuar, këtë situatë do ta quajmë habitus, një fjalë latine që do të thotë pak a shumë “gjendje e zakonshme”, një “zakonshmëri”. Nga latinët ajo përdorej në rastin e një gjendjeje të zakonshme e të përsëritur të trupit. Ndërsa nga pikëpamja antropologjike, një atribut i tillë do të përfshinte të kuptuarit e natyrës së pushtetit, të kapitalit simbolik etj. Habitus, është diçka që qëndron në mes të objektivës dhe subjektivës, kolektivës dhe individuale. Nga pikëpamja kulturore është i përcaktuar, por vendi i saj është në mendjen e individit. Habitus është një tip strukture e veprimit social e kryer nga ekzekutorë që nga pikëpamja kulturore konsiderohen si kompetentë. Në njëfarë mënyre, është një nocion i ngjashëm me atë të Noam Chomsky mbi “kompetencën gjuhësore”, ideja sipas së cilës një folëse që praktikon gjuhën e nënës së saj, ka në kokë një model intuitiv që prodhon “ekzekutimin” e aktit gjuhësor. Në rastin e shkencave sociale e antropologjike në veçanti, habitus nuk përbëhet nga institucione so-

cialë, por nga “predispozicione” që anëtarët e një kulture dinë të përdorin në mënyrë intuitive. Në rastin tonë, të një shoqërie të mësuar me pushtetin absolut, historikisht, kjo mendësi është futur në ADN-në shqiptare. Individët e shoqërisë sonë kryejnë zgjedhjet në kuadrin e një habitus, një gjendjeje statike mendore, kufij të e së cilës ngatërrohen me atë të traditës. Tradita në këtë rast ndihmon me të dyja duart ato individë që duan të pluskojnë me mendimet e vullnetet e tyre. Por, jo të gjithë kanë luksin e hyrjes së barabartë në procesin e vendimeve. Në këtë pikë kyçe, hyn në lojë pushteti. Këto persona që arrijnë t’u imponojnë të tjerëve “taksonominë praktike” të botës që i rrethon, fitojnë edhe pushtetin. Një gjë e tillë ndodh edhe në Shqipëri, sipas mendimit tonë. Të bindur ndaj idesë statike, të përzier me traditën shekullore se pushteti duhet të ushtrohet në mënyrë vertikale pa u vënë në diskutim asnjëherë (remineshencë e pastër e autoritetit patriarkal të familjes tipike shqiptare), në momentet më të rëndësishme historike tonat, kur kërkohet mendja e kthjellët dhe vullneti i pastër e i lirë i çdo individit për të vendosur mbi

BIBLIOGRAFIA E PËRGJITHSHMË E KONSULTUAR

Appadurai, A. Disjuncture and Difference in the Global Cultural Economy, te M. Featherstone (nën kujdesin e) Global Culture: Nationalism, Globalization and Modernity. London e Newbury Park, Calif., Sage, 1990.

Hall, S. The local and the Global: Globalization and Ethnicity, dhe Old and New Identities, Old and New Ethnicities, te A.D.King (nën kujdesin e) Culture, Globalization and the World-System, Basingstoke, Macmillan, 1991. Lull J. Media, Communication, Culture: A Global Approach. Cambridge, Polity Press, kap.V, 1994.

Hobsbawm E., Ranger, T. (nën kujdesin e) The Invention of Traditions. Cambridge, Cambridge University Press, 1983.

Lerner, D. The Passing of Traditional Society: Modernizing the Middle East. Glencoe, Ill, Free Press, 1958.

Remotti, F. Noi primitivi. Lo specchio dell’antropologia. Torino, Bollati Boringhieri, 1990 (botimi i dytë është i vitit 2009).

Thompson, John B. Mezzi di comunicazione e modernità, Una teoria sociale dei media. il Mulino Saggi, 1998.

Vehbiu, A. Kuzhinat e kujtesës – ese kritike II. Sejko, Elbasan, 2006.

Wallerstein, I. The Modern World-System I: Capitalist Agriculture and the Origins of the European World-Economy in the Sixteenth Century. New York, Academic Press, 1974.

Weber, M. L’etica protestante e lo spirito del capitalismo, te Sociologia della religione. Milano, Comunità, 1982.

fatet e kombit, shqiptarët nuk bëjnë zgjedhje. Për fat të keq, ato “zgjidhen”. Janë një grusht njerëzish që “zgjedhin” kë do të komandojnë. Pjesa tjetër, shumica, nuk e vë në diskutim, por zbaton qorrazi urdhrin anonim, jehonë e shekujve. Pushteti nuk është një diçka që zotërohet, më shumë se gjithçka është aftësia për të manipuluar një sistem. Pra, as strukturat sociale, por as ato simbolike nuk duhet të konsiderohen si të mirëqena. Po kështu, as skemat kulturore prej nga merr shtysë ky pushtet i ngritur arbitrarisht e pa ndërgjegje, nuk mund të pranohen si skema që ndahen mendërisht nga çdo anëtar i shoqërisë. Nëse tradita jonë në lidhje me pushtetin kërkon këtë, atëherë do të ishim të mendimit se ka ardhur momenti kur tradita duhet të modifikohet, të plazmohet në bazë të interesave të përbashkëta të kohës të gjithë komunitetit. Staticiteti prodhon inerci mendore, pasivitet. Pasiviteti çon në nënshtrim. Nënshtrimi në diktaturë. Shqipëria është në udhëkryqin e mendësisë së saj tradicionale dhe asaj moderne. Por, mos të harrojmë se kur tradita ushqen autarki, është koha të ndryshohet. Pushtetarët nuk mund të fshihen pas traditës, as në forma e aq më shumë në përmbajtje.

Në këtë udhëkryq të zgjedhjeve shqiptare, ka raste që ajo që e quajtmë më lart “rishpikje të traditës”, ngre krye në mënyrën më abuzive e dëmprurëse për shoqërinë. Në këtë këndvështrim do ta shikonim edhe ripërdorimin e “riformatar” të Kanunit të Lekë Dukagjinit në disa

zona të Veriut të Shqipërisë, pas viteve '90 të shekullit të kaluar. Meqenëse funksioni i “legjislacionit” të maleve dihet, nuk është e nevojshme të kujtojmë se për çfarë shërbeu e çfarë rëndësie pati për historinë sociale të atyre trevave. Gati prej dy dekadash, Kanuni është duke u manipuluar në mënyrën më banale nga njerëz të pandërgjegjshëm për dëmin që ajo po shkakton në shoqëri. Vrasja, që nuk përlligjet me asnjë ligj në botë, bëhet në emër të atribuitit të traditës. Mbivendosja e mitit të traditës mbi gjithçka, për fat të keq, ka çuar edhe në keqpërdorimin e saj, apo edhe në shkeljen me të dyja këmbët të formës dhe funksionit fillestar për të cilin u krijua Kanuni. Në këtë rast, u takon intelektualëve nga njëra anë që të sqarojnë popullatën për dëmin e pallogaritshëm që shkakton kjo “mvëshje e re” e Kanunit dhe nga ana tjetër është shteti me institucionet dhe mekanizmat e tij që duhet të ndalë me çdo kusht një abuzim të tillë.

Si përfundim, mund të themi se qëndrimi mendor e praktik shqiptar aktual ndaj traditës dhe modernes reflekton në njëfarë mënyrë atë pozicionim sa gjeografik, aq edhe gjeopolitik të vendit tonë. Ky qëndrim, i ndikuar fuqishëm edhe nga prania aktive e mediave, ka qenë faktor përcaktues në rikrijimin e miteve kombëtare e lokale moderne, si dhe në fenomenin e “rishpikjes së disa traditave” të cilat kanë efekte sa pozitive aq edhe negative në nivelin shoqëror të çështjes. ■

1 Vehbiu Ardian, “Kuzhinat e kujtesës” – Ese kritike II, Sejko, Elbasan, f.183, 2006.

2 Weber, M. “L’etica protestante e lo spirito del capitalismo”, te Sociologia della religione, Milano, Comunità, 1982.

3 Thompson, John B. Mezzi di comunicazione e modernità, Una teoria sociale dei media. il Mulino Saggi, 1998, f.260.

4 Hobsbawm E., Ranger, T. (nën kujdesin e) The Invention of Traditions. Cambridge, Cambridge University Press, 1983.

MITET RRETH ADAMIT

Zgjedha të shkruaj për Adam Smithin, simbolin e kapitalizmit dhe tregut të lirë për shkak të mitizimit ideologjik të forcave të djathta konservatore. Jo vetëm që është një mitizim që shkon përtej të vërtetës së veprës së tij, por edhe realitetet ekonomike, politike dhe sociale të dy kohëve janë kaq të ndryshme. Realiteti i kapitalizmit të sotëm është kaq larg sistemit ekonomik për të cilën ka shkruar ai, aq sa, realisht, shoqëria duhet të tronditet dhe të reflektojë në mënyrë kritike për të korrigjuar funksionimin e vetvetes.



SELAMI XHEPA

FJALA ËSHTË PËR SMITHIN, SIMBOLIN E ‘LAISSEZ FAIRE’, themeluesin e teorisë ekonomike, vepra e të cilit, “Pasuria e Kombeve”, konsiderohet si vepra më madhore e shkruar ndonjëherë në fushën e shkencave sociale. “Me veprat që ka shkruar, Adam Smith i bën hije edhe diellit”, thotë Rothbard Murray. Qëllimi i këtij shkrimi nuk është analiza e veprës së tij, por trajtimi i disa miteve që vazhdojnë ende të rrethojnë emrin e tij,

edhe pse shkrimet dhe veprat e Smithit janë shumë të njohura dhe të studiuara gjerësisht nëpër universitete dhe nga bota akademike. “Ky është fati i personaliteteve të mëdha, - shkruan Russell, - të vlerësohen shumë, por dhe të jenë të keqkuptuar”.

Jo se në shkencën e ekonomisë - për aq sa mund të quhet ajo e tillë - nuk gjen një duzinë mitesh për të cilat mund të shkruash. Për shembull, mitin se çdo shqiptar lind duke trashëguar një borxh



prej 3 000\$, thua se që në maternitet, në vend të certifikatës së lindjes, fëmijës i jepet një letër borxhi (me këtë nuk dua të them se borxhet janë të mira!). Apo mitin se paranë e emeton qeveria (ban-ka qendrore), kur në fakt paraja është krijim kredie që prodhohet nga bankat nëpërmjet procesit të kredisë; miti mbi lidhjen e inflacionit me papunësinë, misteri mbi paranë në shoqërinë njerëzore, etj. Historiografia shqiptare ka rrënjosur argumentin se shkaku i prapam-

betjes ekonomike të vendit buron nga trashëgimia e prapambetjes së Perandorisë Otomane. A është ky një mit, apo një e vërtetë historike? Personalisht anoj nga miti, duke rënë dakord me historianin e madh Inalçik. Për më tepër, kur lexon historinë e ekonomisë moderne, duket sikur mit është shkëputja spektakolare e perëndimit, ndërsa prapambetja e pjesës tjetër të botës, ku bën pjesë dhe Shqipëria, është histori.

Njëri nga mitet më interesante dhe



Njëri nga mitet më interesante dhe intriguese është historia e krijimit të bankës qendrore të SHBA, Sistemi Rezervës Federale (FED), në vitin 1912 (ndonjë studiues skrupuloz do të korrigjonte vitin 1913, viti kur FED filloi të operojë), rreth së cilës janë shkruar aq shumë libra me natyrë konspirative, më interesante nga të cilët është libri i G. Edward Griffin, “The Creature from Jekyll Island - a second look at the Federal Reserve”, botuar në vitin 1994.

intriguese është historia e krijimit të bankës qendrore të SHBA, Sistemi Rezervës Federale (FED), në vitin 1912 (ndonjë studiues skrupuloz do të korrigjonte vitin 1913, viti kur FED filloi të operojë), rreth së cilës janë shkruar aq shumë libra me natyrë konspirative, më interesante nga të cilët është libri i G. Edward Griffin, “The Creature from Jekyll Island - a second look at the Federal Reserve”, botuar në vitin 1994.

“Krijesa e ishullit Jekyll” zë fill me një udhëtim të organizuar në mënyrë tepër sekrete. Udhëtimi për në ishull daton një mbrëmje me shi të ftohtë nëntori të vitit 1910, nga stacioni hekurudhor i Nju-Xhersit. Në një seksion të ndarë të stacionit qëndronte vagoni i trenit privat me etiketën Aldrich, të senatorit të mirënjohur të Rhode Island, vjehri i John D. Rockefeller, pronari i Standart Oil. Nelson Aldrich ishte, përveçse senator, një biznesmen i madh që, si investitor partner i bankës Morgan, zotëronte aksione në sipërmarrje private në shumë degë të ekonomisë. Aldrich do të qëndronte në krye të grupit prej gjashtë vetash që ishin nisur me misionin e rëndësishëm të krijimit të arkitekturës së sistemit bankar modern amerikan. Personazhet e tjera të shquara të atij treni privat asaj nate ishin: Abraham Pi-

att Andrew, asistent i sekretarit të The-sarit; Frank A. Vanderlip, president i National City Bank të Nju-Xhersit; Henry Davison, partner kryesor në J.P.Morgan Company; Benjamin Strong, shefi i J.P.Morgan’s Trust Company; Paul M. Warburg, partner i Kuhn, Loeb&Co, përfaqësues i dinastisë së Rotshildëve në Angli dhe Francë. Udhëtimi prej më shumë se tetëqind miljesh do ta çonte grupin e udhëtarëve drejt një ishulli në bregun kalifornian, që ishte blerë nga Morgan dhe disa partnerë të tij të cilët e përdornin për t’u arratisur nga jeta e përditshme ose për gjueti rosash dhe shpendësh të egër. Asnjë nga pasagjerët që po udhëtonte në vagonin privat të Aldrich nuk ishte i identifikueshëm. Mënyra sekrete e sjelljes do të vazhdonte gjatë gjithë qëndrimit prej nëntë ditësh. Staf i shërbyes i ishullit ishte zëvendësuar me personel të ri dhe të zgjedhur, të gjithë pjesëmarrësit në konferencë do t’i drejtoheshin njëri-tjetrit vetëm në emër. Ishte pikërisht ky mister dhe mënyra sekrete e organizimit që do të shërbente, siç e cilëson Ron Chernow, “si burimi i mijëra historive konspirative”. Njëri prej pjesëmarrësve në konferencën sekrete të Jekyll Island, Paul Warburg, do të shkruante në vitin 1930 një libër të tijin voluminoz prej 1750



faqesh “The Federal Reserve System, Its Origin and Growth”, ku do të nënvizonte se “rezultatet e konferencës do të ishin krejtësisht konfidenciale. Madje dhe fakti se ishte mbajtur ky takim duhej mbajtur sekret për publikun.” Historia vazhdon të zhvillohet si një triler, por nuk përbën interes për këtë shkrim. Në fakt, duket shumë paradoksale që edhe pse sot shkenca ndodhet në kufijtë e së pamundurës, mitet vazhdojnë të jetë po aq të fuqishme sa dhe në botën e lashtë. Duke marrë shkas nga realiteti, ato dalin shumë përtej tij, fitojnë jetën e vet dhe bëhen më të fuqishme se vetë realiteti.

Zgjedha të shkruaj për Adam Smithin, simbolin e kapitalizmit dhe tregut të lirë për shkak të mitizimit ideologjik të forcave të djathta konservatore. Jo vetëm që është një mitizim që shkon përtej të vërtetës së veprës së tij, por edhe realitetet ekonomike, politike dhe sociale të dy kohëve janë kaq të ndryshme. Realiteti i kapitalizmit të sotëm është kaq larg sistemit ekonomik për të cilën ka shkruar ai, aq sa, realisht, shoqëria duhet të tronditet dhe të reflektojë në mënyrë kritike për të korrigjuar funksionimin e vetvetes. Duke qenë se emri i tij është sinonim i tregut të lirë, i interesit personal dhe individualizmit, duket sikur njëherazi

ai është dhe një mbrojtës pakufi i interesave të bizneseve të mëdha dhe se interesat e shoqërisë dhe grupeve të tjera shoqërore nuk duhet të mbahen në konsideratë; sikur publikja nuk duhet të ekzistojë dhe se gjithçka i duhet lënë forcave të pakontrollueshme të tregut. “Pasuria e kombeve” dhe “Teoria e sentimenteve morale” duhen lexuar të dyja në harmoni. Edhe pse “Pasuria e kombeve” u shkrua më vonë, disa nga temat e etikës së sistemit ekonomik ai i rimerr nga “Teoria e sentimenteve morale” dhe i zhvillon sërish duke i vendosur të dyja veprat e tij në koherencë të plotë.

INTERESI VETJAK

Kur Smith thotë se ne nuk e presim bukën nga mirësia e bukëpjekësit, por është interesi i tij vetjak ai që e shtyn atë të prodhojë një mall sa më cilësor, askush nuk mund të gjejë argumente ta hedhë poshtë këtë postulat thelbësor në ekonomi. Por te “Teoria e sentimenteve morale” ai shkruan: “Sado egoist që të jetë njeriu, është e qartë se ka disa parime në natyrën e tij që janë edhe në interesin e pasurimit të të tjerëve dhe se lumturia e tyre është edhe në interesin e tij, edhe pse ai nuk nxjerr asgjë prej tyre, përveç kënaqësisë që po e sheh diçka të tillë.” Pra, edhe po ta shohim në mënyrë egoiste veprimin e interesit vetjak, lumturia e të tjerëve është gjithashtu edhe në interesin e sipërmarrësve. Më tutje, Smith argumenton se skllavëria është më e kushtueshme për sipërmarrësit sesa puna e paguar. Dhe, në këtë linjë arsyetimi, një punë e keqpaguar është më e kushtueshme se një punë e mirëpaguar. Këtu duket sikur futem në një paradoks, pasi Smith dhe Rikardo ishin mbështetës të tezës së teorisë së vlerës nga puna, që shërbeu si bazë e teorisë së mëvonshme marksiste të mbivlerës si

punë e papaguar e punëtorit.

Ajo që Smith argumenton në këtë çështje është se një punëtor i papaguar është krejtësisht i pamotivuar dhe se, për pasojë, puna e tij është shumë joproduktive. Një punëtor i papaguar apo i keqpaguar nuk ka motivimin që të përmirësojë proceset e punës, teknologjinë, organizimin e punës dhe të jetë inovativ në kryerjen e operacioneve të prodhimit. Kenichi O'Hmae, një guru i shkencës së menaxhimit, shkruan se një nga burimet e jashtëzakonshme të inovacioneve për korporatat japoneze janë idetë që japin vetë punëtorët e kompanive. Në katin e parë të firmave qëndrojnë të vendosura kuti ku punëtorët mund të shkruajnë dhe të hedhin idetë e tyre mbi përmirësimet që ata sugjerojnë për gjithçka në korporatë. Kështu grumbullohen mijëra ide - falas, pa asnjë shpenzim shtesë - të cilat studiohen nga inxhinierët, të cilët i shndërrojnë ato në procese inovative duke i bërë firmat japoneze ndër më konkurrueset në botë.

Në fakt, pjesa mbyllëse e citimit të Smithit se "...ai nuk nxjerr asgjë prej tyre përveç kënaqësisë që po e sheh diçka të tillë", nuk duket e saktë. Rritja e pagave stimulon kërkesën ekonomike dhe vetë shitjet për mallrat që prodhojnë vetë firmat. Pra, krijojnë kërkesë shtesë duke rritur vetë shitjet e tyre. Kështu veproi Henri Ford kur e bëri pagën javore 5\$ në vitet 1920, ndërkohë që pagat në SHBA ishin vetëm 1\$. Kjo ishte një strategji tepër

e suksesshme si për kompaninë, ashtu edhe për punëtorët.

U zgjata në këtë pikë për të argumentuar dhe njëherë se Adam Smithi thotë se interesat vetjake shërbehen më mirë kur shërbehen njëherësh po aq mirë edhe interesat e aktorëve të tjerë në kompani apo në shoqëri. Të rrisësh pagat, të mbrosh shëndetin e të punësuarve, të krijosh një ambient pune komod dhe stimulues, të mbrosh mjedisin në komunitetin ku veprojnë, janë po aq në interesin e vetë pronarëve të firmave, sa edhe të punëtorëve.

"DORA E PADUKSHME"

Gjuha që përdor Smithi në veprën e vet është hyjnore, siç është simbolika e dorës së padukshme. Në librat e shenjta lexojmë për frymën hyjnore që sjell rregullin në botën tokësore, ashtu sikurse dhe dora e padukshme sjell ekuilibrin nga kaosi i miliona e miliarda transaksioneve të pakoordinuara ekonomike. Në këtë pikë, Smithi, duhet thënë, se ishte deri diku radikal, pra se tregu prodhon rezultatin më të mirë të mundshëm. Por, sot jeta ekonomike e globit është shumë më tepër komplekse krahasuar me kohën kur jetoi Smithi. Nga epoka e Revolucionit të Parë Industrial, kur jetoi Smithi, në botën e sotme të Revolucionit të Katërt (u fol gjerësisht në numrin e mëparshëm të kësaj reviste për këtë temë), realiteti nuk ka të krahasuar. Por, edhe për kushtet e asaj epoke disi primitive kra-

hasuar me botën e sotme, Smithi na bën disa paralajmërime se, në mjaft raste, tregjet duhen mbajtur nën kontroll. Madje Smithi ishte mbështetës edhe i vendosjes së kufizimeve për normën e interesit mbi huan, një tezë që as ekonomistët e majtë sot nuk e mbështesin.

Ai thoshte se kapitalistët gjithnjë do të përpiqen të shfrytëzojnë njerëzit e zakonshëm ose duke bërë që rregullat të hartohen sipas interesave të tyre, ose duke fiksuar çmimet e mallrave dhe të shërbimeve. “Normat e fitimit ... janë gjithnjë më të larta në vendet që shkojnë drejt rrënimt”. Sikur rregullatorët të lexonin Smithin, me siguri që ekonomia e vendit do të ishte më e shëndetshme; sikur kapitalistët shqiptarë ta kuptonin Smithin, me siguri do të operonin me rregulla të tjera tregu dhe norma fitimesh brenda logjikës normale të vlerësimit të së ardhmes së shoqërisë. Normat e fitimeve, njësoj si dhe normat e interesit, janë shprehje e çmimit që ne i japim të ardhmes sonë. Në shoqëritë me stabilitet dhe ku besimi për të ardhmen është i lartë, edhe fitimet dhe interesat janë më të ulëta; e kundërta ndodh në shoqëritë e trazuar dhe që vuajnë destabilitet social. Kjo është një tezë e studiuar edhe nga ekonomistët e shkollës institucionaliste, të cilët kanë parë lidhjen midis besimit tek e ardhmja, normave të interesit dhe krimit në shoqëri. Fakti se normat e fitimit në bizneset vendase janë shumë të larta, është njëherësh shprehje e mungesës



së besimit që vetë investitorët shohin për të ardhmen, pikërisht siç e thotë dhe Smithi.

KONSUMI DHE PRODHIMI

Përfituesit kryesorë të tregut të lirë duhet të jenë konsumatorët, sipas Smithit, ndërsa interesat e bizneseve i sheh si të varura nga konsumatori. “Konsumi është qëllimi i vetëm dhe final i prodhimit dhe interesat e prodhuesit duhen ndjekur vetëm për atë që ato i shërbejnë promovimit të interesit të konsumatorit. Maksima është kaq vetevidente, sa është absurde të përpiqesh ta provosh. Por, ... interesi i konsumatorit, pothuajse gjithnjë dhe në mënyrë

konstante, sakrifkohet në emër të interesave të prodhuesve; dhe duket se prodhimi, dhe jo konsumi, është qëllim i vetëm dhe final i industrisë dhe tregtisë...”

Por çfarë mendonte Smithi për biznesmenët e kohës së tij? Shfrytëzimi i punëtorëve, pagat e ulëta dhe fitimet e larta duket se kanë ngjallur neveri të Smithi. “Rritja e fitimeve vepron njësoj si interesi i përbërë. Tregtarët dhe manifakturuesit tanë ankohen mjaft për efektet negative që kanë pagat e larta në rritjen e çmimeve dhe rënien e shitjeve si brenda, dhe jashtë vendit. Por ata nuk thonë asgjë rreth normave të larta të fitimeve. Ata heshtin për efektet e dëmshme të fitimeve të tyre; ata ankohen vetëm për ato të personave të tjerë. Kjo logjikë e operimit të sistemit kapitalist ndikon negativisht edhe mbi edukimin.”, thotë Smithi. “Prirja e kapitalizmit për të paguar paga të ulëta krijon klasa të ulëta dhe për pasojë fëmijët e këtyre klasave, në vend që të studiojnë, janë të detyruar të punojnë më shumë në kurriz të edukimit.” Prandaj, në këtë pikë Smithi thekson se qeveritë duhet të luajnë një rol shumë aktiv në fushën e edukimit. Këtë argument Smith e merr edhe kur trajton rreziqet e një specializimi të thellë,

pasi kjo e shndërron individin në një makinë pune duke e zvetënuar intelektualisht. “Prandaj kura është edukimi publik”, thotë Smith. “Qeveria duhet të jetë po aq e përkushtuar ndaj edukimit, - thotë, ai, - sa ç’është edhe ndaj luftës ndaj lebrozës apo sëmundjeve të ndryshme.”

Adam Smith ishte gjithashtu kundër korporatave, duke i paraparë rreziqet e ndarjes së pronësisë nga menaxhimi në një korporatë, një problem themelor në teorinë principal-agjent të ekonomisë të ditëve tona. Krizat e sotme të sistemit financiar nuk mund të mos shihen si dëshmi tronditëse e të vërtetave që na ka thënë Adam Smith që prej shekullit të tetëmbëdhjetë dhe që janë dhe sot po aq të rrezikshme për botën tonë.

A besonte Smithi të tregu i lirë si një sistem më superior se çdo sistem tjetër? Padyshim që po. Por ai asnjëherë nuk ka thënë se ky është sistemi perfekt, ku gjithkush do të jetë përfitues dhe se biznesmenët nuk duan ta manipulojnë sistemin duke përfituar në kurriz të më të dobëtëve dhe të pambrojturve. Dora e padukshme e Smithit kërkon të çlirohet jo vetëm nga ndërhyrjet e qeverisë, por edhe nga manipulimet e ‘oligarkëve’, të biznesmenëve të pushtetshëm që influencojnë ligjberjen dhe rregullimin ekonomik në favor të interesave të tyre. Dora e padukshme është e dobishme kur ajo vepron në përfitim të konsumatorëve dhe jo të interesave të prodhuesve të cilët nuk e quajnë të pamoralshme të abuzojnë me konsumatorin në emër të interesave të tyre. Është provuar se edhe kompani shumë prestigjioze ndërkombëtare kanë abuzuar me lirinë - lista është e gjatë dhe nuk ja vlen të përmenden edhe për faktin se vetëm ata janë “kapur” nga sistemi. Plot kompani të tjera që nuk janë kapur, apo vetë autoritetet nuk dëshirojnë “t’i kapin”, janë përreth. Mentaliteti “për t’ia hedhur konsumatorit” është një

“**Adam Smith ishte gjithashtu kundër korporatave, duke i paraparë rreziqet e ndarjes së pronësisë nga menaxhimi në një korporatë, një problem themelor në teorinë principal-agjent të ekonomisë të ditëve tona.**

mendësi mbizotëruese të shumica e sipër-marrjeve, pikërisht duke keqinterpretuar konceptin smithian të interesit vetjak.

Doktrina smithiane e tregut të lirë dhe e konkurrencës perfekte vështirë se ndeshet në jetën reale. Si mund të konkurrojnë njësoj një kioskë e vogël e rrugës me supermerkatat e mëdha të Tiranës; një punëmarrës i pambrojtur (Zot mëshiroji sindikatat!) ndaj një punëdhënësi me pushtet dhe influencë ekonomike dhe politike; një riparues i vogël makinash ndaj një qendre të madhe distribucioni dhe mirëmbajtjeje të markave të makinave të mëdha. Si mund të ketë ekuilibër forcash kur ballafaqohen një depozitues i vogël në bankë apo huamarrës i vogël dhe banka; një investitor i vogël në një fond investimesh dhe menaxherët e këtyre bankave të investimit. Kjo asimetri është kaq e fuqishme sot sa, nëse nuk vepronhet me shpejtësi dhe forcë, pasojat do të jenë edhe më shqetësuese për shoqërinë nesër. Falimentimet nga kriza e madhe e vitit 2008, ashtu si dhe e gjithë krizave të mëparshme, kanë rrënuar kursimet e miliona depozituesve të vegjël, por nuk kanë cenuar interesat ekonomikë të asnjë bankieri; përkundrazi, ata janë larguar me shuma të majme monetare edhe kur të gjithë janë rrënuar. Rendja drejt fitimeve të larta dhe pasurimit pa kufij ka apeluar dhe filozofë të mëdhenj të virtytit, jo më borgjezët mëkatarë, të cilët kanë qenë historikisht të përbuzur nga shoqëria. Bertrand Russell thotë, për shembull, se “stoiku Seneka, edhe pse ishte filozof stoik, të cilët urrenin pasurinë dhe lëvdonin jetën e thjeshtë, të vështirë dhe të mundimshme, kishte krijuar një pasuri prej rreth 300 milionë sestere (gati 5 milionë paund sterlina të viteve të sotme), kryesisht duke i dhënë hua Britanisë me norma shumë të larta.” Thjesht moralizimi dhe besimi filozofik

VEPRA



Gjuha që përdor Smithi në veprën e vet është hyjnore, siç është simbolika e dorës së padukshme. Në librat e shenjtë lexojmë për frymën hyjnore që sjell rregullin në botën tokësore, ashtu sikurse dhe dora e padukshme sjell ekuilibrin nga kaosi i miliona e miliarda transaksioneve të pakoordinuara ekonomike. Në këtë pikë, Smithi, duhet thënë, se ishte deri diku radikal, pra se tregu prodhon rezultatin më të mirë të mundshëm. Por, sot jeta ekonomike e globit është shumë më tepër komplekse krahasuar me kohën kur jetoi Smithi.

nuk mund t'i vërë fre etjes për superfitime. Kemi nevojë për rregulla të forta që balancojnë më mirë interesat midis grupeve të ndryshme shoqërore.

Triumfi i kapitalizmit sot është kryesisht prej dorës së padukshme që mbahet nën fre dhe kontroll nga dora e dukshme e rregullimit nga ana e institucioneve që mbrojnë interesat publikë. Dhe meqenëse kjo e fundit kërkon shtetar me cilësitë që kërkonte Platoni, filozof dhe mbrojtës të së drejtës, jam skeptik edhe për të ardhmen. ■

MITET PËR TË ZBUKURUAR VETEN



DHE ATO PËR TË SHËMTUAR TJETRIN

Ballkani ka qenë dhe ka mbetur djep i përshtatshëm ku mëkohen e rriten mitet, sepse popujt e këtyre hapësirave gjithmonë kanë vuajtur për të qenë ato që do ua kishte zili e tërë bota, apo që të kenë ato tipare për çka do t'ua kishin lakmi gjithë të tjerët.



KIM MEHMETI

BALLKANI ËSHTË I MBUSHUR ME MITE. Sepse popujve të këtyre hapësirave u është dashur të merren me diçka përtej së vërtetës që i rrethon, për të mundur ta përballojnë më lehtë atë që e jetojnë. Pra atyre u është dashur që edhe bëmave, si dhe heronjve që kanë marrë pjesë në to, t'ua shtojnë përmasat, t'ua zhveshin petkun e të vërtetave dhe t'i veshin atë të dëshiruarin, t'i stolisin edhe me tipare imagjinare vetëm që nëpërmjet tyre ta zbukurojnë dhe madhërojnë vetveten. Pra popujt e Ballkanit, mbase si edhe gjithë të tjerët, kanë ngritur mite jo për të mitizuar ngjarje dhe heronjtë të vet, por për ta ngritur sa më lart mitin për vetveten.

Ballkani ka qenë dhe ka mbetur djep i përshtatshëm ku mëkohen e rriten mitet, sepse popujt e këtyre hapësirave gjithmonë kanë vuajtur për të qenë ato që do t'i kishte zili e tërë bota, apo që të kenë ato tipare për çka do t'ua kishin lakmi gjithë të tjerët. Pra popujt e këtyre hapësirave, sikurse edhe gjithë popujt e kësaj bote, kurrë nuk ia kanë dalë të jenë të kënaqur me atë që janë e atë që kanë si një parakusht për të arritur atë që ëndërrojnë, andaj gjithmonë kanë vuajtur për të munguarën dhe kanë bërë çmos të tregohen të atillë siç do të donin të ishin, të atillë siç do t'i kishin zili të huajt. Kështu që punëtorja ballkanike për prodhimin e miteve ka “nxjerrë” shumë trima e personalitete me tipare përrallore njerëzore, por këto janë veçori që sot nuk mund t'i gjesh thuajse askund mes përfaqësuesve të popujve sypatrembur, të besës e të moralit të lartë. Këta popuj aq shumë e kanë mitizuar, për shembull, mikprit-

jen dhe zemërgjerësinë, sa duket se e kanë bërë vetëm sa për ta mbuluar urrejtjen që ndjejnë ndaj njëri-tjetrit, apo vetëm për t'i fshehur fytyrat vrastare që kanë mbushur varreza masive, ku nuk kanë munguar edhe kufomat e fëmijëve dhe të nënave shtatzëna, të masakruara e të vrara.

Për dallim nga popujt të tjerë, mes të cilëve nuk mungojnë as ata pa mite dhe pa data të lavdishme, pra për dallim nga popujt që madje u duhet të hedhin vështrimin përtej hapësirave ku jetojnë për të gjetur ndonjë nga mitet që do të pëlqenin të kishin, popujt e Ballkanit thuajse as që mund të jetojnë në paqe me vetveten pa arritur paqen me mitet që kanë ngritur. Por dhe me atë se si mitet për ta glorifikuar vetveten, po ashtu edhe ato që kanë për qëllim për ta poshtëruar dhe nxirë tjetrin, e që i kanë aty në oborrin e shtëpisë.

Po pra, të gjithë popujt sa janë në këtë Ballkan kanë mitet për ta madhëruar vetveten, me të cilat stolisen kur duan të prezantohen përpara të tjerëve, dhe mitet që edhe nuk shfaqen aq hapur, që janë “për përdorim shtëpiak”, mitet që shërbejnë si ninulla për t'i trembur dhe vënë në gjumë fëmijët lazdranë, apo për të treguar se me çka dallojmë “ne” nga “ata”, mitet që të tjerët duhet t'i portetizojnë ashtu siç i paragjykojmë, apo siç do të donim të ishin.

Andaj edhe mund të thuhet se ka mite që janë si stoli vezulluese dhe të shtrenjta, jo gjithmonë të bëra prej metali të çmuar, por çdoherë të lara në ujë prej ari! Pra bren dia e të vërtetave për ta është e mbështjellë me gënjeshtër joshëse, që e kanë mirëmbajtur boshtin kurrizor, si dhe dinjitetin dhe krenarinë e pjesëtarëve të një etnie apo të një feje. Dhe ndaj këtyre miteve popujt sillen si pronari i stolisë së shtrenjtë të praruar: duke e pastruar kujdesshëm atë që të mos e gërvishtin, ngaqë mund edhe të ndryshket. Dhe atë jo gjithaq pse do ta dëmtojnë stolinë (lexo: mitin), por pse kështu do mund

GËNJESHTRAT JOSHËSE TË MITEVE

Mund të thuhet se ka mite që janë si stoli vezulluese dhe të shtrenjta, jo gjithmonë të bëra prej metali të çmuar, por çdoherë të lara në ujë prej ari! Pra brendia e të vërtetave për ta është e mbështjellë me gënjeshttra joshëse, që e kanë mirëmbajtur boshtin kurrizor, si dhe dinjitetin dhe krenarinë e pjesëtarëve të një etnie apo të një feje. Dhe ndaj këtyre miteve popujt sillen si pronari i stolisë së shtrenjtë të praruar: duke e pastruar kujdesshëm atë që të mos e gërvishtin, ngaqë mund edhe të ndryshket. Dhe atë jo gjithaq pse do ta dëmtojnë stolinë (lexo: mitin), por pse kështu do mund ta dëshpërojnë pronarin që e ka ruajtur atë si diçka më të shtrenjtë që ka pasur dhe me të cilën është stolitur në ditë kremteje. Por ka edhe mite që janë e kundërta e të lartpërmendurave, që ne i ndërtojmë për të tjerët, apo për nevoja politike, e që gjithashtu mund të jenë shumë të frytshme për ta çuar një popull përpara, por edhe shkatërrimtare nëse bëhen mure të kalasë së urrejtjes ndaj të tjerëve

ta dëshpërojnë pronarin që e ka ruajtur atë si diçka më të shtrenjtë që ka pasur dhe me të cilën është stolitur në ditë kremteje.

Por ka edhe mite që janë e kundërta e të lartpërmendurave, që ne i ndërtojmë për të tjerët, apo për nevoja politike, e që gjithashtu mund të jenë shumë të frytshme për ta çuar një popull përpara, por edhe shkatërrimtare nëse bëhen mure të kalasë së urrejtjes ndaj të tjerëve. Edhe kur jemi te këto mite duhet thënë se popujt e Ballkanit i kanë me shumicë dhe ato shpesh janë përdorur sa në betejat e ndërsjella politike, po aq edhe në luftërat e përgjakura, përfshirë edhe ato të fundshekullit të nëntëmbëdhjetë, kur populli që e kishte shpallur vetveten si të shenjtë - ai serb - filloi betejat e përgjakshme kundër atyre që gjatë dekadave i kishte mitizuar si trashëgimtarë të osmanlinjve dhe ndaj të cilëve duhej t'i vazhdojë betejat e humbura nga e kaluara, përfshi edhe atë

të Kosovës. Pra nisi betejat e përgjakshme kundër të gjithë popujve me përkatësi fetare joortodokse, e kryesisht kundër atyre me përkatësi fetare myslimane.

Dhe mbase mitet janë e vetmja lëmi ku ballkanasit mund edhe të ndjehen superiorë dhe më të pasur e më të zhvilluar sesa popujt e tjerë të Evropës. Sa u përket miteve, as "populli i filozofisë" - ai gjerman - vështirë se mund të bëjë gara me cilindo popull të Ballkanit. Madje atij nuk i bën punë as miti për Barbarosën, që fle në shpellë dhe çdo 100 vjet zgjohet dhe e dërgon xhuxhin e vet jashtë që të shohë nëse korbat vazhdojnë të vërtiten mbi mal e me çak do ta kuptonte se a ka ardhur koha ta braktisë shpellën dhe si sundimtar i ditur të kujdeset për rendin. Sikur ai të jetonte në ndonjë shpellë ballkanike, kurrë nuk mund të bënte gjumë të qetë si në viset gjermane, ku të gjithë punojnë dhe ruajnë rendin e qetësinë, për dallim nga



këto hapësira, ku komunikimi rrugor nga bredhin mitet është aq i ngarkuar, sa askush më nuk e kupton se kur dhe pse ndeshen e vërteta me gënjeshtren.

Ndërkohë duhet pranuar se nga gjithë popujt e Ballkanit, serbët janë të patejkalueshëm sa i përket “prodhimtarisë” së miteve. Si mitet për ta madhëruar vërtetën, po ashtu edhe ato për ta përbuzur apo edhe për të treguar sa më të shëmtuar tjetrin. Duke qenë të tillë, ata, për shembull, ende janë duke vazhduar Betejën e Kosovës duke i shpallur ushtarë të mbetur të Perandorisë Osmane të gjithë myslimanët e këtyre hapësirave. Po pra, punëtoritë serbe për prodhim të miteve janë të afta që nga cilado betejë e tyre e humbur, si dhe nga më i madhi dështim i tyre, me lotët dhe pikëllimin e disfatës që kanë pësuar, të gatujnë brumë të mjaftueshëm për mitin i cili, jo vetëm që do t’i ngushëllojë përjetë, por edhe do t’u mundësojë që

humbjen ta ndjejnë më madhërishtëm se cilëndo fitore. Kjo i bën “baballarët” e këtij populli të mos e fshehin fare se gënjeshtra është një nga shtyllat kryesore mbi të cilat qëndron e “vërteta” për të shkuarën e këtij populli, siç nuk e fshehin as mjeshtrinë si t’i përdorin mitet në betejat politike dhe se si edhe gënjeshtra më e pabesuar, por e përsëritur qindra herë me radhë, një ditë do të tingëllojë si e vërtetë duke e shtyrë kufirin e asaj që e ndan nga mashtrimi. Kështu pra, serbët kanë mundur që edhe në shtëpi publike të gjejnë një prostitutë të virgjër, të cilën pastaj aq e kanë mitizuar, sa e kanë ngritur në rrafshin e “murgeshës”, e cila pastaj ka shërbyer si shembull për moralin dhe vlerat familjare.

Dhe sa i përket Maqedonisë se sotme, që nesër do të quhet Maqedonia Veriore dhe popullit të sotëm maqedonas që jeton në të, e që nesër mbase do të quhet sllavo-maqe-

donas verior, ajo është si një Ballkan i vogël ku jetojnë, të vëllazëruara e madje edhe të birësuar, të gjitha mitet e popujve të këtij gadishulli. Të krijohet kështu përshtypja se sllavo-maqedonasit janë treguar shumë më të gjindshëm se gjithë popujt tjerë: duke e parë begatinë e këtyre hapësirave sa u përket miteve, ata kanë ndjekur rrugën më të lehtë për t'u pasuruar me to: të mos lodhen me krijimin e miteve të reja, por të birësojnë e të huazojnë nga popujt sivëllezër sllavë, të cilët pastaj i kanë mëkuar e rritur në djepin e vet etnik.

Dhe nëse është plotësisht e kuptueshme që popullin që ka trilluar Vilhelm Telin (i cili qëllon me shigjetë mollën mbi kokën e njeriut) ta dallojë saktësia, pra prodhimtaria e orëve dhe drejtimi i bankave, një popull i vogël si ai sllavo-maqedonas, që ende është duke gjurmuar të shkuarën e vet, do të ngrinte apo do të huazonte mite që do t'ia shpërfaqnin dëshirën për të qenë më ndryshe dhe më të madhërishtëm se ata që e akuzonin dhe e akuzojnë se ua ka vjedhur jo vetë mitet, por edhe të vërtetën historike.

Sllavo-maqedonasit kanë mitin për “Dojçinin e sëmurë”, për të cilin kujdeset motra e tij - e që e kanë, por me emër tjetër, thuajse të gjithë popujt e Ballkanit, siç e kanë edhe mitin për Kralin Marko që i ka mposhtur të gjithë që ia kanë prerë udhën, edhe mitin për ndërtimin e kalasë që shembet gjatë natës... Pra sllavomqedonasit kanë aq shumë mite sa i është dashur pyllit të fantazisë për ta mbuluar kodrën e përtejme të dëshirave dhe ëndrrave. Por, mbi të gjitha, ata kanë edhe mite të ngritura gjatë dekadave të fundit, e që kryesisht i kanë ndihmuar në betejat politike dhe në orvatjet që ky popull ta përcaktojë identitetin e vet etnik. Dhe këto mite kryesisht kanë të bëjnë me shqiptarët dhe thuajse kanë pasur vetëm një qëllim: që të maqedonasit ta nxisin përkushtimin dhe

inatin për t'u bërë popull. Me çka edhe të krijohet përshtypja se ata edhe u bënë popull për inat të shqiptarëve.

Pra edhe sllavo-maqedonasit, krahas miteve me të cilat e rrisin famën për vetveten, apo me të cilat duan të theksojnë atë që u mungon, pra krahas miteve që janë banorë të njohur të Ballkanit, ata kanë edhe mitologjinë që u shërben në betejat politike e që shpeshherë edhe të pashpërfaqur publikisht përpara të tjerëve, por që me përkushtim i ruajnë dhe i kultivojnë. Pra edhe ata, si edhe shumë popuj tjerë, kanë trilluar mite për të stolitur vetveten e që t'ua tregojnë lirshëm të tjerëve, por edhe mite për “nevoja shtëpiake” e që kryesisht kanë të bëjnë me rritjen e paragjytimeve, e madje edhe urrejtjes ndaj të tjerëve, kryesisht ndaj shqiptarëve dhe popujve me përkatësi fetare joortodokse.

Shkolla sllavo-maqedonase për përdorimin e miteve është degë e asaj të Beogradit. Andaj edhe mitet për tjetrin si “të keq” dhe “armik të përjetshëm” i cili duhet luftuar deri në shfarosje, janë ato mite që e bartin kullën e vetëmashtrimit se për shëmtinë tënde fajtorë janë ata me të cilët bashkëjeton. Kjo mitologji, ngaqë nuk ka të bëjë me vetveten, por me të tjerët, duhet edhe t'i shfaqë të tjerët ashtu siç i paragjykojmë ne, apo siç do të donim të ishin. Dhe kështu kanë lindur mitet për “magjupen” që vjedh foshnjat, të cilave pastaj ua pi gjakun, si dhe miti për shqiptarin e tmerrshëm i cili për një fjalë goje të ther, rrëfime me të cilat i vëmë në gjumë fëmijët e padëgueshëm.

Sa i përket mitit të rritur në djepin anti-shqiptar serb, të cilin pastaj slavo-maqedonasit e kanë birësuar dhe e kanë “stilizuar” për nevoja të veta, e që ka të bëjë me “shqiptarin e rrezikshëm dhe të pabesë” i cili është i mirë vetëm i vdekur, ai është ndër më të përdorurit dhe atij madje i janë kënduar

edhe këngë, siç është për shembull kënga për “shqiptarët katilë që e kanë rrethuar Manastirin e Leshokut”. Në këtë grup mitesh bën pjesë edhe ai për “turqit e mallkuar”, mit që i ngjan atij tonit për “osmanlinjtë”, që na bën dembelë dhe që na lanë të prapambetur, me çka tjerët i fajësojmë për veset tona të këqija dhe vetëgënjëhemi se do të ishim më të bukur e më të shkathët po të kishim bashkëjetuar me të tjerë dhe sipas një kalendari krejt ndryshe nga ai që i takon të kaluarës së popullit tonë.

Duke qenë një popull që është duke ndërtuar rishtazi të kaluarën e vet, pra duke e arnuar të shkuarën herë me sllavët e jugut - por vetëm kur duan të tregohen si nipër të Shën Kirilit e Naumit - apo duke e veshur me petkun antik maqedonas - kur duan të vetëshpallen nipër të Aleksandrit të Madh, sllavo-maqedonasit nuk i kanë të përrjetshme as mitet. Dhe siç është cekur më lart, ky popull më të përfaqësuara i ka mitet e dekadave pas rënies së Perandorisë Osmane, ato nëpërmjet të cilave është munduar ta tregojë vetveten si popull biblik dhe si epiqendër nga rrezaton njerëzorja. Dhe për ta sforcuar këtë mit për vetveten si popull biblik, ata kanë ngritur edhe mitin për zilinë që ua kanë të tjerët, si dhe mitin se për shkak të kësaj zilie të gjithë popujt e Ballkanit, e madje edhe të Europës, e duan shfarosjen e këtij populli.

Mitkrijuesve të popullit maqedonas nuk u ka munguar material krijues as për mitet lidhur me padrejtësitë që këtij populli i janë bërë dhe që vazhdojnë t'i bëhen nga fuqitë e mëdha të botës. Kur bëhet fjalë për këtë viktimizim të tyre, sërish shqiptarët janë shkak për të cilët bota tregohet e padrejtë ndaj sllavo-maqeonasve. Ndërkohë bie në sy një fenomen i palogjikshëm sa i përket mitit politik për shqiptarët si rrezik i natyrshëm për sllavo-maqeodanasit: edhe kur ata vaj-



NGUSHËLLIMI

Ndërkohë duhet pranuar se nga gjithë popujt e Ballkanit, serbët janë të patejkalueshëm sa i përket “prodhimtarisë” së miteve. Si mitet për ta madhëruar vërtetën, po ashtu edhe ato për ta përbuzur apo edhe për të treguar sa më të shëmtuar tjetrin. Duke qenë të tillë, ata, për shembull, ende janë duke vazhduar Betejën e Kosovës duke i shpallur ushtarë të mbetur të Perandorisë Osmane të gjithë myslimanët e këtyre hapësirave. Po pra, punëtoritë serbe për prodhim të miteve janë të afta që nga cilado betejë e tyre e humbur, si dhe nga më i madhi dështim i tyre, me lotët dhe pikëllimine disfatës që kanë pësuar, të gatujnë brumë të mjaftueshëm për mitin i cili, jo vetëm që do t'i ngushëllojë përjetë, por edhe do t'u mundësojë që humbjen ta ndjejnë më madhërisht se cilëndo fitore.

SHERRI PËR MITET

Gjithashtu mbetet edhe e vërteta se popujt e vegjël kanë histori të ngatërruar, sepse o atë e kanë përplot me mitizime dhe glorifikime të pamatura, madje të arnuar nga historitë e popujve tjerë, o e kanë të diskutueshme për shkak se zaptuesit e mëdhenj, pa i pyetur, kanë përvetësuar edhe pjesë nga e kaluara e tyre. Kjo veçanërisht vlen për popujt e Ballkanit, ku historitë shkruhet sipas parimit: “të gjithë heronjtë e vlefshëm janë me përkatësinë tonë etnike, e personalitetet negative nuk kanë gjakun e popullit tonë”. Andaj edhe ballkanasit nuk janë në grindje vetëm për shkak të së sotmes, por edhe për arsye se të kaluarën e kanë po aq të ngatërruar sa edhe ëndrrën për ardhmërinë. E që shpeshherë i bën të duken si kopshtarë të cilët nga kopshti ku kanë mbjellë thera, presin të vjelin qershi.

tojnë nga vuajtjet e shkaktuara nga serbët, grekët e bullgarët, përsëri shajnë shqiptarët. Mbase pse nëndija u thotë se nuk guxojnë t'i shajnë e ofendojnë popujt nga historia dhe mitologjia e të cilëve është arnuar edhe ajo maqedonasja.

Sidoqoftë duhet ripërsëritur se popujt e Ballkanit kanë një tipar të përbashkët: nëse do t'i lavdërosh e t'i bësh të ndjehen mirë, nuk duhet t'u thuash sa të mirë janë ata me të cilët bisedon, por sa trima dhe sa bujarë kanë qenë gjyshërit e tyre të dikurshëm. Si dhe t'ua respektosh mitet me të cilat stolisen. Pra popujt e Ballkanit më shumë jetojnë në të shkuarën sesa në të sotmen e vet, andaj edhe natyrshëm ata më mirë komunikojnë me mitet, sesa me realitetin. Andaj edhe ata nuk ofendohen gjithaq nëse u thua se gjeneratat e sotme nuk vlejné gjë, se janë një turmë pa portet të qartë kolektiv, se përpos së kaluarës dhe miteve të lavdishme, nuk kanë asnjë vlerë me të cilën mund ta identifikosh të sotmen e tyre. Por ata lëndohen lehtësisht nëse ua zhvlerëson të kaluarën, nëse ua shan rrënjët nga është rritur filizi i tyre që sot është bërë degë etnike. Disa popuj të Ballkanit, duke jetuar në të sotmen e mjegullt dhe duke ecur drejt së ardhmes së paqartë, më mirë ndjehen të mbyllur në zgafellën e së kaluarës dhe në kalanë e miteve, ku ritregojnë rrëfimet për gjyshërit e tyre, për lavdinë edhe të heronjve

të paqenë, duke harruar se çdo veprim i tyre i sotëm është farë nga do të mbijë bima e ardhmërisë që do përcaktojë fatin e nipave të tyre. Dhe kështu, këto popuj kanë mbetur në gropën e rrethuar nga brigjet e të sotmes së paqartë dhe të kaluarës së mjegullt, e kaluar e cila thujse gjithmonë është ndërthurje e të vërtetave dhe miteve. Edhe sot, pra, kur lexon librat historikë të tyre, ke përshtypjen se je duke shfletuar ndonjë përmbledhje me përralla popullore, në të cilat gërshetohet edhe ndonjë ngjarje e vërtetë.

Kështu pra, thujse të gjithë popujt e Ballkanit më mirë ndjehen nën fladin e lavdisë së gjyshërve të tyre dhe të heronjve mitikë sesa në rrugën e së sotmes dhe asaj që duhet t'i çojë drejtë të ardhmes. Dhe si të tillë, ata më shumë i përkushtohen stolisjes dhe mirëmbajtjes të së shkuarës, sesa jetësimin të ëndrrave të tyre për të ardhmen. Por, edhe kështu, thujse asnjë popull i Ballkanit nuk ka shkuar aq larg sa të bëjë atë që sot bëjnë ata që veten e quajnë maqedonas etnik: të ndryshojnë kalendarin e së kaluarës së vet sikur ai të jetë pemë “sezonale” të cilën mund ta shkulësh e ta mbjellësh në cilën arë të duash, thujse është pemë, degët e së cilës mund t'i shartosh në cilin do trung që të pëlqen.

Edhe pse shumë popuj të këtij Ballkani kanë stolitur të kaluarën e vet me çka kanë mundur, askush nuk ka bërë atë që bëjnë

sot ata që veten e quajnë maqedonas etnik: kohë pas kohe të ndërrojnë edhe certifikatën e lindjes, të korrigojnë emrat e gjyshërve të tyre edhe këtë në varësi të rrethanave politike të ditës dhe sa herë që u mbushet mendja se të atillë siç janë, meritojnë paraardhës më të famshëm se ata të që me të vërtet i kanë, se janë nipër të cilëve nuk u ka hije cilido gjysh. Gjë të cilën e dëshmojnë dhe librat ku shkruhet për historinë e sllavo-maqedonasve.

Pra, ata që veten sot e quajnë maqedonas, mbase së shpejti sërish do duhet ta rishkruajnë historinë, ndoshta edhe duke i adaptuar ato të deritashmet, e ku mbase kaptinë më interesante do jetë ajo që do shpjegojë se çka ndodh me mitet dhe historinë kur ato bëhen shërbëtores të politikës së ditës. Në këtë libër çdo gjë do të jetë më ndryshe nga gjithë ajo që do të mbetet edhe më tej në librat e mëparshëm të historisë së këtij populli me të cilat mësonin gjeneratat e deritanishme maqedonase e në të cilat thuhej se ata janë pasardhës të sllavëve të jugut. Në librin e fundit të “Historisë së popullit maqedonas”, trugu etnik përshkruhej krejt ndryshe nga ai mbi të cilin deri dje rriteshin degët e këtij populli. Pra, në historinë më të re dhe të korrigjuar thuhet se maqedonasit e sotëm janë fëmijë të adoptuar në familjen e sllavëve të jugut, familje e cila, me xhelozë të paparë e ka fshehur të vërtetën se cilët kanë qenë të parët e tyre të natyrshëm. Andaj, sipas autorit të këtij libri, ka ardhur çasti kur atyre u duhet thënë se jo rastësisht janë atë që janë popull të cilit ia kanë zili të gjithë, popull që të gjithë duan ta përvetësojnë vetëm pse janë nipërit e Aleksandrit të Madh.

Nuk ka dyshim se ata që veten sot e quajnë maqedonas etnikë mund ta ndërrojnë historinë e tyre edhe dy herë në vit dhe mund të pasurohen me mite aq sa u mundëson imagjinata. E kjo të mos u hyjë në punë shqiptarëve të këtushëm. Por,

gjithashtu, nuk ka dyshim se duke gjurmuar të kaluarën e vet, duke e arnuar historinë e vet me mbeturinat e mbledhura nga e kaluara e popujve të Ballkanit, ata që sot veten e quajnë maqedonas etnikë, shtetin e fusin gjithnjë e më thellë në mosmarrëveshje me fqinjët, e me çka e mbajnë peng të ardhmen e vendit ku jetojnë popuj të cilët duan që ardhmërinë ta kenë po aq të qartë sa e kanë të qartë edhe të kaluarën e tyre. Pra, duke pasur të paqartë të kaluarën e vet, sllavo-maqedonasit thuajse e mbajnë peng edhe të ardhmen e shqiptarëve të këtushëm, të cilët jo se nuk kanë çka të korrigojnë në librat e tyre historikë që ua shkruan ideologët komunistë, por gjithsesi nuk kanë mëdyshje si u degëzohet trugu gjenetik dhe cilët janë gjyshërit e tyre.

Sidoqoftë, mbetet e vërteta se mitet që ka ngritur një popull paraqesin edhe historikun e andrrallave të kota të atij populli. Ato janë pasqyrë e thyer ku populli nuk sheh më as fytyrën e vërtetë të gjyshërve të vet, as portretin e gjeneratave të sotme, por ku shihet qartë e vërteta se popujt që nuk kanë vullnet dhe aftësi të ndryshojnë të mundshmen- të sotmen dhe të ardhmen e vet, se popujt që harxhojnë kohë duke u marrë me të pamundurën - me korrigjimin e të kaluarës së vet, janë popuj të pakënaqur me atë që janë dhe atë që kanë.

Gjithashtu mbetet edhe e vërteta se



Ata që veten sot e quajnë maqedonas, mbase së shpejti sërish do duhet ta rishkruajnë historinë, ndoshta edhe duke i adaptuar ato të deritashmet.

E ARDHMJA

Pasi elitat politike të etnitetit maqedonas ta kuptojnë se qëndrueshmëria e shtetit nuk varet nga mitet që ata kanë ngritur për vetveten dhe të tjerët, por nga të kuptuarit se nuk ka fat populli i cili beson se mund ta rindërtosh të shkuarën dhe se mitet ndërrojnë adresën e lindjes posa shpërngulen në lagje të re.

popujt e vegjël kanë histori të ngatërruar, sepse o atë e kanë përplot me mitizime dhe glorifikime të pamatura, madje të arnuar nga historitë e popujve tjerë, o e kanë të diskutueshme për shkak se zaptuesit e mëdhenj, pa i pyetur, kanë përvetësuar edhe pjesë nga e kaluara e tyre. Kjo veçanërisht vlen për popujt e Ballkanit, ku historitë shkruhet sipas parimit: “të gjithë heronjtë e vlefshëm janë me përkatësinë tonë etnike, e personalitetet negative nuk kanë gjakun e popullit tonë”. Andaj edhe ballkanasit nuk janë në grindje vetëm për shkak të së sotmes, por edhe për arsye se të kaluarën e kanë po aq të ngatërruar sa edhe ëndrrën për ardhmërinë. E që shpeshherë i bën të duken si kopshtarë të cilët nga kopshti ku kanë mbjellë thera, presin të vjelin qershi.

Si shoqëri me tipare më të dukshme ballkanase dhe e ndodhur në vetë kërthizën e këtij gadishulli, Maqedonia ishte dhe mbeti e ngatërruar në historinë e popullit shumicë që jeton në këtë shtet - në atë të etnite-

tit sllavo-maqedonas. Ajo pra mbeti pa fizionomi të qartë, për shkak se edhe vetë populli shumicë në këtë shtet ka portret me tipare të papërcaktuara dhe ka histori ndaj së cilës shumëkush sillet si ndaj xhepit të vjedhësit, ku mund të gjesh shumëçka të vlefshme, por të vjedhur nga thesari historik i popujve fqinjë. Andaj edhe ky shtet tani paguan çmimin e popullit që të lë përshtypjen e fëmijës që e di lagjen ku ka lindur, por nuk e di se cilët i ka prind. Me çka edhe shteti mbeti peng i ambicieve të etnitetit sllavo-maqedonas, e për të cilin thuhet sa ka huazuar emrin që u takon grekëve, ka përvetësuar gjuhën bullgare duke e bastarduar atë me serbizma, ka arnuar historinë me mbeturina të mbledhura nga popujt fqinjë, kështu që tani ndodhet aty ku është sot - jeton me ëndrrat e ngatërruara për të ardhmen dhe me ndjenjën se të gjithë nuk e duan për shkak të së kaluarës së famshme. Dhe i pruri qytetarët jomaqedonas të këtij shteti të ndjehen peng i historisë së tyre.

Mbase të gjithë ballkanasit, përfshi këtu edhe ata që veten e quajnë maqedonas etnikë, kanë të drejtë të ndërrojnë dhe t'i mbeten besnikë ëndrrës së tyre etnike. Por, vetëm nëse ambiciet e tyre nuk bëhen pengesë për realizimin e ëndrrave të popujve tjerë që bashkëjetojnë me ta në të njëjtin shtet. Apo nëse ëndrra dhe miti nuk i largon nga realiteti aq sa të mos e shohin se shteti i quajtur Maqedoni nuk është fole ku do të çelë

vetëm e ardhmja e një populli, por e të gjithë atyre që jetojnë në të. Se ky shtet ndoshta ekziston më shumë për shkak të shqiptarëve sesa i etnitetit maqedonas. Dhe si i tillë, ka për obligim të kujdeset edhe për ruajtjen e vlerave etnike të jomaqedonasve, se emri, si edhe çdo gjë që ka të bëjë me këtë shtet shumetnik, shumëreligjioz e shumëkulturor nuk mund të jetë pronë e vetëm një etniteti, por e të gjithë atyre që jetojnë në të. Tani, kur Maqedonia përfundimisht duhet të bëjë ndryshimin e emrit të vetë kushtetues, shihet më qartë se kush si e ndjen këtë shtet. Shihet pra se maqedonasit etnikë e mendojnë si fole ku o do të mëkohet, o do të zhbëhet identiteti i tyre kombëtar, e të tjerët e ndjejnë si kreaturë të përkohshme, e cila mbase ende nuk i ka bë gjitha ndryshimet e duhura, dhe një ditë, do të pësojë edhe shfytyrime tjera më të thella se emri. Ky përfundim edhe mund të jetë i gabuar, por gjithsesi është i vetmi që ka logjikë, nëse vlerësohet sjellja e etniteteve që jetojnë në këtë shtet. E posaçërisht sjellja e shqiptarëve të këtushëm, të cilët mbetën indiferentë edhe në vitet kur Maqedonia ndryshoi kushtetutën dhe flamurin për shkak të kërkesave greke, edhe sot kur vendoset për emrin e shtetit ku ata bashkëjetojnë me të tjerët. Sjellje e cila mund të ketë vetëm dy domethënie: ose askush nuk i pyet për asgjë, ose asgjë nuk u intereson sa i përket të ardhmes së këtij shteti, dhe

mendojnë se “rinovimi” i plotë i shtëpisë do të bëhet pasi të kalojë shtrëngata që ka kapluar Ballkanin. Pasi elitat politike të etnitetit maqedonas ta kuptojnë se qëndrueshmëria e shtetit nuk varet nga mitet që ata kanë ngritur për vetveten dhe të tjerët, por nga të kuptuarit se nuk ka fat populli i cili beson se mund ta rindërtosh të shkuarën dhe se mitet ndërrojnë adresën e lindjes posa shpërngulen në lagje të re. ■





KUJTESA 'E RRËFYEME' E BARLETIT NGA MITI NË HISTORI

Në librin e tij Barleti rrëfeu historinë e kujtuar të popullit të vet, bëmat epike të tij, ashtu siç i kujtoheshin atij, ose, më shpesh madje, siç ia bartnin të tjerët, në trajtën e rrëfimeve gojore, duke e shndërruar edhe vetë heroin e tij epik, Skënderbeun, jo vetëm në hero epik, por edhe në hero të diskursit rrëfimtar, të lidhur për substratin etnik.




VEHBI MIFTARI

NË EPOKËN E HUMANIZMIT vetëdija për “identitet” ndikoi që historia të shkruhej sipas pikëvështrimit të rrëfimitarisë. Rrjedhimisht, historitë e shkruara prej humanistëve qenë histori narrative, të cilat parabazën e gjenin në kujtesën e shtresuar të pjesëmarrësve të “bëmave të mëdha”, ndërsa rrëfeshin gojarisht. Ky lloj i narrativitetit gojor-historik shërbeu si parabazë edhe për tekstin e parë të shkruar me subjekt shqiptar, por në gjuhën latine, historinë (e stilizuar sipas parimit humanist) e Marin Barletit, “Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut”.¹ Duke e shkruar të rrëfyerën, Barleti ringjalli kujtesën për madhësinë e bëmave epike të një epoke dhe, sikur kërkonte Tiesse-ja, ringjalli hirin epik në letra.²

Në librin e tij Barleti rrëfeu historinë e kujtuar të popullit të vet, bëmat epike të tij, ashtu siç i kujtoheshin atij, ose, më shpesh madje, siç ia bartnin të tjerët, në trajtën e rrëfimeve gojore, duke e shndërruar edhe vetë heroin e tij epik, Skënderbeun, jo vetëm në hero epik, por edhe në hero të diskursit rrëfimtar, të lidhur për substratin etnik. Teksti i Barletit, prandaj, e ruan statusin e tekstit historik, të ndërtuar përmbi dëshmitë dhe rrëfimet, në një gjuhë që ishte “gjuha e kohës”. Rrjedhimisht, teksti i tij i përket shkrimtarisë universale, por është e ndërlidhur me letërsinë shqipe për nga subjekti që trajton. Thelbi i kësaj nyjeje është subjekti dhe jo gjuha si dëshmi identitare.

Po kështu, edhe nga aspekti çfarësues i gjinisë së shkrimit, teksti i Barletit shfaqet




si histori. Pra, në kuptimin referencial, teksti përshkruan të ndodhurat (ngjarjet reale). Por, pikërisht ky lloj referencialiteti na shtyn ta kërkojmë raportin e tekstit me përshkrimin përtej “së ndodhurës”, në botën e transformimit të historisë në mit dhe të rikthimit të saj nëpërmjet mitesh të rrëfyera. Barleti vetë nënvizonte se po shkruante një vepër të diskursit historik. Por, për ta shkruar atë, thoshte se i mungonin modellet:

“Unë nuk pata në këtë rrugë asnjë udhëheqës (...) S’pata mundësi të shikoj as analet e vjetra.”³

RRËFYMI - PARADIGMA MITIKE

Barleti e krijoi kësajsoj mitin e heroit në një tekst referencial. Vepra e tij mund të

ishte tekst historie po të mos ishin rrëfimet (e dëshmitarëve) dhe të rrëfyerit (barletian), që mbështillen në një paradigmë mitike. Kujtesa është subtrakti mbi të cilin thuret rrëfimi barletian, me qëllim rishkrimin e historisë së bëmave të kryeheroit shqiptar. Kjo “histori” shkruhet sipas një modeli, i cili e ripërtërin të vërtetën ashtu siç e mbajnë në mend përjetuesit e saj: bashkëluftëtarët e Skënderbeut e banorët e qyteteve të rena të Epirit. Barleti shfaqet, kësajsoj, si mbledhës i rrëfimeve të të tjerëve e rirrëfyës i tyre, duke provuar që kujtimet për ngjarjet e përjetuara, rrëfimet e tyre t’i lidhte sipas një rendi logjik për të krijuar tablonë e plotë të bëmave të heroit mesjetar, Skënderbeut. Ai nuk u referohet shumë kronikave të kohës, më shpesh ai i drejto-



het kujtesës së banorëve, përfshirë edhe kujtesës së vet personale, si “një spektator jo i huaj” i madhëstisë së dikurshme. Pra, të ndodhurat, historitë, na vijnë të shkruara nga Barleti, por në zanafillë ato janë mbledhur e sistemuar si rrëfime gojore të bashkëkohësve të tij. Ato përbëjnë një fill epik të historisë mesjetare, të cilat Barleti i bart në tekst.

ILUZIONI I HISTORISË

Kësisoj, “Historia e Skënderbeut” prek gojëtarinë si zhanër e dokumentaritetin si intencë. Kjo metodë përcakton edhe diskursin: rrëfimtari, duke e afruar jo rrallë me diskursin letrar gjatë përshkrimit të ngjarjeve ose të përjetimeve të personave, historitë e të cilëve i përshkruan në libër.

Teksti i Barletit, sikundër e nënvizon edhe ai vetë, është tekst i cili e synon dokumentaritetin, por i mungojnë mjetet shken-

core për ta arritur plotësisht këtë synim. Prandaj historia e bartur prej tij është histori e rrëfyer prej përjetuesve të madhëstisë epike të një kohe dhe të një heroi. Ajo është histori e cila nuk e bart të vërtetën e dokumentuar shumëfish, por të vërtetën e kujtuar, një të vërtetë kujtesore. Ajo krijon “iluzionin” e historisë në një tekst rrëfimtari. Vetë Barleti thoshte se po e shkruante librin e tij duke u mbështetur në kujtimet e atyre që mund ta kishin jetuar “epokën e Skënderbeut”. Duke qenë se i mungonin referencat, ai i kërkoi dhe i gjeti në kujtesën e njerëzve për to.

“Unë nuk kam shkruar trillime, por ato që m’i kanë treguar me kujdes më të mëdhenjtë dhe ato që kanë parë me sytë e tyre disa që kanë marrë pjesë.”⁴

Pra, ai po ringjallte kujtesën duke i mbledhur copat e rrëfimeve, mbetjet kujte-

KUJTESA

Kujtesa është substrakti mbi të cilin thuret rrëfimi barletian, me qëllim rishkrimin e historisë së bëmave të kryeheroit shqiptar. Kjo “histori” shkruhet sipas një modeli, i cili e ripërtërin të vërtetën ashtu siç e mbajnë në mend përjetuesit e saj: bashkëluftëtarët e Skënderbeut e banorët e qyteteve të rena të Epirit. Barleti shfaqet, kështu, si mbledhës i rrëfimeve të të tjerëve e rirrefyesh i tyre, duke provuar që kujtimet për ngjarjet e përjetuara, rrëfimet e tyre t’i lidhte sipas një rendi logjik për të krijuar tablonë e plotë të bëmave të heroit mesjetar, Skënderbeut. Ai nuk u referohet shumë kronikave të kohës, më shpesh ai i drejtohet kujtesës së banorëve, përfshirë edhe kujtesës së vet personale, si “një spektator jo i huaj” i madhështisë së dikurshme. Pra, të ndodhurat, historitë, na vijnë të shkruara nga Barleti, por në zanafillë ato janë mbledhur e sistemuar si rrëfime gojore të bashkëkohësve të tij. Ato përbëjnë një fill epik të historisë mesjetare, të cilat Barleti i bart në tekst.

sore, përfytyrimet e luftëtarëve e të bashkëkohësve dhe dëshminë personale. Këtë e bënte me të vetmin qëllim që ta shpëtonte nga bjerrja kujtesore madhështinë arbërore. Ky, sikur u tha, përbën raportin thelbësor mes kujtesës e historisë. Por, ngaqë kujtesa rrëfehet, fikcioni është i pashmangshëm. Historia e Barletit e fton në ndihmë mjetin rrëfimitar krahas kujtesës historike. Ashtu sikur është nënvizuar nga P. Nora, kujtesa njeh vetëm këto dy trajta të rishpalosjes së saj. Po t’i shtojmë kësaj edhe praninë e mitit të heroit, si mjet për artikulum historiko-rrëfimitar të madhështisë së kujtuar arbërore, del se Barleti do të shkruante një tekst ripërtëritjeje historike nëpërmjet thurjes së iluzionit për të.

MITI BARLETIAN - RRËFIMI I SË KUJTUARËS

Miti letrar i Skënderbeut, i krijuar prej Barletit, është mit i cili invariantin e gjen në histori, në figurën e Skënderbeut, por i cili është bartur si variant gati-gati letrar i një kujtese historike. Kujtesa e së ndodhurës dhe rrëfimi i së kujtuarës, prandaj, janë karakteristike për të e për një tip të mëvonshëm letërsie, e cila rrënjët e saj i fsheh në histori. Në tekstin e Barletit historia dhe letërsia lidhen një në rrëfim.

Duke ripërtrirë Arbërinë shpirtërore, Skënderbeu ripërtërinte Arbërinë tokësore, nderin e saj e të etnisë, “nderin e mbretërisë”, si sublimim i idesë për të jetuar të lirë. Kjo mbretëri



Të ndodhurat, historitë, na vijnë të shkruara nga Barleti, por në zanafillë ato janë mbledhur e sistemuar si rrëfime gojore të bashkëkohësve të tij. Ato përbëjnë një fill epik të historisë mesjetare, të cilat Barleti i bart në tekst.

në konceptin humanist të Barletit ishte e dyfishtë: fizike dhe shpirtërore. Arbëria, territori etnik, ishte mbretëria e trashëguar, e cila përfshin zotërimet e fiseve arbërore, është “le lieux de momoire” (sipas P. Noras), nderi i së cilës mbrohej duke e mbrojtur nderin etnik. Në fjalimin e tij para betejës së njohur të Sfetigradit, heroi i Barletit, Skënderbeu, si mjet retorik për t’i motivuar luftëtarët, krahas përmasës së lirisë, thekson përmasën e vendit, me të cilin e lidhte nderin etnik:

“Gjer tani ne kemi luftuar për fitoren, për nderin e mbretërisë; tani ju duhet të luftoni për shpëtimin, për lirinë, për muret e atdheut.”⁵

Por, përtej saj, ishte mbretëria shpirtërore së cilës mbretëria arbërore i shërbente si pararojë dhe së cilës ia mbronte nderin nëpërmjet luftërave mbrojtëse kundër osmanëve. Kjo mbretëri që mbretëria e krishterë.⁶ Vlerat shpirtërore e religjioze, kësisoj,

krijojnë një marrëdhënie funksionale, e cila e ndjek fillin e pashkëputshëm mes shpirtërores dhe fizikes.

MITI/KUJTESA E PËRBASHKËT

Identifikimi i arbërorëve (i fiseve të Arbrit) me kryeheroin nuk e prek vetëm dimensionin historik dhe rolin e tij në krijimin e lidhjes, si besatim rreth një ideje: ripërtëritjen e Arbërisë. Ai lidhet edhe me rolin që ai kishte në përlindjen shpirtërore të arbërorëve. Ai që “i krishteri” (ngjashëm me arbërorët e tjerë), i cili e njihte territorin, gjuhën dhe traditat si shenja të identitetit (prandaj luftonte për “Arbërinë historike”), ndërsa shpirtërisht i tejkalonte këta kufij dhe e shrinte mbretërinë e tij brenda mbretërisë së Zotit. Republika për të cilën luftonte ai në rrafshin shpirtëror që “Republika e Krishtit”,⁷ aleanca e krishterë, e cila në pikëshikimin e Barletit që mbrojtësja e vetme e vlerave qytetëruese të Perëndimit. Skënderbeu që princi mbrojtës i saj, ndërsa ushtarët e vënë nën urdhrat e tij qenë “ushtarë kryqtarë”,⁸ të cilët në njërin anë luftonin për “republikën historike” (ripërtëritjen e Arbërisë historike), ndërsa në anën tjetër për “republikën e Krishtit” (ripërtëritjen e qytetërimit perëndimor e të vlerave kulturore të shqiptarëve të kohës). Ai që personaliteti i cili ia ktheu lavdinë Epirit, ose Arbërisë, si dhe ia mbrojtë përhershëmrisht fytyrën krishterimit në njërin nga portat më të sulmuara të saj.

Kruja ishte qyteti qendror i mbretërisë së kujtuar të Gjonit dhe

“ Barleti i referohej territorit të Arbërisë/ Epirit si njërës nga simbolikat e mëdha mbi të cilat që thurur projekti i “territorializimit të kujtesës”.

Skënderbeu e la ushtrinë osmane në log të betejës dhe u nis për në Krujë, për “në vendin e të parëve”, i thirrur sa nga zërat e arbërorëve të tij, të cilët i injoronte publikisht, por i ndrynte në zemër privatisht, sa nga kujtesa e arkivuar për vendin dhe trashëgiminë e të parëve.

i mbretërisë së rilindun të Gjergjit; ajo që kujtesa vendësore përreth së cilës do të hartohej projekti i mbretërisë arbërore, sikundër që do të shërbejë si fortifikatë qendrore e saj. Ajo është vendi i të parëve, vendi i origjinës e i motivimit të madh për t'iu rikthyer kujtesës dhe rrjedhojës së madhe të saj: dashunisë për homeland-in, për vendin e origjinës, i cili nuk është vetëm territori fizik në të cilin zhvillohet kultura e përbashkët, por edhe territor shpirtëror. Kruja është jo vetëm “qendra e mbretërisë”, por edhe shtytësja e madhe e ruajtjes së saj. Kësisoj, ky qytet shndërrohet në qytet simbolik. Për ta përmbushur këtë kuptim, ai duhet të shihet si i pathyeshëm nga njerëzit dhe i mbrojtur nga perënditë:

“Dhe, me të vërtetë, pozita e qytetit (Krujës, v.j.) ishte aqë fort e mbrojtur prej natyre, sa që, edhe sikur qytetarët të rrinin duarkryq, vetë vëndi mund t’ia thyente me lehtësi hundët dhunës.”⁹

“TERRITORILIZIMI” I KUJTESËS

Barleti i referohej territorit të Arbërisë/Epinit si njërës nga simbolikat e mëdha mbi të cilat që thurur projekti i “territorializimit të kujtesës”. Skënderbeu e la ushtrinë osmane në log të betejës dhe u nis për në Krujë, për “në vendin e të parëve”, i thirrur sa nga zërat e arbërorëve të tij, të cilët i injoronte publikisht, por i ndrynte në zemër privatisht, sa nga kujtesa e arkivuar për vendin dhe trashëgiminë e të parëve. Pra, në kujtesën e tij që arkivuar ndjenja e



Kruja është jo vetëm “qendra e mbretërisë”, por edhe shtytësja e madhe e ruajtjes së saj. Kësisoj, ky qytet shndërrohet në qytet simbolik.

përkatësisë dhe e origjinës, mbi të cilat që zhvilluar kulti i përkatësisë ose i ndjenjës se kujt i detyrohem ne për ekzistencën tonë. Toka e të parëve, babai Gjon, tradita kristiane, tradita familjare, doket, zakonet, gjuha, vendi e farefisnia, përbëjnë “kujtesën e arkivuar” të Skënderbeut, thirrjen e brendshme për t’iu kthyer atyre. “Toka e babës Gjon” është territori i ëndërruar i Skënderbeut, vendi i cili përbën Arbërinë shpirtërore të tij. Në kuptimin material ajo përbën pronë familjare së cilës duhet t’i dalim zot. Porse, në kuptimin simbolik¹⁰ ajo ishte “atdheu i kujtuar nëpërmjet babës Gjon”, pra atdheu shpirtëror, trashëgimia të cilën e ripërtërinte vazhdimisht në kujtesë. Ajo përbën jo vetëm territor, por hapësirë në të cilën shtrihen bashkësi (Barleti i quan popuj) të një gjuhe e një gjaku, të një kulture të përbashkët e të riteve, dokeve e zakoneve të përbashkëta:

“Le t’i rifitonin më parë vatrat e të parëve dhe lirinë e gjithë popujve të saj...”¹¹

Toka në të cilën mbretëronte i ati i Gjergjit, Gjoni në kujtesën e tij kishte përmasa jo vetëm të vendit të të parëve, pra të “tokës historike”, por edhe të vendit, i cili, duke u rikujtuar, merr kuptim



simbolik, përtej atij material. Si vend i të parëve ai përbën territor të njohur historikisht (lieux d'histoire), në të cilin kanë jetuar "gjinja" e tij. Rrjedhimisht, ai nuk mund të jetë vetvetiu motivues për lëvizje të reja.

Por, kuptimi simbolik e shndërron në vend të kujtuar (lieux de mémoire), motivues për rikthim të tij e të gjendjes së tij, sikur të përbënte kthim në esencën e gjërave të cilat na përdallojnë nga të tjerët.

"Pa synimin për ta ripërtërirë në kujtesë, lieux de mémoire do të mbetej i pandashëm nga lieux d'histoire."¹²

Pra, atdheu fizik shndërrohet lehtësisht në strumbullar të kujtesës për origjinën e përkatësinë. Kuptimi i tij imaterial, shpirtëror e simbolik, e ndihmon përlindjen e kultit të origjinës. Ai e përjetëson vetëdijen tonë për të, sikundër e ndihmon edhe lindjen e mitit (të heroit), i cili mund ta dëshmojë atë.

ARBËRIA E SAJUAR

Barleti u referohet raporteve historike dhe përmbi to kërkon të ripërtërijë identitetin gjuhësor, kulturor e historik, si dhe t'i përfshijë pjesëtarët e një gjaku, kulture e traditash të përbashkëta. Rrjedhimisht, Arbëria e tij ("Arbëria e sajuar" - Schwyzer) është historike. Ajo lind nga

REFERENCA

- Barletius, Marinus. *Historia de vita et gestis Scanderbegi Epirotarum principis*, pa datë botimi (mendohet se libri është shkruar mes viteve 1508-1510), përkthyer në shqip nga origjinali në latinisht nga: Stefan I. Prifti: Marin Barleti, *Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut ("Rilindja"*, Prishtinë, 1989);
- Curtius, Robert Ernst. *Europäische Literatur und Lateinisches Mittelalter* (Frencke Verlag, Bern und München, Dritte Auflage, 1961). Cituar sipas përkthimit në gjuhën kroate: Ernst Robert Curtius, *Evropska književnost i latinsko srednjovjekovlje*, përkthyer nga Stjepan Markuš. Zagreb, "Naprijed", 1998.
- Hadfield, Andrew. *Literature, Politics and National Identity: Reformation and Renaissance*. Cambridge University Press, 1994.
- Levi-Strauss, Claude. *Myth and Meaning*. London and New York, Routledge Classics, 2001.
- Myhill, John. *Language, Religion and National Identity in Europe and the Middle East: A Historical Study*. Amsterdam, John Benjamins Publishing Co., 2006.
- Nora, Pierre. *Between Memory and History: Le Lieux de Mémoire*, translated in English by: Marc Roudebush ("Representation" 26, Spring, 1989).
- Pierre, Nora. *Realms of Memory*. New York, Columbia University Press, 1996.
- Riza, Selman. *Pesë autorë të vjetër*. Tiranë, Toena, 2002.
- Roques, Mario. *Recherches sur les anciens testes albanais* Paris, 1932, në gjuhën shqipe: Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera. Shkodër, Botimet françeskane, 2011.
- Schwyzer, Philip. *Literature, Nationalism and Memory*. UK, Cambridge University Press, 2004.
- Segal, Robert A. *Myth - A very short introduction*. New York, Oxford University Press Inc., 2004.
- Smith, Anthony D. *Myths and Memories of the Nation*. New York, Oxford University Press, 1999.
- Thiesse, Anne-Marie. *La création des identités nationales - Europe XVIII-XX siècle*. Éditions de Seuil, Mars 1999. Cituar sipas përkthimit në gjuhën shqipe: Thiesse, Anne-Marie. *Krijimi i identiteteve kombëtare - Europa e shekujve XVIII-XX*, përkthyer nga: Etleva Shiroka, Dukagjini", Pejë, 2004.

kujtesa për “trojet e të parëve”, dimensionet e saj shtrihen gjithandej nga shtrihen fiset e Arbrit dhe është “farefisni” e gjerë në kuptimin që këtij nocioni ia njihnin modernistët. Bashkëkohësve të Barletit ajo u shfaqej si jehonë e bëmave të mëdha epike të një epoke. Kufijtë e saj qenë të përcaktueshëm jo vetëm mbi bazën e zotërimeve, por edhe të një “qytetërimi arbëror”,¹³ i dallueshëm nga qytetërimet e tjera dhe i ngulitur në kujtesën e njerëzve abërishfolës e arbërndjesish. Ajo është sajuar si lidhje fisesh të ngulitura në atdheun e shqiptarëve. Pra, mbështetur edhe në premisat moderniste, Arbëria e krijoj lidhjen e njëjtëgjuhësve, njëjtëbesuesve dhe njëjtëkulturësve, duke e krijuar një farefisni, e cila përbën parabazën e fuqishme për krijimin e etnive, të cilat i bashkon gjaku, gjuha, territori dhe kujtesa e përbashkët qoftë ajo historike, religjioze ose kulturore.

PËRFUNDIME

Barleti e sajoi Arbërinë historike nëpërmjet ringjalljes së vetëdijes për territorin historik të arbërve, si dhe synimit për ripërtëritjen e tij. Pra, ai

“e rrëfeu” në tekst të shkruar historinë dhe për të pati një shtysë të fuqishme, të letrarizonte njërin prej miteve më të famshme të Mesjetës, mitin e heroit, i cili mund të pikëpreket me historinë, por gjithsesi është pjellë e rrëfimit. Nëse në letrat shqipe ka pasur një kategorizim të vazhdueshëm të tekstit të Barletit për Skënderbeun, si tekst i cili rri në kufirin mes dëshmisë dhe trillit, kjo ngjet ngaqë ai e rithur mitin për historinë në rrëfim. Barleti trajtohet si “sajuesi” i parë i Arbërisë (Shqipërisë), ai e krijoi atë nëpërmjet mitit të heroit nacional të saj, Skënderbeut.

Te Barleti diskursi historik i nënshtrohet diskursit letrar, sikur që mitologjia, figurat e shumta retorike dhe vetë stili jo rrallë janë të sajuara prej letrari dhe jo prej historiani. Barleti nuk shkroi në gjuhën shqipe, ngaqë ata që do ta lexonin edhe ashtu qenë të paktë, por në gjuhën e kohës, në atë latine. Ajo që e ndërlidh me “substratin identitar” është subjekti, i cili shërbeu si parabazë e paramodel për një vistër tekstesh të mëvonshme, letrare e historike, për Skënderbeun e për epokën e tij. ■

- 1 Marin Barleti, *Historia de vita et gestis Scanderbegi Epirotarum principis*, përkthyer nga latinishtja nga: Stefan I. Prifti: Marin Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, botim i tretë (“Rilindja”, Prishtinë, 1989).
- 2 Thiesse, Anne-Marie. *La création des identités nationales – Europe XVIII-XX siècle* (Éditions de Seuil, Mars 1999). Cituar sipas përkthimit në gjuhën shqipe: Anne-Marie Thiesse. *Krijimi i identiteteve kombëtare – Europa e shekujve XVIII-XX*, (përkthyer nga Etleva Shiroka). Pejë, “Dukagjini”, 2004.
- 3 Po aty, f. 48.
- 4 Po aty.
- 5 Po aty.
- 6 Barleti e quante “Republika e Krishterë”.
- 7 Barleti, M. *Historia...*, e cit., f. 97.
- 8 Po aty, f. 113.
- 9 Po aty, fq. 178-179.
- 10 Pierre Nora theksonte tri dimensione të rëndësishme të territorit (lieux): dimensionin material, simbolik dhe funksional. Shih: P. Nora, *Between Memory and History...*, e cit., f. 18-19.
- 11 Barleti, M. *Historia e Skënderbeut*, e cit., f. 130.
- 12 Nora, P. *Between Memory and History: Le Lieux de Mémoire*, translated in English by: Marc Roudebush (“Representaion” 26, Spring 1989), f. 19.
- 13 Barleti M. *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, e cit., fq. 220.



PROBLEMI ËSHTË
PROGRESI





FITIM ZEKTHI

Bota nuk ka njohur asnjëherë krime më të patregueshme sesa ato të komunistëve dhe nazistëve, të Leninit, Stalinit, Pol Potit, të Maos, Hitlerit etj. **Izaiah Berlin thotë se kushdo që beson në determinizmin historik duhet të dijë se të gjitha këto krime mund të shmangeshin**, ato nuk ishin katastrofa natyrore. Këto krime nuk u shkaktuan thjesht për shkak të ambicjes, lakmisë, mizorisë dhe epshit për pushtet. Sigurisht që kategori të tilla të djallëzores kanë patur rol, por **diçka më e gjerë sesa kaq çoi në këto krime. “Arsyeja kryesore për këto krime, - shkruan Berlin, - kanë qenë idetë.”**

QË NË NISJE TË HISTORISË, njerëzit i kanë shkaktuar njëri-tjetrit dhimbje dhe vuajtje të mëdha, kanë kryer masakra, krime të përbindshme, vrasje në masë, djegie dhe rrënime. Përgjatë historisë bota ka njohur mizorinë e Neronit, dhunën dhe masakrat e Alarikut apo të Atilës, djegien e qyteteve nga Xhengis Khani, plaçkitjet dhe ployën e kryqëzatave, krimet e Kortezeit ndaj aztekëve dhe banorëve indigjenë etj., por bota nuk ka njohur asnjëherë krime më të patregueshme sesa ato të komunistëve dhe nazistëve, të Leninit, Stalinit, Pol Potit, të Maos, Hitlerit etj. Krimet e Stalinit, Leninit, Maos Ce Dunit, Enver Hoxhës, Hitlerit etj. ishin të tmerrshme për nga mënyra e organizimit, për nga sistematizimi, për nga shkalla me të cilën falsifikimi i vazhdueshëm i së vërtetës nuk lejoi që këto tmerre të njiheshin apo të zbuloheshin.


Izaiah Berlin thotë se

kushdo që beson në determinizmin historik duhet të dijë se të gjitha këto krime mund të shmangeshin, ato nuk ishin katastrofa natyrore. Këto krime nuk u shkaktuan thjesht për shkak të ambicies, lakmisë, mizorisë dhe epshit për pushtet. Sigurisht që kategori të tilla të djallëzores kanë patur rol, por diçka më e gjerë sesa kaq çoi në këto krime. “Arsyeja kryesore për këto krime, - shkruan Berlin, - kanë qenë idetë.”

Në të vërtetë, pas këtyre krimeve ishin idetë për të ndërtuar një botë re, ishin idetë se ndërtimi i kësaj bote re do të ishte zgjidhja e të gjitha problemeve. Në fakt, në qoftë se dikush mendon se ka e gjetur zgjidhjen e të gjitha problemeve, në qoftë se dikush mendon se është e mundur të ndërtohet një botë e tillë e re e cila do t'i japë fund çdo vuajtjeje njerëzore, atëherë për këtë botë të re ia vlen të bëhet gjithçka, edhe çdo krim. Bindja bazë që përshkon gjithë këtë është se çështjet qendrore të

TEORIA DHE PRAKTIKA

Lënda për këtë shkatërrim do të gjendej te një klasë njerëzish në shoqëri të cilët sipas Marksit nuk kishin asgjë për të humbur dhe kishin gjithçka për të fituar duke zhdukur rendin e vjetër. Kjo klasë ishte proletariati. Filozofia e Marksit fliste për një marrëdhënie të re të praktikës me teorinë. Teoria dhe praktika, që kishin qenë deri në atë moment të ndara, do të bëheshin një përmes revolucionit. Praktika, që ishte mohimi revolucionar i gjendjes ekzistuese, do të ishte përsosmërisht teorike sepse ajo do të kërkonte dhe do të arrinte çlirimin e njeriut nga vargonjtë, siç thoshte Marksi, të rendit të vjetër. Kritika ndaj fesë kishte arritur të shndërrohej në ateizëm dhe mendimi kishte shkuar larg pa u bërë politikisht aktiv. Ishte koha që filozofia njëherazi të plotësohej, por edhe të zhbëhej.



jetës së njeriut qofshin ato individuale, apo shoqërore kanë një përgjigje e cila mund të zbulohet. Njerëzimi sigurisht që është përpjekur gjithnjë ta gjejë këtë përgjigje, por në kohën e iluminizmit dhe sidomos me Marksit dhe filozofë të tjerë u duk se më në fund kjo përgjigje u gjend.

Në librin “Kontribut mbi kritikën e filozofisë së drejtë të Hegelit”, Marksit shpërfaq idenë mbi zgjidhjen përfundimtare të çështjeve të njeriut dhe të shoqërisë. Marksit thotë se filozofia i ka nxjerrë në shesh, ka zbuluar premtimet e rrejshme

të fesë për shpëtimin në botën tjetër. Sipas Marksit këto premtime kishin patur për qëllim të fshihnin shtypjen politike nën të cilën njerëzit jetonin. Megjithatë detyra finale nuk ishte thjesht ky zbulim i këtyre premtimeve të rrejshme, por ishte zhbërja e kushteve politike që kishin mbajtur në këmbë këto iluzione fetare duke shkatërruar rendin ekzistues. Shkatërrimi i rendit ekzistues do të sillte çlirimin e njeriut nga varësia e njeriut, siç kishte kishte sjellë çlirimin e njeriut nga varësia prej Zotit dhe natyrës.

Lënda për këtë shkatë-



rrim do të gjendej te një klasë njerëzish në shoqëri të cilët sipas Marksit nuk kishin asgjë për të humbur dhe kishin gjithçka për të fituar duke zhdukur rendin e vjetër. Kjo klasë ishte proletariati. Filozofia e Marksit fliste për një marrëdhënie të re të praktikës me teorinë. Teoria dhe praktika, që kishin qenë deri në atë moment të ndara, do të bëheshin një përmes revolucionit. Praktika, që ishte mohimi revolucionar i gjendjes ekzistuese, do të ishte përsos-

mërisht teorike sepse ajo do të kërkonte dhe do të arrinte çlirimin e njeriut nga vargonjtë, siç thoshte Marks, të rendit të vjetër.

Kritika ndaj fesë kishte arritur të shndërrohej në ateizëm dhe mendimi kishte shkuar larg pa u bërë politikisht aktiv. Ishte koha që filozofia njëherazi të plotësohej, por edhe të zhbëhej.

Për Marks, lënda do të formohej nga arsyeja, por kishte një pengesë të vetme për trupëzimin e arsyes në gjëra të

caktuara dhe kjo ishte lidhja e fortë e disa njerëzve me gjendjen ekzistuese. Marksi mendonte se pasioni, që ishte zemërimi i revolucionarëve, mund ta shuante pasionin reaksionar të mbrojtësve të rendit të vjetër duke na futur në një gjendje të ardhshme që do të ishte plotësisht racionale. Dhuna fizike në funksion të mohimit të së tashmes ishte arsye, sepse nëpërmjet dhunës i tërë rendi i vjetër i shtypjes dhe i varësisë së njeriut nga Zoti dhe nga njerëzit e tjerë do të merrte fund.

“Si hap i parë i këtij bashkimi të teorisë me praktikën është shndërrimi i teorisë në kritikë jo për të thënë të vërtetat, por për të shkatërruar armikun”, shkruan Marksi. “Arsyeja bëhet pasioni i ri, por pasioni i filozofit nuk mjafton. Vërtet revolucioni fillon në trurin e filozofit, por arma e kritikës - shkruan Marksi -nuk mund të zëvendësojë kritikën e armës dhe teoria bëhet kështu një forcë materiale sapo ajo prek masat. Masat bëhen trupëzimi material i filozofisë dhe kështu ato kryejnë revolucionin dhe çlirimin.”

Kjo filozofi prodhoi komunizmin dhe krimet e patregueshme në Rusi apo BS, në Europën Lindore, në Kinë dhe në Shqipëri. Kjo filozofi prodhoi kampe përqendrimi, prodhoi tortura dhe genocid, prodhoi miliona të vrarë dhe zhdukur.

Por cila logjikë e të kuptuarit të historisë i solli këto ide? Cila pikëpamje mbi drejtimin

e historisë apo mbi trajektoren e historisë i solli këto ide dhe më pas këto mënyra. Dhe, më kryesorja, a ka historia një qëllim, një synim të saj in dhe a është njeriu një agent që mund ta drejtojë apo ta korrigjojë këtë trajektore ose të përshpejtojë ecjen në këtë trajektore?

Gjithçka rrotullohet rreth idesë së progresit. Të paktën 100 - 150 vjet përpara Marksit kjo ide kishte nisur të merrte jetë dhe të shndërrohej në pikëpamjen më të fuqishme mbi historinë dhe rolin e njeriut në botë. Progresi shihej si një proces në të cilin stadi më i fundit konsiderohej si më i mirë se ai përpara tij. Ky përkufizim për progresin nënkupton se ndryshimi bëhet në një drejtim të caktuar (pra ecet përpara) dhe se ky ndryshim sjell përmirësim. Ky ndryshim duke ecur përpara nuk ndalet dhe është i pakthyeshëm. Alain de Benoist, një teoricien francez, thotë se progresi për

REVOLUCIONI


“Si hap i parë i këtij bashkimi të teorisë me praktikën është shndërrimi i teorisë në kritikë jo për të thënë të vërtetat, por për të shkatërruar armikun”, shkruan Marksi. “Arsyeja bëhet pasioni i ri, por pasioni i filozofit nuk mjafton. Vërtet revolucioni fillon në trurin e filozofit, por arma e kritikës - shkruan Marksi -nuk mund të zëvendësojë kritikën e armës dhe teoria bëhet kështu një forcë materiale sapo ajo prek masat. Masat bëhen trupëzimi material i filozofisë dhe kështu ato kryejnë revolucionin dhe çlirimin.”

shumë autorë është parë si përmasor. Në radhë të parë kemi të bëjmë me një konceptim linear të kohës në të cilën historia kishte kuptim dhe ishte e orientuar nga e ardhmja. Së dyti njerëzimi shihet si një trup i vetëm dhe ftohet i tëri bashkë si njësi unitare të ecë përpara. Së treti, bota mund dhe duhet të transformohet duke pohuar kështu pushtetin e njeriut si sovran mbi natyrën.

Në Greqinë e vjetër vetëm përjetësia shihej si reale. Qenia është e pandryshueshme dhe lëvizja rrethore që bën të mundur kthimin e përjetshëm të së njëjtës në një seri të vazhdueshme ciklesh është shprehje e përsosur e hyjesisë. Sigurisht që ka rënie dhe ngritje, ka ecje para dhe pas dhe këto ndodhin brenda cikleve që ndjekin njëri-tjetrin. Në një farë mënyre faktorët përcaktues vijnë nga e kaluara dhe jo nga e ardhmja.

“Me ardhjen e krishterimit historia u shndërrua në një proces linear që ecën përpara nga gjeneza për të mbërritur në fund të kohës. Hyn koncepti i kohëshmërisë i cili shihet si vektor, i cili bën të mundur që më të mirët progresivisht duhet t’i zbulojnë veten botës”, thotë De Benoist. Kohëshmëria është e drejtuar drejt së ardhmes nga krijimi deri në ditën e gjykimit. Historia do të përfundojë një ditë dhe do të përfundojë mirë, do të përfundojë me shpëtimin. Ky linearitet përjashton çdo “rikthimim të përjetshëm të së njëjtës”, përjashton çdo konceptim ciklik mbi historinë.

Teoritë mbi progresin e sekularizojnë këtë konceptim linear të historisë. Tashmë gjithçka që do të vijë më pas shihet si e ardhmja dhe lumturia zëvendëson shpëtimin. Krishterimi, por edhe fetë e tjera të mëdha monoteiste, si hebraizmi më herët dhe islami më vonë, e shohin progresin më shumë në sensin eskatologjik dhe jo në atë histo-



rik. Shpëtimi kërkohet në këtë botë duke e pasur vazhdimisht në mendje botën tjetër, sepse njeriu nuk ka asnjë kontroll mbi hyjnoren. Fetë monoteiste e dënojnë dëshirën e pangopur të njeriut dhe madje thonë se dija morale gjendet te kufizimi i dëshirave dhe jo te shumëfishimi i tyre. I parë kështu, progresi është shumë larg, në mos krejt në anën tjetër të asaj që ai është sot dhe atij iu deshën shumë



“

Shpëtimi kërkohet në këtë botë duke e pasur vazhdimisht në mendje botën tjetër, sepse njeriu nuk ka asnjë kontroll mbi hyjnoren. Fetë monoteiste e dënojnë dëshirën e pangopur të njeriut dhe madje thonë se dija morale gjendet te kufizimi i dëshirave dhe jo te shumëfishimi i tyre. I parë kështu, progresi është shumë larg, në mos krejt në anën tjetër të asaj që ai është sot dhe atij iu deshën shumë elemente të tjera për ta shpërbërë apo tjetërsuar kuptimin e mësipërm.

elemente të tjera për ta shpërbërë apo tjetërsuar kuptimin e mësipërm.

Me Rilindjen Europiane u shfaqën mundësitë që ky tëhuajësim apo ndryshim të ndodhte. Lindja dhe zhvillimi i shkencës, si dhe zbulimet detare nxitën një valë optimizmi se ishte i mundur një përmirësim i vazhdueshëm deri në pafundësi. Ndër të parët që e ka përdorur fjalën “progres” ishte Francis Bacon,

një filozof anglez, i cili besonte se njeriu mund të kontrollojë natyrën pasi të njohë ligjet e saj. Edhe Rene Descartes tha se njeriu mund të jetë mjeshtri dhe zotëruesi i natyrës. Pra, në një farë mënyre, natyra, universi, kozmosi nuk kishin asnjë kuptim në vetvete, ato ishin veçse makina që mund të përdoreshin dhe të manipuloheshin nga njeriu.

“Optimizmi shkencor mbi progresin

NEVOJA NJERËZORE

Gradualisht dëshirat e pangopura njerëzore nisën të legjitimohen. Pikëpamja fetare mbi to nisi të zbythet dhe t'i lërë vendin një pikëpamjeje të re. Sipas kësaj pikëpamjeje të re, që mori jetë në veprat e mendimtarëve dhe të ekonomistëve të asaj kohe, nevojat njerëzore mund të rriten vazhdimisht. Njeriu ishte një qenie që mund të dëshironte gjithnjë e më tepër dhe të sillej në përputhje me këtë cilësi duke kërkuar gjithnjë të maksimalizonte interesin e tij. Kështu që shkenca do të bënte të mundur fuqizimin e teknologjisë dhe teknologjia do të bënte të mundur rritjen e prodhimit të të mirave materiale. Progresi nuk do të ndalej, sepse teknologjia do të bënte të mundur edhe rritjen e nevojave apo shumëfishimin e dëshirave të njeriut.

e pandalshëm, që mund të çonte në përmirësime të pafundme, - thotë Alain de Benoist, - u pa me simpati edhe nga shtresa e re apo nga klasa e re e borgjezëve e cila po merrte nën kontroll tregjet dhe prodhimin.” Sipas De Benoist, mentaliteti i kësaj shtrese ka vëmendje vetëm ndaj gjërave të llogaritshme dhe të matshme, vetëm ndaj vlerave të tregtueshme dhe përgjithësisht vetëm ato i sheh si të vlefshme.

Kështu, gradualisht dëshirat e pangopura njerëzore nisën të legjitimohen. Pikëpamja fetare mbi to nisi të zbythet dhe t'i lërë vendin një pikëpamjeje të re. Sipas kësaj pikëpamjeje të re, që mori jetë në veprat e mendimtarëve dhe të ekonomistëve të asaj kohe, nevojat njerëzore mund të rriten vazhdimisht. Njeriu ishte një qenie që mund të dëshironte gjithnjë e më tepër dhe të sillej në përputh-

je me këtë cilësi duke kërkuar gjithnjë të maksimalizonte interesin e tij. Kështu që shkenca do të bënte të mundur fuqizimin e teknologjisë dhe teknologjia do të bënte të mundur rritjen e prodhimit të të mirave materiale. Progresi nuk do të ndalej, sepse teknologjia do të bënte të mundur edhe rritjen e nevojave apo shumëfishimin e dëshirave të njeriut.

Në rrafshin e politikës pikëpamja zotëruese ishte se ajo duhet të bëhej racionale. Veprimi politik duhet të ndalte së qeni art, duhet të reshtte së udhëhequri nga parimi i kujdesit dhe duhet të bëhej shkencor dhe të qeverisej nga parimi i arsyes. Shoqëria ishte si universi, ajo ishte mekanike apo fizike dhe duhet të shihej si makinë në të cilën njerëzit janë veç ingranazhe. Progresi do të prekte jo thjesht shkencën dhe teknologjinë, jo thjesht



“

Shoqëria ishte si universi, ajo ishte mekanike apo fizike dhe duhet të shihej si makinë në të cilën njerëzit janë veç ingranazhe. Progresi do të prekte jo thjesht shkencën dhe teknologjinë, jo thjesht prodhimin e të mirave dhe rritjen e dëshirave, por ai do të prekte edhe shoqërinë dhe njeriun. Njerëzimi si i tërë do të bëhej gjithë e më perfekt. Ai do të çlirohej kështu edhe nga paragjykimet, supersticionet dhe nga gjithçka e vjetër. E reja, “novum”, ishte e mirë në vetvete.

prodhimin e të mirave dhe rritjen e dëshirave, por ai do të prekte edhe shoqërinë dhe njeriun. Njerëzimi si i tërë do të bëhej gjithë e më perfekt. Ai do të çlirohej kështu edhe nga paragjykimet, supersticionet dhe nga gjithçka e vjetër. E reja, “novum”, ishte e mirë në vetvete.

Si pasojë e mbretërimit të arsyes, gradualisht do të zbehej e keqja, do të mpakeshin format e ndryshme të varfërisë, të injorancës dhe të shtypjes për të mbërritur në një stad fundor ku e mira do të ishte e vetmja gjë që sundonte dhe ku arsyeja do të ishte absolute. Pak a shumë këtu do të çonte progresi. Në

një farë mënyre progresi do ta bënte njeriun të paaftë për të zgjedhur lirisht, ai do të ishte i “dënuar” të zgjidhte vetëm të mirën, pasi çdo formë shtypjeje dhe injorance do të ishte zhdukur.

Ishin këto ide të progresit që çuan te tezat e Marksit, që çuan te revolucioni dhe te krimet e përbindshme. Gjithashtu idetë e progresit, duke e parë njerëzimin si një njësi të vetme që është i ftuar të ecë përpara si një njësi e vetme, bënë të mundur kolonializmin dhe përpjekjet e për të “ilunimuar” për të “emancipuar” vendet e Afrikës, të Azisë dhe Amerikës. Këto vende duhet të përfaqonin progres-

in pasi ky ishte i drejtë, i vërtetë dhe rruga e vetme.

Jo vetëm që historia u pa si progresive, u pa si lineare, ku çdo pikë më e avancuar në kohë është më e avancuar edhe në cilësi, por edhe shkrimi i historisë u bë mbi po të njëjtat pikëpamje. Çdo moment i jetuar, çdo ngjarje apo ide politike, çdo mënyrë jetese, çdo besim iu nënshtrua këtyre ideve. Kështu shoqëria e traditës, shoqëria paramoderne u pa si e prapambetur dhe e errët. Tekstet në masë të gjerë jo vetëm trumbetonin progresin, por edhe bënë thirrje që të përqafohej ai.

Shqipëria e jetoi në mënyrën e vet më të keqe idenë e progresit. Me themelimin e shtetit shqiptar ajo u gjend mes luftës së parë dhe të dytë ballkanike, të cilat ishin produkte tipike të luftërave shoviniste me frymëzim nacionalist. Dihet se nacionalizmi është parë si një hallkë e rëndësishme

në avancimin linear përpara. Shqipëria e porsakrijuar u pa si e padenjë për të qenë shtet i pavarur dhe ajo duhet të bëhej pjesë e një vendi që ishte i denjë për të qenë i pavarur, si Greqia, Mbretëria Serbo-Kroate dhe Italia. Më pas Lufta e Parë Botërore e trajtoi Shqipërinë përsëri nën këtë optikë. E njëjta gjë vazhdoi edhe gjatë kohës së mbretërisë derisa vendi u push-tua nga komunizmi.

Komunizmi u pa si zgjidhja finale, si çlirimi përfundimtar, si mbërritja e një epoke të mrekullueshme. Krimet dhe masakrat u panë si arsye në vet-vete. Ajo që shkruante Marksi u jetësua gati plotësisht. Historia jonë ishte në fazën e fundit dhe kjo kjo gjë duhet të thuhej edhe nga historiografia.

Tek ne njeriu dhe shoqëria u panë saktësisht si makina që duhet të ecnin përpara nën dritën e arsyes që impononte progresi, pra komunizmi.

U ndërtua një historiografi që nuk donte të shihte asgjë siç ishte por siç donte komunizmi që ajo të ishte. Kjo lloj historiografia është sot ende e pranishme. Sado që ajo të kritikohet, sado që ajo të rishikohet, ajo mbetet një historiografi e ndërtuar në terma të tillë që e sheh komunizmin më të mirë sesa koha e mbretërisë së mbretit Zog, ajo mbetet një historiografi që e ka zhveshur atë që ka ndodhur nga çdo kuptim metafizik. Historiografite sot në botë janë thuajse të gjitha të shkruara në terma që e shohin

“ Shkalla me të cilën në Shqipëri fshihen apo bëhen përpjekje për të emërtuar ndryshe krimet është shumë e lartë. Këtu arrihet deri

sa një kamp shfarosjeje si ai i Tepelenës, ku kanë vdekur fëmijë nga uria dhe ku rrinin bashkë në stalla mjaft familje, ku për 2 700 banorë kishte vetëm një banjë, të mos quhet një kamp shfarosës, por madje të thuhet se ai ishte shumë më i mirë sesa një burg.




progresin si filozofinë e vetme të drejtë, por historia jonë është e gati e gjitha nën ndikimin e një fraksioni shumë radikal të progresit, komunizmit. Duke qenë kështu, ato rreken të gjitha të fshehin krime, të emërtojnë ndryshe krime të mëdha, por shkalla me të cilën në Shqipëri fshihen apo bëhen përpjekje për të emërtuar ndryshe krimet është shumë e lartë. Këtu arrihet deri sa një kamp shfarosjeje si ai i Tepelenës, ku kanë vdekur fëmijë nga uria dhe ku rrinin

bashkë në stalla mjaft familje, ku për 2 700 banorë kishte vetëm një banjë, të mos quhet një kamp shfarosës, por madje të thuhet se ai ishte shumë më i mirë sesa një burg.

Progresi dhe sidomos dimensionin komunist i tij nuk mund të pranojë kurrë që një pikë e avancuar në kohë dhe një rend i ri në kohë të mos jetë më i mirë sesa ai i mëparshmi. Kështu që krimet përmbysen, ato marrin emra të ndryshëm deri edhe akte çliruese. ■



REDI SHEHU



Të gjithë ne i lexojmë të dhënat historike duke u bazuar në besimet dhe bindjet tona intelektuale dhe konceptuale. **Ne nuk duhet t'i kuptojmë historianët si qenie më vete jashtë historisë: ata janë pjesë e saj në kohën që ata jetojnë, janë konsumues të fragmentit të kësaj kohe duke mbartur simptomat e saj.**

NJERIU DHE “E VËRTETA HISTORIKE”

DEBATET E MËDHA MES SHKOLLARËVE të shumtë, shpesh janë përqendruar mbi atë se a ekziston diçka që quhet “e vërteta historike”. Cilat janë mekanizmat që çojnë drejt saj? A është në të vërtetë historia objektive apo historianët qëndrojnë diku mes ngjarjeve reale dhe “shportave të tyre të memories”? Me pak fjalë, vërtet historianët kanë arritur të bëjnë histori? Në fakt e shkuara është tërësia e gjithçkaje që ka ndodhur me njeriun dhe shoqëritë njerëzore, ndërsa historia është ekstrakti i kësaj të shkuare e nxjerrë në pah sipas këndvështrimit të historianit, arma e të cilit përmbledhet te memoria dhe te përgjigja e pyetjes: “Çfarë duhet të kujtojmë dhe si ta kujtojmë”? Armë e cila bëhet efektive te balanca e ndërtuar mes objektivitetit të fakteve dhe subjektivitetit të përzgjedhjes dhe interpretimit

të tyre. Të gjithë ne i lexojmë të dhënat historike duke u bazuar në besimet dhe bindjet tona intelektuale dhe konceptuale. Ne nuk duhet t'i kuptojmë historianët si qenie më vete jashtë historisë: ata janë pjesë e saj në kohën që ata jetojnë, janë konsumues të fragmentit të kësaj kohe duke mbartur simptomat e saj.

PËRTEJ VETVETES

Historia e treguar nuk është e tërë e vërteta, ajo është vetëm një version i saj i formësuar nga perspektivat dhe këndvështrimet individuale të historianëve. Po atëherë, si mund të shkohet tek e “vërteta historike” kur një pjesë e mirë e profesionistëve të historisë e pranojnë se nuk ka interpretim të pastër objektiv të fakteve historike? Një mision i tillë duket shpesh i pamundur. Nëse i marrim faktet historike të veçara pa lidhjen e tyre me kontekstin, ata nuk nënkuptojnë asgjë. Ata janë subjekt i selektimit dhe i vendosjes së tyre nga historianët brenda një kuadri kohor dhe konteksti në mënyrë që ata të marrin kuptim, në atë që Bertrand Russell e quante “biznesi i seleksionimit”. Është pikërisht këtu ku gjetja e së “vërtetës historike” bëhet një mision i pamundur, për arsye se konteksti dhe vizioni i historian-



Nuk mund ta konsiderojmë çfarëdo shkrimi njerëzor që mund të ekzistojë si riprodhim besnik i realitetit, sepse **shkrimi njerëzor, qoftë edhe histori, për shkak të mangësive që qenia njerëzore ka, përfshin një të dhënë, ndërkohë që heq një tjetër bazuar në botëkuptimin e tij filozofik.**



it me atë të realitetit të fakteve historike shpesh nuk përkon. Politologu dhe historiani i njohur britanik Edward Hallett Carr shprehej se “e vërteta historike gjendet diku në mes fakteve pak të vlefshme dhe vlerës së gjykimeve. Faktet historike janë atje, por përzgjedhja e tyre dhe interpretimi është subjektiv”. Në këtë këndvështrim, ndryshe do të shkruhej historia e Kosovës parë nga perspektiva serbe dhe ndryshe nga ajo e shqiptarëve; ndryshe do të shkruhej historia e Çamërisë parë nga perspektiva greke dhe ndryshe nga ajo shqiptare.

Nuk mund ta konsiderojmë çfarëdo shkrimi njerëzor që mund të ekzistojë si riprodhim besnik i realitetit, sepse shkrimi njerëzor, qoftë edhe histori, për shkak të mangësive që qenia njerëzore ka, përfshin një të dhënë, ndërkohë që heq një tjetër bazuar në botëkuptimin e tij filozofik. Gjithë rreziku i cili ka kano-

sur të vërtetën historike përgjatë udhëtimimit të saj ka qenë lidhja personale që secili prej nesh ka me historinë. Kërshëria që kemi për të ditur të shkuarën, ngjarjet, personazhet dhe thelbin e asaj ç’ka ndodhur, ngjan me etjen e atij që ka ecur në shkretëtirë. Kjo lidhje personale me historinë është ndërtuar bazuar në raporte të përcaktuara nga tjetërkush.

Roli i historianit në këtë kontekst duhej të ishte pikërisht i atij që këtë lidhje personale të secilit, ta kalibrojë me historinë e vërtetë. Kështu, fatkeqësisht mund të konstatohet se prej mungesës së këtij kalibrimi, në shumë raste, disiplina e historisë ka ecur në drejtim të kundërt me vetë natyrën thelbin e historisë. Megjithatë, një mënyrë për të arritur tek e “vërteta historike” duhet të ketë, dhe besoj se kjo gjendet, në ata historianë të cilët dalin mbi kontekstin e kohës ku jetojnë, të cilët duke njo-



hur kuptimin e ekzistencës së tyre kthehen në ndërmjetësues objektivë mes përmbajtjes të së shkuarës dhe audiencës të së tashmes, në ndërtues perfekt të ekuilibrit mes formës dhe përmbajtjes historike. Me pak fjalë duke dalë përtej vetvetes.

MANIFESTIMI NJERËZOR SI OBJEKT I HISTORISË

Është interesant vështrimi

i filozofit gjerman neokantian Heinrich Rickert mbi dallimin mes shkencës së historisë dhe shkencave natyrore. Këto të fundit - thotë ai - merren me studimin e fenomeneve natyrore të cilat kanë një vlerësim thjesht objektiv, një konsideratë neutrale për shkak se ato thjesht ndodhin. Studimi i historisë dhe i jetës njerëzore nuk është si studimi i fenomeneve natyrore, sepse për jetën

njerëzore dhe historinë e saj ne nuk kemi thjesht konsideratë neutrale: ajo ka vitalitetin e saj dhe formën me të cilën e manifeston këtë vitalitet. Pra historia është fusha ku këto manifestime vitale dhe qëllimplota marrin formë, brenda strukturave të caktuara sociale dhe rendeve politike. Këto manifestime në fakt janë shumatorja e jetëve të individëve të cilët jetojnë dhe jeta e tyre e shumëllojshme krijon gjithnjë situata të reja që në nuk janë gjë tjetër veçse histori të reja. Pra njeriu si qenie me shpirt është krijues i situatave të ndryshme të njëpasnjëshme duke u shfaqur në forma të llojllojta gjatë jetës së tij, që në thelb përbëjnë manifestime të ndryshme të historisë.

Më qartë koncepti vjen nga një prej filozofëve anglezë të fundit të modernizmit, Robert Collingwood, në qasjen e tij mbi filozofinë e historisë, të përmbledhur në librin "Ideja e historisë". Duke u përpjekur pikërisht për të hulumtuar manifestimin njerëzor si objekt të historisë ai është i mendimit se objekt i kësaj shkence quhen veprimet e njerëzve. Historiani nuk mund të perceptojë mendimet ashtu siç shkencëtari percepton faktet natyrore, por ai duhet t'i kuptojë ato duke aktivizuar procesin e mendimit. Në këtë kuptim, historia nuk është gjë tjetër veçse një proces i riaktivizimit të mendimeve të së shkuarës në mendjen e historianit. Si i tillë, procesi his-

torik është vetë jeta e mendjes e përmbledhur në diturinë historike.

Kështu, njeriu është në qendër të historisë me gjithë manifestimet e veta, por ai është një qenie që gjallon në formë të dyfishtë, ka anët e tij të brendshme e të jashtme, çka do të thotë se edhe studimi i historisë, bazuar në veprimet e njerëzve, nuk është i shkëputur nga studimi i anës së jashtme dhe të brendshme të ngjarjeve, për sa kohë ato janë manifestime të vetë kësaj qenie të dyfishtë siç është njeriu. Puna e historianit nuk mundet në asnjë mënyrë të mbarojë vetëm me studimin e anës së jashtme të ngjarjeve historike. E nëse ai e ka parasysh se ngjarja historike është një veprim njerëzor, ai futet në logjikën e mendimit të asaj kohe dhe bëhet pjesë e ngjarjes, duke kuptuar nga brenda të gjithë elementet që e shkaktojnë atë. Kjo sepse mendimet janë pjesa e brendshme e qenies njerëzore e cila manifestohet me veprime. Prosesi



Studimi i historisë dhe i jetës njerëzore nuk është si studimi i fenomeneve natyrore, sepse për jetën njerëzore dhe historinë e saj ne nuk kemi thjesht konsideratë neutrale: ajo ka vitalitetin e saj dhe formën me të cilën e manifeston këtë vitalitet.

E SHKUARA

Të ulesh në prehrin e së tashmes, duke menduar se e shkuara është pikërisht vetëm ajo çka ty të shkon në mend, është një formë e hamendjes e cila nuk i kalon caqet e të qenurit irracional. E shkuara nuk është thjesht një perceptim personal, ajo është një formë konsensuale e kolektives e cila risillet në vëmendje duke iu referuar provave që i japin ngjyrimin apo domethënien historike asaj. Kokëfortësia e fakteve dhe e shifrave përplaset me striptizën e interpretimeve historike në një luftë për domethënien e vetë të shkuarës. Interpretime të cilat marrin përsipër të kthehen në mbrojtëse të ideologjive paçka se e vërteta si thelb i historisë ndodhet në qenësinë e saj.

historik është një pikësëpari operacion mendimesh, parë nga ana e brendshme, dhe pastaj veprimesh, parë nga ana jashtme, që përfundon më vonë me aktin historik.

Prandaj, duke u mbështetur në këtë formë arsyetimi, mund të kuptojmë fare lehtë se ndryshe nga shkencat e tjera ekzakte, ku objekti dhe subjekti janë të pavarur nga njëri-tjetri, në shkencën e historisë ato të dy - objekti historik dhe subjekti historian - nuk mund të ekzistojnë të pavarur nga njëri-tjetri. Në këtë kuptim gjetja e “së vërtetës historike” është në fakt aftësia për të kuptuar së brendshmi dhe pastaj së jashtmi një proces historik. Pra për të kuptuar historinë duhen kuptuar qëllimet e veprimeve historike. Gjetja e kësaj të vërtete kthehet në mision të pamundur kur historia shkruhet në formatin thjesht deskriptiv të veprimeve të jashtme të aktorëve duke mos u thelluar dhe kuptuar thelbin e mendimit të brendshëm të tyre.

Të ulesh në prehrin e së tashmes, duke menduar se e shkuara është pikërisht vetëm ajo çka ty të shkon në mend, është një formë e hamendjes e cila nuk i kalon caqet e të qenurit irracional. E shkuara nuk është thjesht një percep-

tim personal, ajo është një formë konsensuale e kolektives e cila risillet në vëmendje duke iu referuar provave që i japin ngjyrimin apo domethënien historike asaj. Kokëfortësia e fakteve dhe e shifrave përplaset me striptizën e interpretimeve historike në një luftë për domethënien e vetë të shkuarës. Interpretime të cilat, marrin përsipër të kthehen në mbrojtëse të ideologjive paçka se e vërteta si thelb i historisë ndodhet në qenësinë e saj.

HISTORI E POLITIKËS APO POLITIKË E HISTORISË?

Një ndër telashet më të mëdha të shkencës së njohjes dhe studimit të së shkuarës është përdorimi populist, duke e nxjerrë historinë nga funksioni i saj publik drejt një mjete politik me qëllim afatshkurtër. Pra një ndrydhje e historisë nga historianët brenda një kafazi mediokriteti. Ky prototip historiani përkufizon ata që janë shquar duke e komplikuar të shkuarën në kohën kur ajo ishte e thjeshtë dhe duke e thjeshtëzuar në kohën kur ajo ishte e komplikuar. E gjitha përmes skemës bardhe e zi të kuptimit të ngjarjeve dhe rolit të figurave



“

Një ndër telashet më të mëdha të shkencës së njohjes dhe studimit të së shkuarës është përdorimi populist, duke e nxjerrë historinë nga funksioni i saj publik drejt një mjeti politik me qëllim afatshkurtër. Pra një ndrydhje e historisë nga historianët brenda një kafazi mediokriteti.

historike. Imagjinoni kur kësaj anomalie t'i shtohet nga pas një pushtet i tërë politik i cili fabrikon pjesë të historisë apo tërë historinë vetë.

I tillë ishte edhe sistemi totalitar shqiptar. “Nga ato regjime totalitare që prodhojnë gënjeshtër totalitare dhe, nga ana tjetër, gënjeshtër totalitare që nuk mund të imponohen veçse në regjimet totalitare”, për ta thënë me fjalët e Pierre Hassner. Një sistem i cili prodhoi dëmet më të mëdha për popullsi të tëra në botë gjatë gjithë kohës së rrugëtimit të tij historik, dëme të cilat u kalçifikuan në shumë shtresa sociale e nivele identi-

tare. Arsyeja e këtij denigrimi progresiv historik qëndroi në faktin se totalitarizmi komunist, përmes strukturave të mirëngritura vrasësish me pagesë të historisë, të ashtuquajturve “akademykë”, të cilët mykjen intelektuale e këmbenin me teza të ofruara sipas recetave të përgatitura nga regjimi, fshihte dhe transformonte fakte historike dhe identitete të cilat kishin të bënin me të kaluarën e një kombi, për të ndërtuar e falsifikuar identitete të reja të arnuara me pjesë këmbimi historike të marra hua.

Influencën e politikës mbi interpretimin e fakteve historike e shohim në tri

KURSI I INTERPRETIMIT

Kështu, konceptet e tradhtarit dhe të patriotit të kategorizuar nga ideologjizimi enverist i historisë i gjejmë edhe sot të shndërruara në tipologjinë e tradhtarit dhe të patriotit karshi ideologjisë së integritimit, duke u mbështetur tek i njëjti mit i historisë të ndërtuar nga ata vetë. Të gjithë ne mund të kishim menduar se një çerek shekulli mendim i lirë do të kishte filluar të shkatërronte kalanë ideologjike të historiografisë të ndërtuar gjatë regjimit komunist, e cila karakteristikë të sajën kishte materializmin dialektik dhe përcaktimin e kursit të interpretimit të historisë nga pushteti.

nivelet e shprehura nga Hassner. Niveli i parë është ai i sajimit të miteve apo i narrativave identitare të një populli; i dyti është manipulimi dhe shfrytëzimi politik i historisë nga një fraksion politik kundër një fraksioni tjetër; niveli i tretë është ai i krijimit dhe imponimit totalitar të mitit historik që i imponohet me forcë gjithë shoqërisë si një e vërtetë zyrtare, kritika ndaj së cilës pastaj konsiderohet akt tradhtie.

Nëse i plazmojmë këto nivele në kontekstin tonë, shohim se i gjejmë besnikërisht të përputhshme me kriteret e shprehura nga Hassner. Sigurisht që sajimin e miteve apo narrativave identitare si shpëtimtare të kombit, si pikë ku duhet të fillojë epoka e re, e hasim në ndërtimin e identitetit të ri nacional shqiptar, i cili kishte nevojë për figurat veta të mitizuara për t'i dhënë forcë këtij realiteti të ri. Më pas, manipulimin dhe shfrytëzimin politik të historisë nga një fraksion politik ndaj një tjetri e gjejmë te qëndrimet dhe mendimet irracionale ndaj historisë sonë parë në dy përthyerje të ndryshme që zgjaten deri vonë në kuptimin mbi luftën apo mbi data e çlirimit të vendit. Ndërsa nivelin e tretë, atë të imponimit totalitar të sajës historike dhe

imponimit me forcë në shoqëri deri në zyrtarizim të kësaj manie, e gjejmë sigurisht te metodologjia marksiste-leniniste, ku vija politike e partisë përcaktonte kursin ideologjik të trajtimit dhe interpretimit të fakteve historike, duke i shndërruar ato në “të vërteta historike” të pamohueshme. Një soj parafabrikimi historik i ndërtuar si model i paprekshëm dhe i pacenueshëm nga askush. Çdo koncept i kundërt me këtë trajtim konsiderohej akt zyrtar tradhtie.

Kështu, konceptet e tradhtarit dhe patriotit të kategorizuara nga ideologjizimi enverist i historisë i gjejmë edhe sot të shndërruara në tipologjinë e tradhtarit dhe të patriotit karshi ideologjisë së integritimit, duke u mbështetur tek i njëjti mit i historisë të ndërtuar nga ata vetë. Të gjithë ne mund të kishim menduar se një çerek shekulli mendim i lirë do të kishte filluar të shkatërronte kalanë ideologjike të historiografisë të ndërtuar gjatë regjimit komunist, e cila karakteristikë të sajën kishte materializmin dialektik dhe përcaktimin e kursit të interpretimit të historisë nga pushteti.

Kujtesa historike ka të bëjë direkt me identitetin e një populli, nga mënyra



se si kjo kujtesë trajtohet, përcaktohet edhe mënyra se si e ruhet apo mirëmbahet identiteti. Për më tepër, vrasja e kujtesës, qëllimisht ose jo, do të thotë edhe vrasje identitare. Në fakt neuroza historike, përmes shpërfytyrimit të fakteve historike, në formë totalitare ose jo, nuk është gjë tjetër veçse vrasje e kujtesës dhe krijim i një modeli të ri i të kujtuarit neurotik, i cili i përshtatet gënjeshtrës totalitare.

"E VËRTETA HISTORIKE" ËSHTË E TILLË VETËM NË KONTEKSTIN E LIRISË

"Historia është një dialog i përherëshëm mes shoqërisë së sotme dhe asaj të shkuarës", shkruante Carr. Ky dialog zhvillohet në formë korrekte vetëm në një kontekst lirie, të një shoqërie të lirë, sepse e vërteta merr kuptimin e saj vetëm në një mjedis të lirë. Për të kuptu-

ar veprimet e njerëzve si thelbi i manifestimit të historisë, duhet të kuptojmë rolin që ka liria në vetë njeriun, i cili e përmbush historinë përmes veprimeve apo mosveprimeve të tij. Historia pa njeriun është një enë bosh, është njësi



Historia është një dialog i përherëshëm mes shoqërisë së sotme dhe asaj të së shkuarës", shkruante Carr. Ky dialog zhvillohet në formë korrekte vetëm në një kontekst lirie, të një shoqërie të lirë, sepse e vërteta merr kuptimin e saj vetëm në një mjedis të lirë.

abstrakte e pakuptueshme dhe e pa sens. Njeriu si thelb i saj, me vitalitetin dhe manifestin e këtij vitaliteti, i jep kuptimin dhe shpirtin historisë dhe e kthen atë në një shkencë e cila dallon katërcipërisht nga shkencat natyrore, të cilat nuk kanë nevojë për njeriun dhe mjedisin e lirë për ta aktualizuar veten.

Historiani dhe puna e tij me të shkuarën dhe të tashmen është e lidhur me vlerat personale dhe se çfarë synimi parësor ka ai në punën e tij. Të dyja këto si vlera personale, ashtu edhe prioriteti i punës janë të deformatuara nëse nuk zhvillohen në një mjedis lirie, brenda një shoqërie të lirë.

HISTORIA NUK KA PËRFUNDUAR, AJO VAZHDON

Sot një ndër problemet e mëdha me konceptin mbi historinë ka të bëjë pikërisht me heqjen e rolit të manifestimit njerëzor si objekt dhe qendër e historisë. Një gjë e tillë shfaqet qartazi në grupet kryesore të mendimit mbi historinë. Grupimi i parë është ai që mbështetet në këndvështrimin ciklik të historisë, i cili bazohet në bindjen se historia ecën në formë rrethore, gjërat

ndodhin në formë gjithashtu rrethore, duke mos pasur një kuptim dhe pa pikë sensi të ngjarjeve. Njeriu nuk ka asnjë rol në ngjarjet dhe kuptimet historike. Grekët e lashtë e mbështetnin këtë ide, por që më vonë e hasim edhe te Niçe, i cili i dha një kuptim modern këtij sensi ciklik të historisë.

Grupimi, i dytë është ai që ka të bëjë me determinizmin historik, bazuar kryesisht mbi teorinë e Hegelit dhe Marksit, të cilët mendonin se historia vihet në lëvizje nga forca jonjerëzore, nga forca ekonomike (shteti absolut), natyrore. Frojdi shkon edhe më tej duke thënë që historia vihet në lëvizje nga erosi.

Të dyja këto pikëpamje mbi historinë kanë të përbashkët përjashtimin e rolit të njeriut si qenie e aftë të përzgjedhë dhe të mbartë përgjegjësi historike (për këtë përzgjedhje). Bazuar në këto pikëpamje, e sidomos mbi pikëpamjen (hegeliane) deterministe të historisë, ndeshim teorinë e “fundit të historisë”, përpunuar nga Francis Fukujama. Është krejt interesant fakti se si lulëzon një ide e tillë brenda konceptit se lëvizjet natyrore, shtetërore, ekonomike, erotike, vetëpërmbushen në epokën tonë brenda një triumfi të kapitalizmit të liberal-demokracive. Me këtë status përcaktimi, Fukujama i jep fund historisë, ku ky triumf përcakton edhe pikën fundore të zhvillimit të njerëzimit, fundin e evolucionit të tij ideologjik. Historia, sipas Fukujamës, mbaron me universalizimin e këtij triumfalizmi determinist, për të gjitha shoqëritë njerëzore.

Nëse qendra e historisë do të përbëhej nga ekonomia, shteti, sigurisht që këto janë koncepte që duhet të kenë një fund. Prandaj edhe fundi i historisë së Fukujamës është i pashmangshëm, për sa kohë ai nuk bazohet në rolin e individit në histori, por në rolin e struk-



Historia nuk ka një fund dhe është infinit nëse ajo ka në qendër manifestimin njerëzor, veprat dhe qëllimet e tij. Në këtë kuptim njeriu është thelbi i historisë dhe qendra e këtij thelbi është liria e tij për të përzgjedhur një veprim historik.



turave ndaj saj. Njeriu është një nocion infinit, kurse strukturat janë nocione fundore. Për këtë arsye historia nuk ka një fund dhe është infinit nëse ajo ka në qendër manifestimin njerëzor, veprat dhe qëllimet e tij. Në këtë kuptim njeriu është thelbi i historisë, dhe qendra e këtij thelbi është liria e tij për të përzgjedhur një veprim historik. Qasja deterministe bën pikërisht të kundërtën: i heq njeriut lirinë e veprimit historik, duke ia kaluar strukturave; e zhvesh atë nga infiniti i tij, duke i dhënë historisë pastaj attribute fundore. Po si mund të gjejmë "të vërtetën historike" nëse i heqim kësaj të vërtete elementin qendror të saj, njeriun? A mund të krijojmë një ide të qartë mbi

ngjarjen historike nëse e kuptojmë vetëm së jashtmi, duke njohur vetëm rolin e shtetit apo ekonomisë si determinuese të historisë? Ku ndodhen veprimi i brendshëm dhe roli i mendimit si përcaktues i këtij veprimi?

Që e vërteta historike të rivendoset, duhet dhe është e nevojshme që historia e shkruar të kalojë përmes një procesi rivlerësimi dhe mbi të gjitha rimoralizimi të domethënies historike të ngjarjeve dhe hapave vendimtarë të saj. Për këtë është e nevojshme që të rritet përkuptimësia e mesazheve të brendshme që vijnë nga historia. E jo vetëm kaq. Është e nevojshme që diafragma e fakteve dhe provave e historike duhet të zgjerohet për një frymëmarrje të natyrshme. ■



MODELI MONOHEROIK SHQIPTAR



PËRBALLË MODELIT POLIHEROIK EUROPIAN





ARDIAN MUHAJ

HEROI I MIRË ME SHOKË SHUMË

Në vitin e parë të studimeve të mia të masterit për histori mesjete në Lisbonë, duke u përpjekur të pasuroj idenë mbi heroin kombëtar përmes njohjes së traditës së heroit kombëtar në një vend të largët si Portugalia, iu vura punës për të ndërtuar një pyetësor që do të më shërbente si bazë fillimisht për një detyrë kursi dhe më pas edhe si tezë masteri. Qëllimi i pyetësorit historiografik ishte të sqaroja një paradoks me të cilin përballësia në përditshmërinë e studimeve të mia. Ky paradoks kishte të bënte me paaftësinë e portugezëve për të përcaktuar qartë heroin e tyre kombëtar. Fillimisht, përpara se të filloja studimet, këtë e shihja si një problem që kishte të bënte me faktin se portugezët të cilët unë pyesja ishin njerëz të thjeshtë dhe papërcaktueshmëria e tyre mund të vinte nga padijenja ose dijenia e pamjaftueshme.

Me vazhdimin e studimeve, sërish, shokët e kursit ma përforconin idenë e paqartësisë që ata kishin për heroin e tyre kombëtar, sepse cilindo që pyesja se kush ishte heroi kombëtar apo figura më e shquar e historisë së vendit të tyre, merrja përgjigje tërësisht të ndryshme. Dikush përmendte një mbret të shekullit XII, dikush një poet të shekullit XVI, dikush tjetër një lundërtar të shekullit XV, tjetërkush një princ të shekullit XV, apo një dukë të shekullit XVII. Nga atë njohuri sa kisha, dy figura ishin të spikatura: mbreti i parë i Portugalisë që kishte jetuar në shekullin XII dhe Henrik Lundërtari, ose inicuesi i zbulimeve gjeografike, që i përkiste shekullit XV. Detyra e kursit dhe më pas teza e masterit, të cilën planifikoja të zhvilloja, synonte pikërisht këtë, matjen e opinionit publik portugez për të zgjedhur figurën e vetme më të madhe të historisë portugeze. Megjithatë plani im i madh u zhbë sa hap e mbyll sytë me t'ia paraqitur idenë e projektit profesorëshës së kursit. Për habinë time ajo as që e kuptonte se çfarë doja të demonstroja apo të provoja me projektin tim. Për të ideja



“A duhet të vazhdojmë të mbetemi te ky model, apo të adoptojmë modelin poliheroik?” është një pyetje që duhet shtruar sot. Tanimë në Shqipëri, për shembull, janë njohur me ligj nëntë pakica kombëtare që, së bashku me shumicën shqiptare, e çojnë në dhjetë numrin e bashkësive etnike. Për fat, asnjëra nga bashkësitë e tjera etnike nuk ka modelin e një hero kombëtar të zyrtarizuar, sepse përndryshe kjo do të sillte në kontradiktën e nderimit të disa heronjve kombëtarë në një vend ku ka vetëm një hero kombëtar. Greqia, Maqedonia, Bosnja, Mali i Zi, Serbia, Bullgaria, komuniteti rom, egjiptian dhe ai arumun nuk e kanë këtë traditë të heroit të vetëm kombëtar. Greqia ka disa figura të shquara që spikasin dhe nderohen më shumë krahas figurash të tjera. Po ashtu, edhe shtetet e tjera fqinje me pakica në Shqipëri. Madje, as Serbia nuk e ka këtë model.

ime për të gjetur heroin apo figurën më të rëndësishme të historisë së Portugalisë nuk kishte pikë kuptimi. Pyetjes se cilin prej dy kandidatëve që kisha përzgjedhur për shqyrtim mendonte se ishte figura më e rëndësishme e historisë së vendit të saj, iu përgjigj se asnjërin nuk e kishte për zemër aq sa ç’kishte për zemër një mbret tjetër të cilit ajo i kishte kushtuar doktoraturën e saj dhe jetën e saj hulumtuese. Aty e kuptova atë që nuk kisha dashur ta kuptoj deri atëherë: kishte popuj që nuk kishin “Një hero kombëtar” dhe portugezët qenkëshin një prej tyre.

MES MODELIT TURK DHE ATIJ EUROPIAN

Kjo çështje vazhdoi të më interesonte dhe, duke e zgjeruar perspektivën, hulumtimi i një çështjeje të tillë më bëri të qartë se në fakt nuk ishin portugezët të pashoq në mesin e popujve europianë, por përkundrazi, ne shqiptarët ishim. Për habi, asnjë popull europian nuk e ka modelin shqiptar të heroit të vetëm kombëtar, apo modelin mono-

Skëndërbeu paraqitet si masakruar dhe genocidues i bashkësive të caktuara fetare, konkretisht i asaj myslimane, gjë e cila, po ashtu, nuk provohet nga të dhënat historike, dhe, përveçse një shtrembërim i plotë i së vërtetës, përbën edhe një akuzë të pavërtetueshme, përveçse me keqinterpretimin e dëshmive të Marin Barletit. Akuzat të tilla të pabaza vijnë në fakt nga pseudohistorianë, por megjithatë kanë gjetur përkrahje ose të paktën miratim dashamirës nga drejtues mediash, gazetarë e intelektualë. Ajo që i bashkon të gjithë, megjithatë, është dëshira për fyerje e akuzat të pabaza që u shkojnë për shtat botëkuptimeve të tyre radikale. Kështu, e njëjta akuzë e bërë nga një “gazetar” turk në Lezhë, para dy vitesh, i cili nga mediat shqiptare u gradua menjëherë në historian, duke e quajtur terrorist, përsëritet edhe në botime me pretendime shkencore nga vetë shqiptarët. Padijenja dhe radikalizmi, kur bashkohen, përbëjnë një përzierje toksike që nuk është e lehtë të treten.

heroik të historisë kombëtare. Po ashtu, për habinë më të madhe, rasti i vetëm i ngjashëm me ne është ai i Turqisë. Pra vetëm Shqipëria dhe Turqia kanë modelin e një heroit të vetëm kombëtar të zyrtarizuar. Të gjithë popujt e tjerë europianë kanë modelin e shumë heronjve apo figurave historike të pazyrtarizuara.

Ka një dallim mes dy konteksteve. Nderimin zyrtar për Ataturkun në dy dekadat e fundit ata e kanë relaksuar. Ne, përkundrazi, vazhdojmë të mbajmë të

njëtin qëndrim zyrtar. Megjithatë duhet theksuar se edhe te ne zërat për një përforcim të këtij modeli unik në Europë, përmes ligjeve që synojnë mbrojtjen e tij të shprehura tek-tuk nuk kanë gjetur mbështetje zyrtare. Pra mbetemi te ngurtësimi i modelit të kahershëm, pa e përforcuar dhe pa e relaksuar atë.


“A duhet të vazhdojmë të mbetemi te ky model, apo të adoptojmë modelin poliheroik?” është një pyetje që duhet shtruar sot. Tanimë në Shqipëri, për shembull, janë njohur me ligj nëntë pakica kombëtare që, së bashku me shumicën shqiptare, e çojnë në dhjetë numrin e bashkësive etnike. Për fat, asnjëra nga bashkësitë e tjera etnike nuk ka modelin e një heroit kombëtar të zyrtarizuar, sepse përndryshe kjo do të sillte në kontradiktën e nderimit të disa heronjve kombëtarë në një vend ku ka vetëm një hero kombëtar. Greqia, Maqedonia, Bosnja, Mali i Zi, Serbia, Bullgaria, komuniteti rom, egjiptian dhe ai arumun nuk e kanë këtë traditë të heroit të vetëm kombëtar. Greqia ka disa figura të shquara që spikasin dhe nderohen më shumë krahas figurash të tjera. Po ashtu, edhe shtetet e tjera fqinje me pakica në Shqipëri. Madje, as Serbia nuk e ka këtë model. Në Mitrovicën veriore serbët nuk vendosën Stefan Dushanin, por princin Lllazar. Pikërisht këtu qëndron edhe arsyeja pse në Kosovë nuk ka aktualisht një model monoheroik sikurse në Shqipëri, sepse aty bashkësitë e ndryshme etnike, sidomos komuniteti serb, ka heronjtë dhe historinë apo versionin e vet historiografik dhe nuk ka ndonjë mundësi që t’u imponohet dhe as ta përvetësojnë modelin shqiptar.

Po të hedhim vështrimin më tutje në Europë, do të gjejmë modele e tradita të ndryshme brenda modelit të madh poliheroik, apo atë të shumë figurave kombëtare të pazyrtaizuara. Vetë BE-ja ka adoptuar modelin jozyrtar amerikan të “etërve themelues” (founding fathers), të cilët deri tani konsiderohen të jenë njëmbëdhjetë. Madje faqja zyrtare e BE-së thekson se numri i tyre është i projektuar për t’u zgjeruar në përputhje me procesin e zhvillimit historik.¹ Franca ka modelin e Panteonit Kombëtar, sipas modelit antik dhe numri i figurave që bëjnë pjesë në këtë panteon shkon me dhjetëra dhe shtohet vazhdimisht. Mes tyre bëjnë pjesë figura të kontributeve e profileve të ndryshme, që nga Volteri e Rusoi, deri te Mari Kyri dhe Andre Malro. Po kështu Spanja nuk ka sesi të ketë modelin monoheroik, kur sipas kushtetutës është e përbërë nga një shumësi popujsh e krahinash autonome duke filluar nga Katalonja, Vendi Bask, Galicia, etj. Ideja që nganjëherë haset në opinionin publik shqiptar sikur spanjollët paskan si hero të tyre kombëtar El Sidin, në fakt, nuk ka asnjë bazë. Figura e El Cid Campeador është e barasvlershme me figurën e Gjergj Elez Alisë në kulturën tonë. El Sidi, ashtu sikurse Gjergj Elez Alia, nuk ka asnjë status zyrtar dhe gjithashtu nuk është objekt hulumtimi i historiografisë, por më shumë i folklorit. Po ashtu edhe Vilhelm Teli, në rastin e Zvicrës, që shpesh citohet si shembull i ngjashëm me Skënderbeun, është i pambështetur. Vilhelm Teli, gjithashtu, futet në kategorinë e heronjve folklorikë, sikur El Sidi dhe Gjergj Elez Alia dhe larg qoftë të ketë ndonjë status zyrtar apo të jetë objekt studimi i historiografisë. Mund të lexosh mijëra faqe e qindra libra mbi historinë mesjetare të Konfederatës Zvicerane në Mesjetë dhe nuk ka mundësi të përmendet as edhe një

herë të vetme Vilhelm Teli. Krahasimi i një figure tërësisht historike, të dokumentuar gjerësisht nga dokumentacioni i kohës, si Skënderbeu, me figura legjendare të folklorit mbase i nderon ato, por padyshim që nuk e vlerëson aspak Skënderbeun.

Për t’u rikthyer në rastin e Turqisë, më 1951 Parlamenti Turk miratoi ligjin që ndalon fyerjen e kujtimit dhe figurës së Ataturkut ose shkatërrimin e objekteve që kanë imazhin e tij. Interpretimi i kufirit jo lehtësisht të dallueshëm mes kritikës dhe fyerjes, ndërkohë, i është lënë në dorë jo prokurorisë, por Ministrisë së Drejtësisë. Një faqe zyrtare është krijuar enkas për denoncimin e faqeve të internetit që thyejnë këtë ligj.² Në vitin 2010, OJQ-ja “Reporterët pa kufi”, me qendër në Francë, e ka kundërshtuar këtë praktikë me argumentin se është në kundërshtim me standardet e BE-së mbi lirinë e shprehjes në mediat.³ Ndërkohë shteti turk është treguar dashamirës për një zbutje dhe rishikim të këtyre çështjeve të cilat nuk kanë të bëjnë vetëm me mbrojtjen e Ataturkut, por edhe me pika të tjera, si çështja armene, ajo kurde, etj.

Në rastin e heroit tonë të vetëm kombëtar, Skënderbeut, nuk vërehet ndonjë prirje e dukshme fyerjeje përmes ofendimit, por, kryesisht, fyerje të tilla vijnë përmes fryrjes dhe shtrembërimit të skajshëm të figurës së tij, që e deformon tërësisht figurën historike, dhe përmes këtij shpërftyrimi total arrihet të paraqitet edhe në botime me pretendime shkencore apo në biseda e takime zyrtare si shkatërrues i atdheut përmes luftës së pandërprerë, gjë e cila nuk provohet nga dokumentacioni autentik. Ky shtrembërim vjen si pasojë e idesë së gabuar se Skënderbeu luftoi për 25 vjet me radhë. Faktet,



përkundrazi, tregojnë se ai më shumë bëri punë sesa luftë, më shumë negocioi sesa luftoi.

Gjithashtu, Skënderbeu paraqitet si masakruer dhe genocidues i bashkësive të caktuara fetare, konkretisht i asaj myslimane, gjë e cila, po ashtu, nuk provohet nga të dhënat historike, dhe, përveçse një shtrembërim i plotë i së vërtetës, përbën edhe një akuzë të pavërtetueshme, përveçse me keqinterpretimin e dëshmive të Marin Barletit. Akuza të tilla të pabaza vijnë në fakt nga pseudohistorianë, por megjithatë kanë gjetur përkrahje ose të paktën miratim dashamirës nga drejtues mediash, gazetarë e intelektualë. Ajo që i bashkon të gjithë, megjithatë,

është dëshira për fyerje e akuza të pabaza që u shkojnë për shtat botëkuptimeve të tyre radikale. Kështu, e njëjta akuzë e bërë nga një “gazetar” turk në Lezhë, para dy vitesh, i cili nga mediat shqiptare u gradua menjëherë në historian, duke e quajtur terrorist, përsëritet edhe në botime me pretendime shkencore nga vetë shqiptarët. Padijenia dhe radikalizmi, kur bashkohen, përbëjnë një përzierje toksike që nuk është e lehtë të treten. Megjithatë, sa për ilustrim, këto akuza i referohen një shtrembërimi flagrant të historisë që pretendon se, gjoja, kur Skënderbeu mbërriti në Krujë në nëntor 1443, masakroi të gjithë popullsinë myslimane të Krujës, numri i së cilës varion sipas oreksit nga

qindra deri në 30 mijë. Vetëm dy fakte të thjeshta e hedhin poshtë tërësisht një pretendim të tillë dhe një akuzë të tillë të pabazë. Së pari, Kruja në vitin 1431 kur u bë regjistrimi apo censusi i popullsisë nga vetë osmanët nuk ka asnjë familje myslimane nga 125 në total të regjistruara në defterin osman.⁴ Pretendimi se mund të ketë ndodhur një islamizim i shpejtë në ato dhjetë vite nga 1431 deri në 1443 bie, po ashtu, poshtë po të kemi parasysh se Kruja edhe në vitin 1431, kur hartohet regjistri osman, kishte tashmë dy dekada që ishte nën sundimin osman, e megjithatë gjatë këtyre dy dekadave asnjë familje nuk rezultoi e islamizuar.⁵

DREJT MODELIT EUROPIAN

Përballë shtrembërimeve të tilla, që gjejnë edhe miratimin oportunist të disa intelektualëve dhe drejtuesve mediatikë, ilaçi më i mirë do të ishte adoptimi i praktikës europiane. Kjo praktikë europiane, në fakt, ka në thelb parimin e thjeshtë të trimit apo të heroit të mirë me shokë shumë dhe që në rrafshin shkencor krijon kushtet dhe mundësinë që figurat historike të këndvështrohen më qartë duke i vendosur ato në nivele krahasimi me figura të ngjashme të së njëjtës periudhë apo të periudhave të ndryshme. Kemi plot figura të historisë sonë të cilat nuk kanë pasur nevojë për asnjë status zyrtar për të qëndruar me veprat e tyre në histori. Ashtu sikurse Ali Pashë Tepelena, Gjon Buzuku, Ismail Qemali, Papa Kristo Negovani, Pjetër Budi, dera e Bushatlinjve, vëllezërit Frashëri, etj., kanë bërë vend në historinë tonë natyrisht, përmes vlerave të tyre, padyshim që edhe Skënderbeu do të qëndronte në mesin e tyre me veprat e veta të vërte-




Kjo praktikë europiane, në fakt, ka në thelb parimin e thjeshtë të trimit apo të heroit të mirë me shokë shumë dhe që në rrafshin shkencor krijon kushtet dhe mundësinë që figurat historike të këndvështrohen më qartë duke i vendosur ato në nivele krahasimi me figura të ngjashme të së njëjtës periudhë apo të periudhave të ndryshme.

tuara e të dokumentuara, pa ia pasur nevojën as shtrembërimeve pseudohistorike, as burokracisë zyrtare. Përderisa edhe vetë Turqia po e rishikon modelin e vet për t'ia përshtatur zhvillimeve e prirjeve europiane, nuk ka arsye që vetëm ne të qëndrojmë larg shembullit të mbarë popujve europianë.

- 1 https://europa.eu/european-union/about-eu/history/founding-fathers_en.
- 2 ihbarweb.org
- 3 rsf.org/en/news/time-break-out-legislative-straitjacket-stifling-media-freedom.
- 4 Defteri i Sancak-i Arvanid, botuar më 1954 nga Halil Inalcik, e jeppopullsinë të totalit të Krujës në rreth 700 vetë. Në vitin 1415 tashmë për mendet sundimtarosman Amur Beu: "Amor bechoturcho domino Croye"-ASV-Sen. Mist. LI/43v, 4 korrik 1415.

ROLI I TEKNOKRATËVE NË TRANZICIONIN E SË DREJTËS





Tranzicioni i së drejtës ushqehet nga pushteti politik, por më pas konfigurohet nga pushteti i teknokratëve. Shpesh **beteja midis cilësisë së moralit të politikës së ditës dhe moralit të teknokratit janë vijat përcaktuese të suksesit të tranzicionit ligjor.**



FABIAN ZHILLA

“

Menjëherë pasi komunistët morën pushtetin, Bashkimi Sovjetik lançoi të ashtuquajturën “Politika e Re Ekonomike” në vitin 1921. **Shteti sovjetik i periudhës leniniste adoptoi menjëherë kodet (civile dhe penale) dhe një sistem ligjor të ngjashëm me sistemet juridike civile evropiane.** Sipas së drejtës tregtare të kohës lejohej e drejta private dhe hapja e shoqërive tregtare. **Por, me marrjen e pushtetit nga Stalini, Bashkimi Sovjetik kaloi tërësisht në një sistem të centralizuar.**

SHQIPËRISË POSTKOMUNISTE IU DESH TË PËRBALLEJ me shumë sfida gjatë tranzicioneve të ndryshme politike që mbas Luftës së Dytë Botërore. Ndër më të dhimbshmet prej tyre është tranzicioni që kaloi dhe po kalon ndërtimi i shtetit ligjor edhe sot. Duhet cilësuar që në krye të herës se kalimet nga një sistem ligjor në tjetrin duhet domosdoshmërisht të shoqërohen me tranzicione të mendimit politik të elitës drejtuese ose të atij segmenti shoqëror i cili orienton dhe drejton këtë tranzicionin ligjor. Ndërsa mendimi politik është ai që plazmon dëshirën e shoqërisë për të ndryshuar sistemin juridik, tranzicioni i së drejtës është më pas një proces teknokratik. Tranzicioni i së drejtës

ushqehet nga pushteti politik, por më pas konfigurohet nga pushteti i teknokratëve. Shpesh beteja midis cilësisë së moralit të politikës së ditës dhe moralit të teknokratit janë vijat përcaktuese të suksesit të tranzicionit ligjor. Jo pa qëllim, në përgjithësi, analizat që lidhen me tranzicionet e sistemeve politike vuajnë nga limitimi i fokusit në ekografinë e mendimit dhe aksionit politik të elitave drejtuese. Sidoqoftë, ndryshimet politike të Evropës Lindore pas rënies së murit të Berlinit dhe luftërat që shoqëruan Ballkanin Perëndimor pas viteve '90-të risollën edhe njëherë vëmendjen e studiuesve në format dhe pasojat e tranzicionit të shtetit ligjor. Këto studime riorientuan edhe njëherë debatin mbi atë se tranzicionet politike janë më shumë komplekse sesa duken. Se zgjerimi i kufijve politikë të demokracive liberale në Evropën Lindore nuk ishte fundi i sistemeve totalitare, sipas Fukajamës, por vetëm fillimi i transformimit të autoritarizmit në një kompleksitet ligjesh dhe institucionesh ligjore, të cilat vetëm sa vështirësonin ngritjen e shteteve ligjore sipas modelit perëndimor. Keqpërdorimi i teknokratëve të sofistikuar, të cilët do të përdornin dijen e tyre për të manipuluar të “drejtën” duke e fshehur atë në terminologjitë komplekse dhe ligjet difektoze, ishte shumë i nevojshëm. Sidoqoftë, fare pak punime kanë sqaruar në mënyrë shteruese sesi sistemet diktatoriale arritën të legjitimohen dhe sesi u arrit tranzicioni i tyre nga sisteme jototalitare në sisteme diktatoriale. Cili



ishte roli i teknokratëve në këtë tranzicion?

Në kontekstin e pyetjeve të mësipërme, qëllimi i këtij shkrimi nuk është të analizojë tranzicionin ligjor pas rënies së komunizmit, përkundrazi, të bëjë një shikim sipërfaqësor mbi rolin e teknokratëve që legjitimuan diktaturat komuniste gjatë tranzicionit ligjor të tyre nga sistemet monarkike. Nëpërmjet një qasjeje kritike, shkrimi hedh dritë mbi disa juristë të spikatur të periudhës leniniste dhe staliniste në Bashkimin Sovjetik, si dhe mbi disa ju-

ristë të njohur shqiptarë që spikatën gjatë periudhës komuniste në Shqipëri. Duhet cilësuar se studime të këtij lloji për rastin shqiptar janë shumë të limituara dhe konstatimet e këtij shkrimi duhen kuptuar në këtë kontekst. Një ndër objektivat kryesorë të këtij artikulli është të hapë debatin në një terren të patrajtuar deri më tani nga studiues shqiptarë. Por dhe në literaturën ndërkombëtare të tranzicionit ligjor është folur fare pak për fenomenin e tranzicionit ligjor nga sistemet monarkike në



ato komuniste gjatë viteve. Ky punim ndahet në tre pjesë kryesore. Në pjesën e parë trajtohet se çfarë kuptohet teorikisht me tranzicion të së drejtës dhe për ndikimin e teknokratëve në këtë proces. Në pjesën e dytë, shkrimi fokusohet te disa juristë të spikatur në Bashkimin Sovietik, të cilët kishin një ndikim të ndryshëm në tranzicionin ligjor. Në pjesën e fundit shkrimi bën një vështrim të përgjithshëm të dy juristë shqiptarë të edukuar në universitete perëndimore dhe mënyrën sesi ata u për-

poqën të ruajnë një farë ekuilibri midis anës profesionale dhe asaj politike.

Studimet mbi tranzicionet e së drejtës (transitional justice) u zhvilluan mbas viteve 1990 dhe morën hov kryesisht nga konfliktet e asaj periudhe, sidomos nga luftërat në ish-Jugosllloavi. Sipas David Crocker janë të paktën tetë objektiva të cilat studimet mbi tranzicionin e së drejtës synojnë të arrijnë: e para është “e vërteta”, reformat ligjore, viktimizimi, përgjegjshmëria, dënimi etj. Sidoqoftë,



“ Ende sot disa nga punimet e Andrea Nathanailit janë referencë e së “Drejtës civile” në Shkollën e Magjistraturës. **Është e vështirë të kuptosh rolin frenues apo “solistikues” që këta juristë kanë luajtur gjatë viteve më të ashpra të regjimit komunist.** Ndonëse për rolin e juristëve në tranzicionin politik të shtetit bolshevik ka studime të shumëllojshme dhe serioze, kjo nuk ndodh me rastin shqiptar.

sot akoma nuk ka një teorizim të qartë të “tranzicionit të së drejtës” (transitional justice) në lidhje me rolin që kanë luajtur teknokratë të ndryshëm dhe përgjegjësinë e tyre në forcimin apo dobësimin e fuqisë shkatërruese të regjimeve totalitare. Studimet që lidhen me këto tematika janë orientuar kryesisht te pasojat dhe konfigurimet e deformatuara të shtetit ligjor që kanë sjellë ligjet në tranzicion. Në përgjithësi, debati është ndërtuar në raste studimore të pas viteve '90. Kjo

ka sjellë vështirësi në ndërtimin e një “lakmushi teorik”, i cili do të ndihmonte shpjegimin e problematikës që shoqëron shoqërinë gjatë tranzicionit të së drejtës nga regjimet totalitare në ato demokratike, pasi vetë periudhat historike të marra në analizë janë kufizuar kryesisht vetëm në ngjarjet e 28 viteve të fundit.

Në këtë punim do të hedhim dritë mbi një tematikë pak ose aspak të trajtuar në studimet që lidhen me tranzicionin e së drejtës. Në mënyrë të përgjithshme do të nënvizohet roli i rëndësishëm që kanë pasur teknokratë të njohur të ligjit për të mbrojtur parimet e së drejtës ose për t'i manipuluar ato. Rasti më tipik është kalimi nga qeverisja leniniste në atë staliniste në Bashkimin Sovjetik.

Menjëherë pasi komunistët morën

ZËVENDËSIMI

Pas daljes graduale të juristëve të edukuar në perëndim nga rolet parësore, të cilët u keqpërdorën apo u vunë në shërbim të shtetit komunist në fillimet e tij, siç është rasti i Bilbil Klosit, më pas u vazhdua me formimin e një plejadë juristësh, si Aranit Çela, të cilët do të legjitimonin haptazi pas asnjë gjuhë lakonike makinën dehumanizuese të sistemit diktatorial. Kjo kategori juristësh është një tjetër tipologji teknokratësh që, gjithashtu, meriton të studiohet më në thellësi. Pra, nëse në gjyqet speciale të famshme trupa gjyquese përbëhej në 80% të saj nga individë që nuk kishin asnjë lidhje me ligjin si rasti i Bedri Spahiut, më pas ata u zëvendësuan me juristë të shkolluar kryesisht në Bashkimin Sovjetik. Nëse në Bashkimin Sovjetik Stalini do të përdorte mendjen diabolike, por profesionale të Vishinski për gjyqet speciale, në Shqipërinë komuniste kjo u bë fare brutalisht nga njerëz me arsim fare minimal ose pa arsim fare.

pushtetin, Bashkimi Sovjetik lançoi të ashtuquajturën “Politika e Re Ekonomike” në vitin 1921. Shteti sovjetik i periudhës leniniste adoptoi menjëherë kodet (civile dhe penale) dhe një sistem ligjor të ngjashëm me sistemet juridike civile evropiane. Sipas së drejtës tregtare të kohës lejohej e drejta private dhe hapja e shoqërive tregtare. Por, me marrjen e pushtetit nga Stalini, Bashkimi Sovjetik kaloi tërësisht në një sistem të centralizuar. Çdo pronë u shtetëzua dhe u krijua sistemi kooperativist (kolkozet). Ndër tranzicionet ligjore më të njohura të kohës ishte kalimi nga Kushtetuta Sovjetike e vitit 1924 në të ashtuquajturën Kushtetutën Staliniste të 1936. Kjo kushtetutë u konsiderua si triumfi i Stalinit për kinse frymën më të avancuar liberale që solli për shkak të disa ndryshimeve, si p.sh. kalimin nga votimi hapur në votim i fshehtë, nga zgjedhje të tërthorta në zgjedhje të drejtpërdrejta,

përfshirjen e të drejtës së besimit, si dhe mbrojtjen e të drejtës së shprehjes. Megjithatë, sipas historianit të njohur të Bashkimit Sovjetik, Leonard Shapiros, këto veprime ishin të gjitha propagandë dhe tregonin nivelin e lartë të konfidencës që kishte shteti stalinist si rezultat i kontrollit të hekurt në çdo qelizë të shoqërisë sovjetike. Peter Solomon nënvizon paradoksin bolshevik në lidhje me konceptimin e rolit të ligjit në shoqëri që udhëhoqi dhe shtetin stalinist. Nëse ligji ishte parë nga Marksi si një instrument i elitës borgjeze për të kontrolluar shoqërinë, po e njëjta qasje u ndërmor edhe nga bolshevikët të cilët e konsideronin ligjin dhe sistemin gjyqësor si mekanizma kontrollues të proletariatit. Roli i teknikienëve të politizuar ishte i domosdoshëm në ndërtimin e shtetit të ri socialist. Ndër ta do të spikasnin një numër juristësh, të përkthyer madje edhe në literaturën juridike komuniste shqiptare, si: Vishinski, Perlov, Vasiliev,



Karleva, Fedkin, Smirnov etj. Sidoqoftë, disa juristë me frymë më liberale, si Peter Stuchka, që do të cekim më poshtë, nuk figurojnë në listën e referencave akademike të literaturës juridike shqiptare gjatë periudhës komuniste.

Në periudhën leniniste juristi më i spikatur do të ishte Peter Stuchka. Ky i fundit do të argumentonte, në favor të Leninit, nga pikëpamja juridike zhvillimin e së drejtës publike, dhe jo thjesht zgjerimin e së drejtës penale. Sipas Stuchka-s kalimi nga sistemi kapitalist në atë socialist kërkon një ligj proletar për të mirëqeverisur institucionet publike. Lenini nënvizonte se ligji proletar duhet të jetë i thjeshtë dhe i kuptueshëm nga masat, larg burokracive, pasi ai do të jetë në shërbim të tij dhe në funksion të socializmit, paçka se kjo nuk a arrit kurrë. Peter Stuchka më vonë do të ishte edhe Kryetari i Gjykatës Supreme së Federatës Socialiste Ruse, e cila më pas u njoh si Bashkimi Sovjetik. Stuchka

karakterizohej nga një frymë më liberale dhe profesionale. Ai ishte ndër ata juristë i cili, jo pak herë, denoncoi shkeljet ligjore të ndjekura në proceset gjyqësore të mbajtura ndaj “kulakëve”. Ai, gjithashtu, argumentonte se sistemi gjyqësor adversarial nuk është një “institutcion borgjez”, por një arritje e shoqërisë njerëzore, e cila meriton të mbrohet. Sidoqoftë, Stuchka nuk arriti të shmange kufizimin që iu bë të drejtës së të pandehurit për t’u mbrojtur sipas versionit të propozuar nga Nikolai Krylenko të Kodit të Procedurës Penale i cili u votua nga Pleniumi i Federatës Socialiste Ruse në vitin 1928. Është për t’u cilësuar se, paçka se në periudhën leniniste legjislacioni ishte deri diku shumë më kufizues në gërmë se ai stalinist, më pas, roli i disa juristëve profesionistë, si Stuchka, do të minimizonte deri diku fuqinë represive të shtetit bolshevik në shkelje të parimeve universale të së drejtës.

Në të kundërt, në letër, siç u cek më



sipër, e ashtuquajtura “Kushtetuta Staliniste” ishte më liberale në dukje, por filozofia e së drejtës që udhëhiqte mendimin e juristëve stalinistë ishte shumë më e politizuar dhe krejtësisht e indoktrinuar. Ai që njihet si “truri juridik” i Stalinit ishte juristi Andrei Vyshinsky (shqipëruar si Andrei Vishinski). Paradoxialisht, Vishinski e ka filluar jetën e tij politike si socialdemokrat (menshevik). Madje, njihet edhe si juristi që firmosi urdhrin e arrestit të Leninit në vitin 1915. Është njohur me Stalinin në burg në vitin 1908 dhe i është bashkëngjitur bolshevikëve në vitin 1920. Pasi filloi punën si profesor i së drejtës në Universitetin e Moskës, ai do të bëhej kryetar i Kolekiumit të Juristëve të Moskës në vitin 1922. Vishinski ishte “arkitekti i ambalazhimit” të shkeljeve

të parimeve të së drejtës nëpërmjet argumentimeve të tij të mprehta juridike. Si kryeprokuror, Vishinski, ishte gjithashtu përpiluesi në prapaskenë i vendimeve gjyqësore për tri gjyqet e famshme të Stalinit kundër kundërshtarëve të tij, të ashtuquajturave trockistë, midis viteve 1936 dhe 1938. Pra Vishinski jo vetëm që ka marrë pjesë aktive në përpilimin e ligjeve dhe ka luajtur një rol kyç në ndjekjet penale ndaj kundërshtarëve politikë të Stalinit, por ka ndikuar fuqishëm edhe në të drejtën penale sovjetike, e drejtë e cila pati ndikim në të gjitha shtetet e bllokut komunist të kohës.

Shqipëria do të ishte një kopje e keqe staliniste e shtetit ligjor dhe kjo nuk është çudi duke pasur parasysh se Stalini ishte idhulli politik i Enver Hoxhës. Kushtetuta shqiptare e vitit 1950

TRANSFORMIMI

Ndryshimet politike të Evropës Lindore pas rënies së murit të Berlinit dhe luftërat që shoqëruan Ballkanin Perëndimor pas viteve '90-të risollën edhe njëherë vëmendjen e studiuesve në format dhe pasojat e tranzicionit të shtetit ligjor. Këto studime riorientuan edhe njëherë debatin mbi atë se tranzicionet politike janë më shumë komplekse sesa duken. Se zgjerimi i kufijve politikë të demokracive liberale në Evropën Lindore nuk ishte fundi i sistemeve totalitare, sipas Fukajamës, por vetëm fillimi i transformimit të autoritarizmit në një kompleksitet ligjesh dhe institucionesh ligjore, të cilat vetëm sa vështirësonin ngritjen e shteteve ligjore sipas modelit perëndimor. Keqpërdorimi i teknokratëve të sofistikuar, të cilët do të përdornin dijen e tyre për të manipuluar të “drejtën” duke e fshehur atë në terminologjitë komplekse dhe ligjet difektoze, ishte shumë i nevojshëm.

ishte pothuajse identike me kushtetutën staliniste të vitit 1936. Edhe në kushtetutën shqiptare kishte një kapitull të veçantë për “Mbrojtjen e të drejtave dhe detyrave të shtetasve”, ku garantohej barazia para ligjit, mosdiskriminimi për shkaqe “origjine, pozite, pasurie, ose shkalle kulture” (neni 14). Garantohej liria e besimit, si dhe e drejta e shprehjes, e organizimit dhe e manifestimit publik (nenet 18 dhe 20). Gjithashtu në nenin 22 çdo shtetasi i garantohej liria për t’u mbrojtur, masa e paraburgimit jo më shumë se 3 ditë dhe e drejta se çdo dënim duhet të jepej vetëm në bazë të ligjit dhe nga gjykata kompetente. Megjithatë, një vit mbas miratimit të kësaj kushtetute ndodhi procesi i famshëm, i njohur si ai i “Bombës në Ambasadën Sovjetike”, ku u ekzekutuan pa gjyq rreth 22 intelektualë të njohur. Ky proces ishte në shkelje flagrante të legjislacionit të kohës. Si mbase në asnjë rast tjetër më pas, gjykata ka përpiluar vendimin pasi është kryer dënimi me vdekje.

Nga juristët shqiptarë më të spikatur të kohës nga pikëpamja profesionale do të veçonim Manol Konomit dhe Andrea Nathanailin. Të dy të arsimuar në uni-

versitete perëndimore dhe me një përgatitje juridike të admirueshme. Edhe sot, në rrethet e juristëve ata kujtohen si juristë të cilët bënë diferencën në krahasim me bashkëkohësit e tyre. Ende sot disa nga punimet e Andrea Nathanailit janë referencë e së “Drejtës civile” në Shkollën e Magistraturës. Është e vështirë të kuptosh rolin frenues apo “sofistikues” që këta juristë kanë luajtur gjatë viteve më të ashpra të regjimit komunist. Ndonëse për rolin e juristëve në tranzicionin politik të shtetit bolshevik ka studime të shumëllojshme dhe serioze, kjo nuk ndodh me rastin shqiptar. Vetë formati i këtij artikulli nuk lejon hapësirën e nevojshme dhe do të ishte jokorrekte nga pikëpamja intelektuale qasja kritike ndaj rolit të kësaj kategorie juristësh në përdhosjen apo mbrojtjen e parimeve të së drejtës gjatë qeverisjes komuniste. Duke pasur parasysh rolin e tyre në pozicione të larta ekzekutive, por dhe akademike, do të ishte me shumë interes që kjo tematikë të zhvillohej larg ngarkesave emocionale dhe ideologjike. Nga një vështrim shumë i përciptë i jetës së Manol Konomit nuk del shumë i qartë roli i tij. Ky i fundit kishte përfunduar studimet në Tuluzë të Francës dhe kryer doktoraturën

në Peruxhia, Itali. Konomi jep dorëheqjen nga Ministër i Drejtësisë pasi e drejtoi atë nga viti 1944 deri në vitin 1951. Sipas disa copëza kujtimesh të tij të botuara në media, arsyeja që e ka shtyrë atë të japë dorëheqjen ishin ankesat që i vinin kur ishte Ministër Drejtësie, të cilat tregonin shkelje të vazhdueshme të ligjit dhe këto në dijeni të Enver Hoxhës. E vërteta është se që pas dorëheqjes Manol Konomi ruajti një profil më shumë akademik duke drejtuar Akademinë e Shkencave dhe duke punuar si jurist i Presidiumit Popullor. Konomi do të ishte dhe anëtar i Gjykatës Kushtetuese 1992-1997. Po të lexojmë disa artikuj të këtyre dy juristëve në numrat e parë të revistës juridike të kohës “Drejtësia Popullore” do të vëmë re gjuhën lakonike që ata përdorin. Për shembull, ndërsa Konomi shprehet me nota shumë kritike për rolin neutral që regjimet reaksionare (perëndimore) i kanë dhënë gjyqtarit, apo dhe instrumen-

talizmin e ligjit nga klasat sunduese, nga ana tjetër shprehet në favor të mbrojtjes së gjyqtarëve ekzistues nga regjimi i ri komunist edhe pse ata gjyqtarë “nuk morën pjesë në revolucion”. Vihet re në fakt një arsyetim shumë i sofistikuar për kohën, i cili i jep më shumë përparësi rolit të gjyqtarit në regjimet popullore në krahasim me rolin e gjyqtarit në regjimin juridik “të vjetër”. Madje gjuha kritike e përdorur është mjaft cinike. Nga ana tjetër, Nathanailli bën një interpretim shumë interesant të ligjit nr. 61, datë 17 maj 1945, mbi abrogimin e dispozitave ligjore të promlugarara gjatë pushtimit fashist dhe nazist dhe për vlerën e dispozitave ligjore që ishin në fuqi para datës 7 prill 1939. Ai i mëshon faktit se dënimet penale dhe administrative të dhëna jo për motive politike gjatë periudhës së shtetit të Zogut duhet të qëndrojnë deri sa nuk bien në kundërshtim me legjislacionin e shtetit të ri, por, nga ana tjetër, e cilëson këtë fuqi juridike si “relative”, e cila mbetet e paqartë dhe duket më shumë si një “artificë” juridike e tij. Nathanailli vijon duke u shprehur se nëse normat juridike të regjimit të vjetër do të miratoheshin pjesërisht ose plotësisht, ato do të bëheshin pjesë e rendit të ri juridik. Ato norma juridike ishin antipopullore dhe ishin të lidhura me sistemin e vjetër duke vdekur bashkë me të. Nathanailli propozon që normat e vjetra juridike të shërbejnë si

“ Termi “tranzicioni i së drejtës” duhet ta shtrijë gamën e studimeve të tij edhe te “tranzicioni kapaciteteve njerëzore” në fushën e reformave juridike. **Për ta lexuar mirë të tashmen do të na duhet të njohim mirë të shkuarën dhe ta studiojmë atë me një qasje kritike, kjo edhe në rastin e tranzicionit të së drejtës.**

TRANSFORMIMI

eksperiencë për gjykatat e shtetit të ri nga pikëpamja procedurale, por jo të jenë pjesë e së drejtës pozitive. Nga ana tjetër, Nathanaili mbështet parimin e gjësë së gjykuar, sipas të cilit kjo mund të aplikohet te çështjet civile.

Pas daljes graduale të juristëve të edukuar në perëndim nga rolet parësore, të cilët u keqpërdorën apo u vunë në shërbim të shtetit komunist në fillimet e tij, siç është rasti i Bilbil Klosit, më pas u vazhdua me formimin e një plejadë juristësh, si Aranit Çela, të cilët do të legjitimonin haptazi pas asnjë gjuhë lakonike makinën dehumanizuese të sistemit diktatorial. Kjo kategori juristësh është një tjetër tipologji teknokratësh që, gjithashtu, meriton të studiohet më në thellësi. Pra, nëse në gjyqet speciale të famshme trupa gjyquese përbëhej në 80% të saj nga individë që nuk kishin asnjë lidhje me ligjin si rasti i Bedri Spahiut, më pas ata u zëvendësuan me juristë të shkolluar kryesisht në Bashkimin Sovjetik. Nëse në Bashkimin Sovjetik Stalini do të përdorte mendjen diabolike, por profesionale të Vishinskit për gjyqet speciale, në Shqipërinë komuniste kjo u bë fare brutalisht nga njerëz me arsim fare minimal ose pa arsim fare.

Në përfundim, historia e tranzicionit ligjor nga sisteme demokratike në ato totalitare tregon se roli e teknokratëve në këtë proces ka qenë i ndërlikuar. Për këtë arsye kjo tematikë meri-

Historia e tranzicionit ligjor nga sisteme demokratike në ato totalitare tregon se roli e teknokratëve në këtë proces ka qenë i ndërlikuar. Për këtë arsye kjo tematikë meriton t'i kthehet një debati serioz akademik, pasi do t'i shërbente reformave të herëpashershme juridike të shoqërive në tranzicion, ku përfshihet dhe Shqipëria. Rasti i Bashkimi Sovjetik, kryesisht, por dhe ai shqiptar, tregojnë se përdorimi i këtyre teknokratëve ka sjellë në jo pak raste fshehjen dhe mbrojtjen e krimeve të komunizmit pas gjuhës së sofistikuar të ligjit.

ton t'i kthehet një debati serioz akademik, pasi do t'i shërbente reformave të herëpashershme juridike të shoqërive në tranzicion, ku përfshihet dhe Shqipëria. Rasti i Bashkimi Sovjetik, kryesisht, por dhe ai shqiptar, tregojnë se përdorimi i këtyre teknokratëve ka sjellë në jo pak raste fshehjen dhe mbrojtjen e krimeve të komunizmit pas gjuhës së sofistikuar të ligjit. Ky lloj sofistikimi është edhe një nga arsyet që shumë aparatçikë të sistemit të djeshëm vazhduan të kishin funksione të rëndësishme edhe pas ndryshimit të sistemit. Ky artikull nënvizon se termi “tranzicioni i së drejtës” duhet ta shtrijë gamën e studimeve të tij edhe te “tranzicioni kapaciteteve njerëzore” në fushën e reformave juridike. Për ta lexuar mirë të tashmen do të na duhet të njohim mirë të shkuarën dhe ta studiojmë atë me një qasje kritike, kjo edhe në rastin e tranzicionit të së drejtës.





MITET DHE REALITETI I URREJTJES

“Përvoja e shpirtit është
domethënia e vërtetë e mitit”
Erich Fromm



AGIM BAÇI

...SHKOLLA IME E FILLO-RES mbante emrin e një dëshmori të vrarë në vitin 1949. Thusaje të gjithë e dinin se shkak i vrasjes së tij ishte ngacmimi i një gruaje të martuar... Për regjimin e kohës një përfaqësues i pushtetit nuk mund të ishte i pamoralshëm, ndaj u zgjodh të shpallej dëshmor. Shkolla ku të mësohej ABC-ja mori emrin e tij dhe i gjithë fshati duhet t'i shprehte nderimet. Për ne të vegjlit e asaj kohe ishte krejt e pakuptueshme ajo nënqeshje e gjyshërve kur vinte 5 Maji e ku ne duhet të dërgonim lule e të qëndronim me grushtin lart për të nderuar heroin që "sakrifikoi" për atdheun... Sot, shkolla nuk mban më atë emër, por për "heroin"ende historia nuk është rishkruar....

...Prifti i fshatit Bizë shpëtoi burrat e të gjitha fshatrave të zonës së Ishmit që ushtria

gjermane kishte vendosur t'i pushkatonte. Prifti, zotërues i disa gjuhëve, mes të cilave edhe gjermanisht, hyri garant dhe gjermanët i lanë të lirë. I gjithë komuniteti i zonës, shumica muslimanë, i ishin mirënjohës dhe e vazhdojnë ta tregojnë me admirim atë histori edhe sot e kësaj dite duke e konsideruar priftin një hero dhe mik të komunitetit. Për historiografinë dhe ideologjinë e diktaturës prifti s'mund të ishte njeri i mirë e aq më tepër shpëtimtari i gjithë atyre njerëzve që nuk i përkisnin as të fesë së tij, ndaj ia njohu çetës partizane lirin e atyre burrave. Në atë zonë ka edhe sot e kësaj dite lapidarë për anëtarët e çetës partizane e asnjë pllakë në nderim të priftit.

...Merita për marrjen e betejës së Tiranës pas vitit 1944, ishte veçanërisht e Dali Ndreut, i cili që nga 18 gushti 1944 drejtoi Korparmatën I të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë (i pari dhe më i madhi i formacioneve ushtarake deri atëherë). Dokumentet e botuara pas vitit '90 e konfirmojnë atë si njeriun që ishte në krye të korparmatës I, që drejtoi veprimet e njësiteve luftarake të shumta për çlirimin e Tiranës, njëherazi edhe të Lezhës dhe të Shkodrës. Pas shpalljes së tij armik dhe pas pushkatimit të tij në vitin 1956, së bashku me bashkëshorten shtatzënë, Liri Gega, e gjithë

“ Dhe në 28 vjet ndryshimi të sistemit politik në Shqipëri, duket se ka qenë një luks rishkrimi i historisë sonë, e shkuara dhe sotmja, pasi **ideologjia e dikurshme mbetet ende shumë e fortë në shumicën e atyre që e kanë shkruar apo konsumuar historinë**, por sidomos mbeten të forta mitet mbi ngjarjet dhe heronjtë.

merita për çlirimin e Tiranës iu dha Mehmet Shehut. Dhe pas (vet)vrasjes së Shehut më 18 dhjetor 1981, merita e luftimeve në Tiranë iu njoh Hysni Kapos, i cili nuk kishte qenë fare në ato ditë në Tiranë...

Ka shumë histori të tilla në të shkuarën tonë që ende jetojnë në qytete e fshatra gati të patrazuara, duke vijuar jetën mes gjuhës së përditshme dhe historive që u rrëfejme fëmijëve, pa vënë re se vijojmë të transmetojmë atë që përputhej me ideologjinë e kohës kur u ndërtuan të tilla mite. Dhe në 28 vjet ndryshimi të sistemit politik në Shqipëri, duket se ka qenë një luks rishkrimi i historisë sonë, e shkuara dhe sotmja, pasi ideologjia e dikurshme mbetet ende shumë e fortë në shumicën e atyre që e kanë shkruar apo konsumuar historinë, por sidomos mbeten të forta mitet mbi ngjarjet dhe heronjtë. Mjafton të shohësh në përditshmëri debate mes njerëzve apo emisione me batutat e filmave që prodhoi Kinostudioja deri në vitin 1990. Për një ilustrim të vogël të fuqisë së mitologjisë komuniste mjafton të marrim shprehjen që u vjen rëndom shumë shqiptarëve: “këto janë kinezërira”- që thuhet për diçka që shkon keq, edhe pse Kina rreshtohet ndër vendet më të forta dhe më të zhvilluara të botës. Kjo vjen nga miti i qëllimshëm komu-





nist mbi projektet e Kinës në Shqipëri pas vitit 1978 kur u prishën marrëdhëniet diplomatike, edhe pse shumica e ayre projekteve nuk ishte as e gabuar e as jashtë kohës që u ndërtuan.

Parimisht duket se nuk janë pak vitet ndoshta për të shkruar apo rishkruar të paktën atë që ka ndodhur prej afro pesëdhjetë

vjetësh nën diktaturë, e më pas edhe në shekuj të mëparshëm. Por ndoshta janë shumë pak kohë për të shëruar atë urrejtje që ka pushtuar atë pjesë të njerëzve që kanë besuar tek ajo ideologji, tek ato histori. Dyert e mendimit shqiptar për disa dekada kanë qenë të mbyllura për gjithçka tjetër jashtë ideologjisë së

NOSTALGJIA

Kjo nostalgji apo ndjenjë që fshihet pas nostalgjisë mund të ketë vetëm një shpjegim - urrejtjen! Vetëm kjo ndjesi irracionale dhe shkatërruese mund të jetë vaditësja e madhe e nostalgjisë për atë të shkuar, pa përfillur asnjë të vërtetë që thuhet për të, asnjë fakt sado kriminal që të ketë qenë. Dhe kjo shpjegohet qartësisht për shkak se orientimi në liri, edhe pas çlirimit nga burgu i ideologjisë, është tepër i vështirë. Edhe më i vështirë bëhet kur konsumatori i atyre mitologjive ideologjike ka qenë një njeri që ka humbur atë pushtet të falur nga regjimi vetëm e vetëm nga aftësia e tyre dehumane për të shërbyer kundër së vërtetës dhe për të justifikuar çdo lloj krimi. Pra, është një urrejtje që bazohet te pafuqia për të harruar të shkuarën, për të harruar marrëdhënien e ngushtë me krimin. Një perversitet që mban të lidhur mijëra të dashuruar të atij sistemi, që në fund të diktaturës nuk kishin më asnjë ideal, por vetëm krime, edhe pse në fillimet e veta folën për ideale dhe për barazi.

kohës. Ndërkohë, ata që janë marrë me këta “çelësa historikë” pas ndryshimit të sistemit politik kanë qenë ose sërish shkruar, ose rojtarë të mbrojtjes së versioneve historike dhe mitologjike të ndërnuara gjatë komunizmit, sidomos të atyre historive dhe mitologjive të ndërnuara pas prishjes së kishave dhe xhami-

ave, ku humbi dhe busulla e rëndësishme e orientimit shpirtëror për veten, tjetrin dhe botën. Madje, ata të cilët e kishin ngritur mitin e Europës dhe SHBA-ve si gogolin e popujve, u kthyen në flamurtarë të integritit të menjëhershëm në “familjen e madhe evropiane ku na takon të jemi si një popull i lashtë i këtij kontinenti”.

Po përse vijon të jetë kaq e fuqishme kjo nostalgji ndaj asaj të shkuare të mbushur plot vrasje e denatytime? Me se mund të lidhet dëshira për të mbajtur në këmbë atë të shkuar, edhe kur kanë dalë fakte të pafundme lidhur me gënjeshtat e montuara apo me heronj të rremë që ende mbushin librat e historisë?

Kjo nostalgji apo ndjenjë që fshihet pas nostalgjisë mund të ketë vetëm një shpjegim - urrejtjen! Vetëm kjo ndjesi irracionale dhe shkatërruese mund të

jetë vaditësja e madhe e nostalgjisë për atë të shkuar, pa përfillur asnjë të vërtetë që thuhet për të, asnjë fakt sado kriminal që të ketë qenë. Dhe kjo shpjegohet qartësisht për shkak se orientimi në liri, edhe pas çlirimit nga burgu i ideologjisë, është tepër i vështirë. Edhe më i vështirë bëhet kur konsumatori i atyre mitologjive ideologjike ka qenë një njeri që ka humbur atë pushtet të falur nga regjimi vetëm e vetëm nga aftësia e tyre dehumane për të shërbyer kundër së vërtetës dhe për të justifikuar çdo lloj krimi. Pra, është një urrejtje që bazohet te pafuqia për të harruar të shkuarën, për të harruar marrëdhënien e ngushtë me krimin. Një peversitet që mban të lidhur mijëra të dashuruar të atij sistemi, që në fund të diktaturës nuk kishin më asnjë ideal, por vetëm krime, edhe pse në fillimet e veta folën për ideale dhe për barazi. “Kushdo që mendon se regjimet komuniste të Europës Qendrore ishin vepër ekskluzivisht e

kriminelëve, nuk kupton një të vërtetë thelbësore: regjimet kriminale nuk u krijuan nga kriminelë, por nga entuziastë, të bindur se kishin zbuluar të vetmen rrugë për në parajsë. Ata e mbrojtën me aq vendosmëri atë rrugë, sa u detyruan të vrisnin shumë njerëz. Më pas u bë e qartë se nuk ekzistonte asnjë parajsë dhe se entuziastët ishin vrasës”, shkruan Milan Kundera lidhur me të shkuarën komuniste, duke dhënë ndoshta një nga prognozatat më kuptimplote se përse shumë nga ata që trashëguan ideologjinë dhe frymën e atij pushteti e kanë shumë të rëndësishme të ruajnë mitet e asaj së shkuare.

PO PSE I BESOJNË ENDE?

Ideologjia e miteve të rrejshme komuniste synonte ndrydhjen, skllavërimin dhe rrëgjimin e vetive njerëzore. Kultura masive e drejtuar nga bindja shkakton një dehumanizim të thellë e, për pasojë, manipulimi është lehtësisht i arritshëm. Miti i ideologjisë së pushtetit në diktaturë ushqen pasues që udhëhiqen nga mendjengushtësia, besimi i verbër ndaj asaj që i thuhet nga institucionet, vetëmashtrimi dhe vesi i urrejtjes së tjetrit. Të gjithë këto janë baza psikologjike që nostalgjia për atë kohë të jetë e fortë, pasi një njeri i rritur dhe edukuar mbi dehumanizimin e thellë që pasoi shoqëritë ish-komuniste nuk përfill faktet, por atë që i është thënë dhe ushqyer nga

“ Dhe në 28 vjet ndryshimi të sistemit politik në Shqipëri, duket se ka qenë një luks rishkrimi i historisë sonë, e shkuara dhe sotmja, pasi **ideologjia e dikurshme mbetet ende shumë e fortë në shumicën e atyre që e kanë shkruar apo konsumuar historinë**, por sidomos mbeten të forta mitet mbi ngjarjet dhe heronjtë.



kultura e urrejtjes ndaj dijes dhe ndaj besimit. Me gjithë faktet e shumta të botuara lidhur me të vërteta krejtësisht të ndryshme nga historitë që tregonte sistemi i asaj kohe, nuk është mundur të shuhet ende dashuria dhe respekti për udhëheqjen e asj kohe. Në mbrojtje të miteve të tilla nuk dalin individë të pashkolluar, por edhe historianë që kanë marrë pjesë në shkrimin e historisë. Dhe kjo do të ndodhë të paktën për aq kohë sa idhujtarët e asaj kohe, që u brumosën me mitologjitë e ideologjisë së kohës

mbi luftën, do të jenë ende në botë, të palëkundur për të mos pyetur nëse ishte e vërtetë apo e gënjeshtërt. “Të vërtetat mitologjike kanë jetuar në ato shoqëri që kanë besuar tek ato”, shkruan sociologu i njohur Emile Durkheim në librin e tij “Leksione sociologjike”. Sipas Durkheim krijimet mitologjike kanë disa lidhje me realitetin dhe ky realitet s’është gjë tjetër veçse shoqëria që shpreh vetveten nëpërmjet gjërave që ka arritur të transformojë dhe të shpërftyrojë gjatë periudhës së dehumanizimit.



Ndaj diktatura vuri në dispozicion të historianëve dhe shkrimtarëve gjithçka që të krijohej “historia epepe”, “diktatura e proletariatit” apo “Shqipëria, shkëmb graniti”, duke devijuar thuajse shumicën e fakteve të para vitit 1944. Kinostudio më pas, e dirigjuar nga të njëjtë ideologë, përhapte me shpejtësi gënjeshtërën e fabrikuar, ndërkohë që

“ Në mbrojtje të miteve të tilla nuk dalin individë të pashkolluar, por edhe historianë që kanë marrë pjesë në shkrimin e historisë. Dhe kjo do të ndodhë të paktën për aq kohë sa **idhujtarët e asaj kohe, që u brumosën me mitologjitë e ideologjisë së kohës mbi luftën, do të jenë ende në botë, të palëkundur për të mos pyetur nëse ishte e vërtetë apo e gënjeshtërt.**

historia zëvendësohej me mitet komuniste mbi të shkuarën e bijve të saj.

Shumëkush me të drejtë mund të pyesë se përse sot ende kanë shumë fuqi ato mite kur mijëra dokumente kanë dalë duke vërtetuar të kundërtën e asaj që është thënë për gati pesëdhjetë vite? Po kështu, si mund të shpërfillen qindra dëshmi të ish-të burgosurve, kundërshtarë të regjimit, që kanë dhënë një fytyrë krejt tjetër të asaj që flitej e shkruhej në teskte, dokumentarë e filma?

Por, në një nxitim të braktisjes së miteve të vjetra, siç e konsideron Roland Barthes shkrimin e historisë dhe mitologjisë në kohë konsumi, brezat kërkojnë të krijojnë mite të prekshme, të krahasueshme. Në këtë kohë konsumi fabrikuesit e djeshëm kanë vijuar të ruajnë nostalgjinë përmes lojës së pranimit të gjysmë të vërtetave, duke u justifikuar gjithnjë me shprehjen perverse “ashtu ishte koha”, a thua se nuk ishin ata vetë “krijuesit e asaj kohe”. Një

GJYSMË TË VËRTETAT

Në këtë kohë konsumi fabrikuesit e djeshëm kanë vijuar të ruajnë nostalgjinë përmes lojës së pranimit të gjysmë të vërtetave, duke u justifikuar gjithnjë me shprehjen perverse “ashtu ishte koha”, a thua se nuk ishin ata vetë “krijuesit e asaj kohe”. Një nga mitet që trashëgojmë është ai i idesë se populli merr pjesë në qeverisje. Aq i lakmueshëm është ky mit, sa, edhe pse prej shumë kohësh është vërtetuar se vetëm për popullin nuk shqetësoheshin ish-drejtuesit e diktaturës, sërish ai ka mbetur eposndjellës, duke u kthyer në versionin e mitit modern se “po dëgjohet zëri i qytetarëve”. Të tillë mbështetës janë përgjithësisht ata që fatkeqësisht as nuk janë përpjekur kurrë të emigrojnë as shpirtërisht nga ajo skëterrë që vijon të mbajë dritat ndezur për ata që e shohin lirinë si rrëmbyesen e privilegjeve të tyre.

nga mitet që trashëgojmë është ai i idesë se populli merr pjesë në qeverisje. Aq i lakmueshëm është ky mit, sa, edhe pse prej shumë kohësh është vërtetuar se vetëm për popullin nuk shqetësoheshin ish-drejtuesit e diktaturës, sërish ai ka mbetur eposndjellës, duke u kthyer në versionin e mitit modern se “po dëgjohet zëri i qytetarëve”. Të tillë mbështetës janë përgjithësisht ata që fatkeqësisht as nuk janë përpjekur kurrë të emigrojnë as shpirtërisht nga ajo skëterrë që vijon të mbajë dritat ndezur për ata që e shohin lirinë si rrëmbyesen e privilegjeve të tyre.

SHTREMBËRIMI I HISTORIGRAFISË ARBËRESHE

“Sajimet, falsifikimet, rindërtimet e sheqerosura të së shkuarës e kanë shoqëruar historinë e njerëzimit dhe shpesh e kanë përgjakur atë: mjafton të sjellin ndërmend arsenalin simbolik të diktaturave të mëdha të shekullit XX”, shkruan në hyrje të librit të tij “Mitet e historigrafisë arbëreshe” studiuesi arbëresh, Prof. Matteo Mandala. Përmes titullit

“Mundus vult decipi” (bota ka qejf të gënjëhet) që përfshin saktësisht këtë lojë të shumë popujve europianë për të ndërtuar të shkuarën përmes miteve që shpesh nuk kanë asnjë bazë, Mandala përshkruan përpjekjen mitologjike, pa asnjë bazë historike të arbëreshëve, për të dhënë vetveten pasardhës të pellazgëve hyjnorë të Homerit. Ai nuk synon të çmitizojë, por thjesht të çmontojë historinë e ngritur mbi mitet e gënjeshtërtë. Fjala është më së pari për dy dokumente të lëshuara në emër të mbretit të Aragonës, Johanit II, të datuara më 18 tetor 1467 dhe të botuara nga Zef Skiroi në librin “Canti tradicionalit albanesi”. Skiroi i mori nga kuria episkopate e Horës së Arbëreshëve. Por këto letra nuk u gjendën në arkivin e mbretit Johan II pas kërkimit të profesor Farnescos Giunta në vitin 1989. Letrat, sipas studimit të Profesor Mandalasë, rezultojnë të sajuara për shkaqe të tjera, duke përbërë një mashtrim historik. Por, sipas studiuesit, dy letrat kishin qenë një busull morale, madje detyrim moral, për të gjithë ata që shkruanin lidhur

GJYSMË TË VËRTETAT

Mandala përshkruan përpjekjen mitologjike, pa asnjë bazë historike të arbëreshëve, për të dhënë vetveten pasardhës të pellazgëve hyjnorë të Homerit. Ai nuk synon të çmitizojë, por thjesht të çmontojë historinë e ngritur mbi mitet e gënjeshtërtë. Fjala është më së pari për dy dokumente të lëshuara në emër të mbretit të Aragonës, Johanit II, të datuara më 18 tetor 1467 dhe të botuara nga Zef Skiroi në librin “Canti tradicional albanesi”. Skiroi i mori nga kuria episkopate e Horës së Arbëreshëve. Por këto letra nuk u gjenden në arkivën e mbretit Johan II pas kërkimit të profesor Farncesco Giunta në vitin 1989. Letrat, sipas studimit të Profesor Mandalasë, rezultojnë të sajuara për shkaqe të tjera, duke përbërë një mashtrim historik. Por, sipas studiuesit, dy letrat kishin qenë një busull morale, madje detyrim moral.

me arbrit e larguar menjëherë pas vdekjes së princit të tyre, Skënderbeut, drejt mbretit të Napolit. Dhe për të nuk ka qenë aspak e lehtë të publikojë këtë mashtrim të vjetër, pasi rezistenca për ta mbajtur ende mitin e këtij komunikimi ka qenë e madhe.

Çudia e mospranimin të gënjeshtërsisë së vjetër zmadhohet përpara nesh për faktin se bëhet fjalë për një minoritet kulturor që ka qenë i hapur, që ka qenë në një vend ku askush nuk e ka ndalur debatin dhe gjetjen e dokumenteve apo verifikimin e atyre që sugjeroheshin. Ajo që mund të pyesim pas librit të rëndësishëm të Mandalasë, është fakti se sa gënjeshtër kemi thurur në Shqipëri në bashkëpunim me historinë e falsifikuar të arbëreshëve? Sepse, në mungesë dokumentesh në Shqipëri, për 3-4 shekuj dëshmitë vijnë nga ar-

bëreshët, nga historia e tyre. Dhe në Shqipëri mitet e tyre nuk janë përdorur për një mbijetesë kulturore, siç i kanë përdorur arbëreshët, por në shërbim ideologjik të diktaturës. Kjo mënyrë e ndryshme e përdorimit të miteve qoftë për qëndrimet heroike, për marrëdhënien me pushtuesit e ndryshëm që kanë kaluar shekuj e shekuj, mbetet për t'u parë, edhe pse besojmë se rezistenca e pranimin nga ata që i kanë përdorur e keqpërdorur do të jetë e madhe, ashtu siç ka ndodhur edhe më studimin e Mandalasë që mjeshtërisht solli përpara lexuesit një studim të parrëzueshëm nga ana metodike dhe një leksion i kurajës për të kërkuar rrënjët e së vërtetës edhe kur ajo mund të na thyjë një besim të gjatë ndaj një të shkuare historike dhe kulturore.



PO A I BËN MASHTRIMI I HERËPASHERSHËM TË DËMSHËM MITET?

Për të shkuar në këtë pikë, më së pari vlen të pyesim: Cila është më e fuqishme, e vërteta e asaj që duam apo e vërteta e asaj që ndodh? Ajo që duam është e vërteta potenciale. Ajo që ndodh është e vërteta faktike. Por në ç'raport qëndrojnë brenda nesh këto dy të vërteta? A e lëkund, pra a e mposht ajo që ndodh atë që duam, meqenëse ajo që ndodh

mbetet më e prekshme mes njerëzve? Realiteti, ajo që prekim, ajo që dyshojmë, ajo që hetojmë, ajo që na zgjon e na vë në gjumë, ka vetëm një rival- aftësinë për të menduar se si të mundesh që gjithçka që ke përreth ta ndërtohet sipas asaj që të bën ty të jesh atje ku dëshiron. "Shoqëria shpreh vetveten nëpërmjet gjërave që ka arritur të transformojë dhe të shpërftyrojë realitetin. Ja përse me përfaqësimet me formën e një miti figura të ndryshme bëhen qenie që janë në gjendje të shprehin ndjenja

njerëzore” shkruante Emile Durkheim në librin Leksione sociologjike (Plejad, Tiranë, 2004). Mitet janë përvojë shpirtërore, sipas Frommit. E nëse janë kështu, atëherë ato përputhen shpesh me dëshirën për t'u vetëgënjyer, sepse një vetëgënjim i tillë na mban gjallë en-

drren, të cilën besojmë se mund t'ia arrijmë, nëse ende do të vrapojmë pas saj. Miti na bën që të ngrihemi e të nxitojmë drejt asaj që duam – sidomos asaj që ëndërruam. Kjo pamje i jep miteve fytyrë poetike, optimiste, entuziashte. Por për sa kohë? Këtu mund të na ndihmojë vetëm Don Kishoti që, për të mundur pjesën e vet ëndërrimtare merr me vete Sanço Pançon, që t'ia tregojë realitetin krejt të pastër, pas asnjë ngjyrë optimizmi dhe vetëm përmes pragmatizmit.

Ndërkohë, miti ka aleat dëshirat e përhershme njerëzore, sidomos anët e pashmangshme të jetës njerëzore, që lidhen me dashurinë, epshin, pushtetin dhe ëndërrimin për të besuar në një fund heroik. Frojdi, në shpjegimin e tij mbi mitet, shprehej se, nëse “Edipi mbret” është në gjendje të tronditë njeriun modern ashtu sikurse ka tronditur bashkëkohësit e vet grekë, kjo do të thotë se aspekti i tragjedisë greke nuk është në kontrastin mes fatit dhe vullnetit, por te natyra e veçantë e materies ku shfaqet ky kontrast. Pra, për Frojdin, miti e ka forcën e vet te ajo që është e brendshme dhe njerëzore, dhe e mundshme që të përsëritet, për shkak se brenda qenieve njerëzore ka gjithnjë udhë që na lidhin me kohën e që na thërrasin drejt asaj që është shkruar shumë kohë më parë për ne.

Pra, mundet të themi se historia dhe mitet do ta kenë gjithnjë peshën për të na tronditur. Por është shumë e rëndësishme të hetojmë që pas rishkrimeve të historisë apo interpretimeve të reja të miteve të mos fshihen ideologji, të cilat pasi kërkojnë të ndërtojnë një të shkuar tjetër, apo që kërkojnë të fshehin të vërteta të mëdha, mbjellin edhe krimin e pashërueshëm të urrejtjes që vijon ende të mbajë me forcë gënjeshtrenë e ndërtuar në të shkuarën.



“Ndërkohë, miti ka aleat dëshirat e përhershme njerëzore, sidomos anët e pashmangshme të jetës njerëzore, që lidhen me dashurinë, epshin, pushtetin dhe ëndërrimin për të besuar në një fund heroik.

Frojdi, në shpjegimin e tij mbi mitet, shprehej se, nëse “Edipi mbret” është në gjendje të trondisë njeriun modern ashtu sikurse ka tronditur bashkëkohësit e vet grekë, kjo do të thotë se aspekti i tragjedisë greke nuk është në kontrastin mes fatit dhe vullnetit, por te natyra e veçantë e materies ku shfaqet ky kontrast.



#Icebreaker */First of it's kind in the hospitality market of Tirana/*

+355 (0) 422 112 21



info@plazatirana.com



www.plazatirana.com



THE
PLAZA
TIRANA

Excellence redefined.